



ISSN 2413-1334



# Policimi dhe **SIGURIA**

Nr. 7  
SHTATOR  
2017

Revistë periodike shkencore  
Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2017



**POLICIMI DHE SIGURIA**  
**AKADEMIA E SIGURISË**

Policimi  
dhe **SIGURIA**

BOTIM PERIODIK  
Botuar nga Akademia e Sigurisë, Tiranë

NR 7  
SHTATOR  
2017

**Copyright © - Akademia e Sigurisë, Tiranë.**

Të gjitha të drejtat e botimit dhe ribotimit janë të Akademisë së Sigurisë. Asnjë material nuk mund të riprodhohet, kopjohet, ripublikohet, modifikohet, shpërndalet apo shitet në asnjë mënyrë, i plotë apo pjesë të tij në formë elektronike apo në letër, pa autorizimin e shkruar të Akademisë së Sigurisë. Përdorimi i materialeve të kësaj reviste, pa autorizim, përbën shkelje penale të të drejtave të autorit.

Akademia e Sigurisë zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Policinë e Shtetit dhe Arsimin e lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike. Pikëpamjet e shprehura në revistën "Policimi dhe Siguria", janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Akademisë së Sigurisë. Autorët e publikimeve në revistën "Policimi dhe Siguria" gëzojnë liri të plotë akademike, me kushtin e vetëm që kur shkruajnë, ata të zbatojnë të gjithë legjislativin përkatës si të komunikimit edhe atë profesional, i cili nuk cenon të drejtat e ndryshme.



**Botues**  
AKADEMIA E SIGURISË  
Rruga e Elbasanit, Sauk, Tiranë

---

NR **7**  
SHTATOR  
2017

## **BORDI EDITORIAL**

### **Kryetari i Bordit**

Dr. Xhavit SHALA

### **Anëtarët e Bordit**

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO

Prof. Dr. Ismet ELEZI

Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI

Prof. Dr. Giovanni ARCUDI

Prof. Dr. Sebastiano TAFARO

Prof. Asc. Dr. Pandeli TAÇI

Prof. Asc. Dr. Snezana MOJSOSKA

Prof. Asc. Dr. Bejtush GASHI

Prof. Asc. Dr. Ferdinand ELEZI

Prof. Asc. Dr. Fatmir TARTALE

Dr. Frank HARRIS

### **Redaktor shkencor**

Albert HITOALIAJ

### **Përkthyes**

Vangjel LILI

Lavdim KAZAZI

### **Punimet grafike**

Andi OSMANI

### **Realizimi teknik**

Qendra Kërkimore Shkencore,  
Akademia e Sigurisë

Revista shkencore "**Policimi dhe Siguria**", botohet nga "Qendra Kërkimore Shkencore" e Akademisë së Sigurisë, me qëllim përmbushjen e standardeve më të larta në veprimtarinë kërkimore-shkencore në aktivitetin e Akademisë së Sigurisë.

---

P È R M B A J T J A

---

1. **Dr. Sandër LLESHI, Dr. Xhavit SHALA**  
Parandalimi i kultivimit, kyçi i suksesit antikanabis. .... 8
  2. **MSc. Nikoll RICA, MSc. Erand RICA**  
Parandalimi i krimit mjedisor, si përgjegjësi e policisë gjyqësore. .... 32
  3. **MSc. Besnik SHEHAJ**  
Shërbimi i motoçikletave në Policinë e Shtetit. .... 47
  4. **Dr. Xhavit SHALA , MSc. Gledis NANO**  
Ekstremizmi i dhunshëm dhe ISIS, rrezik dhe kërcënim për sigurinë ... 58
  5. **MSc. Dashmir ÇALI**  
Teknologjia e informacionit dhe Policia e Shtetit. .... 73
  6. **Prof. Asc. Dr. Stavri SINJARI**  
Sër Robert Pil, krijues i policisë moderne .. .... 96
  7. **MSc. Anisa AGASTRA**  
Krimet virtuale psikologjike: rasti “balena blu”. .... 108
  8. **MSc. Qetësor GURRA, MSc. Jonida GURRA**  
Mbrojtja ndërkombëtare e pronësisë intelektuale. .... 116
  9. **Prof. Asc. Dr. Qetsor ORHAN, Prof. Asc. Dr. Edmond BRANESHI**  
Organizatat si sisteme të mësuari - domosdoshmëri për sukses. .... 130
- Abstraktet në anglisht / Abstracts** ..... 140







**POLICIMI DHE SIGURIA**  
**AKADEMIA E SIGURISË**

# Parandalimi i kultivimit, kyçi i suksesit antikanabis



■ **Dr. Sandër LLESHI**  
Këshilltar i Kryeministrit për Sigurinë



■ **Dr. Xhavit SHALA**  
Drejtori i QKSH, Akademia e Sigurisë

## Abstrakt

*Objekti i studimit dhe i hulumtimit në këtë punim, është trajtimi për periudhën 1992-2016, i dukurisë së kultivimit të kanabisit, si një aktivitet kriminal i penalizuar nga legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar, me potencialet e kthimit në një kërcënim për sigurinë kombëtare, i dinamikës dhe trendit të përhapjes së kësaj dukurie në vendin tonë, i faktorëve që kanë ndikuar në lindjen dhe përhapjen e tij, i veçorive të luftës së deritanishme kundër kësaj dukurie, me qëllim identifikimin e metodologjisë më të mirë dhe dhënien e rekomandimeve për hartimin e politikave që garantojnë suksesin e luftës ndaj kultivimit të kanabisit.*

*Kultivimi i kanabisit ka qenë dhe mbetet një sfidë serioze për strukturat e shtetit shqiptar. Kultivimi i kësaj bime si dukuri, u bë i njohur në Shqipëri zyrtarisht në vitin 1993. Më pas, si një epidemi e rrezikshme, u përhap me shpejtësi pothuajse në të gjithë vendin. Heqja dorë, - ndër vite, - nga puna parandaluese për kultivimin e kanabisit, mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional, lënia e përgjegjësive të kësaj lufte vetëm Policisë së Shtetit si dhe mungesa e bashkëpunimit me komunitetin në zonat e kultivimit, ka kufizuar, në vite, suksesin e agjencive ligjzbatuese në luftën ndaj kësaj dukurie. Operacioni policor për marrjen nën kontroll të zonës së Lazaratit, në qershor 2014, ka ndikuar pozitivisht në rivendosjen e autoritetit të shtetit edhe në atë pjesë të territorit që ishte nën kontrollin e rrjeteve kriminale të kultivimit dhe trafikimit të kanabisit.*

*Në këtë punim ne do të fokusohemi kryesisht tek dukuria e kultivimi të kanabisit, pasi, sukcesi në këtë fazë, përcakton dhe dinamikën e luftës ndaj trafikimit të tij. Gjatë këtij punimi janë aplikuar metodat dhe instrumentet bazë kërkimore shkencore, sasiore dhe cilësore, si metoda e analizës dhe sintezës, analizës krahasuese, ajo historike, juridike, e krahasimit dhe konfrontimit si dhe ajo e studimit të rastit. Në përfundim të punimit, pas aplikimit të metodave dhe instrumenteve bazë kërkimore shkencore, konkludohet, ndërmjet të tjerave se, vetëm një strategji që konsideron sukses parandalimin e mbjelljes së kanabisit si kriter optimal ose shkatërrimin kur ato janë ende fidanë, si kriter i pranueshëm do të jetë kyçi i suksesit antikanabis. Punimi përmbillet me përfundimet, prognozën për të ardhmen e këtij fenomeni si dhe rekomandimet për hartimin e politikave që garantojnë suksesin e luftës ndaj kultivimit të kanabisit.*

## Fjalëkyçe:

**cannabis sativa, kultivim, bimë narkotike, penalizim, siguri kombëtare, marljuanë, strategji antikanabis, plan veprimi.**

## 1. Hyrje

Thuajse i gjithë territori shqiptar mund të klasifikohet si “zonë e përshtatshme për kultivim” kanabisi, nisur nga karakteristikat e tij si: kushtet klimaterike, elementet përbërës të tokës ku mund të kultivohet; të fluksit të dritës së diellit, e përshtatshme për biosintezën apo reaksionet biokimike që kalon bima deri në fazën e prodhimit të saj si dhe mundësia e sigurimit të burimeve ujore. Përhapja e kësaj dukurie pas vitit 1995 dhe sidomos, tolerimi i rrezikshëm dhe “licencimi i heshtur”, i aktivitetit të kultivimit të hapur të kanabisit në komunën e Lazaratit, të qarkut Gjirokastrë, krijoi kushte të favorshme për grupet kriminale, të cilat, për më shumë se një dekadë, arritën të konsolidojnë financat, rrjetet, tregjet, specialistët dhe lidhjet politike. Modeli negativ i krijuar në Lazarat ndikoi shumë, jo vetëm në fuqizimin e shumanshëm të grupeve dhe rrjeteve kriminale, por edhe në inkurajimin e kultivimit të kanabisit në rajone të tjera të vendit, si dhe në përkeqësimin e imazhit ndërkombëtar të Shqipërisë<sup>1</sup>. Rritja e kultivimit me këto ritme, rrezikonte ta kthente territorin shqiptar nga një “zonë e përshtatshme për kultivim”, në një “zonë prodhimi” të kanabisit, pra në një vend, ku prodhimi i tij ndikon në çmimet e tregut ndërkombëtar të drogave si dhe, në përcaktimin e ndërtimit e linjave ndërkombëtare të këtij trafiku.

Por, si ka qenë dinamika e kultivimit dhe trendi i përhapjes së kësaj dukurie në vendin tonë? Cilët janë faktorët që kanë ndikuar në lindjen dhe përhapjen e tij? Cilat

<sup>1</sup> *Plani i veprimit kundër kultivimit të bimëve narkotike 2017-2020*, miratuar me VKM Nr. Nr. 248, datë 29.3.2017. Publikuar në Fletore Zyrtare Nr. 65, datë 30 mars 2017, f. 36-44.

janë veçoritë që kanë kufizuar suksesin në luftën e deritanishme kundër kësaj dukurie dhe, cila është metodologjia më e mirë që garanton suksesin e luftës ndaj kultivimit të kanabisit? Këto dhe çështje të tjera të rëndësishme që lidhen me kultivimin dhe luftën kundër kanabisit, do të trajtohen në vijim të këtij punimi.

## 2. Dinamika e kultivimit dhe e përhapjes së fenomenit të kultivimit të kanabisit

Sipas informacioneve të komunitetit shqiptar të inteligjencës, që në vitet 1991-1992, shtetas grekë kanë ardhur në Shqipëri dhe kanë studiuar disa zona të përshtatshme në Tiranë e Lezhë për kultivimin e kanabisit, duke e kamufluar këtë para specialistëve shqiptarë të bujqësisë si bimë medicinale si dhe duke iu dhënë siguri për vjeljen e blerjen e prodhimit. Gjithashtu, po në këtë periudhë, shtetas të ndryshëm kanë sjellë farëra të kësaj bime nga Greqia, duke mundësuar fillimin e kultivimit të saj fillimisht në rrethet Sarandë, Delvinë dhe Gjirokastrë.

Të dhënat statistikore, tabelore dhe grafike, të përhapjes së kultivimit të bimëve narkotike sipas viteve, numrit të fshatrave, rasteve të konstatuara, bimëve të asgjësuara dhe personave të penalizuar për periudhën 1993-2004 paraqiten si më poshtë<sup>2</sup> në tabelën nr. 1 dhe grafikët nr. 1 dhe nr. 2:

Tabela nr. 1


Vepra penale	VITI	SHTRIRJA NË RRETHE	NUMRI I RASTEVE	NUMRI I BIMËVE TË ASGJËSUARA	AUTORË TË PENALIZUAR
Kultivimi i bimëve narkotike	1993	-	14	-	14
	1994	-	46	-	46
	1995	24	110	167417	110
	1996	30	69	346968	69
	1997	4	13	807	13
	1998	10	325	58577	314
	1999	11	219	91267	218
	2000	13	374	256398	374
	2001	8	112	276803	112
	2002	6	138	484958	56
	2003	5	111	168298	6
	2004	-	155	73757	79

Lleshi, S. dhe Shala, Xh. « Parandalimi i kultivimit, kyçi i suksesit antikanabis »

Policimi dhe Siguria nr.7, 2017


<sup>2</sup> Xhavit Shala: *Between anticannabis and cannabis politics*. Qendra Shqiptare e Studimeve për Sigurinë Kombëtare. Tiranë 2005, f. 76. (Të dhënat statistikore janë konfirmuar dhe nga Shërbimi Qendror i Luftës Kundër Drogës.)

### Rastet e evidentuara dhe autorët e penalizuar për kultivim të cannabisit për periudhën 1993 - 2004



Grafiku nr. 1

### Numri i bimëve narkotike cannabis të asgjësuar në vitet 1995 - 2004



Grafiku nr. 2

Nga analiza e të dhënave statistikore, tabelore dhe grafike (tabela nr. 1 dhe grafikët nr. 1 dhe nr. 2) gjejmë se:

- Kjo dukuri filloi të evidentohet që nga viti vitit 1993, kohë kur janë regjistruar dhe dokumentuar nga strukturat policore rastet e para të kultivimi të kanabisit. Përhapja lidhet si me vendosjen e kontakteve me organizime të ndryshme të huaja kriminale, ashtu dhe me joshjen nga të ardhurat e mëdha që ofronte ky aktivitet.

- Në vitin 1994 janë trefishuar rastet e evidentuara të kultivimit si dhe personat e ndjekur penalisht.

- Në vitin 1995, dukuria e kultivimit të kanabisit masivizohet dhe arriti një shtrirje në 24 rrethe të vendit në gjithsej 259 fshatra<sup>3</sup>.

- Në vitin 1996 shtrirja e kultivimit vazhdoi përhapjen në 30 rrethe dhe numri i bimëve të asgjësuar është rreth dy herë më shumë se në vitin 1995.

Lleshi, S.  
dhe

Shala, Xh.

« Parandalimi i kultivimit, kyçi i suksesit antikanabis »

Policimi dhe Siguria nr.7, 2017

- Në vitin 1997, si pasojë e dobësisë së strukturave antikrim, numri i bimëve narkotike të asgjësuar dhe i personave të penalizuar për kryerjen e kësaj vepre penale, ka qenë në nivelet më të ulëta se në të gjithë vitet. Gjithashtu, në këtë vit nuk ka pasur evidencim të saktë të shtrirjes së kultivimit të bimëve narkotike.

- Në vitet 1998-2002, numri i rretheve ku ka pasur kultivim të bimëve narkotike ka qenë më i kufizuar (10-13), ndërkohë, që numri i rasteve të konstatuara, i personave të penalizuar për kryerjen e kësaj vepre penale dhe numri i bimëve të asgjësuar, ka ardhur në rritje. Në kufizimin e përhapjes, në këtë periudhë, ka ndikuar edhe krijimi i Shërbimit Qendror të Luftës Kundër Drogës, si strukturë e specializuar policore për luftë më të organizuar kundër këtij fenomeni.

- Viti 2002 shënon nivelin më të lartë, për këtë periudhë analizuese, për numrin e bimëve narkotike të evidencuara dhe të asgjësuar nga policia.


- Viti 2003 shënon fillimin e rënies së tendencës së kultivimit të bimëve narkotike në vendin tonë. Në këtë vit u evidencuan dhe u asgjësuan 2,8 herë më pak bimë narkotike se në vitin 2002.

- Viti 2004 shënon shifrën më të ulët, deri në atë kohë, të bimëve narkotike të asgjësuar (duke mos përfshirë këtu, kultivimin e lirë në Lazarat).

- Shifrat e analizuar për periudhën 1998-2004 nuk përmbajnë të dhënat për kultivimin e bimëve narkotike në zonën e Lazaratit, pasi ajo zonë ishte jashtë kontrollit të agjencive shqiptare të zbatimit të ligjit<sup>4</sup>.

Ndërkohë, sasia e nënprodukteve të kanabisit të sekuestruar në Itali,<sup>5</sup> të trafikuar nga Shqipëria, për vitet 1996-2000, të kësaj periudhe studimore (shih grafikun nr. 3), është disa herë më e madhe se ajo e sekuestruar në Shqipëri. Kjo tregon për një kërkesë në rritje të tregut italian për marihuanën e ardhur nga Shqipëria, si dhe për mosvlerësimin sa e si duhet, të luftës kundër fenomenit të kanabisit, nga ana e autoriteteve shqiptare. Kështu, në vitin 1996, sasia e kanabisit të sekuestruar në Itali, në kilogramë, është 2444 herë më e madhe se në Shqipëri. Në vitin 1997, kjo sasi e sekuestruar në Itali, është 14.8 herë më e madhe se në Shqipëri; në vitin 1998, është 4.8 herë më e madhe; në vitin 1999, 2.8 herë më e madhe; ndërsa në vitin 2000, sasia e nënprodukteve të kanabisit të sekuestruar në Itali, është dy herë më e madhe se sasia e sekuestruar në Shqipëri.

Grafiku nr. 3



Lleshi, S.  
dhe  
Shala, Xh.  
« Parandalimi  
i kultivimit,  
kyçi i suksesit  
antiknabis »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr. 7, 2017

<sup>3</sup> Informacion Nr. 3894/1, datë 20.8.1995, i Zëvendësministrit të Punëve të Brendshme, drejtuar Presidentit, Kryeministrit dhe Ministrit të Brendshëm. Fondi Nr. 146, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë. "Informacione mbi drogën, trafikun e zhvilluar dhe luftën kundër saj". Dosje nr. 4. Viti 1995. Faqe 15-16.

<sup>4</sup> LAZARAT, Albania (Reuters) 12 shtator 2006: *Shumë diell, ujë, varfëri, anarki dhe kodra të vështira për t'u arritur e kthyen Shqipërinë postkomuniste në një nga eksportuesit më të mëdhenj të kanabisit në Evropë.* Lazarati ka qenë në qendër të kësaj tregtie dhe, për shumë vite, ka qenë zonë e ndaluar për policinë shqiptare. Në vitin 2004 fshatarët qëlluan një helikopter që zbulonte drogën, ndërsa përpiqej të fotografonte fushat me marihuanë


<sup>5</sup> Të dhënat e DSCA (Shërbimi Antidrogë i Policisë Italiane) janë publikuar në faqen e tyre zyrtare.

Të dhënat statistikore, tabelore dhe grafike, të përhapjes së kultivimit të kanabisit sipas viteve, numrit të rasteve të evidentuara e të zbuluara, numrit të bimëve të asgjësuara si dhe të autorëve, për periudhën 2005-2016<sup>6</sup>, paraqiten si më poshtë, në tabelën nr. 2 dhe grafikët nr. 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8.

Tabela nr. 2

Vepra penale	VITI	NUMRI I RASTEVE	ZBULUAR	NUMRI I BIMËVE	AUTORË	ARRESTUAR	GJENDJE TË LIRË	KËRKIM
Kultivimi i bimëve narkotike	2005	458	226 (53%)	332186	227	31	181(79.7)	15
	2006	145	56 (38.6%)	74052	84	44	31(36.9%)	9
	2007	271	73(26.9%)	177074	84	44	31(36.9%)	9
	2008	360	124(34.4%)	145175	129	41	71(55%)	17
	2009	280	47(16.7%)	125292	52	37	9(17%)	6
	2010	178	60 (33.7%)	37216	79	52	13(25%)	14
	2011	89	55 (30%)	21267	79	47	19(24%)	13
	2012	168	100(59.5%)	76185	113	94	9(7.9%)	10
	2013	239	86 (35%)	98491	96	60	16(16.6%)	20
	2014	570	164(27.7%)	551414	204	105	37(18.1%)	62
	2015	1198	382(31.8%)	797422	553	402	48(8.6%)	103
	2016	1671	285(17%)	2536288	444	276	51(11.4%)	117

Grafiku nr. 3




Lleshi, S.  
dhe  
Shala, Xh.  
«Parandalimi  
i kultivimit,  
kyçi i suksesit  
antikanabis»

<sup>6</sup> Të dhënat statistikore për periudhën 2005-2013 janë marrë në Shërbimin Qendror të Luftës Kundër Drogës. Të dhënat statistikore për periudhën 2014-2016 janë nga Plani i Veprimit Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit, miratuar nga Këshilli i Ministrave me VKM Nr. Nr. 248, datë 29.3.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 65. Shtojca 2, tabela nr. 1. Faqe 3678. Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare. Tiranë 2017.


Grafiku nr. 4

Numri i rasteve të evidentuara dhe të zbuluar 2005-2016




Grafiku nr. 5

Autorë të proceduar për kultivim të bimëve narkotike 2005-2016



Grafiku nr. 6

Numri i bimëve narkotike të asgjësuar (2005-2016)




Lleshi, S.  
dhe  
Shala, Xh.  
« Parandalimi  
i kultivimit,  
kyçi i suksesit  
antikanabis »


Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017



**Grafiku nr. 7**



**Grafiku nr. 8**



Nga analiza e të dhënave statistikore, tabelore dhe grafike (tabela nr. 2 dhe grafikët nr. 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8), për periudhën 2005-2016 gjejmë se:

- Në vitin 2005, në raport me një vit më parë, ka një rritje prej 2.95 herë të numrit të rasteve të konstatuara të kultivimit, një rritje prej 2.87 herë të numrit të autorëve të penalizuar ndërkohë që, 79.7% e tyre janë proceduar në gjendje të lirë si dhe një rritje prej 4.5 herë të numrit të bimëve të asgjësuar.

- Në vitin 2006 ka një kufizim të fenomenit dhe rikthim afërsisht në shifrat e vitit 2004. Gjithashtu vihet re një rënie e forcës zbuluese në 38.6% të rasteve të evidentuara.

- Në vitin 2007 fillon përsëri ngritja e kurbës së kultivimit të kanabisit, duke shënuar një rritje prej 1.86 herë të rasteve të evidentuara të kultivimit si dhe 2.39 herë të numrit të bimëve të kultivuara. Vihet re një rënie akoma më e madhe e forcës zbuluese në 26.9% të rasteve të evidentuara.

**Lleshi, S.  
dhe  
Shala, Xh.**

« Parandalimi  
i kultivimit,  
kërcënues i suksesit  
antikanabis »

Polici dhe  
Siguria  
**nr.7, 2017**

- Nga viti 2008 deri në vitin 2011, ka një tendencë në ulje të rasteve të evidentuara të kultivimit, një nivel të ulët të zbulimit të autorëve të kultivimit (në vitin 2009 niveli i zbulueshmërisë ulet në nivelet 16.7%), një ulje të numrit të bimëve të asgjësuara në gjithsej 21 267 (duke mos përfshirë këtu kultivimin e lirë në Lazarat), që përbën dhe nivelin më të ulët të asgjësimeve pas atyre të vitit 1997.


- Më pas, nga viti 2012 deri në vitin 2016, ka një rritje të ndjeshme, nga viti në vit, të numrit të rasteve të evidentuara të kultivimit si dhe të numrit të bimëve të asgjësuara, duke arritur në vitin 2016 shifrën rekord për 2 536 288 bimë të asgjësuara si dhe një nivel të ulët në zbulueshmërinë e autorëve të kultivimit të kanabisit.

- Shifrat e analizuar për periudhën 2005-2013, nuk përmbajnë të dhënat për kultivimin e bimëve narkotike në zonën e Lazaratit, pasi ajo zonë ishte jashtë kontrollit të agjencive shqiptare të zbatimit të ligjit.<sup>7</sup>

- Në muajin qershor 2014, pas një pune disa mujore e të mirëorganizuar policore, u përmyll me sukses dhe pa asnjë viktimë, operacioni për rivendosjen e rendit dhe sigurisë në fshatin Lazarat, duke kryer kështu një investim të rëndësishëm edhe për sigurinë tonë kombëtare.<sup>8</sup>

Në përfundim, për të gjithë periudhën analizuese 1993-2016, numri i rasteve të evidentuara të kultivimit të kanabisit, të asgjësimit të tyre si dhe të autorëve të penalizuar, në paraqitje grafike (grafikët nr. 9, 10 dhe 11) është si më poshtë:

**Grafiku nr. 9**




**Lleshi, S. dhe Shala, Xh.**  
 «Parandalimi i kultivimit, kyçi i suksesit antikanabis»

Policimi dhe Siguria  
**nr.7, 2017**


<sup>7</sup> Stefano Bastone, komandant i repartit të aviacionit të Guardia di Finanza, në 5 Gusht 2013, do të deklaronte se "... kemi bërë fotografi nga lartësia, që dëshmojnë realitetin në Lazarat si kurrë më parë ... lënda narkotike mund të arrijë në 900 tonë, me një vlerë shitejeje mbi 4.5 miliardë euro". Nga *Konferenca e përbashkët për shtyp e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Hysni Burgaj dhe Stefano Bastone*, komandant i repartit të aviacionit të Guardia di Finanza-s, Tiranë, 5 Gusht 2013

<sup>8</sup> Vetëm me operacionet "Lazarati" dhe "Dukagjini", u bë e mundur të asgjësoheshin 2214 parcela të kultivuara me cannabis sativa. U asgjësuan në total 530.177 bimë narkotike cannabis sativa si dhe 65 ton e 86.937 kg Marijuanë. Gjithashtu u sekuestrua 53 kg e 750 gram marijuanë e përpunuar në trajtë çokollate, 16.8 litra vaj Hashashit, 4.395 kg farë bimë cannabis sativa si dhe 5 kg Heroinë. Gjatë kontrolleve në Lazarat, janë gjetur dhe 5 laboratorë nga të cilët 2 përpunimi të bimëve narkotike dhe 3 për përpunimin e vajit të hashashit, si dhe 2 inkubatorë ku u sekuestruan 27 llamba për ngrohje. Inkubatorët shërbenin për kultivimin e bimës narkotike në ambiente të mbyllur gjatë gjithë periudhës së vitit. Marrë nga: *Raporti "Për performancën e punës së Policisë së Shtetit për periudhën Janar - Dhjetor 2014"*. Faqe 6. Tiranë, Janar 2015.

**Grafiku nr. 10**



**Grafiku nr. 11**



Nga analiza e të dhënave statistikore, e numrit të rasteve të evidentuara të kultivimit të kanabisit, të numrit të bimëve të asgjësuar si dhe të autorëve të penalizuar si kultivues të bimëve narkotike (grafikët nr. 9, 10 dhe 11) gjejmë se:

- Kultivimi i kanabisit, për të gjithë periudhën analizuuese 1993-2016, pavarësisht disa zigzageve, ka pasur një tendencë të theksuar në ngritje.
- Numri i bimëve të kanabisit të asgjësuar, për të gjithë periudhën analizuuese 1993-2016, pavarësisht disa zigzageve, ka ardhur vazhdimisht në rritje.
- Numri i autorëve të penalizuar për kultivim të bimëve narkotike, për të gjithë periudhën analizuuese 1993-2016, ka ardhur vazhdimisht në rritje.
- Niveli i zbulueshmërisë së autorëve të kultivimit të bimëve narkotike, sidomos në periudhën 2005-2016, ka ardhur vazhdimisht në ulje çka ka ndikuar negativisht në luftën ndaj kësaj dukurie.
- Politika penale e ndjekur, nuk ka mbështetur luftën ndaj kësaj dukurie, sidomos në fillimet e saj. Procedimi i kultivuesve, kryesisht në gjendje të lirë, nuk e ka mbështetur frenimin e kësaj dukurie që në fillimet e saj.
- Operacioni policor për marrjen nën kontroll të zonës së Lazaratit ka ndikuar

**Lleshi, S.  
dhe  
Shala, Xh.**  
« Parandalimi  
i kultivimit,  
kyçi i suksesit  
antiknabis »

Policimi  
dhe  
Siguria  
**nr.7, 2017**

pozitivisht fshirjen e zonës gri, nën kontrollin e rrjeteve kriminale të kultivimit dhe trafikimit të kanabisit.

Nga gjetjet e mësipërme konkludojmë se, pavarësisht përpjekjeve në vite, dukuria kultivimit të kanabisit ka ardhur vazhdimisht në rritje dhe se metodologjia e zgjedhur për ta frenuar dhe minimizuar atë nuk garantonte suksesin dhe pritshmërinë në këtë fushë.

Po ashtu, evidentohet fakti se pas goditjes së fortë që iu dha dukurisë së kanabisit në rastin e marrjes së kontrollit shtetëror mbi Lazaratin në vitin 2014, numri i bimëve të asgjësuar më pas ka njohur një rritje të dukshme deri në vitin 2016. Kjo rritje nuk duhet kuptuar thjesht e vetëm si rritje e shkallës së kultivimit, por edhe si rritje e fuqisë goditëse të institucioneve ligjzbatuese. Kjo gjë, reflektohet edhe në rritjen përpjesëtimore edhe të numrit të procedimeve penale, krahas rritjes së numrit të bimëve të asgjësuar.

### 3. Faktorët që mundësuan fillimin dhe përhapjen e dukurisë së kultivimit të kanabisit

Në fillimin dhe përhapjen e kultivimit të kanabisit në Shqipëri kanë ndikuar disa faktorë. Ndër më kryesorët janë: mosmarrja që në fillim e masave për parandalimin e dukurive të tilla negative që do të shoqëronin hapjen e Shqipërisë ndaj vendeve të tjera, pas një periudhe të gjatë izolimi; krizat politike të njëpasnjëshme, të shoqëruara me mungesën e shtetit ligjor herë pas here në Shqipëri<sup>9</sup>; varfërimi i popullatës dhe papunësia në shifra të mëdha në zonat rurale<sup>10</sup>; pozicioni gjeostrategjik i përshtatshëm i Shqipërisë, si “një hap larg” perëndimit dhe ekzistenca pothuajse e të gjithë territorit shqiptar si një “zonë e përshtatshme për kultivim” të kanabisit, për shkak të cilësive së tokës, klimës, burimeve ujore e fluksit të dritës; mungesa në vitet e para, e legjislacionit për parandalimin e luftës kundër dukurisë së drogave dhe moszbatimi si duhet i ligjeve ekzistuese<sup>11</sup>; mangësitë në përgatitjen e strukturave policore dhe të institucioneve të tjera ligjzbatuese për të përballuar dukuri të tilla<sup>12</sup>; korrupsioni në shifra relativisht të larta për vite të tëra në polici, në prokurori dhe në gjykata, etj..

Një faktor tjetër i rëndësishëm për nxitjen e kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, ka qenë edhe kërkesa e shtuar ndërkombëtare, e shoqëruar më një aktivitet intensiv të rrjeteve ndërkombëtare të krimit dhe e lehtësuar nga politika të ndryshme, nganjëherë edhe kontradiktore, të vendeve europiane, të cilat përbëjnë edhe destinacionin kryesor të kanabisit të kultivuar në Shqipëri.

Ndërsa, si faktorë kryesorë të vazhdimësisë dhe të trendit rritës të kultivimit të kanabisit deri në fund të periudhës analizuuese (viti 2016) përveç faktorëve të evidentuar më sipër, mund të veçojmë: vazhdimi i trajtimit të këtij problemi thjesht si një problem

Lleshi, S.  
dhe

Shala, Xh.

Parandalimi  
i kultivimit,  
kyçi i suksesit  
antikanabis

Policimi  
dhe

Siguria

nr.7, 2017

18

<sup>9</sup> Në vitin 1997, pavarësisht masivizimit të mbjelljeve të bimëve narkotike, strukturat policore arriten të shkatërrojnë vetëm 807 bimë narkotike në shkallë vendi.

<sup>10</sup> Si rezultat i ndryshimeve, 34% e femrave dhe 23% e meshkujve në marrëdhënie pune humbën vendet e tyre të punës gjatë viteve 1989-1993. Në fund të vitit 1999, niveli i punësisit paraqitej 9% më i ulët në krahasim me fundin e vitit 1994. *INSTAT- Vjetari Statistikor 1991-1999*, f. 92

<sup>11</sup> Megjithëse kultivimi i bimëve narkotike në Shqipëri filloi që në vitin 1993, në Kodin Penal të RSH ai u parashikua si vepër penale vetëm në vitin 1995. Ndonëse në Kodin Penal të RSH, në nenin 284, parashikohej dënimi deri në 10 vjet burg për kultivuesit e bimëve narkotike, disa muaj më vonë, ligji Nr.7975, datë 26.7.1995, “Për Barnat Narkotike dhe Lëndet Psikotrope” u kërkonte fshatarëve të shkatërronin vetë bimët narkotike të mbjella nga ana e tyre, duke e trajtuar këtë problem për disa vite më tepër si kundravajtje penale.

<sup>12</sup> [Punonjësit e strukturave policore dhe të agjencive të tjera të zbatimit të ligjit vinin pothuajse të gjithë nga sistemi socialist, ku kultivimi i bimëve narkotike dhe përdorimi e trafikimi i drogave njihet vetëm në literaturë].

policor; heqja dorë nga puna parandaluese dhe përqendrimi i luftës ndaj kësaj dukurie, në fazat e vonshme të rritjes e pjekjes së bimëve narkotike; niveli i përgjegjësisë brenda policisë, që ka rezultuar pasiv, në rastin më të mirë dhe i përfshirë, në rastin më të keq - në mbylljen e syve ndaj shfaqjes së fenomenit, në të gjitha territoret e mbjella vitin e shkuar<sup>13</sup> (2016); moskoordinimi i punës midis strukturave të ngarkuara me ligj për të luftuar këtë dukuri; mospërfshirja e komunitetit në këtë luftë; rritja progresive e kërkesave të tregut për prodhimin cilësor shqiptar të kanabisit dhe për pasojë, rritjen progresive të interesimit të organizatave të huaja kriminale për të shtrirë aktivitetin e tyre në Shqipëri; zbatimi i standardeve të ndryshme ligjore në vendet e destinacionit për konsumin e kanabisit; hapja e parakohshme e debatit për legalizimin e kanabisit si dhe përcjellja për këtë e mesazheve të gabuara nga persona me mandat politik.

#### **4. Kultivimi i kanabisit, aktivitet kriminal që kërcënon sigurinë**

Kultivimi i kanabisit është i ndaluar me konventa ndërkombëtare dhe klasifikohet aktivitet kriminal nga legjislacioni shqiptar. Dhe, kur një aktivitet kriminal është masiv, i shtrirë në fshatra e territore të caktuara, nxit krijimin e të ashtuquajturave “zona gri”, zona ku sundon paligjshmëria; nxit rezistencën e dhunshme ndaj autoritetit shtetëror dhe shteti humbet kontrollin e pjesëve të territorit të tij<sup>14</sup>. Kjo përbën një kërcënim serioz për sigurinë kombëtare të vendit. Shqipëria, synon integrimin e saj në Bashkimin Evropian dhe është në prag çeljes së negociatave për anëtarësim. Por, për t’u integruar, vendi ynë, nuk mund të vazhdojë të etiketohet përsëri si një “republikë e hashashit” në mes të Evropës. Në këto kushte, janë të gjitha gjasat që angazhimin dhe sukseset në luftën ndaj dukurisë së kultivimit të kanabisit në ditët e sotme, aleatët tanë euroatlantikë do t’i vlerësojnë si një çështje të vullnetit politik qeverisës, por dhe të aftësive e kapacitetit profesional të Policisë Shtetit dhe të agjencive të tjera ligjzbatuese në vend, për t’u përballur me këtë dukuri.

Kultivimi masiv i kanabisit sjell pasoja negative për komunitetin e për sigurinë publike. Ai ndikon në rritjen e kriminalitetit në vend, penalizon një numër të madh personash brenda dhe jashtë vendit; ndikon në rritjen e numrit të përdoruesve të marihuanës në popullsinë vendase, sidomos në brezin e ri; heq interesin e të rinjve për t’u angazhuar në veprimtari të ligjshme fitimprurëse; ndikon që fermerët e zonave kultivuese të bimëve narkotike, të humbasin interesin dhe traditën e kultivimit të bimëve të tjera bujqësore, etj.

#### **5. Tiparet e luftës kundër kultivimit të kanabisit deri në vitin 2016. Rast studimor.**

Në përgjithësi, gjatë gjithë periudhës studimore (1993-2016) lufta kundër kultivimit të kanabisit është përqendruar vetëm në korrjen e tij nga ana e policisë, para ose gjatë

<sup>13</sup> Fjala e Kryeministrit Edi Rama në takimim ku u prezantua puna për zbatimin e Planit Kombëtar të Luftës për Parandalimin e Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit, mbajtur me datë 7.07.2017. <http://www.kryeministria.al/al/newsroom/lajme/2017-a-fund-historise-se-gjate-te-kultivimit-te-kanabisit/7.7.2017>.

<sup>14</sup> Rasti i Lazaratit nga viti 1998 deri 2014 është rasti më tipik i krijimit të një zone gri, ku sundoi paligjshmëria dhe shteti humbi kontrollin mbi atë pjesë të territorit të tij.

Lleshi, S.  
dhe

Shala, Xh.

« Parandalimi  
i kultivimit,  
kyçi i suksesit  
antikanabis »

Polici  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017


pjekjes së bimëve dhe, më pas, në përpjekjet për zbulimin dhe goditjen e trafikantëve të marihuanës, pra, të lëndës së përpunuar pas korrjes së bimëve narkotike në zona të paevidentuara e të pa asgjësuar më parë. Pavarësisht përpjekjeve në vite për kontrollin e kultivimit, mosparashikimi i punës për parandalimin e mbjelljes së kanabisit, lënia e përgjegjësive të kësaj lufte vetëm Policisë së Shtetit dhe mungesa e bashkëpunimit me komunitetin në zonat e kultivimit, janë ndër arsyet kryesore të mos arritjes së nivelit të duhur të pritshmërive në luftën ndaj kësaj dukurie. Me luftën kundër kanabisit, pothuajse në të gjithë periudhat janë angazhuar vetëm strukturat policore, reagimi i të cilave ka qenë në rritje, sidomos në vitet 2014-2016, si: në drejtim të evidentimit, të kultivimit, të asgjësimit të bimëve të kanabisit dhe të penalizimit të autorëve.

Por, ka munguar bashkëpunimi i policisë me komunitetin dhe me strukturat e pushtetit vendor për ta luftuar këtë dukuri. Strukturat e pushtetit vendor, agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit dhe institucionet shtetërore, nuk e kanë ndjerë asnjëherë veten bashkëpërgjegjëse për ta luftuar kultivimin e kanabisit. Në vitet e para të fillimit të kultivimit në komunitet, ka pasur mungesë të theksuar informacioni për pasojat dhe për penalitetet që jepen në rastet e kultivimit të bimëve narkotike.

Në disa zona, të paktën deri në vitet 2000, kanabisin e quanin thjesht “barishte” që shitej shtrenjtë dhe nuk kishin informacion se ai që e kultivonte, mund të shkonte në burg. Këto mendime i kanë favorizuar dhe vendimet e dhëna nga gjykatat. Kështu, në qarkun e Fierit, 95% e 207 autorëve të dënuar në vitet 1998-2000, morën vetëm dënim me kusht. Pra, “politika penale” e ndjekur nga gjykatat nuk kishte ndikuar në pakësimin e kultivimit të bimëve narkotike<sup>15</sup>.

Efektshmëria e parandalimit të kultivimit të kanabisit, si metodë e suksesshme në luftën ndaj këtij fenomeni, është përdorur me sukses në nivel rajonal nga struktura policore. Për këtë mjafton të marrim si rast studimor luftën ndaj kësaj dukurie në Qarkun e Fierit në vitet 2001-2003. Në Shqipëri, deri në vitin 2000, qarku i Fierit zinte vendin kryesor në hartën e kultivimit të kanabisit. Numri i bimëve të kanabisit të asgjësuar në këtë qark në raport me ato të asgjësuar në shkallë vendit për vitet 1998, 1999 dhe 2000 zinte përkatësisht 36.8%, 75% dhe 20.6% (shih grafikun nr. 12).

Grafiku nr. 12



Lleshi, S.  
dhe  
Shala, Xh.  
« Parandalimi  
i kultivimit,  
kyçi i suksesit  
antikanabis »



Policimi  
dhe  
Siguria  
nr. 7, 2017

<sup>14</sup> Rasti i Lazaratit nga viti 1998 deri në 2014 është rasti më tipik i krijimit të një zone gri, ku sundoi paligjshmëria dhe shteti humbi kontrollin mbi atë pjesë të territorit të tij.

<sup>15</sup> Të dhënat janë të Zyrës Rajonale të Shërbimit të Luftës Kundër Drogës në Fier, në vitin 2000.

Ndërsa numri i autorëve të penalizuar në qarkun e Fierit për kultivimin e bimëve narkotike, për vitet 1998, 1999 dhe 2000, krahasuar me ata të penalizuar në shkallë vendi për këtë veper penale në të njëjtën periudhë zinte përkatësisht 37.5%, 62.3% dhe 26.2%(shih grafikun nr. 13)<sup>16</sup>. Ndërsa, po të krahasojmë sasinë e marihuanës së sekuestruar në shkallë vendi me atë të sekuestruar në qarkun e Fierit, gjejmë së marihuana e sekuestruar në qarkun e Fierit zinte nga 14- 20% të sasisë të sekuestruar në shkallë vendi (grafiku nr. 14).

Grafiku Nr.13



Përballja me këtë dukuri kaq masive kriminale ishte një sfidë e vërtetë. Pas analizës që iu bë shkaqeve të dështimit në vite të luftës ndaj kësaj dukurie, u pa domosdoshmëria e hartimit të një strategjie me një qasje të re për t'u përballur me të. Strategjia përfshinte forma dhe metoda të reja lufte kundër kultivimit të kanabisit, të përpunuara më parë nga policia shqiptare. Në realizimin e kësaj strategjie investimi më i madh u planifikua të

<sup>17</sup> Të dhënat statistikore janë të Zyrës Rajonale të Luftës Kundër Drogës të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Fier në vitin 2000 dhe janë konfirmuar në atë kohë në Shërbimin Qendror të Luftës Kundër Drogës.

Lleshi, S.  
dhe  
Shala, Xh.  
« Parandalimi  
i kultivimit,  
kyçi i suksesit  
antikanabis »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

bëhej për parandalimin e kultivimit të kanabisit<sup>17</sup>, si: organizimi, para fazës së mbjelljeve, të takimeve të shpeshta me komunitetin në çdo lagje e fshat, sidomos në zonat që kishin kultivuar më parë kanabis, me synim ndërgjegjësimin e banorëve për përgjegjësitë ligjore që do të kishin nëse kultivonin kanabisin; përgatitja dhe shpërndarja e fletëpalosjeve me informacionin e nevojshëm për pasojat ligjore që parashikon legjislacioni shqiptar në rast kultivimi të kanabisit; numra telefoni të policisë për të thithur informacion për këtë problem, etj.; bashkëpunim i ngushtë me mediet lokale për të sensibilizuar më mirë opinionin publik kundër kësaj dukurie; përgatitja e temave ku do të trajtoheshin pasojat e drogës, rreziqet që ajo mbart dhe vënia në dispozicion të drejtorive arsimore; nxitja e ndërhyrjes së organizmave shtetërore me programe dhe mbështetje me kredi biznesi për fermerët e zonës; përgatitja dhe shpërndarja e deklaratave tip, me anë të së cilave fermeri të deklaronte se në sipërfaqen e tokës që disponon nuk do të kultivonte kanabis dhe se nuk dispononte farë apo prodhime narkotike të viteve të shkuara; bashkëpunim më i ngushtë me gjykatat dhe prokuroritë sipas rretheve të qarkut, për të ashpërsuar politikën goditëse ndaj personave që do të tentonin kultivimin e kanabisit dhe trafikimin e prodhimit të tij; krijimi i shtabit të drejtimit në Drejtorinë e Policisë së Qarkut dhe në njësitë vendore pranë çdo komune e fshati, për të ndjekur dianmikën e zbatimit të planit strategjik; rritjen e masave për kontrollin e territorit dhe parashikimi që inspektorët e zonave të përgatishin raport javor për zonat që mbulonin, etj.



Plantacion me bimë narkotike cannabis sativa në Cakran, Fier 1999<sup>18</sup>

Ky plan u parashikua të realizohej në bashkëpunim me komunitetin, prefekturën, qarkun, drejtoritë e bujqësisë, drejtoritë arsimore, struktura të tjera të pushtetit vendor si dhe organizatat joqeveritare. Strategjia e re u publikua për herë të parë në qarkun e Fierit, në një konferencë rajonale, në shkurt të vitit 2001<sup>19</sup>. Në atë konferencë u konkludua se rol përcaktues në suksesin e luftës kundër kultivimit masiv të kanabisit, ka puna për parandalimin, qysh para fillimit të fazës së mbjelljes së bimëve dhe se kjo nuk mund të arrihet vetëm nga strukturat e policisë, pa një mbështetje nga pushteti

Lleshi, S.  
dhe  
Shala, Xh.

« Parandalimi  
i kultivimit,  
kyçi i suksesit  
antikanabis »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr. 7, 2017

<sup>18</sup> Shërbimi Qendror i Luftës Kundër Drogës, viti 2000.

<sup>19</sup> Për ta prezantuar këtë plan strategjik dhe me synimin për ta vënë sa më shpejt atë në zbatim, më datë 07.02.2001, me iniciativën e Drejtorisë së Policisë së Qarkut, në bashkëpunim me Prefekturën Fier, u organizua në mjediset e Drejtorisë së Policisë Konferenca Rajonale me temë: "Parandalimi i kultivimit të bimëve narkotike në qarkun e Fierit". Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të pushtetit vendor, si kryetarë të komunave të qarkut Fier, kryepleq, përfaqësues nga gjykatat, prokuroria etj. Pra, mund të themi se në njëfarë mënyre morën pjesë të gjithë "aktorët" që do të punonin për zbatimin e kësaj strategjie. Gjithashtu në të morën pjesë përfaqësues të OSBE-së, UNDCP-së, të komuniteteve fetare, medieve lokale, përfaqësues të drejtorive arsimore, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët, më pas, dhanë një ndihmesë të madhe në realizimin me sukses të planit strategjik antikanabis. 3 vite më vonë qeveria shqiptare me vendimin Nr. 292, datë 7.05.2004, miratoi Strategjinë Kombëtare Antidrogë 2004-2010 të Shqipërisë.



vendor, nga struktura të tjera të shtetit, si dhe pa bashkëpunimin me komunitetin e me shoqërinë civile.

Zbatimi pikë për pikë i planit<sup>20</sup> për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike në qarkun e Fierit, solli rezultate befusuese brenda disa muajve. Pas një pune intensive u arrit përfundimisht parandalimi i kultivimit masiv të tyre. U konstatuan në këtë kohë vetëm disa mbjellje sporadike, në sipërfaqe tepër të vogla, kryesisht deri në 20 rrënjë (kjo më tepër për ruajtje të farës, sesa për prodhimin e marihuanës), larg qendrave të banuara, në parcela pa pronësi (përrenj, buzë kanaleve dhe në kodra), të mbjella në mënyrë të çrregullt dhe që nuk iu kryen shërbime. Konkretisht, në vitin 2001, u evidencuan dhe u asgjësuan 3080 rrënjë bimë narkotike, një shifër kjo mjaft e ulët në krahasim me një vit më parë, kur qenë asgjësuar 51 775 bimë kanabisi. Pra, rezultoi një rënie e kultivimit të kanabisit krahasuar me vitin paraardhës: rreth 17 herë. Numri i procedimeve u ul në mënyrë ndjeshme. Në këtë vit pati vetëm 17 raste nga 77 raste që ishin në vitin 2000. Pra, pati një ulje të procedimeve penale për veprën e kultivimit të bimëve narkotike në masën rreth 3.5 herë. Gjithashtu, u konstatua se shumica e kultivuesve ishin të seksit femër dhe në moshë të madhe, të cilat nuk kishin në familjet e tyre meshkuj të aftë për punë dhe kishin mbetur pa të ardhura ekonomike.<sup>21</sup> Në rrethet Lushnjë dhe Mallakastër, atë vit nuk u regjistrua asnjë rast kultivimi bimësh narkotike.

Arritja e këtyre rezultateve që në muajt e parë të zbatimit të strategjisë së re, tregoi se, tashmë, ishte zbuluar dhe testuar “vaksina” për ta luftuar epideminë “kanabis”. U krijua bindja dhe siguria se zbatimi i kësaj strategjie në vitet në vazhdim, do ta çonte drejt nivelit zero kultivimin e kanabisit në qarkun e Fierit. Zbatimi i kësaj strategjie, si një formë dhe metodë e re në punën e policisë, e cila kishte në themel parandalimin e krimit në bashkëpunim me komunitetin dhe shoqërinë civile, si dhe rezultatet e arritura gjetën mbështetjen e opinionit dhe të medias lokale e qendrore.<sup>22</sup> Plani strategjik i aplikuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Fier, megjithëse u hartua dhe u zbatua pa ndonjë orientim të veçantë të politikës, u vlerësua nga vetë Ministri i Rendit Publik,<sup>23</sup> dhe u urdhërua Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për ta aplikuar edhe në qarqet e tjera problematike për kultivimin e bimëve narkotike, sidomos në Vlorë dhe në Shkodër. Megjithatë, në vitet 2001 dhe 2002, strategjia antikanabis nuk u arrit të implementohej në këto dy qarqe. Kjo duket edhe nga shifrat e paraqitura në grafikun e mëposhtëm, ku bëhet krahasimi për kultivimin e kanabisit në qarqet Fier, Vlorë dhe Shkodër<sup>24</sup>.

<sup>20</sup> Me njoftimin për shtyp të datës 30.01.2001, Drejtoria e Policisë e qarkut Fier e bëri publik për të gjithë komunitetin e qarkut Strategjinë e re antikanabis dhe kërkoi bashkëpunimin e tij për ta zbatuar atë.

<sup>21</sup> Është evidencuar si taktikë e kultivuesve të bimëve narkotike që, në rastet e kapjes nga policia, të deklararonin si pronar të bimëve narkotike më të moshuarit e shtëpisë, më qëllim për t'i shpëtuar arrestimit.

<sup>22</sup> Gazeta “Korrieri” më datë 07.09.2001, faqe 9, i bën një analizë të hollësishme fenomenit kanabis në shkallë vendi dhe ndalet veçmas për strategjinë e zbatuar në Fier dhe për suksesin e zbatimit të saj.

Po kështu, edhe revista “Klan”, në numrin e saj të datës 18 mars 2001, me një reportazh nga fshati Cakran, tregon se ka ndjekur në vend zbatimin e strategjisë antikanabis.

Gjithashtu, kjo strategji është trajtuar edhe nga të përditshmet “Shekulli”, “Gazeta shqiptare”, nga televizionet kryesore qendrore, etj.

<sup>23</sup> Strategjia e re antikanabis e Policisë së Fierit u pasqyrua menjëherë në revistën “Drejt”, botim i Departamentit të Informacionit pranë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Në faqen 48-50, të numrit të vitit 2000, jepet një informacion i hollësishëm për Konferencën Rajonale antidrogë të zhvilluar në Fier, si dhe thelbi i strategjisë së re antikanabis.

<sup>24</sup> Xhavit Shala: Between anticannabis and cannabis politics. Botim i Qendrës Shqiptare të Studimeve për Sigurinë Kombëtare. Tiranë 2005. Faqe 75.


**Lleshi, S.  
dhe**

**Shala, Xh.**

« Parandalimi  
i kultivimit,  
kyçi i suksesit  
antikanabis »

Polici  
dhe  
Siguria  
**nr.7, 2017**

Grafiku nr. 15



## 6. Plani i ri, parandalimi i kultivimit si kyçi i suksesit antikanabis

Progres Raporti i Komisionit Evropian i vitit 2016, thekson se Shqipëria e ka intensifikuar luftën kundër kultivimit të kanabisit, “por ajo ende mbetet një sfidë serioze”<sup>25</sup>. Edhe nga analiza e zbatimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Drogës 2012-2016 është konkluduar se “ajo ishte një qasje e pjesshme, rezultatet e së cilës mbeten jo në nivelin e pritshmërive dhe të mundësive”<sup>26</sup>. Gjithashtu nga analiza që i bëmë më sipër dinamikës së kultivimit të kanabisit në vendin tonë, nxorëm përfundimin se pavarësisht përpjekjeve në vite, fenomeni i kultivimit të bimëve narkotike ka ardhur vazhdimisht në rritje dhe se metodologjia e zgjedhur për ta frenuar e minimizuar atë, nuk garanton suksesin dhe pritshmërinë në këtë fushë. Prandaj, lipsej një rikonceptim dhe një qasje e re në luftën antikanabis. Për këtë u bë e domosdoshme, u hartua dhe është vënë në zbatim Plani i Veprimit Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit, i cili u miratua nga Këshilli i Ministrave në muajin mars 2017.<sup>27</sup> Si objektiva kryesore të këtij plani janë përcaktuar: “Goditja dhe reduktimi i kultivimit, goditja dhe shkatërrimi i rrjeteve të trafikimit, si dhe reduktimi i përdorimit të kanabisit”.<sup>28</sup> Goditja dhe reduktimi i prodhimit si objektivi i parë ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në përbushjen e objektivave të tjerë. Për këtë, janë përcaktuar synime të qarta në planin afatshkurtër, duke filluar nga gjysma e parë e vitit 2017.<sup>29</sup>

Lleshi, S.  
dhe  
Shala, Xh.

Parandalimi  
i kultivimit,  
kyçi i suksesit  
antikanabis

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

<sup>25</sup> European Union, European Commission. (2016), *Albania Report*, (Commission Staff Working Document) [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2016/20161109\\_report\\_albania.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf)

<sup>26</sup> *Plani i Veprimit Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit* u miratua nga Këshilli i Ministrave me VKM Nr. Nr. 248, datë 29.3.2017. Fletorja Zyrtare Nr. 65. Faqe 3644. Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare. Tiranë 2017.

<sup>27</sup> *Plani i Veprimit Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit* u miratua nga Këshilli i Ministrave me VKM Nr. Nr. 248, datë 29.3.2017.

<sup>28</sup> *Plani i Veprimit Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit* u miratua nga Këshilli i Ministrave me VKM Nr. Nr. 248, datë 29.3.2017. Fletorja Zyrtare Nr. 65. Faqe 3650. Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare. Tiranë 2017. Burim i cituar.

<sup>29</sup> Në planin afatshkurtër, synohet që, duke filluar nga gjysma e parë e vitit 2017, të parandalohet dhe të shkatërrohet cikli i kultivimit që në fillimin e tij, duke mbajtur në kontroll të rreptë të gjithë elementët e tij si: aktivizimi i burimeve financiare, rekrutimi i fuqisë punëtore, sigurimi i farëve dhe fidanëve, hapja apo punimi i tokave, ndërtimi i impianteve të ujitjes etj.

Pavarësisht se është emërtuar “Plan veprimi”, dokumenti i mësipërm është një strategji e mirëfilltë që përfshin një mision, vizion dhe objektiva për një politikë e një qasje komplet të re për luftën antikanabis. Ky plan parashikon dhe disiplinon marrjen e të gjitha masave të nevojshme për goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit dhe trafikimit të kanabisit në vend, duke angazhuar të gjitha burimet e nevojshme njerëzore, materiale dhe financiare të shtetit. Theksi kryesor i këtij plani është bashkëpunimi për krijimin e një sinergie ndërinstucionale për arritje një goditje frontale për identifikimin, zbulimin dhe shkatërrimin e grupeve dhe rrjeteve kriminale të kultivuesve dhe trafikuesve të kanabisit. Në ndryshim nga qasjet e mëparshme strategjike dhe nga praktika e ndjekur nga organet e ligjzbatimit, plani e orienton përpjekjen e institucioneve në fazat e hershme të ciklit të kultivimit të kanabisit, “duke synuar që sukcesi të arrihet duke parandaluar futjen e farëve në vend dhe duke goditur bimët në fazën kur ato janë fidanë, në mjedise të mbyllura, në sipërfaqe relativisht të vogla dhe kryesisht pranë zonave të banuara”<sup>30</sup>.

Indikatorët kryesorë matin kryesisht suksesin në identifikimin, zbulimin, ndalimin dhe vënien përpara drejtësisë të financuesve dhe drejtuesve të grupeve dhe rrjeteve kriminale. Identifikimi dhe sekuestrimi i aseteve të krijuara nga veprimtaritë kriminale është një tjetër kriter i rëndësishëm për të matur shkallën e suksesit në përballjen me fenomenin e kanabisit. Planin “nuk konsideron sukses shkatërrimin e parcelave në fazën e vonë të ciklit të kultivimit, kur bimët janë të pjekura për korrje, por njeh si sukses parandalimin e mbjelljes së tyre si kriter optimal ose shkatërrimin kur ato janë ende fidanë, si kriter i pranueshëm. Zbulimi dhe asgjësimi i bimëve narkotike në fazën e fundit të ciklit konsiderohet si një situatë ekstreme e cila i ngarkon me përgjegjësi të lartë të gjithë autoritetet përgjegjëse.”<sup>31</sup>

Në këtë plan, i kushtohet një rëndësi e veçantë punës për dekurajimin e qytetarëve për t’u përfshirë në veprimtari të paligjshme në këtë fushë dhe këtu, një rol të rëndësishëm, merr intensifikimi i komunikimit publik në interes të ndërgjegjësimit të qytetarëve, reduktimit të përdorimit të kanabisit dhe të bashkëpunimit të gjerë qytetar në përpjekjen e përbashkët kundër kanabisit. Një rol të rëndësishëm për finalizimin me sukses të këtij plani merr koordinimi dhe bashkëveprimi ndërinstucional. Finalizimi i planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit nuk mund të përballohet dhe nuk do të jetë barrë vetëm për Policinë e Shtetit, siç është konceptuar dhe lënë deri në vitin 2016. Janë përcaktuar detyra specifike për shumë aktorë të tjerë shtetërorë si ata të bujqësisë, të mjedisit, të çështjeve sociale, të shëndetësisë, të arsimit dhe sidomos, ata të autoriteteve të pushtetit vendor. Për ta koordinuar më mirë këtë veprimtari ndërinstucionale, janë ngritur dhe funksionojnë struktura të përbashkëta, të modelit *task force*, në nivelin qendror dhe vendor. Gjithashtu, ky plan nuk mund të përmbushet pa një bashkëpunim të fuqishëm ndërkombëtar<sup>32</sup>.

Për herë të parë në praktikën shqiptare, në një plan të tillë veprimi, parashikohet edhe “rishikimi i kriterëve dhe përforcimi i kontrolleve ndaj integritetit dhe të

<sup>30</sup> Planin i Veprimit Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit u miratua nga Këshilli i Ministrave me VKM Nr. Nr. 248, datë 29.3.2017. Fletorja Zyrtare Nr. 65. Faqe 3644. Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare. Tiranë 2017. Burim i cituar.

<sup>31</sup> Po aty, faqe 3645.

<sup>32</sup> Për këtë është parashikuar krijimi i një bazë të dhënash e dedikuar për kultivimin e bimëve kanabis, në bashkëpunim me: The European Police Office (EUROPOL), European Monitoring Centre for drugs and drug addiction (EMCDDA). Implementimi dhe përdorimi i instrumentit: European Reporting Instrument for sites related to Cannabis Production (ERICP) është element mbështetës për zbatimin e kësaj mase.

Lleshi, S.  
dhe  
Shala, Xh.

« Parandalimi  
i kultivimit,  
kyçi i suksesit  
antikanabis »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

personalitetit të zyrtarëve shtetërorë, të ngarkuar me detyra, në fushën e narkotikëve, të gjitha niveleve, me qëllim verifikimin e plotë të gjithë zyrtarëve të angazhuar kundër fenomenit. Analiza e sukseseve dhe e problemeve të evidentuara gjatë ushtrimit të detyrës, pasuria, lidhjet eventuale me persona të inkrimnuar, kapacitetet profesionale, familjarizimi me gjendjen problematike janë kritere ku do të bazohet kontrolli”.<sup>33</sup>

Në këtë punim, kur trajtuam rastin studimor që i përkiste Qarkut të Fierit në vitin 2001, pamë suksesin e plotë të zbatimit të një strategjie rajonale, që bazë të luftës antikanabis kishte punën parandaluese dhe bashkëpunimin ndërinstytucional.

plani i veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, i miratuar nga Këshilli i Ministrave me VKM Nr. Nr. 248, është një plan kombëtar, gjithëpërfshirës që ka rikonceptuar politikën shtetërore në luftën ndaj fenomenit të kanabisit si nga ana strategjike, ashtu dhe taktike. Ky plan është “vaksina” për ta luftuar epideminë “kanabis”, “vaksinë” e testuar më parë me sukses edhe në nivel rajonal. Ai përfshin në mënyrë të detajuar luftën ndaj fenomenit të kanabisit që në fazën e parandalimit, zbulimit dhe goditjes së tij. Zbatimi i plotë i tij do të garantojë suksesin e luftës antikanabis. Përgatitjen e këtij plani e paralajmëroi ministri i Punëve të Brendshme, z. Fatmir Xhafaj, ditën e marrjes së detyrës. Sipas tij “Qeveria shqiptare, ka hartuar në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, një plan të qartë veprimi për luftën ndaj lëndëve narkotike dhe posaçërisht, për ndalimin e kultivimit të kanabisit”<sup>34</sup> dhe se ky plan, do jetë një sfidë dhe prioriteti thelbësor i punës së tij në krye të ministrisë dhe “i gjithë ekipit drejtues veçanërisht i strukturave të Policisë së Shtetit (nga Drejtori i Përgjithshëm deri tek punonjësi më i thjeshtë i rolit bazë)”<sup>35</sup>.

Rezultatet e gjashtëmujorit të parë të këtij viti janë vërtet premtuese. Të dhënat statistikore të gjashtëmujorit të parë të vitit 2017, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2016, për numrin e rasteve të evidentuara të kultivimit të bimëve narkotike, rasteve të zbuluara, numrin e bimëve narkotike të asgjësuara si dhe të autorëve të tyre, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë (tabela nr. 3 dhe grafikët nr. 16, 17 dhe 18):

**Tabela nr. 3**

Periodha	NUMRI I RASTEVE	ZBULUAR	NUMRI I BIMËVE	AUTORË	ARRESTUAR	GJENDJE TË LIRË	KËRKIM
<b>6-mujori I 2016</b>	334	104(31.14%)	564.317	158	93	27(79.7)	33
<b>6-mujori I 2017</b>	130	74 (56.9%)	38.152	131	79	21(36.9%)	28

Lleshi, S.  
dhe  
Shala, Xh.

« Parandalimi  
i kultivimit,  
kyçi i suksesit  
antikanabis »


Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

<sup>33</sup> *Plani i Veprimit Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit* u miratua nga Këshilli i Ministrave me VKM Nr. Nr. 248, datë 29.3.2017. Fletorja Zyrtare Nr. 65. Faqe 3651. Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare. Tiranë 2017. Burim i cituar.


<sup>34</sup> *Fjala e Ministrisë të Punëve të Brendshme Zotit Fatmir Xhafa*, mbajtur me datë 27 Mars 2017, ditën që Kryeministri, z. Edi Rama, e prezantoi si Ministër të Punëve të Brendshme.

<sup>35</sup> Po aty.


Grafiku nr. 16



Grafiku nr. 17



Grafiku nr. 18



**Lleshi, S.  
dhe  
Shala, Xh.**  
« Parandalimi  
i kultivimit,  
kyçi i suksesit  
antikanabis »

Policimi  
dhe  
Siguria  
**nr.7, 2017**

Nga analiza krahasimore e të dhënave statistikore, tabelore dhe grafike, (tabela nr. 3 dhe grafikët nr. 16,17 dhe 18) të gjashtëmujorit të parë të vitit 2017, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2016, për numrin e rasteve të evidentuara, të zbuluara, numrin e bimëve narkotike të asgjësuara si dhe të autorëve të tyre, gjejmë se pas fillimit të zbatimit të planit të ri të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017, ka një rënie të numrit të rasteve të evidentuara me 2.59 herë; ulje të numrit të bimëve narkotike të asgjësuara me 14.79 herë; rritje të forcës zbuluese me 1.82 herë si dhe një ulje të numrit të autorëve me 17%.

## 7. Përfundime

Pasi trajtuam, për një periudhë thuajse 25 vjeçare (1991-2016), dukurinë e fillimit të kultivimit të kanabisit, të përhapjes së saj në vendin tonë, të faktorëve që kanë ndikuar, të dinamikës sipas viteve të rasteve të evidentuara, bimëve të asgjësuara dhe personave të penalizuar, mbështetur në hulumtime, analiza e sinteza nxjerrim këto përfundime:

### **Përfundimet kryesore**

- Kultivimi i kanabisit, si dukuri, u bë i njohur në Shqipëri zyrtarisht në vitin 1993, vit në të cilin janë regjistruar rastet e para të kultivimit të bimëve narkotike. Pavarësisht përpjekjeve në vite, fenomeni i kultivimit të bimëve narkotike ka ardhur vazhdimisht në rritje dhe metodologjia e zgjedhur për ta frenuar dhe minimizuar atë, nuk garantonte suksesin dhe prishmërinë në këtë fushë.

- Masivizimi i aktivitetit kriminal të kultivimit dhe trafikimit të bimëve narkotike nxit dhe rrezikon krijimin e të ashtuquajturave “zona gri”, zona ku sundon paligjshmëria, nxitet rezistencë dhunshme ndaj autoritetit shtetëror dhe shteti humbet kontrollin e pjesëve të territorit të tij duke u shndërruar kështu në një kërcënim për sigurinë kombëtare.

### **Përfundime të tjera**

- Ndër faktorët kryesorë që ndikuan në fillimin dhe përhapjen e kultivimit të kanabisit në Shqipëri janë: mosmarrja që në fillim e masave për parandalimin e dukurive të tilla negative që do të shoqëronin hapjen e Shqipërisë ndaj vendeve të tjera, pas një periudhe të gjatë izolimi; krizat politike të njëpasnjëshme gjatë viteve të tranzicionit të tejzgjatur, të shoqëruara herë pas here në Shqipëri, me mungesën e shtetit ligjor; varfërimi i popullatës dhe papunësia në shifra të mëdha në zonat rurale; pozicioni gjeostrategjik i përshtatshëm i Shqipërisë - “një hap larg” perëndimit dhe ekzistenca e pothuajse të gjithë territorit shqiptar si një “zonë e përshtatshme për kultivim” të kanabisit, për shkak të cilësive të tokës, klimës, burimeve ujore e fluksit të dritës; mungesa në vitet e para e legjislacionit për parandalimin e luftës kundër dukurisë së drogave dhe moszbatimi si duhet i ligjeve ekzistuese; mangësitë në përgatitjen e strukturave policore dhe të institucioneve të tjera ligjzbatuese për të përballuar dukuri të tilla; korrupsioni në shifra relativisht të larta për vite të tëra në polici, në prokurori dhe në gjykata, etj.

- Ndërsa, si faktorë kryesorë të vazhdimësisë dhe të trendit rritës të kultivimit të kanabisit, deri në fund të periudhës analizuere (viti 2016), përveç faktorëve të evidentuar më sipër, mund të veçojmë: vazhdimi i trajtimit të këtij problemi thjesht si një problem policor; niveli i përgjegjësisë brenda policisë, që ka rezultuar pasiv, në rastin më të mirë

dhe i përfshirë, në rastin më të keq; në mbylljen e syve ndaj shfaqjes së fenomenit në të gjitha territoret e mbjella vitin e shkuar<sup>36</sup> (2016); moskoordinimi i punës midis strukturave të ngarkuara me ligj për të luftuar këtë dukuri; mospërfshirja e komunitetit në këtë luftë; rritja progresive e kërkesave të tregut për prodhimin cilësor të kanabisit shqiptar si dhe për pasojë, rritja progresive e interesimit të organizatave të huaja kriminale për të shtrirë aktivitetin e tyre në Shqipëri; zbatimi i standardeve të ndryshme ligjore në vendet e destinacionit, për konsumin e drogës; hapja e parakohshme e debatit për legalizimin e kanabisit si dhe përcjellja për këtë e mesazheve të gabuara nga persona me mandat politik.

- Numri i bimëve narkotike të asgjësuar dhe i autorëve të penalizuar për kultivimin e tyre, pavarësisht disa zigzageve, ka ardhur vazhdimisht në rritje.

- Niveli i zbulueshmërisë së autorëve të kultivimit të bimëve narkotike në përgjithësi ka ardhur në ulje çka ka ndikuar negativisht në luftën ndaj këtij fenomeni.

- Politika penale e ndjekur nuk ka mbështetur luftën ndaj këtij fenomeni që në fillimet e tij. Procedimi i kultivuesve në fillimet e kësaj dukurie kryesisht në gjendje të lirë nuk e ka mbështetur frenimin e këtij fenomeni.

- Operacioni policor për marrjen nën kontroll të zonës së Lazaratit, në qershor 2014, ka ndikuar pozitivisht në luftën ndaj këtij fenomeni, në rivendosjen e autoritetit të shtetit edhe në atë pjesë të territorit që ishte nën kontrollin e rrjeteve kriminale të kultivimit dhe trafikimit të kanabisit.

- Në përgjithësi, gjatë gjithë periudhës analizuere (1992-2016), pavarësisht eksperiencave të suksesshme në nivel vendor, është hequr dorë nga puna parandaluese dhe lufta ndaj këtij fenomeni është përqendruar në korrjen e tij nga ana e policisë në fazat e vonshme të rritjes e pjekjes së bimëve të kanabisit dhe, më pas, në përpjekjet për zbulimin dhe goditjen e trafikantëve të marihuanës pra, të lëndës së përpunuar pas korrjes së bimëve narkotike në zona të paevidentuara e të paasgjësuar më parë.

## 8. Rekomandime

*Mbështetur në përfundimet e arritura, në përputhje edhe me qëllimin e realizimit të këtij punimi, për minimizimin e plotë të kultivimit të bimëve narkotike, është i rekomandueshëm:*

- Sigurizimi i fenomenit të kultivimit dhe të trafikimit të bimëve narkotike si një kërcënim për sigurinë kombëtare të vendit.

- Ndryshimi i metodologjisë dhe rikonceptimi i plotë i luftës ndaj dukurisë të kultivimit të kanabisit duke zbatuar plotësisht zinxhirin parandalim, zbulim dhe goditje.

- Zbatimi i plotë i planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, i miratua nga Këshilli i Ministrave me VKM nr. 248, datë 29.3.2017, si një plan gjithëpërfshirës që ka rikonceptuar politikën shtetërore në luftën ndaj dukurisë së kultivimit të kanabisit, si nga ana strategjike ashtu edhe nga ajo taktike.

- Ridimensionimi i punës me burimet e informacionit, me qëllim sigurimin e informatave të nevojshme në luftën për zbulimin, parandalimin dhe goditjen me efikasitet të veprimtarisë kriminale të kultivimit të kanabisit.

<sup>36</sup> Fjala e Kryeministrit Edi Rama në takimin në ZOS, ku u prezantua puna për zbatimin e Planit Kombëtar të Luftës për Parandalimin e Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit, mbajtur më datë 7.07.2017.  
<http://www.kryeministria.al/al/newsroom/lajme/2017-a-fund-historise-se-gjate-te-kultivimit-te-kanabisit/7.7.2017>.

- Organizimi i një konference shkencore në funksion të një analize të thelluar pas vitit të parë të zbatimit të planit të veprimit, me qëllim evidentimin e problemeve të shfaqura dhe hartimin e rekomandimeve për përmirësimet e nevojshme.

## **9. Prognoza për të ardhmen**

Zbatimi në detaje i planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, i miratua nga Këshilli i Ministrave me VKM nr. 248 datë 29.3.2017 në planin afatshkurtër, brenda vitit të parë të zbatimit të tij (2017), do të ndalojë, vendosë nën kontroll dhe reduktojë disa herë kultivimin e bimëve narkotike, në raport me një vit më parë. Zbatimi i këtij plani me të njëjtin intensitet si në fillim, do të bëjë që, për një periudhe afatmesme 3-5 vjeçare, kultivimi i kanabisit të shfaqet vetëm në mënyrë sporadike. Ky do të jetë një investim serioz edhe në fushën e sigurisë kombëtare. Çdo zbrapsje nga zbatimi i këtij plani dhe desigurizimi i parakohshëm i dukurisë të kultivimit të kanabisit, mund të hedhë në erë tërë investimin e kryer.

*Lleshi, S.  
dhe*

*Shala, Xh.*

« Parandalimi  
i kultivimit,  
kyçi i suksesit  
antikanabis »

Policimi  
dhe  
Siguria  
*nr.7, 2017*



## Referenca

1. Arkivi i Sistemit të Ministrisë së Punëve të Brendshme: *Informacion Nr. 3894/1, datë 20.8.1995, i Zëvendësministrit të Punëve të Brendshme, drejtuar Presidentit, Kryeministrit dhe Ministrit të Brendshëm. Fondi Nr. 146, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë. "Informacione mbi drogën, trafikun e zhvilluar dhe luftën kundër saj". Dosje Nr. 4. Viti 1995.*
2. European Union, European Commission. (2016), *Albania Report*, (Commission Staff Working Document). Versioni elektronik: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2016/20161109\\_report\\_albania.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf)
3. *Strategjia Kombëtare Antidrogë e Republikës së Shqipërisë 2004-2010*, miratuar me Vendim nr. 292 datë 7.05.2004 të Këshillit të Ministrave.
4. "Plani i veprimit kundër kultivimit të bimëve narkotike 2017-2020", miratuar me VKM nr. 248, datë 29.3.2017. Publikuar në *Fletore Zyrtare Nr. 65*, datë 30 mars 2017.
5. *Fjala e Kryeministrit Edi Rama në takimin në ZOS, mbi prezantimin e Planit Kombëtar të Luftës për Parandalimin e Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit, mbajtur me datë 7.07.2017*. Versioni elektronik: <http://www.kryeministria.al/al/newsroom/lajme/2017-a-fund-historise-se-gjate-te-kultivimit-te-kanabisit/7.7.2017>.
6. *Fjala e ministrit të Punëve të Brendshme, z. Fatmir Xhafaj, mbajtur më datë 27 mars 2017, ditën që Kryeministri, Z. Edi Rama, e prezantoi si Ministër të Punëve të Brendshme*. Versioni elektronik: [www.punetebrendshme.gov.al/](http://www.punetebrendshme.gov.al/)
7. *Ligji nr. 8750*, datë 26.3.2001 "Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike dhe psikotrope".
8. *Ligji nr. 7975*, datë 26.7.1995 "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope"
9. *Ligji nr. 7895*, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë".
10. INSTAT, *Vjetari Statistikor 1991-1999*.
11. *Ligji nr. 7975*, datë 26.7.1995, "Për Barnat Narkotike dhe Lëndët Psikotrope".
12. Policia e Shtetit, *Raport për performancën e punës së Policisë së Shtetit për periudhën janar-dhjetor 2014*. Tiranë, 2015.
13. Xhavit Shala: *Between anticannabis and cannabis politics*. Qendra Shqiptare e Studimeve për Sigurinë Kombëtare. Tiranë 2005.
14. Xhavit Shala: *The Penalization of Cannabis Politics*. Qendra Shqiptare e Studimeve për Sigurinë Kombëtare. Tiranë 2006.
15. Të dhënat statistikore në vite të Shërbimit Qendror të Luftës Kundër Drogës.
16. Të dhënat statistikore të Zyrës Rajonale të Luftës Kundër Drogës të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Fier në vitin 2000.
17. *Planin Strategjik DP Qarkut Fier "Për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike"*. Fier, shkurt 2001
18. *Njoftim për shtyp i datës 30.01.2001*, Drejtoria e Policisë e qarkut Fier.
19. Reuters: *Kronikë në Lazarat, Albania*, 12 shtator 2006.
20. Stefano Bastone, Komandant i Repartit të Aviacionit të Guardia di Finanza-s, *Konferencë e përbashkët për shtyp me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë Hysni Burgaj*. Tiranë, 5 gusht 2013.
21. *Gazeta Korrieri*, datë 07.09.2001.
22. *Revista Klan*, 18 mars 2001, "Reportazh nga fshati Cakran për zbatimin e strategjisë antikanabis".
23. *Revista Drejt*, botim i Departamentit të Informacionit pranë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Tiranë, 2000.

Lleshi, S.

dhe

Shala, Xh.

« Parandalimi i kultivimit, kyçi i suksesit antikanabis »

Polici  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

# Parandalimi i krimit mjedisor, si përgjegjësi e policisë gjyqësore



■ **MSc. Nikoll RICA**  
Drejtorja e Përgjithshme e PSH



■ **MSc. Erand RICA**  
BOKU-Universitat für Bodenkultur, Vjenë, Austri

## Abstrakt

*Nëpërmjet kësaj teme, synojmë të përcillet tek lexuesi informacion i zgjeruar mbi veprat penale që mund të kryhen kundër mjedisit, veçoritë e ndjekjes penale, të zbulimit dhe veçanërisht të veprimtarisë parandaluese që ushtrohet nga shërbimet e Policisë Gjyqësore. Këto lloje krimesh janë ndeshur me kohë në vendin tonë, kanë karakter ndërkombëtar dhe sjellin pasoja tepër të rënda për jetën dhe shëndetin e çdo njeriu. Cilësia e ajrit, cilësia e ujit, niveli i pastërtisë nga mbetjet, niveli i zhurmave dhe mbrojtja e biodiversitetit janë elementët më thelbësorë për një jetë të shëndetshme. Fatkeqësisht, në dy dekadat e fundit, në rajonin e Ballkanit dhe veçanërisht në Shqipëri, konstatohet shtimi i veprimtarisë kriminale kundër mjedisit. Ndërkohë, tema fokusohet tek tiparet dhe mekanizmat parandalues apo mbrojtës që parashikohen në aktet ndërkombëtare dhe në legjislacionin e brendshëm ndaj mjedisit. Aspekti i analizës juridike të këtyre veprave penale trajtohet i lidhur ngushtë me veprimtarinë procedurale penale si dhe detyrat që duhet të kryejnë strukturat ligjzbatuese për investigimin e kësaj veprimtarie. Kjo analizë bëhet nga këndvështrimi i praktikës hetimore e gjyqësore, bazuar në të dhënat statistikore të Policisë së Shtetit dhe prokurorisë në Shqipëri. Gjithashtu, trajtohet bashkëpunimi i strukturave të Policisë së Shtetit me Inspektoratin Pyjor në planin dypalësh dhe rajonal për shkëmbimin e informacionit kriminal dhe realizimin e operacioneve të përbashkëta në funksion të mbrojtjes së mjedisit. Me interes për lexuesin, do të jetë trajtimi i niveleve të rrezikut ndaj mjedisit, të identifikuar si: degradimi mjedisor dhe fatkeqësitë natyrore; shkatërrimi i mjedisit; si dhe shpyllëzimi, ndotja e lumenjve dhe fatkeqësitë natyrore apo industriale të shkaktuara nga ndikimi i njeriut. Këta faktorë që konsiderohen si rrezik i nivelit të parë ndaj mjedisit, njëkohësisht vlerësohen si prioritet të larta në punën e organeve përgjegjëse për parandalimin e tyre. Në të njëjtin grup rreziqesh, përfshihen edhe korrupsioni e krimi i organizuar, si faktorë të lartë rreziku ndaj degradimit mjedisor. Ndërkohë, ndryshimet klimatike, ndonëse vlerësohen si rrezik i nivelit të tretë, duhet të konsiderohen serioze në politikat e shteteve për shmangien pasojave që sjellin ndryshimin jonatyror të klimës.*

## Fjalëkyçe:

**krim mjedisor, biodiversitet, cilësi e ajrit, mbetje, riciklim, informacion kriminal, provë materiale, proces hetimor e gjyqësor.**

Rica, N.  
dhe  
Rica, E.

« Parandalimi i  
krimit mjedisor,  
si përgjegjësi e  
policisë  
gjyqësore »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

## 1. Hyrje

Në raport me mjedisin që na rrethon dallojmë: mjedisin shoqëror, mjedisin kulturor dhe mjedisin natyror. Mjedisi natyror, për vetë rëndësinë dhe karakterin e shtrirjes, krijon tek njerëzit një perceptim më të gjerë në raport me dy të parat. Ai është tërësia e rrethanave përreth një organizmi ose grup organizmash, veçanërisht ndërthurja e kushteve të jashtme fizike e natyrore që veprojnë dhe ndikojnë në rritjen, zhvillimin dhe mbijetesën e organizmave. Ajri, uji dhe klima përbëjnë elementët bazë të mjedisit natyror, pa të cilët nuk ka jetë. Për këtë arsye, mbrojtja e elementeve bazë të mjedisit është një domosdoshmëri për jetën dhe shëndetin e çdo njeriu. Cilësia e ajrit, cilësia e ujit, niveli i pastërtisë nga mbetjet, niveli i zhurmave dhe mbrojtja e biodiversitetit janë elementet më thelbësore për një jetë të shëndetshme. Në këtë kuptim, mbrojtja e mjedisit është një nga detyrat kryesore të së gjithë shoqërisë, çdo qytetari dhe pa dyshim strukturave të pushtetit qendror e vendor në veçanti. Në funksion të këtij qëllimi, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, që në vitin 1972, ka caktuar datën 5 qershor,<sup>1</sup> si “Dita ndërkombëtare e mjedisit”, me qëllim që të shtojë vetëdijen e shoqërisë rreth çështjeve të mjedisit, për t’u tërhequr vëmendjen politikanëve të shteteve ndaj këtyre çështjeve si dhe për të nxitur veprimin individual të çdo njeriu në këtë drejtim. Në këtë kuadër, edhe Shqipëria ka miratuar paketën e saj ligjore<sup>2</sup> në përputhje me standardet

<sup>1</sup> U zgjodh kjo datë sepse përkon me ditën e hapjes e Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin, që u mbajt në vitin 1972 në Stokholm, nën udhëheqjen e Programit Mjedor të Kombeve të Bashkuara.

<sup>2</sup> Ligji nr. 10 1431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Ligji nr. 10 458, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”.

Ligji nr. 162/2014, “Për rritjen e cilësisë së ajrit në mjedis”.

Ligji nr. 103/2014, “Për strategjinë e sigurisë kombëtare të vendit për mjedisin”.

*Rica, A.  
dhe  
Rica, E.*

« Parandalimi i  
krimit mjedor,  
si përgjegjësi  
e policisë  
gjyqësore »

Policimi  
dhe  
Siguria  
**nr.7, 2017**

ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit.

Që prej vitit 2009, në takimin e palëve të “Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike” (KKKBNK), të zhvilluar në Kopenhagën dhe në vijim, Shqipëria ka mbështetur qëndrimin e Bashkimit Evropian dhe komunitetit ndërkombëtar për gjithpërfshirjen e të gjitha palëve të konventës, në arritjen e një marrëveshjeje të detyrueshme në Paris (2015), për reduktimin e gazeve me efekt serrë. Ndërkohë, Shqipëria ka filluar procesin e ndryshimit të statusit, nga një vend në zhvillim në një vend të zhvilluar, në kontekstin e Konventës për Ndryshimet Klimatike. Ky proces është pjesë integrale e procesit të integritimit në Bashkimin Evropian dhe përfshin zhvillimin e kapaciteteve në nivel kombëtar për monitorimin dhe raportimin vjetor të “gazeve me efekt serrë” (GHG), formulimin dhe zbatimin e politikave për reduktim të GHG dhe adaptim ndaj ndryshimeve klimatike, transpozimin dhe zbatimin e *acquis* të Bashkimit Evropian lidhur me ndryshimet klimatike, përfshirë zbatimin e masave kombëtare të përshtatshme për reduktim të GHG (NAMA-s).

Një nga format e mbrojtjes së mjedisit, është veprimtaria parandaluese që ushtrojnë shërbimet e Policisë Gjyqësore si dhe parashikimi i dënimeve penale, për një sërë sjelljesh që dëmtojnë rëndë mjedisin që na rrethon. Legjislacioni penal mjedisor në Shqipëri, prej kohësh ka parashikuar një sërë veprash penale si ndotja e ajrit, ndotja e ujit, prerja e paligjshme e pyjeve, peshkimi i paligjshëm, prishja e qetësisë publike etj. Megjithatë, numri i të dënuarve për këto vepra penale, është i ulët krahasuar me perceptimin publik për përhapjen e këtyre veprave. Ndërkohë, shqetësues mbetet mungesa e denoncimeve për raste konkrete nga qytetarët si dhe sigurimi i provave të domosdoshme për kapjen dhe dënimin e autorëve. Zgjidhja e mundshme e këtij problemi do të ishte një bashkëpunim sa më i madh i komuniteteve të prekura nga krimi mjedisor me Policinë e Shtetit në kuadër të policimit në komunitet. Një bashkëpunim i tillë ndërmjet qytetarëve dhe policisë do të siguronte rritjen e numrit të procedimeve dhe dënimeve penale ndaj autorëve të krimeve mjedisore.

## 2. Kuptimi dhe elementët kryesorë të mjedisit

Mjedisi konsiderohet si një ndër elementët bazë dhe të pazëvendësueshëm për jetën e çdo njeriu, pa të cilin nuk ka lindje, zhvillim dhe të ardhme të shoqërisë. Cilësia dhe pastërtia e ajrit e ujit; grumbullimi, transportimi apo përpunimi i mbetjeve; shmangia e zhurmave dhe mbrojtja e biodiversitetit, janë elementet më thelbësorë për jetën e çdo shtetasi. Në këtë kuptim mbrojtja e mjedisit përbën një nga faktorët bazë të sigurisë së përgjithshme të çdo vendi, pa të cilin nuk ka jetë të popujve apo të ardhme të brezave. Rreziqet që vijnë sot nga degradimi mjedisor, fatkeqësitë natyrore, shkatërrimi i mjedisit, shpyllëzimi pa kriter, ndotja e lumenjve apo fatkeqësi të tjera natyrore e industriale të shkaktuara nga ndikimi i njeriut, konsiderohen si rreziqe të nivelit të parë, të cilat mund të parandalohen vetëm me forcim të rreptë të masave parandaluese e shtrënguese, sidomos nga organet ligjzbatuese, por, edhe komuniteti në tërësi.

Përvoja e viteve të fundit tregon se, jo vetëm në vendet e BE-së, apo të Ballkanit Perëndimor, por edhe në ShBA e më gjerë, rreziqet e degradimit mjedisor shtohen nga shtrirja kaotike e qendrave urbane, prerja masive e pyjeve, dëmtimi i tokave bujqësore, ndotja e lartë e baseneve hidrike apo gërryerja e lumenjve. Këto dukuri prodhojnë pasoja në territor, peizazhin urban, në shëndetësi dhe në ekonominë e çdo vendi. Prandaj të gjitha agjencitë ligjzbatuese duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë

*Rica, N. dhe Rica, E.*  
« Parandalimi i krimit mjedisor, si përgjegjësi e policisë gjyqësore »

Policimi dhe Siguria  
nr.7, 2017

parandalimit të degradimit mjedisor, reduktimit të pasojave të ndryshimeve klimatike, duke: menaxhuar me efektivitet basenet ujore, shtuar sipërfaqet pyjore, trajtuar në mënyrë të integruar mbetjet urbane, si dhe duke bashkëpunuar me shoqërinë civile për ndërgjegjësimin e opinionit publik për ruajtjen e mjedisit.

Për realizimin e këtij qëllimi nuk ka një model të njëjtë të masave, por aplikohen modele të ndryshme për mbrojtjen e mjedisit në përputhje me:

- specifikat apo veçoritë e çdo vendi,
- legjislacionin kombëtar të tyre,
- marrëveshjet dhe protokollet ndërkombëtare të ratifikuara,
- strukturat ligjzbatuese që funksionojnë në çdo vend,
- sistemet e drejtësisë,
- traditën e çdo vendi etj.

Modelet e strukturave ligjzbatuese që kontrollojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit në vendet e BE-së, apo jashtë saj, janë të ndryshme, në varësi të:

- ndërtimit të tyre,
- përgjegjësiwe funksionale që ato kanë,
- veprimtarisë praktike që ushtrojnë.

Kështu:

- Ka disa modele ku inspektoratet për mbrojtjen e mjedisit përfshihen në Ministrinë e Brendshme, por ka një linjë të pavarur komandimi dhe kontrolli nga Ministria e Mjedisit (p.sh. Finlanda dhe Estonia).

- Ka modele të përziera ku funksione të ndryshme të ruajtjes së mjedisit kryhen nga organizata të ndryshme, pa pasur një shërbim të centralizuar në një ministri (p.sh. Greqia).

- Ka modele ku inspektoratet për mbikëqyrjen dhe kontrollin e shkeljeve ndaj mjedisit janë në vartësi të Ministrisë së Mjedisit, dhe punonjësit e tyre gëzojnë dhe ushtrojnë atributet e policisë gjyqësore (p.sh. Kroacia, Sllovenia, Shqipëria etj.).

Në lidhje me këtë çështje, mund të nxirret si konkluzion se:

Nuk ka një model universal shërbimi apo inspektorati për mbrojtjen e mjedisit, por të gjitha modelet duhet të ndjekin disa standarde universale.

Elementët kryesorë të mjedisit janë: cilësia e ajrit, cilësia e ujit, niveli i pastërtisë nga mbetjet, niveli i zhurmave dhe mbrojtja e biodiversitetit. Në varësi të mbrojtjes së këtyre elementëve varet edhe niveli i rrezikut ndaj mjedisit, ku në mënyrë të grupuar mund të rendisim: degradimin mjedisor dhe fatkeqësitë natyrore; shkatërrimin e mjedisit; si dhe shpyllëzimin, ndotjen e lumenjve dhe fatkeqësitë natyrore apo industriale të shkaktuara nga ndikimi i njeriut. Këta faktorë konsiderohen si rrezik i nivelit të parë ndaj mjedisit, njëkohësisht vlerësohen si prioritete të larta në punën e organeve përgjegjëse për parandalimin e tyre. Në të njëjtin grup rreziqesh përfshihen dhe korrupsioni e krimi i organizuar, si faktorë të lartë rreziku ndaj degradimit mjedisor. Ndërkohë, ndryshimet klimatike, ndonëse vlerësohen si rrezik i nivelit të tretë, duhet të konsiderohen serioze në politikat e shteteve për shmangien e pasojave që sjellin ndryshimin jo natyror të klimës.

### **3. Përqasja e legjislacionit shqiptar me aktet ndërkombëtare për mjedisin**

Duke e konsideruar mjedisin si elementin bazë për jetën e çdo njeriu, mbrojtja dhe

*Rica, A.  
dhe  
Rica, E.*  
« Parandalimi i  
krimit mjedisor,  
si përgjegjësi  
e policisë  
gjyqësore »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

rehabilitimi i tij përbën parakusht për gëzimin e të drejtave të çdo individi në shoqëri. Mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit janë pjesë integrale e gëzimit të së drejtës për shëndet, për ushqim dhe cilësi jetese më të mirë për të gjithë. Në të kundërtën, dëmtimi apo shkatërrimi i mjedisit sjell pasoja të rënda për klimën, florën dhe faunën, duke cenuar rëndë vetë ekzistencën e jetës së njeriut në tokë. Për këtë arsye, edukimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve mbi rëndësinë e mjedisit përbën mjetin kryesor të mbrojtjes së tij. Këto vlera krijohen e konsolidohen kur parashikohen procedura standarde e të paanshme për të gjithë. Krijimi dhe funksionimi i kuadrit ligjor funksional për mbrojtjen e mjedisit përbën hapin e parë të këtij procesi.

Korniza ligjore për mjedisin ka ngjashmëri ndërmjet vendeve të ndryshme, për sa i përket vendosjes së standardeve të përgjithshme të mbrojtjes së tij. Ndërkohë, ka dallime në modalitetet e funksionimit të strukturave ligjzbatuese që kontrollojnë regjimin mjedisor si dhe ushtrimin e attributeve të policisë gjyqësore, në këtë proces. Këto dallime varen nga legjislacioni dhe statusi që gëzojnë agjencitë ligjzbatuese të çdo vendi.

Disa nga aktet e përbashkëta të vendosura nga Këshilli i Europës lidhur me mbrojtjen e mjedisit, janë:

- *Traktati i Romës*<sup>3</sup>. Ndonëse Traktati për Komunitetin Ekonomik Europian, që parashikohej në këtë dokument, nuk kishte objektiv të mirëfilltë mbrojtjen e mjedisit, dispozitat e tij mund të zbatoheshin edhe për çështje mjedisore. Në funksion të këtij qëllimi, Këshilli i Europës më vonë aprovoi rreth 150 akte normative - gjatë viteve 1967-1987, - ku ndër të tjera, Akti Unik Europian parashikoi një seksion të posaçëm për mjedisin. Qëndrimi për mjedisin u shfaq më qartë në Samitin e Parisit<sup>4</sup> si një vijim edhe i Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Mjedisin Njerëzor të Stokholmit.

- *Akti Unik Europian*<sup>5</sup>. Parashikon mbrojtjen mjedisore si një objektiv kryesor të Komunitetit Europian si dhe përkrah parimin e afërsisë, që do të thotë: dëmi mjedisor duhet ndaluar, zvogëluar apo shmangur që në burim dhe të bëhet zhëmtimi nga ndotësit. Në thelb të kësaj mase është parandalimi i ndotjes së mjedisit. Në këtë akt u parashikuan edhe masa të forta lidhur me shëndetin, sigurinë, mbrojtjen e mjedisit dhe të konsumatorit. Kjo bëhej me qëllim vendosjen e tregut të përbashkët.

- *Konferenca e Amsterdimit*<sup>6</sup>. Parashikon zhvillimin e politikave komunitare lidhur me mjedisin, duke synuar një nivel më të lartë të mbrojtjes së tij në përshtatje me diversitetin e situatave në rajone të veçanta. Ndërkohë vendimet e tjera të kësaj konference u fokusuan në integrimin e mjedisit në fusha të tjera të politikave të BE-së, ku një vëmendje e veçantë ju kushtua fushatës për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e social që synon të luftojë varfërinë dhe të ndihmojë integrimin e vendeve në zhvillim.

- *E drejta Penale Europiane*. Parashikon mbrojtjen e mjedisit duke sanksionuar dispozita penale ndëshkuese për personat fizikë e juridikë që cenojnë, shkatërrojnë apo ndotin mjedisin. Mbrojtja e mjedisit përmes të Drejtës Penale Europiane, si kohë, është zhvilluar më vonë se ajo sipas fushave të veçanta mjedisore<sup>7</sup>. Krimi mjedisor lidhet me veprimet që shkelin legjislacionin mjedisor dhe shkaktojnë dëm apo rrezikojnë mjedisin dhe shëndetin njerëzor.

Veprat penale që lidhen me krimin mjedisor, sipas të Drejtës Penale Europiane<sup>8</sup>,

<sup>3</sup> E drejta e Mjedisit e BE-së - EU Environmental Law.

<sup>4</sup> Në vitin 1973.

<sup>5</sup> Në vitin 1986.

<sup>6</sup> Në vitin 1999.

<sup>7</sup> Center for International Environmental Law.

<sup>8</sup> Environmental crime.

mund t'i grupojmë në:

- vepra që lidhen me emetimet e paligjshme apo shkarkimet e substancave në ajër, ujë apo tokë;

- vepra që lidhen me tregtinë e paligjshme të kafshëve të egra;

- vepra që lidhen me tregtinë e paligjshme të substancave që ndikojnë në pakësimin e ozonit;

- vepra që lidhen me transportimin apo hedhjen e paligjshme të mbeturinave etj.

Bazuar në Traktatin e Mastrohtit<sup>9</sup>, aktet ndërkombëtare kanë epërsi ndaj legjislacionit kombëtar të shteteve anëtare. Për rrjedhojë shtetet që i kanë ratifikuar dhe nënshkruar këto marrëveshje duhet që aktet e tjera që aprovojnë, siç është rasti i akteve për mjedisin, të jenë në pajtueshmëri të plotë me marrëveshjet ndërkombëtare. Edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë<sup>10</sup> parashikohet që: "Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me to".

Disa nga aktet e brendshme që parashikon legjislacioni shqiptar lidhur me mbrojtjen e mjedisit janë:

- *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*. Referuar përbajtjes së neneve të Kushtetutës lidhur me fushën mjedisore rezulton se ato janë në përputhje të plotë me kushtetutat e vendeve të tjera demokratike, që u kushtojnë rëndësinë e nivelit të lartë parimeve mjedisore. Në nenin 59, pika "d" dhe "dh" të këtij akti njihet si objektiv social e drejta për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, si dhe shfrytëzimi racional i pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

- *Ligji nr. 10431, datë 9. 6. 2011, "Për mbrojtjen e mjedisit"*. Sipas këtij ligji mjedisi përkufizohet si: "përbërësit natyrorë ajri, toka, ujërat, klima, flora dhe fauna në tërësinë e ndërveprimeve të këtyre elementeve me njëra-tjetrën, si dhe trashëgimia kulturore, si pjesë e mjedisit të krijuar nga njeriu". Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

- *E drejta penale shqiptare*. Si hap i parë, mbrojtja e mjedisit parashikohet e garantohet në ligje të veçanta, që ngarkojnë me përgjegjësi institucionet administrative për zbatimin e tyre si dhe aplikimin e kundërvajtjeve administrative ndaj shkelësve të këtyre akteve. Por, kur shkeljet përsëriten, apo sjellin pasoja të rënda, atëherë mjedisin e merr në mbrojtje legjislacioni penal, i cili luan rol të veçantë në parandalimin e shkeljeve mjedisore si dhe në dënimin e personave që kryejnë vepra penale mjedisore. Në funksion të këtij qëllimi, kodi penal i Republikës së Shqipërisë parashikon një sërë veprash penale në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Nga koha e miratimit të këtij kodi, (janar 1995), e deri tani ka pasur një rritje të ndjeshme të numrit të veprave penale që marrin në mbrojtje mjedisin, si dhe specifikime më të detajuara të këtyre veprave. Në pikëpamje të analizës juridike, veprat penale në fushën e mjedisit klasifikohen në krime dhe kundërvajtje penale. Kjo, në varësi të rrezikshmërisë shoqërore që paraqesin këto vepra penale si dhe ardhjes së pasojave prej tyre. Një karakteristikë e veçantë e këtyre veprave është se nuk kërkohet ardhja e pasojave të rënda për kualifikimin ligjor të tyre. Veprat penale<sup>11</sup> që

**Rica, A.  
dhe  
Rica, E.**

« Parandalimi i krimit mjedisor, si përgjegjësi e policisë gjyqësore »

Policimi  
dhe  
Siguria  
**nr.7, 2017**

<sup>9</sup> Traktati i Mastrohtit, 1992.

<sup>10</sup> Neni 122, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë".

<sup>11</sup> Kreu IV i pjesës së posaçme, të kodit penal shqiptar.

aktualisht parashikon kodi penal shqiptar në funksion të mbrojtjes së mjedisit janë:

- ndotja e ajrit;
- transportimi i mbeturinave toksike;
- ndotja e ujërave;
- peshkimi i ndaluar;
- prerja e paligjshme e pyjeve;
- shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor;
- prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë;
- shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve.

Nga pikëpamja, formale rezulton se legjislacioni mjedisor në Shqipëri është i mirë e në koherencë të plotë me direktivat ndërkombëtare për mjedisin. Problemi qëndron tek ushtrimi i përgjegjësive dhe detyrave nga strukturat ligjzbatuese, për zbatimin praktik të akteve për mjedisin. Vitet e gjata të tranzicionit shqiptar u shoqëruan me pasoja të rënda edhe ndaj mjedisit. U prenë dhe u dogjën sipërfaqe të mëdha me pyje, në veri e jug të Shqipërisë, u gërryen shtretërit e lumenjve, u asgjësuan kafshë të rralla, u shkatërruan sipërfaqe të gjelbëruara nga gërmimet për mermer, çimento apo gëlqere, u ndotën ujërat dhe mjediset përreth qendrave të banuara, si dhe dëme të tjera, të cilat kërkojnë kohë të gjatë për rikuperimin e tyre. Ndryshimi i kësaj gjendje kërkon hartimin e strategjive e politikave integruese, miratimin e moratoriumeve, ndryshimeve strukturore të organeve përgjegjëse, e mbi të gjitha, rritjen e perceptimit dhe ndjeshmërisë tek publiku për mbrojtjen e mjedisit.

#### **4. Politika integruese e mbrojtjes së mjedisit, si pjesë e politikës së sigurisë kombëtare**

Dihet se, shoqëria ndërtohet mbi diversitetin e impaktit njerëzor, me ndërthurje idesh dhe idealesh, si dhe me kontributin e vlerave të çdo njeriu. Elementi i vetëm që duhet të bashkojë shoqërinë për një kontribut dhe përkushtim të përbashkët është mjedisi. Ndonëse të gjithë ne e ndërtojmë jetën individualisht, ajo që na bashkon në një entitet të përbashkët dhe na bën pjesë të një pasurie teje të çmuar, përtej interesave personale, është natyra dhe mjedisi. Prandaj hartimi i politikave për mbrojtjen e mjedisit duhet të jetë prioritet e çdo vendi, pavarësisht shtrirjes gjeografike, peshës ekonomike apo fuqisë globale të tij.

Që të hartohen politika integruese e funksionale, duhet fillimisht të analizohen shkaqet dhe të përcaktohen faktorët e rrezikut ndaj mjedisit. Nga analiza e këtyre faktorëve ka rezultuar se Shqipëria është vend i ekspozuar ndaj rreziqeve me origjinë natyrore të karakterit gjeologjik, hidrologjik, atmosferik dhe biofizik, si dhe atyre me origjinë njerëzore, teknologjike dhe industriale. Në rang botëror Shqipëria renditet ndër vendet me pasoja të larta ekonomike nga fatkeqësitë. Rreth 86% e territorit ku gjenerohet afërsisht 88,5% e PBB-së, është e ekspozuar ndaj dy ose më shumë rreziqeve. Ndërkohë, sistemi i mbrojtjes civile është i pamjaftueshëm për të menaxhuar numrin në rritje të emergjencave dhe rehabilitimin e shpejtë të gjendjes së shkaktuar prej tyre.

Gjithashtu, ndryshimi i klimës është një dukuri tjetër globale, që ndikon negativisht në ekuilibrat natyrorë të Shqipërisë. Për shkak të klimës, vendi mund të përballet me fenomene të skajshme më të shpeshta si temperatura të larta, thatësira të zgjatura dhe përmytje të mëdha. Kjo mund ta ballafaqojë vendin tonë me rrezikun nga fatkeqësitë hidrologjike, gjeologjike dhe biofizike, që prekin zonat e banuara dhe ndikojnë në

*Rica, N.  
dhe  
Rica, E.*

« Parandalimi i  
krimit mjedisor,  
si përgjegjësi e  
policisë  
gjyqësore »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017



mënyrë të konsiderueshme në ekonominë kombëtare. Por, edhe degradimi i mjedisit në Republikën e Shqipërisë është një dukuri shumë shqetësuese, e cila shfaqet në forma të ndryshme si shtrirja kaotike e qendrave urbane, prerja masive e pyjeve, dëmtimi i tokave bujqësore, ndotja e lartë e baseneve hidrike dhe gjërryerja e lumenjve. Këto dukuri kanë prodhuar pasoja të dëmshme në territor, në peizazhin urban, në shëndetësi dhe në tërësi në ekonominë e vendit. Shqipëria është e prekur dhe rrezikohet edhe nga erozioni. Zonat më problematike janë ultësira perëndimore, luginat e lumenjve të mëdhenj dhe bregdeti i Adriatikut, ku vija bazë e detit po tërhiqet. Në brendësi të territorit, erozioni parashikohet të shkaktojë reduktim të tokës së punueshme dhe burimeve ujore.

Për këto arsye, politikat që hartohen për mjedisin duhet të kenë si qëllim mbrojtjen e tij në një nivel të lartë, ruajtjen, përmirësimin, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Në funksion të mbrojtjes së mjedisit, Republika e Shqipërisë<sup>12</sup> ka hartuar dhe miratuar objektiva në pajtueshmëri të plotë me Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK)<sup>13</sup>, të zhvilluar në Kopenhagën COP 15, si dhe direktivat e Bashkimit European, ku më kryesoret janë:

- parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;

- ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;

- ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;

- përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;

- ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;

- mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;

- mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.

Në realizimin e politikave integruese, krahas masave ligjore, organizative dhe administrative; edukimi mjedisor përbën një faktor shumë të rëndësishëm në mbrojtjen e kësaj pasurie të çmuar që natyra i ka ofruar njeriut. Mjedisi duhet të perceptohet si një pasuri e përbashkët, i cili, i përket të gjithë brezave. Ky edukim duhet të realizohet me të gjithë shoqërinë, por, në radhë të parë me nxënësit e shkollave dhe të rinjtë. Pa edukim mjedisor të brezave të rinj, çdo iniciativë apo reformë mjedisore që mund të merret nga organet shtetërore, nuk do të kishte sukses. Edukimi mjedisor është po aq i rëndësishëm sa edhe edukimi shoqëror, mjekësor, sportiv etj. Ky edukim sjell harmoni brenda vetë komunitetit, bashkon njerëzit dhe i lidh ata me njëri-tjetrin, brez pas brezi. Kushdo që kontribuon për mbrojtjen e mjedisit, në radhë të parë ka kontribuar për sigurinë kombëtare.

## 5. Veprimtaria parandaluese e policisë gjyqësore për mbrojtjen e mjedisit

Krimi mjedisor mund të konsiderohet si forma më ekstreme e dëmtimit të mjedisit

<sup>12</sup> Neni 3 i ligjit nr. 10 1431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".

<sup>13</sup> Shqipëria është anëtarësuar në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK), në janar 1995 dhe në Protokollin e Kiotos, Janar 2005.

Rica, A.  
dhe  
Rica, E.

« Parandalimi i  
krimit mjedisor,  
si përgjegjësi  
e policisë  
gjyqësore »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

në mënyrë të qëllimshme dhe ilegale. Niveli i ulët ekonomik dhe varfëria janë faktorë që i nxisin këto lloj krimesh, por, kurrësi ato nuk mund të justifikojnë degradimin apo shkatërrimin mjedisor. Kjo për faktin se ky fenomen nuk cenon vetëm një grup të vogël njerëzish, por të gjithë shoqërinë. Prandaj, zbatimi i kuadrit ligjor është barriera e parë e pengimit dhe ndalimit të krimeve mjedisore.

Autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e parandalimit dhe zbulimit të veprave penale mjedisore është Policia e Shtetit. Ajo ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë të çelë procedime policore si dhe të kryejë të gjitha veprimet hetimore sipas rregullave që parashikon Kodi i Procedurës Penale për dokumentimin e veprimtarisë kriminale në fushën e mjedisit.

Duke ju referuar të dhënave statistikore mbi veprat penale të ndodhura, rezulton se deri në vitin 2014, Policia e Shtetit nuk i evidentonte si tregues i veçantë veprat penale kundër mjedisit. Ato grupoheshin tek kolona: “*Të tjera*” në rubrikën “*Hetimi dhe parandalimi i krimit*”, duke i përfshirë si volum, pa ndonjë prioritet. Nga janari i vitit 2014 e në vazhdim këto vepra evidentohen të ndara sipas parashikimeve të kodit penal dhe përbëjnë prioritet në ndjekjen e veprimtarisë kriminale që ushtron Policia e Shtetit. Statistikat e përgjithshme të veprave penale kundër mjedisit për vitet 2014-2016, rezulton të jenë si më poshtë (*shih tabelën*).

Duke ju referuar statistikave të mësipërme (*në tabelë*) arrihet në disa përfundime:

- Numrin më të madh në volum të këtyre veprave e zë prerja e paligjshme e pyjeve, (rreth 770 vepra penale të evidentuara për tre vjet). Në fakt kanë ndodhur më shumë vepra penale të prerjes së paligjshme të pyjeve, por nuk është raportuar apo proceduar ndaj tyre.

- Si objekt parësor në punën e Policisë së Shtetit, këto vepra janë ndjekur nga viti 2015 e në vazhdim. Më përpara, ato trajtoheshin nga policia si tendenca kriminale të dorë së dytë, duke ja lënë për ndjekje inspektoratit dhe policisë pyjore.

- Nisur nga kushtet në të cilat ndodhin këto lloj veprash, mekanizmi i kryerjes së tyre si dhe mjetet që përdoren për t'i realizuar, ato kanë probabilitet më të lartë në zbulim. Konkretisht, nga 1014 vepra penale kundër mjedisit, të evidentuara për vitet 2014-2016, janë të zbuluara 971 ose 95.7%, shifra më e lartë kjo, në raport me zbulimin e veprave të tjera penale. Por, duhet marrë në konsideratë edhe faktori negativ, ku një pjesë e mirë e veprave penale të ndodhura kundër mjedisit nuk evidentohen nga policia, apo nuk kallëzohen nga shtetasit.

- Janë kapur në kushtet e flagrancës një numër i vogël autorësh, - vetëm 79 prej tyre, - ndërsa 976 të tjerë janë referuar në gjendje të lirë.

- Masat e dënimit ndaj autorëve të këtyre veprave penale kanë qenë të ulëta, ku shumica e tyre janë dënuar me gjobë. Ky qëndrim i mbajtur nga ana e gjykatës, ndërkombëtarë, duke rritur rolin e të gjithë pjesëmarrësve në luftë kundër mjedisit. Në fakt duhet të ndodhë e kundërta, për shkak të prioritetit që merr mbrojtja e ajrit, ujit dhe klimës, si elementët bazë të mjedisit natyror, pa të cilët nuk ka jetë. Ashpërsimi i dënimit ndaj autorëve të veprave penale kundër mjedisit duhet të jetë prioritet i politikës penale nga ligjvënësi.

Krahas veprimtarisë hetimore që kryen policia gjyqësore për zbulimin dhe dokumentimin e veprimtarisë kriminale në fushën e mjedisit, një faktor shumë i rëndësishëm që ndikon në forcimin e kësaj lufte është veprimtaria parandaluese. Kjo veprimtari duhet të jetë një betejë që zhvillohet çdo ditë nga të gjitha organet shtetërore, por në radhë të parë është një përgjegjësi që i përket organeve të policisë gjyqësore, e

Rica, N.  
dhe  
Rica, E.

« Parandalimi i  
krimit mjedisor,  
si përgjegjësi e  
policisë  
gjyqësore »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

NR.	Neni	VEPRA PENALE SIPAS TENDECAVE	VEPRA PENALE						Shuma	AUTO RË TË VEPRAVE PENALE											
			EVIDENTUAR			ZBULLUAR				MASAT E MARRA											
										Arrestuar			Ndaluar			Gj. Lirë			Larguar		
			2014	2015	2016	2014	2015	2016		2014	2015	2016	2014	2015	2016	2014	2015	2016	2014	2015	2016
<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>			<b>5</b>			<b>1125</b>	<b>7</b>			<b>8</b>			<b>9</b>			<b>10</b>		
<b>A</b>	<b>Neni</b>	<b>KRIME KUNDER MJEDISIT</b>	<b>360</b>	<b>411</b>	<b>243</b>	<b>355</b>	<b>392</b>	<b>224</b>		<b>34</b>	<b>44</b>	<b>38</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>8</b>	<b>381</b>	<b>387</b>	<b>208</b>	<b>9</b>	<b>6</b>	<b>7</b>
1	201	Vepra penale kundër mjedisit ndotja e ajrit	29	27	20	29	27	17	81	0	2	5	0	0	1	28	32	11	2	0	0
2	202	Transportimi i mbeturinave toksike	1	1	0	1	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0
3	203	Ndotja e ujërave	3	7	4	3	6	2	10	0	0	0	0	0	0	3	5	2	0	0	0
4	204	Peshkimi i ndaluar	24	21	12	24	21	11	88	8	2	2	1	0	0	30	28	14	2	0	0
5	205	Prerja e paligjshme e pyjeve	268	319	183	265	310	174	847	21	39	30	0	0	6	285	292	159	2	6	6
6	206	Prerja e drurëve dekorative dhe frutore	24	27	16	23	25	14	77	1	1	1	0	0	0	26	28	18	2	0	0
7	206/a	Shkatërimi me zjarr i pyjeve dhe mjedisit pyjor	2	5	4	1	0	2	3	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	1
8	206/b	Shkatërimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve	3	4	0	3	2	0	5	0	0	0	0	0	0	3	2	0	0	0	0
9	207	Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve	6	0	4	6	0	4	13	3	0	0	0	0	0	6	0	4	0	0	0

veçanërisht shërbimeve të Policisë së Shtetit. Procesi i grumbullimit, sistemimit, vlerësimit, analizimit, shpërndarjes dhe përdorimit të informacionit policor për nevoja të mbrojtjes së mjedisit përbën një ndër masat më të rëndësishme të Policisë së Shtetit në planin parandalues. Veprimtaria informative që realizohet gjatë këtij procesi, bazohet vetëm në të dhënat e marra në përputhje me ligjet përkatëse si dh aktet normative të nxjerra në zbatim të tyre. Sipas ligjit të ri të Policisë së Shtetit<sup>14</sup>, punonjësi i policisë ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë të mbledhë të dhëna për parandalimin dhe zbulimin e krimeve në fushën e krimit mjedisor, duke shfrytëzuar çdo burim që mund t'i japë të dhëna.

Parandalimi nuk është thjesht identifikim apo kapje e autorit të krimit, por, para së gjithash, krijimi i një klime sociale që frenon dhe pengon kryerjen e veprave penale kundër mjedisit. Me anë të veprimtarisë parandaluese, shërbimet e Policisë së Shtetit mësojnë mbi përgatitjet apo krimet e kryera në fushën e mjedisit, mbledhin informacione e të dhëna për ato që mund të kryhen, si dhe u krijojnë mundësinë organeve të tjera shtetërore për të parandaluar degradimin mjedisor. Janë të paimagjinueshme pasojat që mund të vijnë nga mungesa e informacionit dhe mosmarrja e masave parandaluese për vepra penale të rënda, si: shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor, ndotja e ajrit, prerja e paligjshme e pyjeve, transportimi i mbeturinave toksike etj.

Pavarësisht rëndësisë që ka veprimtaria e Policisë së Shtetit në parandalimin e krimit mjedisor, ky rol ka një ndikim disi të kufizuar. Kjo, për arsye se, siç përmendëm më sipër, faktorët e krimit mjedisor janë të lidhur jo vetëm me varfërinë apo nivelin e ulët kulturor të autorëve të këtyre veprave penale, por edhe me faktorë të tjerë ekonomikë, socialë, rajonalë e më gjerë. Parandalimi i përgjithshëm i krimit mjedisor, karakterizohet nga aplikimi i masave të veçanta që janë elementë të domosdoshëm për tu parashikuar në hartimin e strategjive dhe programeve në mbrojtje të mjedisit. Ato janë të lidhura me përmirësimin e nivelit të jetesës së popullatës, arsimin, krijimin e klimës pozitive për shmangien e shkaqeve dhe kushteve të kriminalitetit etj. Për rrjedhojë veprimtaria parandaluese e policisë gjyqësore në mbrojtje të mjedisit duhet të orientohet drejt bashkëpunimit të ngushtë me të gjithë faktorët e tjerë, subjektet shtetërore dhe komunitetin në tërësi. Në strategjitë e parandalimit të krimit mjedisor duhet të përshkallëzohen veprimtaritë sipas niveleve: lokalë, rajonalë, kombëtarë e duke rritur rolin e të gjithë pjesëmarrësve në luftë kundër krimit mjedisor.

Krahas përgjegjësive të agjencive ligjzbatuese, duhet vlerësuar veprimtaria e komunitetit dhe shoqërisë në tërësi, të cilat janë të interesuara më shumë se kushdo tjetër për stabilitetin mjedisor. Ato janë të gatshme në çdo kohë të mbështesin dhe kontribuojnë në parandalimin e veprimtarisë kriminale mjedisore. Kjo do të thotë që, kur punonjësi i Policisë së Shtetit identifikon një rrezik të krimit mjedisor apo i kërkon ndihmë komunitetit për evitimin dhe parandalimin e këtij rreziku, ai duhet të jetë i përgatitur mirë dhe të jetë në gjendje për të marrë të gjitha masat e nevojshme për zgjidhjen e kësaj situate. Punonjësi i Policisë së Shtetit është përgjegjësi kryesor i ngarkuar me ligj për zbulimin dhe parandalimin e veprimtarisë kriminale në fushën e krimit mjedisor. Por, krahas Policisë së Shtetit, përgjegjësi funksionale për parandalimin e krimit mjedisor kanë edhe: Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Inspektorati i Pyjeve dhe Ujërave, Agjencia Rajonale e Mjedisit, organet e qeverisjes vendore, Forcat e Armatosura, etj. Qëllimi kryesor i të gjithë agjencive ligjzbatuese duhet të jetë angazhimi i përbashkët

Rica, N.  
dhe  
Rica, E.

« Parandalimi i  
krimit mjedisor,  
si përgjegjësi e  
policisë  
gjyqësore »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr. 7, 2017

<sup>14</sup> Ligji nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar.

në parandalimin e degradimit mjedisor, përpara se të vijnë pasojat apo të hetohen e ndëshkohen njerëzit.

Krimi mjedisor është i lidhur ngushtë edhe me krimin e organizuar dhe korrupsionin. Biznesmenë të ndryshëm, në funksion të fitimit të tyre të paligjshëm, herë pas here ndër marrin veprime, për të korrupuar zyrtarë të zbatimit të ligjit, në shfrytëzimin pa kriter të pyjeve e lumenjve, futjen e mbetjeve të pariciklueshme, ndotjen e ajrit me anë të djegieve apo gjermimeve për hidrocentrale të vegjël, duke shtuar rreziqet serioze të degradimit dhe shkatërrimit mjedisor. Në këto raste, krahas procedimit penal të këtyre subjekteve, hetimit dhe gjykimit të tyre, ata duhet të ngarkohen edhe me përgjegjësi administrative, për të mbuluar kostot e rehabilitimit të dëmit të shkaktuar. Vendosija e sanksioneve të ashpra për të gjitha subjektet që bëjnë shkelje penale apo administrative në fushën e mjedisit, do të bënte të mundur parandalimin dhe uljen në maksimum të krimit mjedisor.

Të mos harrojmë se ne jemi bijtë e tokës dhe toka është nëna jonë. Ta duam dhe ndihmojmë tokën, siç kujdeset dhe na do ajo ne.

## 6. Përfundime dhe rekomandime

Mbrojtja e mjedisit duhet të trajtohet si një prej detyrave kryesore të së gjithë shoqërisë, çdo qytetari apo agjencie ligjzbatuese në veçanti. Kjo veprimtari përbën një nga sfidat më të mëdha të njerëzimit për të garantuar jetën, shëndetin, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e social, jo vetëm afatshkurtër, por edhe për brezat e ardhshëm.

Përveç ndërgjegjësimit dhe edukimit mjedisor, për mbrojtjen e mjedisit, rëndësi të veçantë merr përcaktimi i një kuadri të gjerë ligjor, i cili të parashikojë qëllimet, objektivat, të drejtat, detyrat si dhe institucionet përgjegjëse me kompetencat e tyre. Burimet natyrore duhet të shfrytëzohen me kursim, duke ndaluar degradimin mjedisor dhe vlerësuar mjedisin si një domosdoshmëri për jetën dhe shëndetin e çdo njeriu.

Veprimtaria parandaluese duhet t'i paraprijë gjithnjë procesit hetimor. Duke parë rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, për të ndryshuar situatën është e domosdoshme që policia të nxisë bashkëpunimin me komunitetin me anë të strategjive të veçanta për policimin në komunitet dhe mbrojtjen e mjedisit. Kjo formë bashkëpunimi do të sjell një rritje të numrit të denoncimeve si dhe sigurimin e provave të nevojshme për dënimin e shkelësve të ligjit.

Nivelet e rrezikut ndaj mjedisit, të identifikuar si: “degradimi mjedisor dhe fatkeqësitë natyrore; shkatërrimi i mjedisit; si dhe shpyllëzimi, ndotja e lumenjve dhe fatkeqësitë natyrore apo industriale të shkaktuara nga ndikimi i njeriut”, duhet të konsiderohen si rrezik i nivelit të parë ndaj mjedisit, njëkohësisht të vlerësohen si prioritete të larta në punën e organeve përgjegjëse për parandalimin e tyre. Në të njëjtin grup rreziqesh duhet të përfshihet dhe korrupsioni e krimi i organizuar, si faktorë të lartë rreziku ndaj degradimit mjedisor.

Procedimi penal nuk duhet konsideruar si mjeti kryesor i mbrojtjes së mjedisit. Si rregull, ai zhvillohet pas aplikimit të masave administrative. Megjithatë, masat shtrënguese duhet të përdoren sa herë konstatohen sjellje dhe shkelje të dëmshme për mjedisin që na rrethon, si: ndotja e ajrit - që është edhe shqetësimi kryesor i qytetarëve, ndotja e ujit, prerja e pyjeve, peshkimi i paligjshëm, prishja e qetësisë publike etj. Statistikat hetimore e gjyqësore tregojnë se numri i të dënuarve për këto vepra penale mbetet i ulët, çka shtron si domosdoshmëri forcimin e politikës penale ndaj krimit mjedisor.

*Rica, A.  
dhe  
Rica, E.*  
« Parandalimi i  
krimit mjedisor,  
si përgjegjësi  
e policisë  
gjyqësore »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

Aplikimi i një filozofie të re mjedisore ndërmjet qytetarit dhe qeverisë, përbën një sfidë të veçantë në mbrojtje të mjedisit. Qasja duhet të jetë bashkëpunimi i pandërprerë me qytetarët për të mbajtur një mjedis të pastër, të shëndetshëm, duke ndëshkuar cilindo që e ndot apo dëmton atë. Ndërkohë, qeveria me politikat e saja duhet të shprehë angazhimin maksimal në garantimin e një mjedisi të shëndetshëm për qytetarët, në ruajtjen e tij nga ndotja dhe dëmtimi, nga aktiviteti njerëzor dhe veprimtaritë ekonomike; ta trajtojë atë, si vlerë të shtuar dhe pasuri për gjenerim aktivitetesh ekonomike, veçanërisht turistike, si dhe ta ruajë atë si trashëgimi për brezat e ardhshëm. Në situatën aktuale mjedisore që ndodhet në Shqipëri, ulja e nivelit të ndotjes në zonat urbane duhet të jetë prioritet që realizohet nëpërmjet: shtimit të sipërfaqeve të gjelbra në zonat urbane; kontrollit të emetimit të pluhurit, aplikimit të teknologjive të reja monitoruese; zbatimit të standardeve të rrepta në aktivitetet ekonomike që ndotin ajrin, si dhe përdorimin e karburanteve konform kriterëve të BE-së.

Ndërkohë, edhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i mjedisit, duhet konsideruar si një potencial i madh punësimi që i vjen në ndihmë të gjithë shtresave të shoqërisë. Falë bukurisë që ka natyra dhe shumëllojshmërisë së ekosistemeve, çdokush e gjen veten pjesë të shfrytëzimit ligjor të mjedisit. Ndonëse të gjithë ne e ndërtojmë jetën tonë individualisht, ajo që na bashkon në një entitet të përbashkët dhe na bën pjesë të një pasurie teje të çmuar, përtej interesave personale, është natyra dhe mjedisi.

*Rica, N.  
dhe*

*Rica, E.*

« Parandalimi i  
krimit mjedisor,  
si përgjegjësi e  
policisë  
gjyqësore »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

## Bibliografia

1. Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, 1998.
2. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, ribotim, viti 2014.
3. Kodi i Procedurës Penale, ribotim, viti 2015.
4. Ligji nr. 10 1431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".
5. Ligji nr. 10 458, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit".
6. Ligji nr. 162/2014, "Për rritjen e cilësisë së ajrit në mjedis".
7. Ligji nr. 103/2014, "Për strategjinë e sigurisë kombëtare të vendit për mjedisin".
8. Traktati i Romës, 1957.
9. Traktati i Mastrohtit, 1992.
10. E drejta e Mjedisit e BE-së - EU Environmental Law.
11. Protokolli i Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin, viti 1972.
12. Raporti i Progresit 2014 i Komisionit Europian për Shqipërinë.

**Rica, A.  
dhe  
Rica, E.**

« Parandalimi i  
krimit mjedisor,  
si përgjegjësi  
e policisë  
gjyqësore »

Policimi  
dhe  
Siguria  
**nr.7, 2017**

# Shërbimi i motoçikletave në Policinë e Shtetit



■ **MSc. Besnik SHEHAJ**  
Akademia e Sigurisë

## Abstrakt

*Në kushtet e sotme të policimit roli i Shërbimit të Motoçikletave në Polici merr dimension dhe rëndësi të veçantë. Por ai ndikohet nga një sërë faktorësh, ku disa nga më kryesorët që mund të përmendim, janë: mjedisi, zhvillimet teknologjike, problematikat e reja në fushën e rendit publik apo në parandalimin e krimit, kërkesat në rritje të publikut për siguri publike, etj. Parë në këtë këndvështrim, ky punim synon që të analizojë dhe argumentojë nevojën për riorganizimin, kompletimin, aftësimin profesional dhe përdorimin me eficiencë dhe efektivitet të SHMP-së. Mjedisi urban ku vepron pjesa më e madhe e Policisë së Shtetit ka pësuar një transformim rrënjësor krahasuar me të kaluarën. Infrastruktura rrugore urbane dhe interurbane është zgjeruar e përmirësuar ndjeshëm, duke krijuar lehtësi për qarkullimin e lirë të mjeteve dhe shtetasve, ndërkohë që ky faktor zhvillues ka rritur premiset për t'u shfrytëzuar nga individë me prije kriminale apo shkelës të ligjit. Përdorimi i motoçikletave në shërbimet e policisë, duhet konsideruar e vlerësuar si komponent i taktikave të policimit në fushën e parandalimit të kundërvajtjeve administrative dhe veprave penale në fushën e sigurisë publike.*

## Fjalëkyçe:

**shërbimi i motoçikletave, eficiencë, efektivitet, reagim, befasi, mobilitete, rendiment, reduktim, kufizim.**



## 1. Hyrje

Shërbimi i Motoçikletave në Polici (SHMP)<sup>1</sup> nuk është një risi në vetvete, por në kushtet e sotme të policimit *rol*i këtij shërbimi merr dimensione dhe rëndësi të veçantë dhe diktohet nga një sërë faktorësh, ku mund të përmendim më kryesorët: *mjedisi, zhvillimet teknologjike, problematikat e reja në fushën e rendit publik apo në parandalimin e krimit, kërkesat në rritje të publikut për siguri publike*. Në këtë këndvështrim, ky artikull ka për qëllim që të analizojë dhe argumentojë nevojën për *riorganizimin, kompletimin, aftësimin profesional dhe përdorimin me eficiencë dhe efektivitet të SHMP-së*.

Mjedisi urban ku vepron pjesa më e madhe e Policisë së Shtetit ka pësuar një transformim rrënjësor krahasuar me të kaluarën. Infrastruktura rrugore urbane dhe interurbane është zgjeruar e përmirësuar ndjeshëm, duke krijuar lehtësi për qarkullimin e lirë të mjeteve dhe shtetasve, ndërkohë që ky faktor zhvillues ka rritur premisat për t'u shfrytëzuar nga individë me prirje kriminale apo shkelës të ligjit.

*Zhvillimet teknologjike* kanë ndikuar në përmirësimin e cilësisë së jetës për shtetasit, duke u krijuar mundësi që të veprojnë lirisht në hapësirë e kohë për nevoja të aktiviteteve ekonomike, sociale e kulturore. Nga ana tjetër këto zhvillime teknologjike shfrytëzohen në maksimum nga grupet kriminale apo individë të pandërgjegjshëm për të realizuar synimet e tyre antiligjore.

*Problematikat e reja në fushën e ruajtjes së rendit publik*, si konfliktet për pronën, dhuna në familje, ndërtimet pa leje, mbrojtja e mjedisit, etj. kërkojnë strategji dhe

<sup>1</sup> Shërbime të Policisë për Sigurinë Publike, Tiranë, 2004, f. 9-18.

taktika adekuatë kundërveprimi nga Policia. Parandalimi dhe zbulimi i krimeve, për shkak të formave dhe metodave të sofistikuar të përdorura nga elementët e grupet kriminale në ditët e sotme, kërkojnë reagim proaktiv të Policisë, për të grumbulluar informacion dhe për të gjetur prova ligjore, pasi këto të fundit ndryshojnë me shpejtësi cilësinë dhe vlefshmërinë për t'u përdorur në procesin e gjurmimit apo procedimit penal. Është i njohur tashmë fakti se, vonesa në konstatimin e një shkelje ligjore apo hetimin e një ngjarje kriminale, përkeqëson në mënyrë të ndjeshme shanset e ndëshkimit apo zbulimit të tyre<sup>2</sup>.

Garantimi i të drejtave dhe lirive të individit në një shtet demokratik, ndërgjegjësimi i shtetasve për t'i ushtruar këto të drejta dhe rritja e mirëqenies kanë sjellë gjithashtu *kërkesa në rritje të publikut* për sigurinë e jetës, pronës, dinjitetit dhe integritetit. Pra paqja sociale bëhet gjithnjë e më shumë obligim i shtetit, ku barrën kryesore për ruajtjen e saj ka Policia.

Mbas kësaj trajtese "filozofike", gjithkush mund të shtrojë pyetjen se çfarë lidhje kanë këta faktorë të sipërpërmendur me SHMP?! Pikërisht këtë ndërthurje, do të përpiqemi të trajtojmë në këtë shkrim, me disa argumente teorike e praktike, të dalë nga eksperiencia e deritanishme e shërbimeve të Policisë së Shtetit<sup>3</sup> në terren.

## 2. Rëndësia e shërbimit të motoçikletave

Rëndësia e përdorimit të motoçikletave në Policinë e Shtetit është e lidhur me eficiencën dhe efektivitetin e këtyre mjeteve në veprimtarinë e përditshme të shërbimeve të Policisë në terren, pra me nevojën se ku dhe sa ky lloj shërbimi duhet të përdoret(?); pse dhe si duhet të përdoret(?); çfarë do të synohet me përdorimin e tij(?); në ç'raport do të jetë me shërbimet e tjera(?); si duhet menaxhuar(?), etj.<sup>4</sup>

### 1.1. Eficienca e shërbimit të motoçikletave

*Eficienca* e SHMP është e lidhur me *nevojën* e përfshirjes së këtij lloji mjeteve në shërbimet e Policisë së Shtetit, e cila justifikohet sa me argumente teknike të policimit, ashtu edhe me argumente ekonomike. Historikisht, në Policinë Shqiptare ky lloj shërbimi është shfrytëzuar kryesisht në fushën e sigurisë rrugore, në dërgimin dhe marrjen e postës së brendshme, në shërbimet ceremoniale të protokollit të shtetit apo në veprimtarinë e vëzhgimit në procesin e gjurmimit policor. Jetëgjatësia dhe vazhdimësia e këtij lloji shërbimi edhe në ditët e sotme, dëshmon se ai ka justifikuar eficiencën brenda strukturave të policisë, me gjithë kufizimet që mund të ketë. Zhvillimet e vrullshme brenda dhe jashtë policisë mbas viteve '90, duket sikur e zbehën nevojën e këtij shërbimi, veçanërisht për shkak të vjetërimit të flotës së tyre, por edhe të nënvleftësimit për shkak të komfortit jo shumë të pëlqyeshëm nga përdoruesit. Pasurimi gradual i flotës së mjeteve të policisë me automjete të prodhimeve të fundit, krijoi mundësinë që shumë nga shërbimet historike me motoçikleta të zëvendësoheshin me automjete. Kjo gjë, vërtet rriti komoditetin në punë, por ndikoi në përkeqësimin e efektivitetit të shërbimeve të policisë<sup>5</sup>, për të cilin do të flasim në nëntitujt vijues.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për eficiencën ekonomike, ku menjëherë u ndien

<sup>2</sup> Begeja, S. *Kriminalistika*, viti 1985, f. 287.

<sup>3</sup> Shërbime të Policisë për Sigurinë Publike, Tiranë, 2004, f. 9-18.

<sup>4</sup> Manaxhimi i Policisë, Tiranë, 2003, f. 49-57.

<sup>5</sup> Shërbime të Policisë për Sigurinë Publike, Tiranë, 2004, f. 28-41.

vështirësitë e përballimit me karburant dhe nevoja të tjera mirëmbajtje të mjeteve të policisë, pasi dihet se, automjetet kanë kosto më të lartë, si në konsumim karburanti edhe në mirëmbajtje. (Shih tabelën nr. 1)<sup>6</sup>

Tabela 1

Emërtimi	Plani buxhetor vjetor					2017
	2012	2013	2014	2015	2016	
Shpenzime transporti	592,783,51 1	664,931,00 0	712,824,11 3	743,917,99 0	691,223,72 2	609,345,55 0
Karburant dhe vaj	470,927,00 0	532,315,80 0	588,447,58 0	573,259,97 4	531,354,80 0	442,163,00 0
Pjesë këmbimi	56,811,141	63,937,600	49,140,650	51,602,767	76,586,000	34,206,520
Siguracion mjete transp.	19267700	19,380,000	21,039,670	21,356,374	20,692,000	18,759,500
Shpenzime të tjera transporti	3490232	13,070,600	6,904,973	6,511,000	8,812,920	42,900,000
Shpenzime mirëmbajtje	42,287,438	36,227,000	47,291,240	91,187,875	53,778,002	71,316,480

Nga eksperiencat e fundit në vendin tonë, por edhe ato të huaja, në ditët e sotme, konstatohet se SHMP kryen detyra specifike jo vetëm në fushat historike që përmendëm më lartë, por edhe në strukturat e reja apo të riorganizuara, si ato të Patrullës së Përgjithshme, të Policimit në Komunitet, të Policisë Kufitare, të forcave të posaçme “Shqiponja”, FLO & FS, etj. Krijimi i njësisve të motoçikletave në këto struktura, jo vetëm që ka ardhur si kërkesë e dinamikës së veprimtarisë së tyre në terren, por ka çuar edhe në rritjen e performancës së këtyre shërbimeve në sytë e publikut, veçanërisht në zonat urbane, duke dhënë imazh më të pëlqyeshëm dhe, çka është më e rëndësishme, perceptim për më tepër siguri.

## 1.2. Efektiviteti i shërbimit të motoçikletave

*Efektiviteti* i shërbimit të motoçikletave është i lidhur me *rezultatet e matshme* të arritura nga ky shërbim, në raport me shërbimet e tjera policore, në një fushë të caktuar të veprimtarisë së Policisë së Shtetit, si p.sh. parandalimin e aksidenteve rrugore apo ngjarjeve kriminale, kapjen e shkelësve të ligjit, reagimin e shpejtë ndaj thirrjeve të publikut për ndihmë, etj.<sup>7</sup>

Karakteristikat fizike të motoçikletave kushtëzojnë ose *kufizojnë* përdorimin e tyre në periudha të ndryshme të vitit, kryesisht në vartësi të motit. Dihet se përdorimi i tyre në stinën e dimrit nuk do të ishte i këshillueshëm, pasi jo vetëm që ul sigurinë gjatë përdorimit, por është me pasoja edhe për shëndetin e motoçiklistëve. Ndërsa e kundërta mund të thuhet për stinën e pranverës, verës dhe vjeshtës në vendin tonë, ku këto stinë përgjithësisht karakterizohen nga mot me diell dhe i thatë. Nga ana tjetër, veçanërisht gjatë verës, qarkullimi për automjetet në rrugët urbane dhe interurbane vështirësohet në mënyrë të ndjeshme, për shkak të fluksit në rritje të pushuesve. Në këto kushte përdorimi i shërbimit të motoçikletave të Policisë do të ishte shumë *efektiv* për të kontrolluar rrjedhën e trafikut dhe për të ndëshkuar shkelësit e rregullave të qarkullimit

**Shehaj, B.**  
 Shërbimi i motoçikletave në Policinë e Shtetit »

Policimi dhe Siguria  
 nr.7, 2016

<sup>7</sup> Udhërrëfyes për Policimin Demokratik, OSBE, 2008, f. 69.

rrugor, sidomos ata me sjellje agresive. Lehtësia që kanë motoçikletat për të penetruar në kushtet e një trafiku të rënduar, është avantazh i madh, në raport me automjetet në përdorim nga shërbimi i sigurisë në qarkullimin rrugor. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për rastet e njoftimeve për ndihmë nga publiku, në numrat e emergjencës 112, 126 e 129 apo Komisarjatin Digjital. Reagimi me motoçikletë, në këto raste, sidomos në mjediset urbane, do të ishte shumëfish më i shpejtë se sa përdorimi i autopatrullave apo patrullave këmbësore<sup>8</sup>. Nga studimet e bëra kohët e fundit, rezultojnë se *reagimi*<sup>9</sup> i patrullës me motoçikletë, në raport me autopatrullat brenda qytetit, është në progresion aritmetik, më i shpejtë në vartësi të *largësisë* nga vendi i ngjarjes dhe, në progresion gjeometrik, më i shpejtë në vartësi të *ngarkesës në trafik*.<sup>10</sup> (Tabela Nr. 2)




Tabela 2

### 3. Veçoritë e shërbimit të motoçikletave

#### 2.1. Manovrueshmëria

Është i njohur dhe i provuar fakti se, SHMP siguron *manovrueshmëri* më të madhe në planin taktik, për të gjithë shërbimet e policisë ku ai është përdorur tradicionalisht apo në aspektet e reja të policimit bashkëkohorë. Avantazhi kryesor i motoçikletave, në këtë drejtim, është se ato mund të zhvendosen nga një vend dislokimi (planëzimi) në një tjetër, me lehtësi dhe shpejtësi, sidomos në kushtet e trafikut të rënduar. Shpesh, shërbimet me automjete nuk janë efektive, pikërisht sepse ato nuk mund të lëvizin me të njëjtat parametra si ato të motoçikletave, nëpër zonat urbane apo në rrugët interurbane, për shkak të pengesave në infrastrukturën rrugore, të dendësisë së popullimit apo edhe të limiteve të konsumit të karburantit. Në këto kushte, shërbimi me automjete, me urdhër apo iniciativë, kthehet shpesh në shërbim statik, duke humbur kështu elementin e *befasisë* që është një nga avantazhet kryesore në çdo rast të konstatimit të shkeljeve apo të ndërhyrjes në ngjarje kriminale të çastit.<sup>11</sup>

Depërtimi në hapësira të ngushta ose në rrugëkalime jonormale është një epërsi tjetër e motoçikletave, për sa i përket *manovrueshmërisë*. Në shumë raste, shërbimet e policisë që thirren për ndihmë, duhet të futen në territore e terrene që nuk kanë infrastrukturë të kompletuar urbane, ku automjetet jo vetëm që nuk mund të futen, por krijojnë edhe premisa për aksidente. Kështu, në një rast të publikuar në mediet

Shehaj, B.  
« Shërbimi i  
motoçikletave  
në Policinë e  
Shtetit »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr. 7, 2016

<sup>8</sup> *Këqyrja e vendit të ngjarjes*, Tiranë, 1996, f. 9.

<sup>9</sup> Me "*reagim*" kuptohet koha ( $t=S/v$ ) e mbërritjes së patrullës në vendngjarje nga moment i njoftimit, në vartësi të shpejtësisë së lëvizjes në një largësi të caktuar ose në trafik të rënduar.

<sup>10</sup> *The Police Chief*, viti 2000-2004.

<sup>11</sup> *Investigimi i krimi*, Tiranë, 2004, f. 21.

elektronike u stigmatizuan veprimet e një autopatrulle të policisë në autostradë, pikërisht për faktin e manovrave të rrezikshme në ndjekje të një kundërvajtësi. Pra, përgjegjshmëria dhe vendosmëria e punonjësit të policisë për të ndaluar shkelësin e ligjit u interpretua si abuzim në detyrë nga komentues të shumtë në rrjetet sociale, sa u desh të bëhej reagim publik nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, duke përdorur regjistrimet filmike të mjetit të Policisë. Ana tjetër e manovrueshmërisë së motoçikletave, është e lidhur me shumëllojshmërinë e tyre për nga konstruksioni apo fuqia motorike e tyre, gjë që lejon përdorimin në rrethana e kushte të ndryshme, sipas nevojave të shërbimeve të policisë, - siç mund të përmendim, motorët 4x4 në patrullimet e Policisë Kufitare, dhuruar kohët e fundit nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

## **2.2. Reduktimi i forcave**

Shërbimi me motoçikletë, kërkon zakonisht një punonjës policie, ndërsa shërbimi me autopatrullë kërkon dy ose më shumë të tillë. Por, jo në të gjitha rastet e ndërhyrjeve të policisë, për të mos thënë në shumicën e rasteve të përditshme, është e nevojshme prania e dy ose më shumë punonjësve të policisë. Për shembull, konstatimet e kundërvajtjeve në fushën e qarkullimit rrugor, dhuna në familje, konfliktet e çastit midis individëve, verifikimet e ankesave për ndërtime pa leje, etj., që zënë gamën më të madhe të ankesave të përditshme në polici, nuk kanë pse të angazhojnë më shumë se një punonjës policie. Nga ana tjetër, parandalimi shpejtë i këtyre rasteve që në fazën e hershme të konstatimit, nëpërmjet pranisë së shpejtë të policisë, kërkon lëvizshmëri të lartë, ku avantazhi i lëvizjes me motoçikletë është i padiskutueshëm.

## **2.3. Rendimenti**

Si njësi matëse e volumit të punës në një interval të caktuar kohe, rendimenti apo eficientia e një shërbimi, është kusht kryesor për të vlerësuar përparësinë e tij në raport me një alternativë tjetër. Jo rrallë dëgjohen në komunikimet e policisë, shfaqësime për vonesat në përgjigjen ndaj thirrjeve të publikut, se janë të bllokuar në trafik; në ndonjë rast, edhe spekulative. Pra në një turn shërbimi të policisë, ku mund të ketë me dhjetëra thirrje për ndihmë nga publiku, sidomos në zonat urbane, shërbimet me motoçikleta mund të realizojnë disa ndërhyrje më tepër se sa ato me autopatrullë ose patrullë këmbësore.

Kjo u vërtetua më së miri me shtimin në shërbimin “Shqiponja”, të njëjstëve të motoçiklistëve në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë dhe, më pas, në ato të Durrësit, Shkodrës e Vlorës. Kështu, në vitin 2016 u arrit që në qytetin e Tiranës, të reduktohej nga 10 minuta në 2 minuta koha e mbërritjes së shërbimeve të Policisë në vendngjarje.<sup>12</sup>

## **2.4. Kufizimet**

Pra siç shihet nga argumentet e më sipër, rezulton se SHMP ka edhe kufizimet e veta, ku më kryesor është fakti se motoçikletat nuk mund të përdoren në operacionet e shkallës së gjerë antikrim dhe me rrezikshmëri të lartë. Pra ato mund të përdoren kryesisht në fushën e parandalimit dhe në shërbimet rutinë të Policisë. Gjithashtu nuk është e këshillueshme përdorimi i tyre në periudhën e dimrit, terrene të aksidentuara apo zona të thella, në kushtet e pamjes së kufizuar si natën apo në kushte të vështira atmosferike nga shiu, bora, mjegulla, stuhitë, etj.

<sup>12</sup> Analiza e Policisë Tiranë, viti 2016.

**Shehaj, B.**  
«Shërbimi i motoçikletave në Policinë e Shtetit»

Policimi dhe Siguria  
**nr.7, 2016**

### 3. Fushat e veprimtarisë policore ku mund të përdoret SHMP


*Fushat e veprimtarisë policore*, ku mund të përdoret shërbimi me motoçikleta, nuk është se janë të rregulluara me akte specifike normative dhe as me procedura standarde, pavarësisht se ekzistojnë një sërë aktesh normative që kryesisht rregullojnë çështje teknike të lidhura kryesisht me mirëmbajtjen e tyre apo me limitet e konsumit të karburantit. Ndofta ka ardhur koha, që shërbimet me motoçikleta të jenë pjesë e organizimit strukturor, sidomos në ato fusha të veprimtarisë policore që e kanë të nevojshme përdorimin e SHMP-së. Kjo gjë është e domosdoshme në dy aspekte kryesore, së pari: në lidhje me planifikimin e mjeteve si gjendje fizike dhe shpenzimet përkatëse për blerje e mirëmbajtje; së dyti: me nevojat e planifikimit të trajnimeve të specializuara për punonjësit e policisë si përdorues të tyre.

Nisur nga eksperiencia e deritanishme në Policinë e Shtetit dhe nga ajo e policive të tjera, mund të përkufizojmë disa nga fushat e veprimtarisë policore ku shërbimi me motoçikleta është më se i nevojshëm, për të mos thënë parësor, siç janë më poshtë, në vijim.

#### 3.1. Shërbimet e qarkullimit rrugor

Dihet, se historikisht, SHMP-ja në fushën e kontrollit të qarkullimit rrugor ka qenë gjithmonë e pranishme në Policinë Shqiptare, që në krijimet e hershme të saj. Gjithashtu, është i njohur kontributi i këtij lloji shërbimi në fushën e qarkullimit rrugor, prandaj mund të pranohet si aksiomë, se prania e motoçikletave në strukturat e shërbimit të qarkullimit rrugor është “kushti pa të cilën”, - nëse do të shpreheshim me terma matematikor. Por, zhvillimet e reja në mjedisin social-ekonomik dhe nga ana tjetër strategjite e reja të policimit në komunitet, kanë bërë që shërbimi me motoçikleta në kontrollin e qarkullimit rrugor nga policia të jetë më i pranishëm dhe më i shtuar. Kështu p.sh., zgjerimi i rrjetit rrugor në gjithë vendin, me rrugë të standardeve shumë më të avancuara se ato në të kaluarën; kur fluksi i trafikut është rritur shumëfish (shih tabela Nr. 2)<sup>13</sup>; kur shpejtësia e lëvizjes vjen gjithnjë në rritje; kur policia duhet të kontrollojë e monitorojë gjithnjë e më tepër distanca të mëdha, etj., - shërbimi me motoçikleta merr rëndësi të veçantë, sa për nga efikasiteti në parandalimin e aksidenteve, aq dhe për nga leverdia ekonomike.

Tabela 3



Shehaj, B.  
« Shërbimi i  
motoçikletave  
në Policinë e  
Shtetit »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2016

Nga pikëpamja e efikasitetit të kontrollit të qarkullimit rrugor SHPM ka përparësi sepse me të njëjtin numër patrullash policie, mund të mbulohen më shumë sektorë shërbimi, si dhe të mbulohen me monitorim më shumë të ashtuquajtura “njolla të zeza” brenda një sektori shërbimi. Ndërsa autopatrullat, në të shumtën e rasteve, veprojnë si shërbime statike, kontrollojnë më pak zona rreziku ose vihen me vështirësi në ndjekje të shkelësve të Kodit Rrugor. Nga ana tjetër, shërbimi me motoçikleta kursen forcat policore të planifikuara me shërbim, pasi dihet se, një autopatrullë, zakonisht planifikohet minimalisht me dy punonjës policie, ndërsa shërbimi me motoçikletë kryhet zakonisht dhe përgjithësisht, me një punonjës policie.

Nga ana tjetër, duke qenë se kontrollet e policisë në fushën e qarkullimit rrugor kanë kryesisht funksione parandaluese, nuk është e nevojshme që ato të jenë të përforcuara me shumë efektivë njëherësh, pasi në shumicën e raste ndërhyrjet e punonjësit të policisë nuk kërkojnë përdorim të përshkallëzuar të masave shtrënguese. Pra, duke përmendur këto avantazhe të SHMP-së në fushën e kontrollit të qarkullimit rrugor, arrihet në konkluzionin se përdorimi i tij përbën një element taktik, superior, në planifikimin dhe dislokimin forcave të policisë, në këtë fushë të veprimtarisë së Policisë së Shtetit.

### 3.2. Në shërbimet e Patrullës së Përgjithshme

Dihet se këto shërbime janë kryesisht shërbime qytetase, pra në zona urbane ku ka masivitet të aktiviteteve njerëzore, pra potencialisht të rrezikuara nga veprimtaria e kundërligjshme apo kriminale. Përqendrimi gjithnjë e më i madh i popullsisë në qytete, solli si domosdoshmëri rishikimin e organizimit të shërbimeve policore në qytetet kryesore të Shqipërisë; gradualisht në gjithë qendrat urbane, sipas ndarjes administrative tokësore, nëpërmjet mbulimit me patrulla të përgjithshme, - pra siç mund të thuhet me gjuhën e biznesit “*all in one*”, që nënkupton se brenda disa kompetencave të limituara, kjo patrullë duhet të kryej funksionet e një patrulle të qarkullimit rrugor, e një patrulle të rendit apo edhe të një agjenti krimesh, etj.

Por, duke marrë në konsideratë gjithë sa kemi thënë për vështirësitë e autopatrullave në qytet, sidomos në drejtim të *reagimit* ndaj kërkesave për ndihmë nga shtetasit apo ndjekja e neutralizimi i shkelësve të ligjit në flagrancë, epërsi taktike, nga ana policore, merr shërbimi me motoçikleta. Kjo epërsi tashmë është e njohur dhe e vlerësuar nga lidershpi i policisë, ku në analizën vjetore të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, 2016 thuhet:

*“...e rëndësishme këtë vit ka qenë dhe veprimtaria forcës “Shqiponja”, një strukturë tashmë e njohur dhe konsoliduar, e cila ka dhënë tonin e vet në ngjarje apo situata jo të lehta që kemi kaluar. Por risia sigurisht ka qenë njësia “Shigjeta”<sup>14</sup> e atashuar në këtë sektor. Askush nuk e kishte menduar se do të pajiseshim me një flotë moderne motorësh aq të nevojshme për një metropol. Për ne ishte emergjente që të ndërhynim sa me shpejt në operacionet policore, duke shmangur trafikun, por prej vitesh nuk na ishte dhënë mundësia... Tashmë Drejtorija Vendore e Policisë Tiranë është pasuruar edhe me këtë njësi operacionale duke krijuar një model pozitiv të policisë si dëshmi e përpjekjes së vazhdueshme për të patrulluar dhe reaguar me shpejtësi në çdo rast”<sup>15</sup>.*

**Shehaj, B.**  
Shërbimi i motoçikletave në Policinë e Shtetit

Policimi dhe Siguria  
**nr.7, 2016**

<sup>13</sup> <http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/en/id/310/Numri-i-Automjeteve-ne-Shqiperi>, (shikuar më datë 27.07.2017)

<sup>14</sup> Njësia “Shigjeta” janë efektivet e forcës “Shqiponja” me motoçikleta.

<sup>15</sup> Raporti i analizës vjetore të DVP Tiranë, 2016.

### 3.3. Njësitë operationale antikrim

Elementët apo grupet kriminale përgjithësisht e zhvillojnë aktivitetin e tyre nëpër qytete, ku mbajtja e tyre në kontroll vështirësohet sa për shkak të mjeteve të sofistikuara që ata përdorin, aq edhe për nga mundësia e dekonspirimit të veprimeve të punonjësve të policisë, në mjedise ku prania e tyre me automjete bie në sy, apo qarkullimi i këtyre mjeteve është i ndaluar. Në këto rrethana epërsi taktike merr përsëri përdorimi i motoçikletave, të cilat jo vetëm që mundësojnë maskim efikas të mjetit apo punonjësit të policisë, por kanë edhe fleksibilitet më të lartë përdorimi në kushtet e veprimeve të paparashikuara të elementëve kriminalë.

Nëpërmjet shërbimit me motoçikletë, është më e lehtë të vihesh në ndjekje të lëvizjeve, shpesh të befasishme, që bëjnë elementët kriminalë; mund të parkosh e maskohesh më lehtë gjatë vëzhgimit; kursehen forca dhe mjete pasi në këto raste, punonjësi i policisë me motoçikletë lëviz i vetëm ose vetë i dytë, ndërsa më automjetet duhen si rregull jo më pak se tre të tillë; reduktohen shpenzimet operative të karburantit dhe mirëmbajtjes së motoçikletës në raport me automjetet, etj. Në një vlerësim që bëhet nga drejtuesit e policisë për sektorin e Forcës së Posaçme të Operacioneve Speciale dhe Kërkimit në DVP Tiranë, e cila ka në përdorim edhe motoçikleta, thuhet:

*“Ky sektor ka mbështetur pothuajse të gjitha sektorët dhe komisaritet në procedimet dhe hetimet e tyre proaktive. Kanë qenë të shpeshta operacionet, si për arrestimin e personave gjatë procedimeve, ashtu dhe kapjen e personave në kërkim. Për këtë të fundit në total janë kapur 668 persona në kërkim, nga të cilët 100 janë kapur nga kjo njësi operationale... Shifra që përmenda më sipër është domethënëse, dhe bëhet akoma më e fortë, po të përmendim se 18 të kapur janë autorë vrasjesh, 8 për vjedhje me armë dhe me pasojë vdekje, 20 për trafikim dhe shpërndarje narkotikësh, etj.”<sup>16</sup>*

### 3.4. Policimi në komunitet<sup>17</sup>

Është i njohur fakti se vetë filozofia e policimit në komunitet, ka në bosht të saj partneritetin polici-publik, ku policia është në rolin e ofruesit të shërbimit, ndërsa publiku si përfytyrues i këtij shërbimi.<sup>18</sup> Pra performanca e policisë në këtë partneritet, do të matet me kënaqësinë ose pakënaqësinë e publikut ndaj shërbimit të Policisë. Ndërkohë, përditë e më shumë kërkesat e publikut për siguri janë në rritje, por edhe si shumëllojshmëri, pra dinamika e punës me këtë filozofi dhe strategji të policimit është voluminoze, e larmishme, e dukshme, e matshme, e monitoruar dhe llogaridhënëse.

Në këto kushte, përveç të tjerash, një nga taktikat e policimit në komunitet, është lëvizshmëria ose e thënë në terma më të thjeshtëzuar dinamizmi apo zhdërvjelltësia. Siç e kemi argumentuar në nënçështjen 2.1. të këtij shkrimi, përdorimi i SHMP-së, merr përparësi edhe në fushën e policimit në komunitet, si në përditshmërinë e realizimit të detyrave, ashtu edhe për raste emergjente. Kështu, duke analizuar punën e strukturave të policimit në komunitet, drejtuesit e DVP Tiranë i referohen treguesve të matshëm për performancën e këtyre shërbimeve në momentet e reagimeve për ndihmë, të kërkuar nga shtetasit, ku konstatojnë: *“...Kemi shkurtuar kohën nga marrja e telefonatës deri në mbërritjen e shërbimit policor, 2 deri 4 minuta në qytet, duhet pasur parasysh se me sistemin e vjetër... humbnin rreth 35% e thirrjeve telefonike”*.<sup>19</sup>

<sup>16</sup> ibid.

<sup>17</sup> Manaxhimi i Policisë, Tiranë, 2003, f. 228-232.

<sup>18</sup> Lidërshipi në Policinë e Shtetit, Tiranë, 2016, f. 47.

<sup>19</sup> Raport i analizës vjetore të DVP Tiranë, 2016.



### 3.5. Policia Kufitare

Përdorimi i motoçikletave ka epërsi gjithashtu në shërbimet e Policisë Kufitare, sidomos në zonat bregdetare, veçanërisht në stinën e verës, kur këto shërbime ngarkohen edhe me detyra për mbarëvajtjen e sezonit turistik, për shkak të përqendrimit të pushuesve të vendas e të huaj, por njëkohësisht dyndjes të elementëve kriminal shëtitës apo grupeve kriminale me tendenca të mprehta. Nga ana tjetër, forcimi i regjimit kufitar në PKK, rrjedhë e zbatimit të “Strategjisë për menaxhimin e integruar të kufirit”, ka sjellë si kundërveprim të elementëve e grupeve kriminale, përdorimin gjithnjë e më tepër të rrugëkalimeve ilegale në kufirin e gjelbër. Kjo strategji e re, e veprimtarisë kriminale nëpërmjet kufirit të gjelbër, diktoi si masë kundërvepruese të Policisë Kufitare, forcimin e regjimit në drejtimet e mundshme të zhvillimit të kësaj veprimtarie.

Por, në kushtet e organikave të limituara me resurse njerëzore dhe, nisur nga eksperiencat më të mira ndërkombëtare, u vendos pajisja e patrullave të kufirit të gjelbër me motorët “4x4”, të cilët erdhën si donacion, falë dashamirësisë së misionit ICITAP.

## 4. Nevojat e aftësimi teorik dhe praktik të motoçiklistëve të policisë<sup>20</sup>

Aktualisht numri i motoçikletave në përdorim, në shërbimet e Policisë, përbën 1/5 e inventarit të përgjithshëm të flotës së mjeteve të transportit [emërtimi që përdoret në zërat e buxhetit të Policisë – shënim, B. Sh.], fakt ky që na çon në përfundimin tjetër, atë të domosdoshmërisë së përgatitjes së motoçiklistëve të aftë të Policisë në përdorimin e tyre, si në kushte normale, por veçanërisht në situata emergjente policore, pra të ashtuquajturin “*drejtim profesional i mjetit*”.

Në bazë të Ligjit për Policinë e Shtetit<sup>21</sup>, një nga kërkesat e pranimit në radhët e Policisë është: disponimi i patentës së klasit “B”, sipas kategorive të përcaktuara në Kodin Rrugor të RSH, e cila të jep të drejtën e drejtimit të automjeteve me tonazh deri në 3.5 ton. Ndërsa drejtim i motoçikletave, kushtëzohet me pasjen e lejes së drejtimit A1, A2 dhe A<sup>22</sup>, të cilat jo të gjithë aplikantët apo punonjësit e policisë, i zotërojnë. Për të evituar këtë gjendje paligjshmërie, midis nevojës për përdorimin e motoçikletave në polici dhe mungesës së dokumentit ligjor për drejtimin e tyre nga punonjësit e policisë, është kërkesë imediate pajisja e tyre me këto lloj lelesh drejtimi. Përpara kësaj kërkesë, lidhshipi i policisë u gjend midis dy alternativash; e para: që të gjithë punonjësit e Policisë që do të përdornin motoçikleta, të dërgoheshin ose detyroheshin të shkonin në autoshkolla private për t’u aftësuar e pajisur me lejet e drejtimit të motoçikletës; e dyta: vetë policia të fitonte të drejtën e dhënies së këtyre lejeve. Përfundimisht, kjo situatë u zgjidh nëpërmjet aplikimit dhe licencimit të Akademisë së Sigurisë, si subjekt me të drejtë të ushtrimit të aktivitetit të autoshkollës, për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi të klasit A1, A2 dhe A.

Por, zgjidhja e këtij ngërçi ligjor nuk e zgjidhi plotësisht problematikën, për faktin se drejtimi i motoçikletës gjatë shërbimeve të policisë ka kërkesa shtesë, që lidhen me kushtet specifike të natyrës së shërbimit, - kur duhet të lëvizet me shpejtësi tej normave

**Shehaj, B.**  
«Shërbimi i motoçikletave në Policinë e Shtetit»

Policimi dhe Siguria  
**nr.7, 2016**

<sup>20</sup> Menaxhimi i Policisë, Tiranë, 2003, f. 189-192.

<sup>21</sup> Ligji Nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, neni 38, pika 2, germa “ë”.

<sup>22</sup> Kodi Rrugor i RSH, neni 115.

të lejuara, në kushte emergjence, në mjedise e terrene jo të favorshme apo nën kërcënimin e elementëve me rrezikshmëri shoqërore. Pra, drejtuesit e motoçikletave të policisë, duhet të kenë aftësi plus, që nuk jepen në kurset e rregullt të pajisjes me leje drejtimi të kategorisë A1, A2 dhe A. Në këto rrethana, në vitin 2016, pranë Akademisë së Sigurisë u hap kursi i parë për trajnimin e motoçiklistëve të policisë.<sup>23</sup> Ky kurs dhe ata në vazhdim, kanë për qëllim, që nëpërmjet një programi (moduli) të veçantë të aftësojnë motoçiklistët e policisë, për drejtim të siguritë të motoçikletës, nën stres, më shpejtësi të lartë, në manovër, në shoqërim e, pse jo, edhe në formë sportive.<sup>24</sup>

Në manualin e përgatitur nga Akademia e Sigurisë për kursin e motoçiklistëve:

*“Ky kurs është planifikuar si kurs bazë për përgatitjen teorike dhe praktike të punonjësve të policisë në patrullimin e përgjithshëm më motoçikleta, për rritjen e aftësive të tyre profesionale për të qenë në gjendja të vepronjë me profesionalizëm në situata të ndryshme që dikton dinamika e punës së përditshme... Në këtë kurs pritet të trajnohen rreth 160 punonjësit e parë të policisë... Ky trajnim do të përfshijë mësimet teorike dhe praktike që lidhen me motoçikletat, tipat, ndërtimin dhe kontrollin e tyre, përgatitjen për guidim (drejtim – B. Sh.), faktorët që ndikojnë në një guidim të sigurt, guidimin, rreziqet gjatë guidimit, strategjitë për një guidim të sigurt, veprimet në raste emergjente, situata të veçanta të guidimit, faktorët që ndikojnë në një guidim të sigurt, konceptet bazë të sigurisë...”*<sup>25</sup>

Mbas këtij hapi të parë, detyrë e sektorit përkatës të ngritur në Akademisë e Sigurisë, mbetet përgatitja dhe përditësimi i kurrikulave për kurset e specializuara, të drejtuesve të motoçikletës në Polici, ndërsa në vazhdimësi, për të gjithë drejtuesit e mjeteve në përdorim nga policia, qofshin ato të zakonshme apo speciale, si: mjete të blinduara, mjete lundrimi, me kalueshmëri të lartë, etj. Në këtë kuadër, ka filluar puna për krijimin e një banke të dhënash (database) të mjeteve të Policisë, e cila do të shërbej për planifikimin e nevojave dhe pjesëmarrësve në këto lloj trajnimesh. Si në çdo ndërmarrje të re, vështirësitë janë të shumta dhe jo gjithmonë të parashikuara, veçanërisht ato në planin logjistike, pasi kërkohen jo vetëm mjete të përshtatshme për trajnim në klasë, por mbi të gjitha investime me kosto të lartë, si autodrome, pajisje dhe mjete sigurie shtesë,<sup>26</sup> financime për shpenzime shtesë mbi normativat standarde për konsum karburanti apo pjesë këmbimi e deri sigurim të detyrueshëm jete për kursantët, etj.

## 5. Përfundime

Nisur nga parashtrimet në këtë shkrim, mund të nxirren disa përfundime dhe rekomandime si:

- Përdorimi i motoçikletave në shërbimet e policisë, duhet konsideruar e vlerësuar si *komponent i rëndësishëm i elementit të befasisë, në taktikat e policimit* në fushën e parandalimit të kundërvajtjeve administrative dhe veprave penale në fushën e sigurisë publike.

- Drejtuesit e Policisë *duhet t'i kushtojnë gjithnjë e më shumë vëmendje përfshirjes së motoçikletave në planet e tyre të dislokimit të forcave dhe mjeteve në terren*, duke

<sup>23</sup> Urdhri i zëvendësdrejtorit të Policisë së Shtetit Nr. 1/323, datë 03.03.2016, “Për pjesëmarrjen në trajnimin me temë: “Kursi për formimin e motoçiklistëve të Policisë së Shtetit”

<sup>24</sup> Udhërrëfyes për Policimin Demokratik, OSBE, 2008, faqe 70

<sup>25</sup> Kursi i Motoçiklizmit, f. 5.

<sup>26</sup> Udhëzues për kontrollin e automjeteve, United Nations, Office on Drugs and Crime, f. 7-18.

analizuar rast pas rasti, avantazhet e tyre në manovrueshmëri, rendiment, eficiencë dhe efektivitet.

- Përdoruesit e motoçikletave të policisë, *duhet të kryejnë trajnime shitesë* në funksion të përdorimit të tyre, sipas nevojave të shërbimeve të Policisë në kushte emergjence dhe rreziku për jetën.

- Përzgjedhja e motoçiklistëve të policisë, *duhet të bëhet e kujdesshme sa në drejtim të kondicionit të tyre fizik, ashtu dhe aftësive personale*, për t'u përshtatur me veçoritë e drejtimit të motoçikletës.

- Në planifikimin për shtimin dhe mirëmbajtjen e flotës së motoçikletave të policisë, *duhen marrë në konsideratë nevojat për kompletimin e strukturave që do t'i përdorin sipas veçorisë së shërbimit që kryejnë*, si p.sh. përdorimit në autostradë apo zona urbane, në brezin kufitar apo terrene të thyera, në vëzhgim apo eskortim, etj.

- Për shkak të rrezikut të shtuar që ka drejtim i motoçikletave, është e nevojshme që punonjësit e Policisë që do i përdorin, *të kenë sigurim jete* që në momentin e fillimit të kursit të aftësimit profesional e në vazhdim.

## Bibliography

1. Ministria e Rendit Publik, *Strategjia e Reformës në Policinë e Shtetit*. Tiranë: Qendra Shqiptare e të Drejtave të Njeriut dhe Qendra Daneze e të Drejtave të Njeriut, prill 2001.
2. Myftari, E., *Këqyrja e vendit të ngjarjes*. Tiranë: Shtëpia botuese ALBAL, 1996.
3. *Organization for Security and Co-operation in Europe, Udhërrëfyes për Policimin Demokratik*. Vjenë: OSCE, 2008.
4. Yzeiri, B., *Manaxhimi i Policisë*. Tiranë: Shtëpia botuese "ILAR", 2003.
5. Begeja, S., *Kriminalistika*. Tiranë: Fakulteti Shkencave Politiko-Juridike, UT, tekst mësimor, 1985.
6. Kalemi, S., Shehu, B., Vreka, J., *Investigimi i Kriminës*. Tiranë: Akademia e Policisë, tekst mësimor, 2004.
7. Begeja, S., Mandro, I., Afezollu, O., *Policia Shkencore*. Tiranë: Akademia e Policisë, tekst mësimor, 2004.
8. Mandro, I., *"Këqyrja e vendit të ngjarjes në aksidentet automobilistike"*, Tiranë, 2004.
9. Yzeiri, B., Cama, V., *Shërbime të Policisë për Sigurinë Publike*. Tiranë: Akademia e Policisë, tekst mësimor, 2004.
10. Memaj, B., *Lidershipi në Policinë e Shtetit*. Tiranë: Kristalina – KH, 2016
11. United Nations, *Udhëzues për kontrollin e automjeteve*. Vjenë: Office on Drugs and Crime.
12. Harizi, L., *Kurs i Motoçiklizmit*. Tiranë: Akademia e Policisë, me mbështetje nga PAMECA IV, 2017.
13. Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë. *Raporti i analizës vjetore të DVP Tiranë*, 2016
14. IACP. Periodik *"The Police Chief"*, Washington, 2000-2004.

**Shehaj, B.**

Shërbimi i motoçikletave në Policinë e Shtetit

Policimi dhe Siguria nr.7, 2016

# Ekstremizmi i dhunshëm dhe ISIS, rrezik dhe kërcënim për sigurinë



■ **Dr. Xhavit SHALA**  
Drejtor i Qendrës Kërkimore Shkencore,  
Akademia e Sigurisë



■ **MSc. Gledis NANO**  
Drejtor i Drejtorisë së Antiterrorit,  
Policia e Shtetit

## Abstrakt

*Objekti i studimit dhe i hulumtimit në këtë punim, është trajtimi i radikalizmit, ekstremizmit të dhunshëm si dhe veprimtarisë së ISIS-it, si rreziqe e kërcënime për sigurinë. Radikalizmi që çon në terrorizëm është procesi dinamik, sipas të cilit një individ nis ta pranojë dhunën terroriste si një mënyrë të mundshme, ndoshta edhe legjitime, veprimi. Eventualisht, por jo domosdoshmërisht, kjo mund ta bëjë personin që të flasë në favor, të veprojë në mbështetje apo edhe të përfshihet në akte terrorizmi. Ndërsa “ekstremizmi i dhunshëm” është përdorimi i dhunës për arritjen e objektivave politike. Ky, është kuptimi më i gjerë i terrorizmit. Pra, terrorizmi është dhunë me qëllime politike, e ushruar kryesisht kundër objektivave joushtarake. Në një farë mënyre radikalizmi i dhunshëm është procesi dhe ekstremizmi i dhunshëm është rezultati. Përshkallëzimi nga “radikalizimi i dhunshëm” në “ekstremizëm të dhunshëm” është përshkallëzimi nga rrezik në kërcënim për sigurinë kombëtare. Radikalizmi, ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi mund të jetë me sfond etnik, nacionalist, fetar, etj. Edhe ISIS-i përbën një kërcënim serioz për sigurinë ndërkombëtare, rajonale e kombëtare. Kjo organizatë disponon potenciale e kapacitete që nuk i ka pasur më parë asnjë organizatë terroriste dhe konkretisht: në fushën e organizimit shtetëror; mbështetjen ekonomike dhe pasurisë që zotëron; te armatimi që ka në përdorim dhe te burimet njerëzore të trajnuara që ka në dispozicion. Pjesëmarrja e qytetarëve shqiptarë, shtetas të Shqipërisë apo dhe të Kosovës, si vullnetarë në luftëra/konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit, - sidomos në Siri dhe Irak, në përbërje ISIS-it - dhe mundësia e kthimit dhe aktivizimit të tyre, përbën një kërcënim të qëndrueshëm për sigurinë në Shqipëri e Kosovë.*

*Gjatë këtij punimi janë aplikuar metodat dhe instrumentet bazë kërkimore shkencore, sasiore dhe cilësore, si metoda e analizës dhe sintezës, analizës krahasuese, ajo historike, juridike, e krahasimit dhe konfrontimit si dhe e studimit të rastit. Në përfundim të punimit konkludohet ndërmjet të tjerave se radikalizmi, ekstremizmi i dhunshëm, veprimtaria e ISIS-it si dhe të kthyerit nga Siria, për shkak të indoktrinimit dhe premisave për përfshirjen e tyre në aktivitete me karakter destabilizues apo terrorist përbëjnë rrezik, i cili nëse nuk menaxhohet mirë, mund të kthehet në një kërcënim për sigurinë tonë kombëtare. Gjithashtu Shqipëria sot zotëron kapacitetet e duhura dhe ka marrë masat e nevojshme për tu përballur me kërcënimin terrorist.*

## Fjalëkyçe:

**ekstremizëm i dhunshëm, terrorizëm, ISIS, rrezik, kërcënim, siguri kombëtare.**

Shala, XH.  
dhe  
Nano, G.

« Ekstremizmi i dhunshëm dhe ISIS, rrezik dhe kërcënim për sigurinë »

Polici  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

## 1. Hyrje

Radikalizmi, ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi nuk përbëjnë një fenomen të ri për shoqërinë njerëzore. Dhuna dhe shkatërrimi, të motivuara politikisht për të frikësuar dhe dobësuar elitat, shtetet dhe popujt, janë përdorur shpesh gjatë historisë. Fenomen të ri sot, përbëjnë format moderne të radikalizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit, të cilat më së miri arrijnë të shfrytëzojnë mundësitë që ofron globalizmi si dhe përparësitë e teknologjisë bashkëkohore të informimit. Në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë, është përcaktuar se “...rritja e radikalizmit fetar, që rrezikon vlerat e harmonisë fetare në Shqipëri dhe që mund të shkaktojë tension shoqëror”<sup>1</sup> ndonëse është klasifikuar në rreziqet e nivelit të dytë, shfaqja e tij “vlerësohet si me pasoja të larta për sigurinë kombëtare.”<sup>2</sup> Shqipëria sot, si pjesë e botës së qytetëruar dhe e koalicionit botëror antiterror mund të jetë target dhe është përgatitur të përballet me forma të ekstremizmit të dhunshëm.

## 2. Kuptimi mbi radikalizmin, ekstremizmin dhunshëm, terrorizmin dhe xhihadizmin

Radikalizmi që çon në terrorizëm është procesi dinamik, sipas të cilit një individ nis ta pranojë dhunën terroriste si një mënyrë të mundshme, ndoshta edhe legjitime, veprimi<sup>3</sup>. Eventualisht, por jo domosdoshmërisht, kjo mund ta bëjë personin të flasë në

*Shala, XH.  
dhe Nano, G.*  
« Ekstremizmi i dhunshëm dhe ISIS, rrezik dhe kërcënim për sigurinë »

Policimi  
dhe  
Siguria  
**nr.7, 2017**

<sup>1</sup> *Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë 2014*, “Shtojca C: Klasifikimi i rreziqeve”, f. 25.

<sup>2</sup> Po aty.

<sup>3</sup> *Violent Extremism and Religious Radicalization in Albania*. Tiranë: IDM, 2015, f. 9.

favor, të veprojë në mbështetje apo edhe të përfshihet në akte terrorizmi. Ndërsa “ekstremizëm i dhunshëm” është përdorimi i dhunës për arritjen e objektivave politike<sup>4</sup>. Ky është dhe kuptimi më i gjerë i terrorizmit. Pra terrorizmi është dhunë me qëllime politike e ushtruar kryesisht kundër objektivave jo ushtarake. Në një farë mënyre radikalizmi i dhunshëm është procesi dhe ekstremizmi i dhunshëm është rezultati<sup>5</sup>. Përshkallëzimi nga “radikalizimi i dhunshëm” në “ekstremizëm të dhunshëm” është përshkallëzimi nga rrezik në kërcënim për sigurinë kombëtare<sup>6</sup>. Radikalizmi, ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi mund të jetë me sfond etnik, nacionalist, fetar, etj.

Ekstremizmi i dhunshëm, që të arrijë në pikën finale të tij, në atë të veprimit, kalon nëpër një spirale përshkallëzuese të transformimit individual. Shtyllat kryesore të individit, transformohen, duke sjellë edhe një ndryshim rrënjësor të botëkuptimit mbi të mirën e të keqen dhe ç’është më kryesorja, duke transformuar perceptimin mbi identitetin kombëtar e atë personal. Terrorizmi ka si objektiv kryesor shndërrimin dhe zëvendësimin me mënyra radikale të gjithçkaje që njerëzimi ka arritur gjatë zhvillimit të tij historik, me një rend të ri të njëtrajtshëm, i cili funksionon vetëm në bazë të një ideje e që duhet të ndiqet nga kushdo pa u diskutuar. Për të arritur këtë gjë, atij i lipset që të zhveshë individin nga tiparet më të rëndësishme të identitetit e t’i heqë atij atributet kombëtare duke e shndërruar atë në një bashkësi joidentitare, por të përgjithshme<sup>7</sup>.

Gjithsesi, nuk ka një definicion (përkufizim) të dakordësuar ndërkombëtar për terrorizmin. Kjo në një farë mënyrë nuk ndikon pozitivisht në luftën kundër terrorizmit dhe ka mundësuar përdorimin e terminologjive të tilla si termi “terrorizëm islamik” apo “xhihadist”. Në të vërtetë ta islamizosh terrorizmin është shërbimi më i keq që mund ti bëhet luftës kundër terrorizmi. Edhe lidhja e terrorizmit me termin “xhihad” është një shtrembërim i kuptimit kuranor të fjalës “xhihad”<sup>8</sup>. Me të drejtë Ahmed Rehab, drejtor i Zyrës në Çikago të Këshillit për Marrëdhënie Arabe, ka nisur një fushatë, e cila promovon një kuptim më pak të njohur të fjalës “xhihad” – atë të “luftës për një vend më të mirë, të përmirësimit të jetës dhe të së bërit e asaj që duhet bërë e jo që është e lehtë”.<sup>9</sup> Për këtë do të ishte më korrekte përdorimi i termit “i ashtuquajtur terrorizmi islamik” apo dhe “xhihadi-ekstremist i dhunshëm”.

### 3. Shteti Islamik, si kërcënim për sigurinë ndërkombëtare

Në këto vitet e fundit, bota e qytetëruar po përballet me një kërcënim serioz, të së ashtuquajturit, Shteti Islamik i Sirisë dhe Irakut. Shteti Islamik, i ka shpallur luftë të

Shala, XH.  
dhe  
Nano, G.

« Ekstremizmi i dhunshëm dhe ISIS, rrezik dhe kërcënim për sigurinë »

Policimi dhe Siguria nr.7, 2017

60

<sup>4</sup> Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, miratuar me VKM nr. 930, datë 18.11.2015. Fletore Zyrtare Nr. 203 /2015. Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, faqe 13249.

<sup>5</sup> *Violent Extremism and Religious Radicalization in Albania*. Tiranë: IDM, 2015, f. 10.

<sup>6</sup> Xhavit Shala: “Arsimimi, faktor i rëndësishëm për neutralizimin e radikalizmit dhe të ekstremizmit të dhunshëm”. Konferenca e parë ndërkombëtare e Akademisë së Sigurisë: Kontributi në sigurinë publike nëpërmjet arsimimit, nëntor 2016. Policimi dhe Siguria, nr. 4. Tiranë: Akademia e Sigurisë, 2016, f. 113.

<sup>7</sup> Sandër Lleshi: “Edukimi modern si antidot i pazëvendësueshëm në përballjen me ekstremizmin e dhunshëm”. Konferenca e parë ndërkombëtare e Akademisë së Sigurisë: Kontributi në sigurinë publike nëpërmjet arsimimit, nëntor 2016. Policimi dhe Siguria, nr. 4. Tiranë: Akademia e Sigurisë, 2016, f. 42.

<sup>8</sup> Sipas Kuranit dhe thënieve të Profetit Muhamed, fjala “xhihad” është përdorur për katër qëllime, të cilat janë: përpjekja për vetëpërmirësim; përpjekja për t’u përcjellë të tjerëve mesazhin e Islamit; të shpenzosh pasurinë tënde për bamirësi si dhe lufta mbrojtëse. Pra edhe kur përmendet xhihadi lidhur me luftën, bëhet fjalë vetëm për një luftë vetëmbrojtëse e jo për atë ofensive.

<sup>9</sup> <http://noa.al/lajmi/2013/03/295800.html>.18.8.2017

gjithëve pa përjashtim, duke përfshirë edhe vendet e Evropës e të Ballkanit. Aktet terroriste në Francë, Turqi, Belgjikë, Gjermani, Rusi e Suedi dhe së fundmi në Spanjë e në Finlandë, tregojnë për përmasat dhe agresivitetin e veprimtarisë së ISIS-it ku, që me pak njerëz, me armatime të lehta apo edhe me vetëm makina të marrë me qira, ata arritën të realizojnë sulme me impakte të jashtëzakonshme jo vetëm në këto vende, por për mbarë botën.

ISIS-i përbën një kërcënim serioz për sigurinë ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare. Ai disponon potenciale që nuk i ka pasur më parë asnjë organizatë terroriste dhe konkretisht në fushën e:

- *Organizimit*. ISIS dallohet për strukturën e artikuluar, që në shumë aspekte i ngjan një organizimi shtetëror, në majën e piramidës të së cilit, është Kalifi i vetëshpallur Abu Bakr al Baghdadi.

- *Potencialeve ekonomike që zotëron*. ISIS zotëron potenciale ekonomike që gjenerojnë të ardhura të vazhdueshme. Vetëm të ardhura e siguruara nga tregtia klandestine e naftës dhe nga aktiviteti i rafinerive, vlerësohet nga 1 deri në 3 milion dollarë në ditë, duke mos përfshirë këtu milionat e dollarëve që sigurohen nga shpërblimet për pengmarrjet apo dhe taksat që mbledh nga popullsia në zonat që ai kontrollon.

- *Armatimit që ka në përdorim*. Asnjëherë më parë një organizatë nuk ka pasur në përdorim armatime të tilla në sasi dhe cilësi. ISIS-i ka grumbulluar nga zonat e pushtuara prej tij me mijëra armë dhe pajisje nga stacione ushtarake irakene, kryesisht të prodhimit amerikan, të cilat i ishin dhënë si ndihmë ushtrisë irakene nga ana e qeverisë amerikane. Kjo organizatë ka në përdorim tanke dhe artileri të rëndë dhe dyshohet se posedon edhe armë kimike.

- *Burimet njerëzore në dispozicion*. ISIS-it i janë bashkuar një numër i konsiderueshëm elementësh nga e gjithë bota, të mirë trajnuar dhe me njohuri nga të gjithë fushat.

Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë, përndryshe ISIS-i, ISIL-i apo dhe DAESH-it, një organizatë kjo më përmasa, tipare e shtrirje shtetërore është përgjegjës për gjenocid ndaj popullive në zonat që kontrollon, ndër ta të jazidëve, të krishterëve dhe të myslimanëve shiitë. Misioni i tyre i vetëshpallur është gjenocidi, si nga ideologjia, ashtu edhe veprimet e tyre, nga ato çfarë thonë, çfarë besojnë dhe çfarë bëjnë. Ai është bërë qendër botërore për radikalizmin, rekrutimin, trajnimin e qytetarëve të dëshpëruar nga vende të ndryshme të botës, pavarësisht besimit të tyre fetar, si dhe, përdorimin e tyre për akte terroriste. Propaganda e ISIS-it në shumë aspekte ka shumë ngjashmëri me argumentet kryesore të ideologjive të tjera totalitare, si fashizmi apo komunizmi. Të gjitha këto ideologji kanë nevojë për një njeri të ri, të ndryshëm nga modelet e mëparshme. Të gjitha ato kanë një armik qartësisht të identifikuar (përgjithësisht të personifikuar nga SHBA), të gjitha ato kanë një ofertë ideale të lumturisë<sup>10</sup>, e cila për luftëtarët e ISIS-it arrihet pas vdekjes. ISIS-i, brenda një periudhe më pak se dyvjeçare u bë kërcënim kryesor për sigurinë në Evropë dhe për gjithë sistemin aktual të sigurisë ndërkombëtare. Më 22 mars 2016, ky shtet, me një akt të shpallur lufte, goditi Brukselin, kryeqendrën e vlerave të qytetërimit Perëndimor, kryeqendrën e fuqisë ekonomike të Bashkimit Evropian dhe kryeqendrën e NATO-s, duke sfiduar kështu edhe organizatën më të fuqishme e më të madhe të mbrojtjes ushtarake në botë. Për t'ju përgjigjur këtij kërcënimi

*Shala, XH.  
dhe Nano, G.*  
« Ekstremizmi i  
dhunshëm  
dhe ISIS, rrezik  
dhe kërcënim  
për sigurinë »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

<sup>10</sup> Sandër Lleshi: "Edukimi modern si antidot...", f. 44.

Bashkimi Evropian ka adoptuar një plan të detajuar<sup>11</sup>. Ndërkohë që shtetet nga rajoni Lindjes së Mesme e më gjerë, janë grupuar në tre koalicione të armatosura kundër ISIS. Një koalicion drejtohet nga SHBA, një tjetër nga Rusia si dhe koalicioni i vendeve arabe që drejtohet nga Arabia Saudite.

#### **4. Ekstremizmi i dhunshëm dhe Shteti Islamik, si rrezik e kërcënim për sigurinë tonë kombëtare**

Radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm, nëse nuk parandalohet e luftohet, kthehet nga një rrezik në një kërcënim serioz për sigurinë kombëtare edhe në vende me traditë të fuqishme të tolerancës fetare, siç janë Shqipëria dhe Kosova. Ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rritjen e rrezikut dhe kërcënimit nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri janë: varfëria, papunësia dhe tranzicioni i tejzgjatur poskomunist i shoqërisë shqiptare, i shoqëruar nga kriza të pakuruara sociale, emocionale, shpirtërore, financiare e politike, bashkëshoqëruar shpesh dhe me mungesën e shtetit ligjor dhe me cenime të rënda të rendit dhe sigurisë; pamundësia për të ndikuar vendimmarrjen dhe perceptimet për qeverisje të korruptuar apo të padrejtë; importimi që në vitet e para të demokracisë në mënyrë të pakontrolluar nëpërmjet OJQ-ve të spektrit fetar të një sërë sektesh e rrymash fetare, të cilat cenojnë të drejtën e shqiptarëve për të ushtruar besimet e tyre tradicionale fetare; varfëria e komuniteteve fetare, mangësitë në financimin e tyre nga shteti dhe mbështetja vetëm në ndihmat që vinin nga jashtë; lejimi i ndërtimeve pa leje të objekteve të kultit dhe jashtë strukturave zyrtare të komuniteteve fetare; vonesa dhe moskthimi i plotë i pronave të komuniteteve fetare; mungesa e një pakete të plotë ligjore për komunitetet fetare; mungesa për një kohë të gjatë e strukturave efçente shtetërore që të merreshin me menaxhimin e raporteve ligjore dhe të detyrimeve të ndërsjella të shtetit me komunitetet fetare; perceptimi i të qenit pjesëtar i një komuniteti fetar i diskriminuar, i përjashtuar dhe i papërfaqësuar mjaftueshëm në politikë dhe institucione shtetërore<sup>12</sup>; rritja, edhe në vendin tonë, e perceptimit se Perëndimi po sulmon islamin dhe myslimanët<sup>13</sup>; lehtësia e radikalizimit dhe rekrutimit të besimtarëve nëpërmjet rrjeteve sociale; trysnia në rritje e rrymave intolerante në islam si, vehabi-selefizmi, etj”<sup>14</sup>. Ndërsa shtytësit kryesorë që kontribuojnë në radikalizëm të shoqërisë kosovare, mund të ndahen në tri kategori: problemet strukturore të shoqërisë, që përfshijnë dobësitë afatgjate socio-ekonomike e që për pasojë shkaktojnë edhe një varg problemesh tjera. E dyta, besimet personale, që përshkruajnë se si njerëzit e shohin botën dhe vendin e tyre në të dhe, kjo përfshin idetë rreth të drejtës dhe të gabuarës, të drejtësisë dhe ndëshkimit. Në kategorinë e fundit, futen rrethanat personale, që përfshijnë faktorë shumë të rëndësishëm, si: marrëdhëniet personale, familjen dhe miqtë, shoqërimin

Shala, XH.  
dhe  
Nano, G.

« Ekstremizmi i dhunshëm dhe ISIS, rrezik dhe kërcënim për sigurinë »

Policimi dhe Siguria nr.7, 2017

<sup>11</sup> The European Union's Policies on Counter Terrorism Report 2017, [http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2017/583124/IPOL\\_STU\(2017\)583124\\_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2017/583124/IPOL_STU(2017)583124_EN.pdf).

<sup>12</sup> 51% e të anketuarve besojnë se komuniteti fetar, të cilët ai i përket, nuk është i përfaqësuar mjaftueshëm në politikë dhe institucione shtetërore.

Sondazh i realizuar nga IDM, Tiranë: IDM, 2015, f. 11, f. 55.

<sup>13</sup> "Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri". Tiranë: IDM 2015, f. 9.

34% ose një në tre të anketuar beson se "Perëndimi është armiqësor dhe sulmon vazhdimisht vendet dhe kulturën Islame". Në një total prej 792 personash të cilët kanë pranuar të përgjigjen në lidhje me këtë pyetje, 269 prej tyre besojnë se vendet dhe kultura Islame po sulmohen nga Perëndimi.

<sup>14</sup> Xhavit Shala: "Arsimimi, faktor i rëndësishëm për neutralizimin e radikalizmit dhe të ekstremizmit të dhunshëm"..., f. 117-118.



me ekstremistë të tjerë si dhe, çështje të tilla si, lakmia, personaliteti sociopatik ose e kaluara penale.<sup>15</sup>

Politikat për një neutralizim afatgjatë të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, si në Shqipëri ashtu dhe në Kosovë, janë ato politika që mbështeten në një pjesëmarrje sa më të gjerë të komunitetit në këtë proces. Kjo qasje komunitare do të mbështetet përmes një bashkërendimi në rritje, të institucioneve të sigurisë, aktorëve të komunitetit lokal si dhe institucioneve të tjera shtetërore. Kjo do të bëhet e mundur nëpërmjet shfrytëzimit maksimal të kompetencave të punonjësve që janë në vijën e parë: mësuesit, personeli policor, punonjësit socialë, udhëheqësit fetarë dhe individë të tjerë, të cilët kanë një pozicionim strategjik për parandalimin e radikalizimit.<sup>16</sup> Për të përballuar radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm që të çojnë në terrorizëm, qoftë ai i një natyre fetare apo tjetër, një rol të veçantë merr arsimimi dhe shkolla, policia dhe policimi në komunitet, institucionet fetare, media sociale si dhe aktorë të tjerë shtetëror dhe jo shtetëror<sup>17</sup>.

Edhe Shqipëria nuk është e imunizuar nga kërcënimi terrorist. Vendi ynë është e ekspozuar ndaj rrezikut të mundshëm të ndonjë sulmi terrorist nisur nga: Anëtarësimi në NATO dhe pjesëmarrja e RSH në koalicionin kundër terrorizmit ndërkombëtar; pjesëmarrja e shtetasve shqiptarë si vullnetarë në luftëra/konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit<sup>18</sup>; pozita gjeostrategjike e vendit si dhe tensionet e konfliktet me bazë etnike në rajon; afërsia gjeografike dhe destabiliteti në lindjen e mesme; keqpërdorimi i lehtësive që krijon globalizmi, lëvizja e lirë, rrjetet sociale dhe teknologjia e përparuar, përhapja radikalizmit/ekstremizmit me frymëzim ideologjik, fetar apo nacionalist; prezenca e krimit të organizuar, korrupsioni dhe emigracioni i paligjshëm etj.

Pjesëmarrja e qytetarëve shqiptarë, shtetas të Shqipërisë apo dhe të Kosovës, si vullnetarë në luftëra/konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit, sidomos në Siri në përbërje ISIS-it dhe mundësia e kthimit të tyre, përbën një kërcënim permanent për sigurinë në Shqipëri e Kosovë. Përfshirja e qytetarëve shqiptarë në konfliktin në Siri fillon rreth mesit të vitit 2012, me nisjen e udhëtimit të tyre në mbështetje të grupeve opozitare të armatosura të angazhuara kundër regjimit të Bashar al Asad me qëllim dhënien e kontributit “në ndihmë të popullit të shtypur mysliman sunit sirian”. Gjatë vitit 2013, i ashtuquajturit Shteti Islamik (ISIS), vinte duke i konsoliduar dhe duke i forcuar radhët e tij nga fraksionet e ndryshme të Al Kaedës, si në strukturë e aftësi edhe në rekrutim. Në të njëjtin vit, për herë të parë, shtetasi kosovar, Lavdrim Muhaxheri, nëpërmjet një videoje të quajtur “të gjithë myslimanët shqiptarë të bashkohen në luftën kundër regjimit të Bashar al-Asad dhe të tjerëve ‘të pafeve’” u bëri thirrje publike në gjuhën shqipe të gjithë shqiptarëve, që të shkonin e të luftonin në Siri<sup>19</sup>.

<sup>15</sup> Nazmi Iballi, Kujtim Bytyqi, Bekim Podrimqaku: “Shtytësit kryesor të radikalizmit dhe shkalla e problemit me ekstremizëm të dhunshëm-Rasti i Kosovës”. *Konferenca e parë ndërkombëtare e Akademisë së Sigurisë: Kontributi në sigurinë publike nëpërmjet arsimimit, nëntor 2016*. Policimi dhe Siguria, nr. 4. Tiranë: Akademia e Sigurisë, 2016, f. 138.

<sup>16</sup> Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, miratuar me VKM nr. 930, datë 18.11.2015. Fletore Zyrtare Nr. 203 /2015. Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, faqe 13250.

<sup>17</sup> Dr. Xhavit Shala: Arsimimi, faktor i rëndësishëm për neutralizimin e radikalizmit dhe të ekstremizmit të dhunshëm...Faqe 114. Burim i citua

<sup>18</sup> *Sondazh: Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri*. Tiranë: IDM 2015.

47% e të anketuarve besojnë se mbrojtja me çdo mjet, brenda apo jashtë kufijve, e vlerave dhe dinjitetit fetar është detyrë e çdo besimtarit. f. 11, f. 76.

<sup>19</sup> Indeksonline.net (2014) “Lufta në Siri – Indeksonline Youtube. E disponueshme me datë 17.08.2016 në: <https://www.youtube.com/watch?v=zwbwhgS6sv>

**Shala, XH.  
dhe Nano, G.**  
« Ekstremizmi i dhunshëm dhe ISIS, rrezik dhe kërcënim për sigurinë »

Policimi dhe Siguria  
**nr.7, 2017**

Konflikti sirian, përveç ndërhyrjes së shumë vendeve të huaja<sup>20</sup>, që përdorën grupe/organizata për interesat e tyre politiko-strategjike, u pa nga masa e gjerë e besimtarëve salafistë si një shenjë profetike për çlirimin e Shamit<sup>21</sup> dhe vendosjen e Shtetit Islamik në këto territore. Me fillimin e veprimit të grupeve me baza xhihadiste-ekstremiste të dhunshme në Siri dhe shumë brigadave të tjera islamike, u bënë thirrje për të gjithë besimtarët myslimanë që të udhëtonin në Siri, të merrnin pjesë në luftë kundër regjimit të Asadit dhe të arrinin themelimin e Shtetit Islamik. Këto thirrje e organizatave ushtarake xhihadiste-ekstremiste të dhunshme, gjetën mbështetjen e drejtuesve salafistë/tekfiristë shqiptarë dhe të shqiptarëve të rajonit, të cilët filluan të organizonin rekrutimin e besimtarëve të rinj, anëtarë të grupeve të tyre, përgatitjen dhe dërgimin e tyre për në drejtim të grupeve xhihadiste-ekstremiste të dhunshme në Siri.

Kështu, në mes të janar -qershorit të vitit 2012 iu bashkuan konfliktit në Siri, 17 qytetarë të Kosovës. Në këtë periudhë evidentohet fillimi i udhëtimit edhe të qytetarëve nga Shqipëria si vullnetarë për xhihad luftarak, në drejtim të organizatave xhihadiste-ekstremiste të dhunshme në Siri. Ky fenomen arriti kulmin e zgjerimit të tij, në vitin 2013 dhe pati një rënie të fortë në gjysmën e dytë të vitit 2014. Në fillimin e vitit 2015, si pasojë e shumë faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, apo masave të marra nga autoritetet shtetërore shqiptare, thuajse u ndërpre tërësisht vajta e shtetasve shqiptarë për të luftuar në Siri. Në periudhën mes viteve 2012 dhe 2014, krahas përfshirjes së shtetasve shqiptarë në konfliktin sirian, është evidentuar dhe një rritje e propagandës radikale në disa xhami jashtë juridiksionit/kontrollit të KMSH<sup>22</sup> që shërbejnë si baza rekrutimi si dhe shfrytëzim në rritje të mjeteve të komunikimit elektronik nga elementët/grupet ekstremiste<sup>22</sup>.

Sipas të dhënave të Komunitetit Shqiptar të Shërbimeve Inteligjente dhe të agjencive ligjzbatuese shqiptare, për periudhën 2014-2016, pjesëmarrja e shtetasve shqiptarë në konfliktin sirian është si më poshtë: gjithsej, 144 qytetarë nga Shqipëria janë përfshirë në konfliktin e armatosur në Siri/Irak, nga të cilët 79 burra, 27 gra dhe 38 fëmijë; gjithsej, 73 shtetas shqiptarë ndodhen aktualisht në Siri - rreth 23 prej tyre janë aktivë në luftime kurse pjesa tjetër janë gra 20 dhe fëmijë 30; 45 shtetas pjesëmarrës në konfliktin sirian tashmë janë kthyer në Shqipëri - rreth 30 prej tyre kanë qenë aktivë në front ose kanë marrë trajnim ushtarak kurse pjesa tjetër janë gra (7) dhe fëmijë (8); gjithsej 26 shtetas shqiptarë kanë humbur jetën në Siri/Irak.

**Në paraqitje tabelore dhe grafike, pjesëmarrja e shtetasve shqiptar në konfliktin sirian paraqitet si më poshtë:**


Nr.	Persona	Larguar sipas viteve					Aktualisht në zonat e konfliktit	Të dyshuar të vrarë	Të kthyer	Të përfshirë gjithsej
		2012	2013	2014	2015	2016				
1	Meshkuj	7	55	17	0	0	23	26	30	79
2	Femra	0	20	7	0	0	20	0	7	27
3	Fëmijë	0	33	5	0	0	30	0	8	38
		<b>7</b>	<b>108</b>	<b>29</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>73</b>	<b>26</b>	<b>45</b>	<b>144</b>

<sup>20</sup> Grupimet kryesore janë: Iran-Rusi-Hezbollah (Liban) në mbështetje të regjimit të Bashar Al Asad dhe Turqi-Arabi Saudite-Katar, në mbështetje të opozitës siriane. Në këtë konflikt, përveç formacioneve të Ushtrisë së Lirë Siriane (FSA), kundër regjimit të presidentit Bashar Al Asad, luftojnë dhe dhjetëra grupe të ndryshme luftarake, të pavarura nga njëri-tjetri, disa prej të cilëve janë me profil të lartë islamik.

<sup>21</sup> Sham, ose Levant, territor që përfshin Sirinë, Jordaninë, Libanin, Izraelin dhe territoret Palestineze, i përmendur në vargjet e Kuranit dhe në Bibël si zonë ku do të zhvillohen betejat kryesore të njerëzimit para ardhjes së Zotit në tokë.

<sup>22</sup> Të dhënat janë të Komunitetit Shqiptar të Shërbimeve Inteligjente.

Persona larguar në Siri/Irak sipas viteve



Nga analiza statistikore (*tabelore dhe grafike*) e të dhënave të mësipërme gjejmë se:

- Në vitin 2012 janë evidentuar rastet e para (gjithsej 7 raste) të pjesëmarrjes së shtetasve shqiptar në konfliktin sirian.

- Në vitin 2013, krahasuar me vitin 2012, pjesëmarrja e shtetasve shqiptar në konfliktin sirian është rritur 15.4 herë. Ky vit shënon dhe shifrën më të lartë të pjesëmarrjes së shtetasve shqiptar në atë konflikt.

- Në vitin 2014 pjesëmarrja e shtetasve shqiptar në konfliktin sirian ka tendencë të theksuar në ulje. Kjo shifër, ndonëse është 4.1 herë më e madhe se në vitin 2012, është 3.7 herë me e vogël se në vitin 2014.

- Në vitin 2015 dhe 2016, nuk është evidentuar asnjë rast të shtetasve shqiptarë të larguar nga Shqipëria për të marrë pjesë, përkrah grupeve terrorist të ISIS-it, në konfliktin e armatosur në Siri/Irak.

Në rënien drejt zeros të pjesëmarrjes së shtetasve shqiptar në konfliktin sirian për vitet 2015-2016 kanë ndikuar një serë faktorësh ku nga më kryesorët mund të evidentojmë:

- Ndryshimet në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë dhe parashikimin si veprë penale të pjesëmarrjes së shtetasve shqiptar në konfliktet e armatosura jashtë vendit, organizimi dhe thirrja për pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj, përkatësisht neni 265/a, 265/b e 265/c, i cili parashikon masa të rënda dënimi që shkojnë nga 3-8 vjet dhe 8-15 vjet burg.<sup>23</sup>

- Arrestimi dhe dënimi i personave dhe grupeve të organizuara, të angazhuar direkt në rekrutimin e shtetasve shqiptar për t'i dërguar në konfliktin sirian. Konkretisht në 11 mars 2014, u arrestua një grup prej 9 shtetasish shqiptar mes tyre dhe të dy imamë<sup>24</sup> të vetëshpallur të xhamive “Unaza e Re” dhe “Mëzesit” në Tiranë<sup>25</sup>.

Këta faktorë jo vetëm ndikuar në uljen e menjëhershme të numrit të individëve të interesuar për të udhëtuar drejt Sirisë por ndikuan dhe në rritjen e menjëhershme të numrit të shtetasve shqiptar të kthyer nga Siria në Shqipëri (rreth 40 shtetas janë kthyer

<sup>23</sup> Ndryshimet në Kodin Penal të RSH të bëra me Ligjin nr. 98/2014, i cili hyri në fuqi më datë 3 shtator 2014.

<sup>24</sup> Të diferencuar si organizatorët kryesor për propagandimin, rekrutimin dhe mundësimin e dërgimit të shtetasve shqiptarë në Siri/Irak

<sup>25</sup> Pjesëtarë të këtij grupi u akuzuan dhe u gjykan për “Rekrutimit të personave me qëllim kryerjen e veprimeve terroriste”, “Nxitjes, thirrjes publike dhe propagandës për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste”, “Nxitjes së urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve” të parashikuara nga neni 231, 232/a dhe 265 të Kodit Penal. Në vitin 2016 gjykata shpalli fajtorë nëntë persona dhe i dënoi me nga 7 deri në 18 vjet, që përbëjnë gjithsej 126 vite burg. *Vendim nr. 58 datë 03.05.2016* i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, ndryshuar me *vendim nr. 118 datë 30.11.2016* të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda.

**Shala, XH. dhe Nano, G.**  
 « Ekstremizmi i dhunshëm dhe ISIS, rrezik dhe kërcënim për sigurinë »

Policimi dhe Siguria  
**nr.7, 2017**

deri tani).

Në kthimin në Shqipëri të shtetasve shqiptar nga konflikti sirian, përveç përpjekjeve të tyre për t'i shpëtuar përgjegjësisë së mëvonshme penale, kanë ndikuar dhe:

- zhgënjimi nga realiteti me të cilin janë përballur në Siri;
- mospërshtatja me kushtet, vështirësitë dhe mënyrën e atjeshme të jetesës;
- trauma psikologjike apo plagosjet e marra gjatë luftimeve në Siri;
- moskallimi i fazës së selektimit pranë grupeve rebele dhe moskallimi i ndonjë detyre konkrete;
- kthimi i përkohshëm me mendimin për të udhëtuar përsëri më vonë;
- motive personale dhe familjare;
- konfliktet e brendshme mes grupeve xhihadiste-ekstremiste të dhunshme (ISIS–Al Nusra);

Shumica e të kthyerve nga Siria mbajnë një profil të ulët, duke mos komunikuar hapur në grupet e besimtarëve myslimanë se ku kanë qenë apo çfarë kanë bërë konkretisht në Siri, ndërkohë që vazhdojnë kontakte, kryesisht nëpërmjet komunikimit online me shqiptarët e mbetur në Siri, të inkuadruar në grupet ndërluftuese atje.

Pavarësisht profilit të ulët që ata përipiqen të mbajnë në vend, të kthyerit nga Siria vlerësohet se përbëjnë një rrezik dhe nëse nuk menaxhohen me kujdes mund të kthehen në një kërcënim serioz për sigurinë tonë kombëtare sepse:

- janë trajnuar dhe kanë fituar eksperiencë ushtarake;
- janë indoktrinuara nga ideologji radikale;
- vazhdojnë mbajtjen e kontakteve me individë/grupe të lidhur me xhihadin islamik.

Cilësitë e mësipërme krijojnë premisa për përfshirjen e të kthyerve nga Siria, në aktivitete me karakter destabilizues apo terrorist. Gjithashtu, kontingjenti i shtetasve shqiptarë që janë pjesë e grupeve xhihadiste-ekstremiste të dhunshme në Siri (ISIS<sup>26</sup> dhe Jabhat al-Nusra<sup>27</sup>), përbëjnë pjesën më të radikalizuar, çka vlerësohet seriozisht se ky kontingjent mund të përdoret nga këto organizata dhe/apo grupe të tjera aleate me to, për kryerje të sulmeve terroriste në Siri, Irak, në vendin tonë, në vendet e rajonit apo në Evropën Perëndimore e më gjerë.

Ndryshe nga të kthyerit nga Siria, pjesëtarë të grupit të arrestuar në Shqipëri si rekrutues në muajin mars 2014, edhe pas arrestimit, vazhdojnë të mbajnë një profil të lartë radikal si dhe po tentojnë afrimin dhe radikalizimin e të burgosurve të tjerë, me të cilët qëndrojnë. Propaganda radikale që ata po zhvillojnë në ambientet e burgut, vlerësohet tepër e rrezikshme pasi bashkëbiseduesit e tyre janë individët që kanë një profil dhe lidhje në veprimtari kriminale, të cilët mund të radikalizohen e të shfrytëzohen më vonë për akte të mundshme ekstremiste/terroriste.

Gjithashtu, është vërejtur se pas akteve terroriste në Francë, organizatorë dhe ekstremistë të veçantë, kryesisht në drejtimet: Tiranë – Kavajë; Elbasan – Peqin, Cërrik, Librazhd; Korçë – Pogradec – Çërravë; Peshkopi – Bulqizë; Sarandë – Delvinë, Shkodër e Kukës, kanë shprehur komente/deklarata mbështetëse ndaj këtyre akteve.

Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar të ashtuquajturve “ujqërit e vetmuar”, të cilët janë elementë potencialisht të indoktrinuara dhe motivuar për të ndërmarrë planifikimin apo kryerjen individuale të akteve terroriste. Veprimtaria e tyre përbën një rrezik e kërcënim potencial për sigurinë. Identifikimi i elementëve të tillë, apo i

Shala, XH.  
dhe  
Nano, G.

« Ekstremizmi  
i dhunshëm  
dhe ISIS, rrezik  
dhe kërcënim  
për sigurinë »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

<sup>26</sup> Shteti Islamik i Irakut dhe Shamit.

<sup>27</sup> Fronti i Fitores - dega zyrtare e Al Kaeda në Siri e cila ka ndryshuar emrin e saj në Jabhat Al Fatah Al Sham.

grupeve me pak anëtarë (celulave) përbën një sfidë të vazhdueshme dhe të qenësishme jo vetëm për strukturat antiterror, në vendin tonë, por për të gjithë komunitetin e shërbimeve inteligjente dhe të sigurisë.

Përveç rrezikut dhe kërcënimit për sigurinë nga shtetasit shqiptarë, duhet vlerësuar edhe kërcënimi terrorist nga shtetas të huaj të lidhur me grupe apo organizata terroriste, përfshirë xhihadistët ekstremist të dhunshëm dhe elementët radikalë nga rajoni, kryesisht B&H, Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi, të cilët kanë lidhje/kontakte me elementë radikalë në vendin tonë. Kjo sidomos nisur nga fakti se xhihadistët-ekstremistët e dhunshëm shqiptarë dhe nga rajoni, për shkaqe kulture dhe gjuhe, veprojnë në formacione të përbashkëta luftarake me ata në Siri/Irak.

Një vend të rëndësishëm në përcaktimin e nivelit të kërcënimeve terroriste e zë orientimi apo vendimmarrja e grupeve xhihadiste - ekstremiste të dhunshme që luftojnë në Siri, për t'u angazhuar në ndërmarrjen e sulmeve në vendet evropiane. Pas ndërhyrjeve ushtarake në Irak dhe Siri të koalicionit ndërkombëtar, ka mundësi që ISIS të trajtojë luftëtarë të huaj për sulme të vetëorganizuara pasi të kthehen në vendet e origjinës. Për më tepër, përqendrimi i ISIS për të sulmuar në Perëndim, ka si objektiv strategjik edhe rivalizimin e Al Kaeda-s, me qëllim pozicionimin e organizatës së tyre në krye të hierarkisë xhihadiste - ekstremiste të dhunshme.

Ekziston rreziku që nga organizatat terroriste ISIS dhe Al Kaeda mund të përdorin edhe linjat e trafikut ilegal të klandestinëve, kryesisht nga vendet e MENA-s<sup>28</sup>, për dërgimin e operativëve terroristë në Evropë, ku nuk përjashtohen vendet e Ballkanit, dhe vendi ynë. Përfshirja në aktet e fundit terroriste në Evropë, të elementëve ardhur nëpërmjet linjës së refugjatëve nga zonat e luftës e provojnë më së miri këtë "modus operandi" të ISIS-it dhe jo vetëm.

Vlerësohen si objektiva me risk të lartë të infrastrukturës kritike, që mund të shenjestrohen nga sulme të mundshme terroriste, objektet si më poshtë:

- aeroporti, portet detare si dhe mjetet e transportit ajror dhe detar;
- ambasadat dhe përfaqësitë e vendeve perëndimore, por edhe ato të vendeve të Lindjes, pjesëmarrëse në koalicionin anti-ISIS;
- shkollat e huaja në Shqipëri, sidomos të vendeve perëndimore;
- sistemi i transmetimit energjetik të vendit;
- qendrat e madha kulturore-tregtare në qytetet e mëdha;
- agjencitë e zbatimit të ligjit e të inteligjencës si dhe punonjësit e tyre, që u kundërvihen fenomenit etj.

## **5. Politikat dhe masat e marra në dinamikë për neutralizimin e radikalizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe të kërcënimit terrorist**

Politikat shqiptare për neutralizimin e radikalizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe të kërcënimit terrorist mbështeten në këto shtylla kryesore:

- hartimi i strategjive të nevojshme së bashku me planet e veprimit për zbatimin e tyre;
- realizimi i përmirësimeve të nevojshme ligjore;
- ndryshimet e duhura strukturore për t'ju përgjigjur kërcënimit më të ri terrorist.

<sup>28</sup> Middle East and North Africa – Lindja e Mesme dhe Afrika e Veriut.

*Shala, XH.  
dhe Nano, G.*  
« Ekstremizmi i dhunshëm dhe ISIS, rrezik dhe kërcënim për sigurinë »

Policimi dhe Siguria  
**nr.7, 2017**

Në vetvete politikat për një neutralizim afatgjatë të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, janë ato politika publike, që mbështeten në një pjesëmarrje sa më të gjerë të komunitetit në këtë proces. Kjo qasje komunitare do të mbështetet përmes një bashkërendimi në rritje të institucioneve të sigurisë, aktorëve të komunitetit lokal si dhe institucioneve të tjera shtetërore.

Ndër masat e marra në kundërvënje të fenomenit dhe kërcënimeve terroriste mund të evidentojmë:

- Miratimin dhe fillimin e zbatimit të “*Strategjisë Kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm*”<sup>29</sup> dhe planit të saj të veprimit, si konkretizim i sigurizimit të rrezikut dhe kërcënimit nga radikalizmit dhe ekstremizmi i dhunshëm.

- Nismën për ndryshime ligjore dhe realizimin e ndryshimeve në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, duke parashikuar si vepër penale pjesëmarrjen e shtetasve shqiptarë në konfliktet e armatosura jashtë vendit - përkatësisht neni 265/a, 265/b e 265/c, i cili parashikon masa të rënda dënimi, që shkojnë nga 3-8 vjet dhe 8-15 vjet burg.<sup>30</sup>

- Rritjen e kapaciteteve me burime njerëzore dhe infrastrukturë bashkëkohore të strukturave antiterror në Policinë e Shtetit dhe ngritja e Drejtorisë së Antiterrorit.<sup>31</sup>

- Ngritjen, që në dhjetor 2013, të grupit të përbashkët të punës, “SHISH - Polici e Shtetit - Prokurori”, për tu përballur me këtë fenomen.

- Bashkëpunimin intensiv me agjencitë partnere të zbatimit të ligjit dhe inteligjencës, për ndjekjen e përbashkët të fenomenit/shkëmbimin e informacionit;

- Fillimin zyrtar të hetimeve nga Policia e Shtetit, në bashkëpunim me Prokurorinë për Krimet e Rënda, në dhjetor të vitit 2013; më pas arrestimin dhe dënimin nga gjykata të grupit të rekrutuesve të shtetasve shqiptar për xhihad të dhunshëm në Siri, për veprën penale të “Rekrutimit të personave me qëllim kryerjen e veprimeve terroriste”, “Nxitjes, thirrjes publike dhe propagandës për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste”, “Nxitjes e urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve” të parashikuara nga neni 231, 232/a dhe 265 të Kodit Penal;

- Forcimin e kontrollove kufitare ndaj shtetasve shqiptarë pjesëmarrës në konfliktin Siri/Irak dhe të dyshuarve që planifikojnë të udhëtojnë drejt konfliktit sirian si dhe, të shtetasve të huaj, - përfshirë ata të etnisë shqiptare, nga rajoni, - pjesëmarrës në konflikt, të dyshuar si të lidhur me organizata ekstremiste/terroriste, apo financues të tyre.

- Intervistimin e të kthyerve, nga strukturat e specializuara të luftës kundër terrorizmit në momentin e hyrjes në territorin shqiptar, me synimin e sigurimit të provave të prezencës në zonat në konflikt dhe pjesëmarrjes në aktivitete/trajnime luftarake.

- Shtimin e masave të sigurisë nga Policia e Shtetit dhe strukturat e tjera në mbrojtje të infrastrukturës kritike më risk të lartë shënjestrimi nga sulme të mundshme terroriste.

- Forcimin e policimit nëpërmjet inteligjencës. Policia e Shtetit ka bërë vlerësimin dhe analizën e situatës në lidhje me individë, grupe apo organizata që kanë mundësinë, aftësinë dhe qëllimin për tendenca të tilla si dhe objektet dhe vendet publike me risk duke orientuar edhe shërbimet në terren.

- Forcimin e bashkëpunimit policor ndërkombëtar. Policia e Shtetit ka intensifikuar punën dhe evidentohet një rritje e fluksit të shkëmbimit të informacionit me Europol,

Shala, XH.  
dhe  
Nano, G.

« Ekstremizmi i dhunshëm dhe ISIS, rrezik dhe kërcënim për sigurinë »

Policimi dhe Siguria nr. 7, 2017

68

<sup>29</sup> Miratuar me VKM nr. 930, datë 18.11.2015.

<sup>30</sup> Ndryshimet në Kodin Penal të RSH të bëra me Ligjin 98/2014, i cili hyri në fuqi më datë 3 Shtator 2014.

<sup>31</sup> Me Urdhër MPB Nr. 548/7 datë 17.10.2014, Sektori i Antiterrorit në Policinë e Shtetit u ngrit në rang drejtorie.

Interpol, midis policive të vendeve të BE-së, Kosovë, Maqedoni etj., për çështje konkrete dhe partnerët tanë strategjikë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilët na kanë asistuar e mbështetur në vazhdimësi për të gjitha nismat e reformat.

- Rritjen e kapaciteteve profesionale të strukturave përkatëse, në hetimet proaktive dhe procedimet penale, për problemet e ekstremizmit të dhunshëm, të terrorizmit, të trafikut të armëve dhe municioneve etj.

## 6. Përfundime

Pas studimit dhe hulumtimit, në këtë punim, të radikalizmit, ekstremizmit të dhunshëm si dhe të veprimtarisë së ISIS-it, arrijmë në këto përfundime:

- Radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm përbëjnë një rrezik dhe nëse nuk menaxhohet mirë, mund të kthehet në një kërcënim për sigurinë tonë kombëtare.

- Veprimtaria e ISIS-it përbën një kërcënim serioz për sigurinë ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare.

- Të kthyerit nga Siria, për shkak të indoktrinimit nga ideologji radikale, trajnimeve, pjesëmarrjes së tyre në veprime luftarake, kontakteve që mbajnë me elementë terroristë si dhe premisave që kanë për përfshirjen e tyre në aktivitete me karakter destabilizues apo terrorist, përbëjnë rrezik, i cili nëse nuk menaxhohet mirë mund të kthehet në një kërcënim për sigurinë tonë kombëtare.

- Shqipëria zotëron kapacitetet e duhura dhe ka marrë masat e nevojshme për tu përballur me kërcënimin terrorist.

## 7. Rekomandime

Me qëllim reduktimin e kërcënimin terrorist si dhe të nivelit të rrezikut nga radikalizmi, ekstremizmi i dhunshëm dhe veprimtaria e të kthyerve nga konflikti sirian është i rekomandueshëm:

- Zbatimi i politikave, strategjive të miratuara dhe të planeve të tyre të veprimit që vijnë si produkt i një vlerësimi paraprak të situatës, mbështetjes së tyre në buxhetin e nevojshëm dhe rishikimin herë pas here, për tu përditësuar me fenomenet, rreziqet dhe kërcënimet aktuale.

- Angazhimi konkret i të gjithë institucioneve, aktorëve dhe faktorëve që përfshihen, kanë detyrime të përcaktuara në strategji e plane veprimi/operacionale, duke mos e lënë gjithçka vetëm në dorë të agjencive ligjzbatuese.

- Mbështetja e fuqizimit me burime njerëzore e logjistike bashkëkohore, të strukturave të specializuara në luftën ndaj fenomenit të terrorizmit, nisur nga rreziqshmëria dhe impakti që ka zhvillimi i këtyre tendencave dhe mundësisë reale për ballafaqim nga agjencitë e zbatimit të ligjit me qëllim parandalimin, zbulimin dhe goditjen e këtyre dukurive në Shqipëri.

- Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit, agjencive të inteligjencës dhe Prokurorisë për marrjen, vlerësimin, shkëmbimin e shpejtë të informacionit dhe hetimit intensiv duke përdorur me efikasitet të gjitha format dhe metodat e punës operativo-gjurmuese.

- Hartimi i procedurave standarde për menaxhimin e krizave në rast të një sulmi terrorist në RSH si dhe trajnimi i strukturave menaxhuese të krizave në situata të simuluar.

*Shala, XH.  
dhe Nano, G.*  
« Ekstremizmi i dhunshëm dhe ISIS, rrezik dhe kërcënim për sigurinë »

Policimi dhe Siguria  
nr.7, 2017

- Ngritja e trajnimi, i strukturave kibernetike, të specializuara për fushën e antiterrorit.
- Planifikimi dhe mbështetja me buxhet për trajnimin në këtë fushë edhe të stafit të institucioneve të drejtësisë (prokurorë dhe gjykatës).
- Nxitja e ndryshimeve të nevojshme ligjore në të cilat të parashikohet revokimi i dokumenteve të udhëtimit për shtetasit shqiptarë, të cilëve u dokumentohet qëllimi i udhëtimit drejt vendeve të huaja në konflikt.
- Hartimi i një strategjie për rehabilitimin e vullnetarëve të kthyer nga konflikti sirian.
- Hartimi dhe zbatimi i programeve socioekonomike, në ato zona ku janë evidentuar bazat kryesore të rekrutimit të vullnetarëve xhihadistë/ekstremistë të dhunshëm.
- Bashkëpunimi me komunitetin mysliman shqiptar për marrjen nën juridiksionin e tyre të xhamive dhe musalave të paligjshme/pa leje (89 të tilla në tërë vendin), në të cilat predikohen ideologji radikale nga imamë të vetëshpallur.
- Rritja e rolit të sistemit arsimor dhe të medieve në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

**Shala, XH.  
dhe  
Nano, G.**

« Ekstremizmi  
i dhunshëm  
dhe ISIS, rrezik  
dhe kërcënim  
për sigurinë »

Policimi  
dhe  
Siguria  
**nr.7, 2017**



## Referenca

1. *Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë 2014*. Miratuar me Ligjin nr. 103/2014, datë 31.07.2014. Publikuar në Fletore Zyrtare nr. 137.
2. *Violent Extremism and Religious Radicalization in Albania*. Publishing IDM 2015.
3. *Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm*, miratuar me VKM nr. 930, datë 18.11.2015. Fletore Zyrtare nr. 203 /2015. Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare.
4. Xhavit Shala: "Arsimimi, faktor i rëndësishëm për neutralizimin e radikalizmit dhe të ekstremizmit të dhunshëm". *Konferenca e parë ndërkombëtare e Akademisë së Sigurisë me temë: Kontributi në sigurinë publike nëpërmjet arsimimit*, nëntor 2016. *Policimi dhe Siguria, nr. 4*. Tiranë: Akademia e Sigurisë, 2016.
5. Sandër Lleshi: "Edukimi modern si antidot i pazëvendësueshëm në përballjen me ekstremizmin e dhunshëm". *Konferenca e parë ndërkombëtare e Akademisë së Sigurisë me temë: Kontributi në sigurinë publike nëpërmjet arsimimit*, nëntor 2016.
6. <http://noa.al/lajmi/2013/03/295800.html>.18.8.2017.
7. Nazmi Iballi, Kujtim Bytyqi, Bekim Podrimçaku: "Shtytësit kryesor të radikalizmit dhe shkalla e problemit me ekstremizëm të dhunshëm-Rasti i Kosovës". *Konferenca e parë ndërkombëtare e Akademisë së Sigurisë me temë: Kontributi në sigurinë publike nëpërmjet arsimimit*, nëntor 2016.
8. Indeksonline.net (2014) "Lufta ne Siri - Indeksonline" Youtube.  
E disponueshme me datë 17. 8. 2016 në: <https://www.youtube.com/watch?v=zhbWhgS6svc>
9. Të dhëna të Komunitetit shqiptar të Shërbimeve Inteligjente.
10. Ligji nr. 98 datë 31.07.2014, për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905 datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", hyrë në fuqi më datë 3 shtator 2014.
11. *Vendim nr. 58 datë 3. 5. 2016 i Gjykatës së Shkallës së parë për Krimet e Rënda ndryshuar me vendim nr. 118, datë 30. 11. 2016 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda* (i formës së prerë). Për dënimin e 9 personave (Genci Balla etj), për "Rekrutimit të personave me qëllim kryerjen e veprimeve terroriste", "Nxitjes, thirrjes publike dhe propagandës për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste", "Nxitjes së urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve" të parashikuara nga neni 231, 232/a dhe 265 të Kodit Penal.
12. *Urdhër MPB nr. 548/7 datë 17.10.2014 për krijimin e Drejtorisë së Antiterrorit*.
13. *The European Union's Policies on Counter Terrorism Report 2017*, [http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2017/583124/IPOL\\_STU\(2017\)583124\\_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2017/583124/IPOL_STU(2017)583124_EN.pdf)

**Shala, XH.  
dhe Nano, G.**  
« Ekstremizmi i dhunshëm dhe ISIS, rrezik dhe kërcënim për sigurinë »

Policimi  
dhe  
Siguria  
**nr.7, 2017**

# Teknologjia e informacionit dhe Policia e Shtetit



■ **MSc. Dashamir ÇALI**  
Akademia e Sigurisë

## Abstrakt

*Gjatë viteve të fundit, teknologjia e informacionit (SI/TI) ka luajtur një rol të veçantë në realizimin e misionit të Policisë së Shtetit dhe në kryerjen e objektivave proiritare të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Artikulli trajton zhvillimin dhe rritjen e SI/TI në polici, si një qasjeje e bazuar në përpjekjet e vazhdueshme për njohuri dhe zhvillime për t'ju përgjigjur sfidave të kohës, për rendin dhe sigurinë publike. Kjo teknologji informacioni - ku më vonë, me rritjen e kapaciteteve të komunikimit "Data", mori kuptimin "Sisteme të informacionit dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit" (SI/TIK), me zhvillimin e "Rrjetit shpërndarës të informacionit" (LAN/WAN)<sup>2</sup>, më tej me zhvillimin e intranetit dhe internetit, - ka mundësuar sigurimin e një cilësie më të lartë të shërbimit, për strukturat e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Policisë së Shtetit në veçanti. Zhvillimet dinamike të tregut dhe teknologjive, si një seri të teknologjive TI (Teknologji Informacioni)<sup>3</sup> për mbledhjen, ruajtjen, gjetjen, përpunimin, analizimin dhe transmetimin e informacionit, kanë çuar në një konvergencë, të kufijve për nevoja dhe shërbime të veçanta, me rritjen e volumit të informacionit, për rritje të efektivitetit në punë të strukturave të Policisë së Shtetit. Që të arrihej në nivelet e sotme të zbatimit të teknologjisë, brenda zyrave, sektorëve, drejtorive dhe nga specialistë jo vetëm të të teknologjisë së informacionit, të profilizuar e jo, ka kaluar në një rrugë të gjatë dhe plot sfida. Këtë ecuri do e shohim hap pas hapi në këtë artikull.*

## Fjalëkyçe:

**teknologji e informacionit, rrjetat informatike, baza të dhënash, TIMS, sisteme, strategji e zhvillimit**

## 1. Hyrje

Teknologjia e informacionit (SI/TI)<sup>1</sup> ka luajtur një rol të veçantë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në zhvillimin e një qasjeje të bazuar në përpjekjet e vazhdueshme për njohuri dhe zhvillime për t'ju përgjigjur sfidave të kohës, për rendin dhe sigurinë publike. Kjo teknologji informacioni - ku më vonë, me rritjen e kapaciteteve të komunikimit “Data”, mori kuptimin “Sisteme të informacionit dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit” (SI/TIK), me zhvillimin e “Rrjetit shpërndarës të informacionit” (LAN/WAN)<sup>2</sup>, më tej me zhvillimin e intranetit dhe internetit, - ka mundësuar sigurimin e një cilësie më të lartë të shërbimit, për strukturat e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Policisë së Shtetit në veçanti. Zhvillimet dinamike të tregut dhe teknologjive, si një seri të teknologjive TI (Teknologji Informacioni)<sup>3</sup> për mbledhjen, ruajtjen, gjetjen, përpunimin, analizimin dhe transmetimin e informacionit, kanë çuar në një konvergencë, të kufijve për nevoja dhe shërbime të veçanta, me rritjen e volumit të informacionit, për rritje të efektivitetit në punë të strukturave të Policisë së Shtetit.

Në këtë kuadër dallojmë rolin e specialistëve, zyrave, sektorëve, drejtorive dhe specialistëve të teknologjisë së informacionit të profilizuar dhe në veçanti, të drejtuesve të institucionit. Sektorë të rëndësishëm strategjikë, për aplikimet informatike në institucionin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policinë e Shtetit në veçanti, kanë qenë policia e kufirit dhe migracionit, policia kriminale, antiterrori dhe ajo e luftës kundër krimit të organizuar, policia e rendit dhe sigurisë publike, policia e qarkullimit rrugor, administrata dhe mbështetja logjistike etj. Sektorë të tillë janë, kush më shumë e kush më pak, kanë qenë dhe janë nën vëmendjen e teknologjisë së informacionit.

<sup>1</sup> SI/TI - Sisteme informacioni, TI: Teknologji informacioni.

<sup>2</sup> LAN/WAN Lan Area Network dhe Wan Area Network , Tipologji rrjeti informatik.

<sup>3</sup> TI- Teknologji Informacioni Software & Harware programe dhe pajisje që mundësojnë ato.

## **2. Historia e shërbimit të teknologjisë së informacionit në botë, Europë dhe në Shqipëri**

Vitet e fundit të shekullit të 20-të, filluan që të luajnë një rol të rëndësishëm *sistemet e menaxhimit të informacionit* dhe ato të specializuara në fushën e *internetit*, duke e afruar individin dhe institucionet shtetërore me pjesën tjetër të publikut, në një mjet të fuqishëm komunikimi mbarëbotëror. Në këtë kuptim, roli i sistemeve të informacionit dhe i teknologjive të informacionit, të aplikuara në kuadrin e rrjetave telepatike, u bë prioritar. Ky prioritet shprehet në mbështetjen nga ana e të gjithë vendeve në botë, për sistemet dhe teknologjitë e informacionit, duke lënë hapur pjesëmarrjen e institucioneve, të atyre të specializuara e, pse jo, edhe të individëve, duke krijuar një hapësirë të gjerë për një pjesëmarrje masive të institucioneve dhe specialistëve në zhvillimin e aplikimeve informatike, projektet e të cilëve do të jenë masive në fushën e informatikës dhe të teknologjive të informacionit.

### **2.1 Rrjetat informatike të shpërndara, aplikimet/shërbimet në to, evolucioni i internetit**

Zhvillimi i sistemeve informatike, të lidhura njëra me tjetrën në një rrjet botëror, - Internet, - mori përmasa të tilla, që shkaktoi një revolucion të vërtetë teknologjik e shoqëror, duke na shpënë drejt të ashtuquajturës “shoqëri e informacionit”. Rruga drejt një të ardhmeje të tillë, nuk ishte shpikje e ndonjë qeverie apo ndonjë grupi shkencëtarësh. Konkretisht, ky koncept lidhet me evolucionin e Internetit dhe revolucionin teknologjik që ai po ndryshonte thelbësisht mënyrën e punës, si një rezultat i natyrshëm i nevojës dhe veprimtarisë njerëzore.

### **2.2 Zhvillimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit**

Zhvillimi i SI/TI në vendet e BE-së<sup>4</sup>, e shikon zhvillimin të lidhur ngushtë me zhvillimin ekonomik dhe social të këtyre vendeve. Në këto zhvillime është punuar në drejtim të shtimit dhe promovimit të shërbimeve elektronike për qytetarët, biznesin dhe administratën, në përdorimin e SI/TI në edukim për të kapërcyer hendekun digjital dhe, për të aftësuar përdoruesit drejt përmirësimit dhe zgjerimit të kapaciteteve njerëzore, në mënyrë që të rritet numri i përdoruesve dhe në konsolidimin e infrastrukturës digjitale.

### **2.3 Zhvillimi i bazave të së dhënave**

Bazat e të dhënave në këtë kohë, përbëjnë një nga kategoritë kryesore të aplikimeve informatiko-telematike. Nga ana tjetër, ato përfaqësojnë tërësinë e informacioneve të strukturuar dhe të klasifikuara - trashëgimi e njohurive të grumbulluara gjatë veprimtarisë manuale njerëzore. Roli i tyre nuk ishte thjeshtë, arkivues, për hir të arkivimit. Rritja e volumit të informacionit ishte bërë element i pashmangshëm dhe vendimtar, në procesin e analizës dhe marrjes së vendimeve, në të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore. Një tipar karakteristik i shoqërisë së sotme është pikërisht varësia e saj nga informacioni, tipar që sa vjen e theksohet. Sot, informacioni është një mall

<sup>4</sup> BE: Vendet e Bashkimi Europian.

tepër i kërkueshëm dhe i kushtueshëm.

Fushat e aplikimit të bazave të së dhënave me interes shtetëror dhe kombëtar janë të shumta. Përmendim të dhënat demografike, shëndetësore, ekonomike, gjeografike, gjeologjike, ekologjike, dokumentare, ligjore, historike etj. Në thelb, çdo institucion publik ose jo, nuk mund të funksionojë pa u mbështetur në baza të dhënash (që për momentin mund të mbahen thjesht në letër, të futura në dosje). Rritja e konsiderueshme e të dhënave dhe ndërveprimi midis organizatave, e bënë të pashmangshëm krijimin e bazave të mirëfillta të së dhënave, duke përdorur teknologji informatike dhe duke i integruar në rrjeta telematike, për ta bërë informacionin të disponueshëm, sipas kriterëve të caktuara për shoqërinë.

## ***2.4 Zhvillimi i teknologjive të reja***

Zhvillimi i teknologjive të reja me mundësi zbatimin e sistemeve të zhvilluara të informacionit, përbënin një domosdoshmëri, që lidhet me mundësinë e nxitjes dhe mbështetjes së investimeve për zbatimin e tyre në kohën dhe vendin e përshtatshëm, duke rekomanduar në parim zgjidhjet e mundshme teknike dhe duke pasur një bazë, për thellimin e njohjes së tyre në një kohë të shkurtër, për t'i mbështetur këto zbatime.

## ***2.5 Historia e teknologjisë së informacionit në Europë***

Prioritetet e SI/TI në nivel evropian, kanë qenë të përshkruara nga interesi për rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse që synon përgatitjen e ekonomisë së BE, për sfidat e dekadës së ardhshme. Qëllimi i saj në mënyrë të veçantë është për të përmbushur një nga nismat e saj - të njohur si Agjenda Digjitale për Europën (DAE)<sup>5</sup>, e cila është e lidhur drejtpërdrejtë me problemet në fushën e teknologjisë së informacionit dhe internetit. SI/TI është pranuar gjerësisht nga vendet e BE, si një nga forcat kryesore, duke krijuar inovacion nëpërmjet Teknologjisë së Informacionit në proceset e digjitalizimit si: proceset ekonomike, proceset sociale, proceset institucionale dhe administrative, përmes shërbimeve<sup>6</sup> e-Government, identitetit digjital, thjeshtëzimit të procedurave institucionale dhe administrative, shërbimeve ndihmëse, pjesëmarrjes në vendimmarrje të qytetarëve dhe biznesit etj.

Objektivi kryesor i Agjendës Digjitale për Evropën është krijimi dhe mbështetja e zhvillimit të rrjetave telematike në administratën dhe institucionet me karakter shtetëror dhe publik, nxitja dhe mbështetja e zhvillimit të infrastrukturës dhe shërbimeve bazë të telekomunikacioneve, mbi të cilat ngrihen rrjetat telematike, liberalizimi i shërbimeve të transmetimit të së dhënave, si baza e aplikimeve telematike, duke ndjekur tendencat e zhvillimit të shoqërisë.

## **3. Historia e teknologjisë së informacionit në Shqipëri**

Zhvillimet për SI/TI dhe shoqërinë e informacionit në Shqipëri, kanë qenë të bazuara në modelin evropian, e parë kjo, në harmoni me zhvillimet rajonale dhe në perspektivën e integritimit me Bashkimin Evropian. Infrastruktura globale e informacionit, e bazuar në teknologjitë e reja të informacionit dhe telekomunikacionin me përdorimin e fibrave

<sup>5</sup> Një Agjendë Digjitale për Evropën, COM(2010)245, miratuar 19.05.2010, EC.

<sup>6</sup> e-Government - është përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) për të përmirësuar aktivitetet e organizatave të sektorit publik.

optike dhe komunikimet satelitore, krijuan kushte për zhvillimin në shkallë të gjerë të shërbimeve të reja në fushën e administratës publike, të cilat u reflektuan edhe në shërbimet që afrojnë SI/TI.

Në nëntor të vitit 2013 vendet e Europës Juglindore miratuan “Strategjinë Rajonale për Europën Juglindore”, SEE-2020<sup>7</sup>. Në këtë dokument strategjik objektivat për zhvillimin e agjendës digjitale zënë vend nën dimensionin e Shoqërisë Digjitale të shtyllës “Për një rritje të zgjuar”, “*smart growth*”. Ky dokument që prezanton agjendën digjitale për 2014-2020, vjen në harmoni me objektivat e zhvillimeve rajonale dhe me ato të BE-se, duke u përshtatur me kushtet dhe zhvillimet konkrete të vendit. Dokumenti, pas një analize të situatës dhe zhvillimeve aktuale, përcakton vizionin dhe objektivat e zhvillimit për periudhën 2014-2020 si dhe jep drejtimet kryesore të politikave, që do të ndiqen për realizimin e këtyre objektivave.

### **3.1 Rrjetat informatike të shpërndara dhe të centralizuara**

Zhvillimi i vullshëm i sistemeve të informacionit, mbas viteve 1985 e këtej, ka vijuar me metodologjinë e re të bazave të së dhënave dhe teknologjive të kompjuterëve personalë (Personal Computer) të parë, si dhe me aplikimin e tyre me *Operating System*, fillimisht <sup>8</sup>MS-DOS e më tej<sup>9</sup> *Windows*, të shoqëruara edhe me paketa programesh të gatshme (*Wordprocessor*, *spreadsheet* dhe aplikimet grafike e para të paketës *MS-Office*) dhe editorë pune fleksibël dhe profesionale.

Përpjekja e parë për një rrjet ndërinstucional në Tiranë (metropolitan), në vendin tonë, u bë në vitin 1985 në kuadrin e projektit të UNDP-së<sup>10</sup>, nën administrimin e INIMA-s. Në këtë, ka aderuar me një terminal edhe <sup>11</sup>MPB. Ky rrjet, funksionoi deri në 1991, kur si pasojë e ndryshimeve të thella që ndodhen në vend ai u braktis nga përdoruesit. Pas kësaj periudhe vihen re edhe përpjekjet në Ministrinë e Brendshme për rikrijimin e rrjetit LAN/WAN<sup>12</sup> dhe bashkimin e tij me intranetin e institucioneve (GOVnet<sup>13</sup>), internetin. Duke zgjidhur nevojat e drejtorive dhe sektorëve të ndryshëm MPB, vlen të përmendet ligji për telekomunikacionet i vitit 1995<sup>14</sup> dhe ligji për zhvillimet dhe investimet e SI/TI i vitit 1998, kur me ndryshimin e ligjit nr. 8288 dt. 18. 2. 98, kufizimet e ligjit të mëparshëm u hoqën.

Në sajë të financimeve nga UNDP dhe Soros, në vitin 1998, - të cilat ofruan lidhje me internetin për shumë institucione akademike e shkencore, për dikastere qendrore dhe organizata joqeveritare, në kuadrin e Memorandumit të Bashkëpunimit “@net” midis INIMA-s, Qendrës së Hapur të Internetit (Oic - Fondacioni Soros), dhe Universitetit Politeknik të Tiranës, - rrjeti shtrihet në Tiranë dhe në dikasteret shtetërore, pjesë e të cilave ishte edhe MPB-ja. Në këtë kuptim, roli i informatikës dhe i teknologjive të informacionit, të aplikuara në kuadrin e rrjetave telematike në MPB<sup>15</sup> ishte prioritar. Ky prioritet shprehet në mbështetjen nga ana e qeverisë shqiptare të projekteve të

Çali, D.

« Teknologjia  
e informacionit  
dhe Policia  
e Shtetit »

Policimi  
dhe  
Siguria

nr. 7, 2017

76

<sup>7</sup> SEE-2020 ( South East Europe-2020).

<sup>8</sup> MS-DOS: Sistemi Operativ Microsoft Dos Operating System.

<sup>9</sup> Windows: Microsoft prezantoi një sistem operativ të quajtur Windows më 20 nëntor 1985

<sup>10</sup> UNDP: Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim.

<sup>11</sup> MPB: Ministria e Punëve të Brendshme.

<sup>12</sup> LAN/WAN : Një rrjet i gjerë zonë (WAN). Një rrjet lokal (LAN).

<sup>13</sup> Gov.net : Rrjeti i Qeverisë që siguron mjete për përcjelljen e legjislacionit në internet.

<sup>14</sup> Ligji nr. 8083 dt. 23/11/95 - Heqjen e kufizimit për shërbimet komerciale të transmetimit së të dhënave dhe bazave të së dhënave, që zhvillohen mbi infrastrukturën klasike të telekomunikacionit.

<sup>15</sup> MPB: Ministrinë e Punëve të Brendshme.

teknologjisë informacionit.

### **3.2 Krijimi i bazës së të dhënave në Shqipëri**

Krijimi i bazave së të dhënave fillimisht ka pasur karakter “individual” për organizatën e interesuar. Është e natyrshme që në këtë kuadër të bashkëpunohet me institucione të specializuara për të bërë punën teknike. Gjithashtu nuk duhet nënvleftësuar rëndësia e integritetit të bazës në rrjetat telematike, për ta bërë informacionin të disponueshëm, sipas kriterëve të caktuara për shoqërinë në tërësi. Në shumë sektorë bazat e të dhënave kanë rëndësi kombëtare, si për funksionimin e veprimtarive publike edhe për mbështetjen e procesit të zhvillimit të shoqërisë me informacione të sakta dhe në kohën e duhur. Por krijimi i tyre kërkon investime, kohë dhe punë njerëzore të konsiderueshme. Trajtimi i bazave së të dhënave në kuadrin e një planifikimi strategjik do ta lejonte vlerësimin e drejtë të kërkesave dhe mundësive, duke përqendruar vëmendjen në objektiva me interes dhe plotësisht të realizueshme.

### **3.3 Strategjia ndërsektoriale për shoqërinë e informacionit**

“Strategjia ndërsektoriale për shoqërinë e informacionit”, (SNSHI) 2008-2013, e miratuar me <sup>16</sup>VKM nr. 59, dt. 21. 1. 2009, përbën dokumentin strategjik që përcaktonte drejtimet kryesore dhe objektivat e zhvillimit, në fushën e shoqërisë së informacionit gjatë 2008-2013. Ky dokument pasonte dokumentin e parë të strategjisë për SI/TI të miratuar në vitin 2003 dhe vinte si plotësim i objektivave kryesore për SI/TI, të përcaktuar në dokumentin e SKZHI-së<sup>17</sup>, 2007-2013.

Policia e Shtetit, mbetet një nga përfituesit kryesore të programeve të zhvillimit dhe ndihmës së huaj nëpërmjet asistencës së ofruar ICITAP<sup>18</sup> e SHBA, BE, Interforca e qeverisë italiane si dhe një numër organizatash ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri. Qëllimi kryesor i të gjithë donacioneve dhe projekteve të realizuara, ka qenë rritja e kapaciteteve të PSH, në funksion të përmirësimit të performancës së saj, si dhe arritjes së sukseseve në fushën e rendit dhe sigurisë publike, PSH është mbështetur në vijueshmëri nga partnerët ndërkombëtarë për projekte.

Mbështetja e përfutur nga financimet e huaja dhe fushat e SI/TI orientohen nga kërkesat e policisë si dhe në bazë të prioritetëve dhe objektivave kryesore për realizimin e detyrimeve të vendosura në dokumentet strategjike të PSH. Nga fondet e BE, PSH është përfituese e një numri projektsh, të cilat janë në fazë shfrytëzimi. Këto projekte, zbatohen dhe financohen nga programi IPA (Instrumenti i Ndihmës së Paraaderimit).

### **3.4 Komunikimet e elektronike dhe teknologjia e informacionit dhe komunikimit**

Gjatë viteve të fundit Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm lidhur me përafrimin e legjislacionit në fushën e komunikimeve elektronike me rregullat e Bashkimit Evropian. Kuadri rregullator i BE-së në lidhje me shërbimin universal është përfshirë në DSHU<sup>19</sup>, e cila fillimisht doli në vitin 2002 dhe u rinovua në vitin 2009. Kapitulli V i Ligjit nr. 9918 (i ndryshuar) përfshin dispozita të shërbimit universal dhe është hartuar

<sup>16</sup>VKM Nr. 59, dt. 21.1.2009: Miratimin e strategjisë ndërsektoriale të shoqërisë së informacionit

<sup>17</sup>SKZHI-së: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

<sup>18</sup>ICITAP – Programi Ndërkombëtar i Ndihmës për Trajnimin Hetimor Penal.

<sup>19</sup>DSHU – Departamenti Shërbimit Universal.

në përputhje të plotë me dispozitat kryesore të DSHU (versionin original të 2002 dhe ndryshimet e 2009).<sup>20</sup>

Ligji nr. 9918, datë 19. 5. 2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 102/2012, është në përputhje me *acquis communautaire* më të fundit të BE-së. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, në nenin 104 të saj: “Rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik”, përcakton se qeveria shqiptare në fushën e shoqërisë së informacionit, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga neni 70 mbi përparimin e legjislacionit si dhe neni 103 “*Shoqëria e Informacionit*”<sup>21</sup> të MSA-së, vëmendje të veçantë i ka kushtuar plotësimin të kuadrit ligjor dhe atij institucional në përputhje me standardet evropiane.

## 4. Lindja dhe zhvillimi i shërbimit të teknologjisë së informacionit në MPB (1988-2003)

### 4.1 Një vështrim i përgjithshëm

MPB, kjo pjesë e strukturës së re të Shtetit Shqiptar, si e tillë, ka luajtur një rol të rëndësishëm si një ndër institucionet më kryesore, për të ndërtuar një jetë moderne, demokratike dhe të sigurt të këtij vendi. Kjo është dhe arsyeja, për të cilën ka lindur nevoja e zhvillimit të një sistemi informacioni dhe teknologjie informacioni (SI/TI), në përputhje me kërkesat e kohës, për të mbështetur sa më mirë objektivat afatgjata të këtij institucioni, gjë që do të ndihmonte edhe në integrimin e Shqipërisë në Komunitetin Europian. Një nga objektivat e MPB dhe e Policisë së Shtetit, ka qenë dhe mbetet menaxhimi e monitorimi i dokumentacioneve të brendshme dhe të atyre që vijnë nga jashtë Policisë së Shtetit, rritja e performancës dhe eliminimi në maksimum i veprimeve burokratike, standardizimi i procedurave të punës dhe i dokumentacionit në radhët e saj, rrjedhojë e saj është implementimi i menaxhimit së të gjithë dokumentacionit, duke përfshirë afërsisht mbi 2 000 000 dokumente teknike, administrative, operative etj., në një vit.

Zhvillimi i aplikimeve të informatikës dhe teknologjive të informacionit është një çështje që i takon të gjithë strukturave të Policisë së Shtetit, kjo për arsyen e thjeshtë se këto aplikime prekin praktikisht të tërë veprimtarinë e shoqërisë, si skemën e organizatës funksionale, detyrat dhe procedurat e punës etj. Për të realizuar një objektivi të tillë madhor, duhet kontributi i institucionit në tërësinë e vet, por elemente të veçanta të tij kanë peshë specifike të dallueshme.

Me sisteme informacioni kuptojmë strukturat dhe skemat e grumbullimit, ruajtjes, përpunimit dhe qarkullimit të informacionit; ndërsa me teknologji të informacionit kuptojmë mjetet fizike (*hard-in* dhe *soft-in*) që përdoret për materializimin e sistemeve të informacionit.

### 4.2 Historiku i shkurtër i zhvillimit të sistemit informatik (SI/TI) në Policinë e Shtetit

Në vitet 1988-1992, filluan aplikimet e para me kompjuter personal me sistem

<sup>20</sup> Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 (I ndryshuar) për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave.

<sup>21</sup> Bashkëpunimi përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit për shoqërinë e informacionit. Ai mbështet kryesisht orientimin gradual të politikave dhe legjislacionit të Shqipërisë për këtë sektor me ato të Komunitetit Europian.



operativ (OS) shfrytëzimi MS-DOS (ver. 1.1 , 2.1, 6.21) dhe njëherësh, brenda një periudhe të shkurtër, edhe me sistem operativ Windows v. 3.1, 3.11 etj.). Për këtë qëllim u vendosën në disa sektorë të ministrisë (sektori kartotekës kriminale, viza-pasaporta, financë, kufiri, listëpagesa etj.) disa PC të instaluar, të cilët plotësonin kërkesat e individëve dhe sektorëve përkatës për grumbullimin e informacionit dhe përpunimin e tij, me anën e programeve të hartuara në gjuhën e programimit “Cobol - 85”, për MS-DOS softuerë, më tej me zhvillimin e aplikacioneve në formë<sup>22</sup> *Revelation database* dhe BASIC+ *scripting language* për MS-DOS v. 1.1, v. 3.1, v. 6.21 dhe SO-Windows v. 3.11, aplikacione tabelore sikurse; softuerë për përpunimin tabelor,<sup>23</sup> VP-Planner plus 1985-1989, *works* për MS-DOS v. 3.21, 1989-1992, *WordPerfect* për MS-DOS për OS-Windows 3.1, *Windows95*, *WindowsNT 3.15* , Os *Novell* në vitin 1991-1992 etj.

Zhvillimi i mëtejshëm në aspektin konceptual të sistemeve të informacionit (SI/TI), si dhe përdorimi i tij në proceset e regjistrimit-konsultimit (pas vitit 1992), sollën rritjen e kërkesave, fillimisht për PC me kapacitet më të madh, në sektorë të ndryshëm të ministrisë dhe më vonë për rrjetat lokale. Kështu, në vitin 1993-2002, informatika në këtë institucion u zhvillua me shpejtësi, duke zbatuar një numër të konsiderueshëm rrjetash lokale të SI/TI dhe PC me kapacitete më të mëdha, ku gjeti përdorim të gjerë paketa MS- *Office Profesional*,<sup>24</sup> *Acess database*, aplikacionet në formë *Data Ol-Revelation &BASIC+ scripting language*, MS-SQL Server 2000, përpunimet tabelore në VP-Planner, Lotus123, *Excell* me OS *windows v. 3.11*, *windows95,98*, 2000, *profesional*, *xp* etj. dhe *windows Server NT v. 3.11*, v. 4.0 , *windows2000* dhe 2003 Server etj.

Si shembull vlen të përmendim disa sisteme, sikurse:

- Ndër sistemet e para të aplikuar në Policinë e Shtetit, me shtrirje në të gjithë vendin, për nga tipologjia dhe gjeoshpërndarja (bazë qyteti e komisariati policie) si dhe sasia e informacionit që do të hidhej, ruhej dhe përpunohej, ishte sistemi i regjistrimit, lëshimit dhe personalizimit të pasaportave për jashtë shtetit në vitin 1994. Sistemi i lëshimit të pasaportave për jashtë shtetit (që përbëhet nga 1 Server me OS Windows Server NT, v. 3.15<sup>25</sup> dhe 5 kompjuterë në qendër dhe 45 PC - nga një PC për çdo komisariat policie, me program në *Form Btree software database* në OS-MS-DOS , v. 3.1 , v. 6.21). Më vonë ky sistem u zhvillua në *Form SQL – Server 2000*<sup>26</sup>, me 12 rrjeta lokale në drejtoritë e policive vendore në qarqe me një qendër grumbullimi dhe përpunimi informacioni, me arkitekturë “Cluster Server”<sup>27</sup> me OS- *Windows 2003 Server* (komunikimi bëhej me linja 2 Mbs të Alb Telekom Albania).

- Si rezultat i shtimit të numrit të lejeve të qarkullimit e automjeteve në Shqipëri, shtimit të lejeve të qarkullimit, filloi puna për sistemin e regjistrimit, ruajtjes, konsultimit dhe përpunimit të arkivit së lejeve të qarkullimit (të automjeteve) dhe më vonë të lejeve të drejtimit (patentave) në Komisariatin e Policisë Rrugore Tiranë, në vitin 1995. Sistemi i komisarariatit të policisë rrugore përbëhej nga 1 server me OS *Windows Server NT v. 3.15* dhe më vonë, NT v. 4.0; 10 kompjuterë në qendër për regjistrimin, konsultimin,

<sup>22</sup> Revelation database dhe BASIC - Ishte gjuha e parë e programimit të OpenInsight dhe është një zgjerim i BASIC ++.

<sup>23</sup>VP- Planner Plus - gjuhë dhe përpilues i të dhënave për kompjuterin personal.

<sup>24</sup>Microsoft Access - është një sistem i menaxhimit të bazës së të dhënave nga Microsoft.

<sup>25</sup>OS Windows Windows NT është një familje e sistemeve operative të prodhuara nga Microsoft, versioni i parë i të cilit është lëshuar në korrik 1993.

<sup>26</sup>Microsoft SQL Server është një sistem i menaxhimit të bazës së të dhënave relacionale i zhvilluar nga Microsoft.

<sup>27</sup>“Cluster Server” Arkitekture IT dhe konfigurime ku përfshihen dy a më shumë serverë dhe punojnë, shërbejnë njëkohësisht garantojnë vazhdueshmëri shërbimi të pandërprerë.



printimin dhe përpunimin e informacionit dhe 2 kompjuterë në sallën operative të Policisë Rrugore, për menaxhimin nëpërmjet sistemit me radio, të informacionit me trafikun rrugor, me program në *Form Revelation software database* dhe *BASIC+scripting language* për SO- Windows 98 SE). Sot, këto aplikime kanë evoluar në Web Aplikation për Oracle database<sup>28</sup>, mobile aplikacion për telefoninë digjitale sikurse android, iphone, apple etj.

- Si rezultat i hapjes së Shqipërisë në të gjithë vendin me emigrimin e qindra mijëra qytetarëve në vendet e BE, Policia e Shtetit aderoi edhe në organizatat ndërkombëtare të luftës ndaj krimit, sikurse *Interpol*<sup>29</sup>; u bë konfigurimi i disa sistemeve me aktivitetet sektorial (lokal) sikurse “Interpol arkives” apo shërbimet e luftës kundër trafikëve të paligjshme, drogës, përpunimit të arkivës kriminale, personave në kërkim, statistikave, komunikatës operative ditore, menaxhimi në kartotekën e personelit, qarkullimit të hyrje-daljeve në vend, kalimet kufitare, financës, listë-pagesa etj. Nga viti 1989 deri në vitin 2002, kjo erdhi si rezultat i shtimit të informacionit dhe i nevojave për konsultim dhe përpunim i regjistrimit, ruajtjes, konsultimit dhe përpunimit të arkivës të këtyre sektorëve, fillimisht me 2- 3 kompjuterë, pastaj me një rrjet lokal (LAN) me 5 kompjuterë dhe më tej me një server me 7-15 kompjuterë etj., duke bërë të mundur menaxhimin, përpunimin, printimin e raporteve të informacionit në kohë të shpejtë me program me aplikacion *Form OI-Revelation software*, *BASIC+ scripting language*, *Form Access*, *Form SQL – Server 2000*, *Form Oracle Databases*, të mbështetur nga OS MS-Dos, windows v. 3.11, v. 95, v. 98, v. 2000, v. XP dhe windows server NT v. 3.11, v 4.0, 2000 & 2003 server etj.

Zbatimi i këtij Sistemi ishte ti paraprinte ngritjes së një sistemi të integruar informacioni për administrimin e të gjithë informacionit dhe dokumentacionit teknik, juridik, administrativ kudo ku prodhohet, shpërndahet, miratohet, arkivohet dhe administrohet në mënyrë dixhitale dhe elektronike, përpunimi i informacionit në kohë reale, monitorimi i hapave të miratimit dhe zhvillimit, përmirësimi i performancës së shërbimeve të qarkullimit, kërkimit të dokumentacionit që i afrohen strukturave të Policisë së Shtetit në çdo kohë dhe në çdo vend.

**Tabela 1, zhvillimi i kapaciteteve të SI/TI në MPB në vitet 1989 – 2001.**

TABELA E ZHVILLIMIT TE KAPACITETEVE SI/TI NE MINISTRINE E BRENDESHME 1989 - 2001															
Nr.	Pershkrimi i SI/TI ne Perdorim	SHPERNDARJA SIPAS VITEVE													
		1988	1989	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001
1	Serveret Lokale / Qendrore & OS System & Procesore te Instaluar						2	2	4	4	6	8	10	12	
2	Personal Computer (PC)	1	7	10	15	25	40	100	110	150	150	200	295	360	400
3	Aplikime Informatike ne perdorim	1	3	4	4	4	5	6	7	7	7	9	10	10	10
4	Sasia e Rekordeve qe ruhen & perpunohen	5000	10000	50000	70000	125000	250000	600000	1000000	1500000	2000000	3000000	5000000	5300000	6200000
5	Pendones & Operatore gjithesaj	2	12	15	20	25	30	120	150	180	180	250	350	400	450



Çali, D.  
« Teknologjia  
e informacionit  
dhe Policia  
e Shtetit »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

<sup>28</sup> Oracle Database është një sistem i menaxhimit të bazës së të dhënave relacionale të prodhuar dhe të tregtuar nga Oracle Corporation.

<sup>29</sup> Interpol – Organizata ndërkombëtare e policisë.

### 4.3 Zhvillimi i bazave së të dhënave në Policinë e Shtetit dhe shfrytëzimi i tyre


Bazat e të dhënave përbëjnë një nga kategoritë kryesore të aplikimeve informatiko-telematike. Nga ana tjetër ato përfaqësojnë tërësinë e informacioneve të strukturuar dhe të klasifikuara, trashëgimi e njohurive të grumbulluara gjatë veprimtarisë së PSH. Roli i tyre nuk është thjesht, arkivues për hir të arkivimit. Sot informacioni është bërë element i pashmangshëm dhe vendimtar në procesin e analizës dhe marrjes së vendimeve në të gjitha fushat e sektorët e Policisë së Shtetit. Një tipar karakteristik i saj, është pikërisht varësia e saj nga informacioni, tipar që sa vjen e theksohet. Sot informacioni është një mjet i rëndësishëm për realizimin e objektivave në Policinë e Shtetit.

Rritja e konsiderueshme e të dhënave dhe ndërveprimi midis sektorëve dhe organizatave, e bën të pashmangshëm krijimin e bazave të mirëfillta së të dhënave, duke përdorur: teknologjinë informatike dhe duke e integruar në rrjeta telematike, strukturim dhe standardizim së të dhënave, zhvillim të programeve aplikative për përpunimin e tyre, futje intensive për një kohë të shkurtër së të dhënave masive “mbushja” e bazës, administrimi i bazës së të dhënave, për garantimin e shfrytëzimit normal të saj nga përdoruesit në Policinë e Shtetit dhe sigurimi i konfidencialitetit së të dhënave.

### 4.4 Rrjetat informatike të shpërndara, rrjeti informatik dhe skema funksionale

Duke pasur parasysh mundësitë dhe hapat e shpjeguara më lartë, rrjetat informatike të shpërndara dhe aplikimet/shërbimet në to, duke mbështetur organigramën strukturore dhe funksionale sektoriale të dikasterit, përbënë çelësin për shkuarjen drejt një qendre të dhënash dhe intraneti në MPB dhe në Policinë e Shtetit në një sistem qendror, ku vlen të përmendet roli dhe ndihma shumë e madhe intelektuale, financiare, organizative e partnerëve ndërkombëtarë dhe në veçanti e misionit ICITAP, PAMECA<sup>30</sup> etj.

Figura 2, Tipologjia e rrjetit informatik dhe skema funksionale deri në vitin 2003



<sup>30</sup> Interpol - Organizata ndërkombëtare e policisë.

<sup>31</sup> Pameca - është Misioni i Asistencës Policore e Komunitetit Evropian në Shqipëri.

Sistemi SI/TI kërkonte investime për përmirësimin dhe plotësimin cilësor të posteve të punës me kompjuterë dhe aksesorë të tyre, në qendër e në bazë kërkonin investime në *strage* (memorien), serverë, skanerë, softuerë përpunimi etj., për të përballuar ngarkesën në rritje, në prodhimin, qarkullimin dhe administrimin e dokumentacionit, me përdoruesit dhe shtimin e infrastrukturës për rrjetin e *networkut* dhe shtimin e posteve të punës në varësi të kërkesave etj.

#### **4.5 Drejtimit përparësore të kërkimit dhe zhvillimit teknologjik, në fushën e sistemeve dhe teknologjive të informacionit në Policinë e Shtetit**

Drejtimit përparësore të kërkimit dhe zhvillimit teknologjik në fushën e sistemeve dhe teknologjive të informacionit në Policinë e Shtetit, do të ishin si më poshtë:

a. Edukimi i masës së njerëzve me njohuri mbi sistemet dhe teknologjitë e informacionit të përdorshme në jetën dhe punën e përditshme.

b. Zhvillimi i rrjetave të shpërndara dhe konsolidimi i rrjetave metropolitane të shtrira nëpër komisariate policie dhe të ndërlidhura në shkallë kombëtare, duke krijuar mundësi komunikimi midis institucioneve të ndryshme, për të rritur intensitetin dhe cilësinë e shkëmbimit të informacionit, si një nga elementet themelore në veprimtarinë e Policisë së Shtetit.

c. Zhvillimi i aplikimeve dhe bazave së të dhënave, si e vetmja mënyre për realizimin e grumbullimit, përpunimit, shpërndarjes dhe shkëmbimit të informacionit si pasojë dhe shfrytëzimin real dhe efektiv të infrastrukturave, rrjetave informatike në Policinë e Shtetit.

d. Konkretizimi i projekteve dhe financimi i tyre për zhvillimin e proceseve edukative masive, shtrirjen e rrjetave informatike ndërinstucionale, krijimin e aplikimeve e shërbimeve telematike, krijimin e bazave së të dhënave të integruara në rrjeta të shpërndara nëpërmjet shfrytëzimit me efektivitet për grumbullimin, përpunimin, shpërndarjen dhe qarkullimin e informacionit.

Shfrytëzimi i teknologjive dhe infrastrukturave të informacionit dhe sistemeve të informacionit (aplikimeve informatike dhe bazave së të dhënave) duke e konsideruar teknologjinë dhe infrastrukturën thjesht si një mjet për realizimin e sistemeve të informacionit në shërbim të Policisë së Shtetit.

f. Fati i sistemeve të informacionit në Policinë e Shtetit është i lidhur ngushtë me rolin e strukturave të grumbullimit, përpunimit dhe administrimit të njohurive dhe përvojës njerëzore, teknike të domosdoshme, për një zhvillim të integruar në shkallë kombëtare.

## **5. Lindja dhe zhvillimi i shërbimit të teknologjisë së informacionit në Policinë e Shtetit**

### **5.1 TIMS (Total Information Management System)**

Nisur nga fakti që informacioni që përbën bazën e të dhënave në sektorët e lartpërmendur e ka burimin në komisariate, në drejtoritë e policive vendore e në qarqe, kuptohet se, këtu ka nisur puna për grumbullimin, përpunimin dhe transferimin e tij. Ky informacion sot menaxhohet në një sistem të vetëm të quajtur<sup>31</sup> TIMS (Total

<sup>31</sup>TIMS - Total Management Information System.

Management Information).

Nga pikëpamja operative, TIMS, na siguron me shpejtësi të dhëna të besueshme, të qëndrueshme dhe të thjeshta në përdorim, për të arritur objektivat e policisë, si: parandalimin e krimit, rritjen e zbulueshmërisë së krimeve, ruajtjes së sigurisë publike etj. Nga pikëpamja administrative TIMS eliminon përsëritjen e punëve, duke mundësuar shfrytëzimin e informacionit të përbashkët nga departamente të ndryshme të policisë, duke i ardhur në ndihmë drejtuesve të saj, në marrjen e vendimeve të shpejta dhe efikase.

Vlera e madhe që ka informacioni, grumbullimi dhe administrimi i tij, njihet nga kushdo. Kjo vlerë rritet po të fokusohet mbi një subjekt siç është Policia e Shtetit. Në këtë aspekt, ne duhet të vlerësojmë rolin e madh që luan TIMS, e parë kjo në dy aspekte. Së pari: aspekti operativ dhe, së dyti: në aspektin administrativ. Duke pasur parasysh punën e bërë dhe analizën e sektorëve në veçanti, janë identifikuar një sërë kategorish informacioni brenda strukturës së të dhënave në TIMS, të cilat shërbejnë si bazë në analizën e informacioneve. TIMS, përmban aplikacione informatike si më poshtë:

- *Hyrje-daljet*. Shërben për menaxhimin e personave që hynë dhe dalin nëpërmjet kufirit të Republikës së Shqipërisë; ka filluar zbatimin në vitin 2003.

- *Sistemi i kërkimit*. Mundëson kërkimin e personave, dokumenteve ose mjeteve motorike, viti 2004.

- *Raporti i ngjarjes*. Shërben për të menaxhuar në sistem raportin e detajuar të vend ngjarjes, viti 2006.

- *Regjistri i të huajve*. Menaxhimi i shtetasve të huaj, rezident në Republikën e Shqipërisë, viti 2008.

- *E-VISA*. Shërben për menaxhimin e vizave shqiptare shtetasve të huaj, viti 2010.

- *NCR*. Regjistri i gjendjes civile, viti 2011.

- *RIMS*. Shërben për menaxhimin e burimeve njerëzore, viti 2011.

- *KOMOP*. Menaxhimi i komunikata operative ditore dhe statistikat, Viti 2011.

- *Interpol ASF -2*. Shërben për shfrytëzimin e bazës së të dhënave të Interpolit, viti 2011.

- *E-GJOBA*. Është sistemi elektronik i menaxhimit të procesverbalit të konstatimit të shkeljes, viti 2012

- *ADAM*. Shërben për regjistrimin në sistem të dhënave për personat shoqëruar/ ndaluar/arrestuar, viti 2012

- *MEMEX*. Shërben për regjistrimin e analizës së informacionit kriminal (LAN), viti 2012.

- *FER*. Moduli i lejeve të qëndrimit, viti 2013.

8. Menaxhimi policor i çështjes. Shërben për menaxhimin dhe analizën e raportit të ngjarjes, viti 2016.

- *SIMA*. Sistemi i menaxhimit të armatimit, viti 2015.

- *ZSHQ*. Zyrat e shërbimit ndaj qytetarëve, viti 2015.

- *Komisariati digjital*. Denoncimi *on-line* i Komisarariatit Digjital, viti 2015.

- E-mail, numëror, raporte dhe statistika, menaxhimi i karburantit, SMSK, biblioteka, AMZA.

- *Payroll*. Janë aplikime informatike në shërbim të strukturave të veçanta të Policisë së Shtetit, viti 2015

**Çali, D.**  
« Teknologjia  
e informacionit  
dhe Policia  
e Shtetit »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

**DTI** e-albania  
 Drejtoria Teknologjisë & Informacionit  
 Për Qytetarët | Për Bizneset | Për Qeverinë | Për Vizitorët

SEARCH keywords... Home About Us Services Test Zone Contacts

**APPLICATIONS**

- TIMS PORTAL
- TIMS Oracle
- Dokumenta Udhëtimi
- Reports & Statistics
- ADAM V2
- Policies & Procedure
- INTERPOL
- Interpol ARKIVA
- Europol
- RMS
- ZSHQ
- Telephone Directory
- E-MAIL ASP
- Komunikata Ditore
- SIVET
- SIMA
- PAYROLL
- Komisariati Dixhital
- Kastrati
- Libraria Elektronike
- SMSK
- Biblioteka
- Amza
- GIS-Narkotik

**Information!**

- Të gjithë përdoruesit të cilët kanë probleme me logimin në shërbimet tona janë të lutur të kontaktojnë në:
  - HelpDesk center by: email: [helpdesk@asp.gov.al](mailto:helpdesk@asp.gov.al)
  - Mobile: +355 69 41 11 711
  - Tel: +355 42 279 711
  - VoIP: 711

**SHERBIME**

- Regulioja TIMS
- Dokumenta PRADO
- Paketa SCHENGEN
- ZRPP
- Pastrimi i parave
- Dogana
- Aluзни



**MANUALE**

- TIMS Java Manual
- Manual E-Visa
- Manual i Sistemit të Kërkimit
- Event Report Manual
- Komunikata Ditore Manual
- Manuali i perdorimit të DSR
- Manual SIMA
- Manuali i Detektoreve të Kufirit
- Manual Zyrtar e Shërbimit Per Qytetarët
- Manual FER
- Menaxhimi i Policor i Gënjtyes

## 5.2 Zhvillime të SI/TI në Policinë e Shtetit, në vitet 2003-2017

Tabela 2, Zhvillimi i kapaciteteve të SI/TI në MPB në vitet 2002 - 2010.

TABELA E ZHVILLIMIT TE KAPACITETEVE SI/TI NE MINISTRINE E BRENDESHME 2002 - 2010										
Nr.	Pershkrimi i SI/TI ne Perdorim	SHPERNDARJA SIPAS VITEVE								
		2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
1	Serverat Lokale / Qendrore & OS System & Procesore te Instaluar	24	26	28	28	28	32	34	40	45
2	Personal Computer (PC)	450	500	600	750	950	1200	1800	2150	2350
3	Aplikime Informatike ne perdorim	12	12	14	14	16	16	18	18	18
4	Sasia e Rekordeve qe ruhen & perpunohen	6400000	6800000	7000000	8500000	10500000	11800000	12900000	13250000	15000000
5	Perdorues & Operatore gjithesj	500	600	800	1000	1500	1800	3100	4450	6850



Çali, D.  
 «Tecnologjia e informacionit dhe Policia e Shtetit»

Policimi dhe Siguria nr.7, 2017

TABELA E ZHVILLIMIT TE KAPACITETEVE SI/ TI NE MINISTRINE E BRENDESHME 2010 - 2016							
Nr.	Pershkrimi I SI/ TI ne Perdorim	SHPERNDARJA SIPAS VITEVE					
		2011	2012	2013	2014	2015	2016
1	Serverat Lokale / Qendrore & OS System & Procesore te Instaluar	78	84	84	88	89	60
2	Personal Computer (PC)	2350	2500	2800	3000	4100	4700
3	Aplikime Informatike ne perdorim	18	20	22	24	26	28
4	Sasia e Rekordve qe ruhen & perpunohen	17700000	18700000	18600000	20600000	23300000	25700000
5	Perdorues & Operatore gjithsej	6850	7000	9000	9500	10100	10632




Tabela 3, Zhvillimi i kapaciteteve të SI/ TI në MPB në vitet 2011 – 2016.

Nimri i serverëve fizikë, dy vitet e fundit është ulur ndjeshëm, sepse është futur teknologjia e virtualizimit duke eliminuar serverët fizikë, të cilët ishin tashmë të amortizuar dhe me kapacitete procesimi të ulëta për aplikacionet dhe databazat e reja. Serverët duke u mbështetur nga sisteme operimi sikurse: *Microsoft Windows Server 2003, 2008 Standart dhe Enterprise, CentOS, Linux* kanë rritur ndjeshëm menaxhimin e databazave bashkëkohore sikurse *Oracle DB server* etj.

### 5.3 Strategjia e zhvillimit të teknologjisë së informacionit në Policinë e Shtetit

Gjithçka është menduar të trajtohet si një projekt strategjik afatgjatë zhvillimi, për implementimin e një infrastrukture, e cila do të mbështesë projektin TIMS në të gjithë aspektet dhe veçoritë që lidhen me shfrytëzimin e informacionit në Policinë e Shtetit. Zhvillimet që përfshinin një hark kohor prej disa vjetësh, kërkuan financime me qëllim që të instalohej dhe plotësohej infrastruktura dhe teknologjitë për hedhjen dhe përpunimin e informacionit, si dhe implementimin e shërbimeve të ndryshme, krahas përmirësimit të kushteve të punës, komunikimit me telefoni dhe radio etj. Hapat zhvilluese do ishin si më poshtë:

1. Krijimi i sistemit të informacionit eficient në të gjitha fushat dhe sektorët.
2. Instalimi i infrastrukturës dhe organizimi i punës për të thithur informacionin e bazës.
3. Krijimi i infrastrukturës së komunikimit WAN/LAN midis strukturave të centralizuara të Policisë së Shtetit.
4. Zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i aplikimeve në sistemet e policisë, si TIMS, RMIS<sup>32</sup>, AFIS<sup>33</sup>, Memex<sup>34</sup> dhe në sistemin e telefonisë digjitale VoIP<sup>35</sup> etj.
5. Trajnimi i vazhdueshëm i stafit të policisë, të cilët do të përdorin këto sisteme.

<sup>33</sup> AFIS - Sistemi i identifikimit automatik të gjurmëve të gishtave.

<sup>34</sup> Memex -software analize dhe përpunimi informacioni.

<sup>35</sup> VoIP - teknologji për shpërndarjen e komunikimeve zanore dhe sesioneve multimediale mbi rrjetet e Internet Protocol (IP), siç është interneti.

6. Mirëmbajtja dhe përmirësimi i rrjetit të komunikimit *DataCom*<sup>36</sup>.
7. Mbështetja me burime dytësore energjie: gjeneratorë.
8. Mbështetja e vazhdueshme e përdoruesve nga Qendra e Shërbimeve HELPDESK<sup>37</sup>.

**Nje vështrim kronologjik i sistemeve të informacionit të zhvilluara në Policinë e Shtetit në Vitet 1988 - 2017**



Çali, D.  
« Teknologjia  
e informacionit  
dhe Policia  
e Shtetit »

Polici  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

<sup>36</sup> DataCom - Sistemi i Transmetimit të të Dhënave të Policisë së Shtetit.

<sup>37</sup> HELPDESK është një burim që synon t'i ofrojë konsumatorit ose përdoruesit përfundimtar informacion dhe mbështetje në lidhje me produktet dhe shërbimet e DTI - Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, DPP - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.



#### **5.4 Objektiva të përgjithshme dhe synimet e teknologjisë së informacionit në Policinë e Shtetit**

Objektivat kryesore të SI/TI, konsistojnë në zhvillimin sa më të shpejtë dhe në aplikimin sa më intensiv, në fusha nga më të ndryshmet të sistemeve dhe teknologjive të informacionit, duke filluar me edukimin dhe duke vazhduar me krijimin e rrjetave informatike dhe zhvillimin e aplikimeve mbi to, për përmirësimin e vazhdueshëm të punës së Policisë së Shtetit duke zbatuar teknologji dhe sisteme të informacionit. Këto sisteme synojnë përmirësimin e menaxhimit të informacionit, rritjen e shpejtësisë dhe sigurisë së tij.

Për të realizuar këto objektiva është synuar në realizimin e studimeve analizuese-projektuese, si dhe me konkretizimin e projekteve dhe financimin e tyre për zhvillimin e proceseve edukative masive, shtrirjen e rrjetit informatik, krijimin e aplikimeve e shërbimeve telematike, krijimin e bazave së të dhënave të integruara.

Në këtë kontekst rezultatet e teknologjisë së informacionit synojnë në disa drejtime:

a. Krijimi i kushteve për një përmirësim cilësor të punës të punonjësve të Policisë së Shtetit në realizimin e detyrave dhe shërbimeve ndaj qytetarit dhe të zhvillimit të vendit.

b. Lehtësim i shkëmbimeve të dokumentacionit dhe praktikave zyrtare dhe nxitjen e arritjes së rezultatit, si rezultat i përmirësimit të rrugëve të shkëmbimit të informacioneve si brenda vendit dhe me vendet e tjera.

c. Rinovimi i teknologjive në përputhje me Strategjinë e Policisë së Shtetit dhe me zhvillimet në fushën e IT-së.

d. Përmirësim i marrëdhënieve të punonjësve me shoqërinë si rezultat i një njohjeje më të mirë të realitetit shqiptar, nëpërmjet intensifikimit të qarkullimit të informacioneve të gjithanshme.

e. Krijimi dhe zhvillimi i sistemeve të informacionit pranë strukturave të Policisë së Shtetit.

f. Shfrytëzimi i këtyre sistemeve në mënyrën më të mirë të mundshme, për t'i ardhur në ndihmë mbarëvajtjes së punës së punonjësve të Policisë së Shtetit.

g. Realizimi i trajnimeve të punonjësve që përdorin pajisjet dhe sistemet e ofruara nga DTI<sup>38</sup>.

Objekti kryesor i zhvillimit të sistemit TIMS, mbetet që në të ardhmen të krijojë shërbime cilësore të transferimit dhe përpunimit të informacionit, me drejtim nga komisaritet, drejtoritë vendore të policisë si dhe të serverëve qendrore. Implementimi i sistemit TIMS është realizuar në disa faza. Ky sistem do t'i afrohet gradualisht qëllimit final, porë kjo nga pikat e vështirimit të funksionaliteteve dhe shërbimeve me shtrirje gjeografike në të gjithë vendin. Modulariteti dhe aftësia për përdorim të hapur nga të gjithë, është baza e elementeve që përbëjnë sistemin.

#### **5.5 Cilësitë themelore të sistemit TIMS**

Cilësitë themelore të sistemit TIMS, të sjella në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë:

a. Eficienca dhe efektiviteti në përdorimin e bazës së të dhënave.

<sup>38</sup> DTI- Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit.

- b. Përdorim i informacionit për të gjitha sektorët.
- c. Ndërthurje e informacionit për sektorë të ndryshëm.

### 5.6 Akseset e përdoruesit

Përdoruesit fundorë kanë të drejtë të përdorin shërbimet që ofron TIMS, nëpërmjet posteve të punës të sistemit. Shërbimet i janë dedikuar personit dhe jo postit të punës. Kjo do të thotë që aksesit mund të lejohet vetëm pas identifikimit të vetë përdoruesit dhe verifikimit të së drejtës së tij për përdorimin e shërbimit. Aksesimi bëhet i mundur me përdorimin eficient të *password* (fjalëkalim) të *default account* “Sentinel (Dong)” për ekzekutimin e softuerëve, njohje me “Smart Card”<sup>39</sup> apo identifikim “Biometrik”<sup>40</sup> për futjen në sistem. Përdoruesi ka të drejtë që të përdorë një shërbim që ofron sistemi, në varësi të pozicionit funksional që ai ka. Në varësi të këtij pozicioni do të përcaktohen edhe nivelet e autorizuar për të drejtat e përdorimit të shërbimeve, të cilat aktivizohen vetëm pasi të ketë kapërcyer me sukses hyrjen në sistem.

### 5.7 Aksesit në internet

Sistemi TIMS, në përgjithësi nuk lejon hyrje të plotë në internet për të gjithë përdoruesit e tij (duke përjashtuar këtu disa përdorues të veçantë, të cilëve u lejohet lidhja me shërbimin e plotë të internetit). Sistemi FIREWALL<sup>41</sup> dhe përbërësit e tjerë të sistemit janë të aftë të dallojnë aksesin e lejuar në internet dhe shërbimet e tjera të jashtme, sipas kategorisë dhe të drejtave të përdoruesit dhe ta filtrojnë atë ndaj hyrjeve të paautorizuara.

### 5.8 Shërbimet “e-mail”

Sistemi i postës elektronike siguron një zgjidhje të plotë dhe të lehtë, të përdorshme si për dërgim dhe për marrje informacioni midis përdoruesve, duke përfshirë këtu dhe

STATISTIKA E PËRGJITHSHME VEPRAT PENALE TË DENTUARË DHE AUTORE TË NGJARJEVE

NR.	VEPRA PENALE SIPAS TENDENCJAVE	VEPRA PENALE												PERSONA TË DENTUARË									
		EVOGJENTUAR		Zbërthor nga të evident.		Në bashkëpunim.		Org. Krisimale		Gjithësisht		Nën 14 vjeç		14 deri në 18 vjeç		Moshë		LLOJË					
1	2	Gjithësisht	Në shtet	6	9	12	13	Gjithësisht	Fem.	Stesk.	Gjithësisht	Fem.	Stesk.	Femra	Bases men	Shkollës	Prisur	Shkollës	Prisur	Fëmija	Parisur		
<p><b>1. KUNDËR PERSONIT</b></p> <p>1. Kundra personit</p> <p>2. Vjedhje</p> <p>3. Vjedhje me armë</p> <p>4. Vjedhje me armë në transport</p> <p>5. Kundra personit në transport</p> <p>6. Kundra personit në transport</p> <p>7. Kundra personit në transport</p> <p>8. Kundra personit në transport</p> <p>9. Kundra personit në transport</p> <p>10. Kundra personit në transport</p>																							
<p><b>2. KUNDËR PËRSONËS</b></p> <p>1. Vjedhje e pasurisë</p> <p>2. Vjedhje e pasurisë</p> <p>3. Vjedhje e pasurisë</p> <p>4. Vjedhje e pasurisë</p> <p>5. Vjedhje e pasurisë</p> <p>6. Vjedhje e pasurisë</p> <p>7. Vjedhje e pasurisë</p> <p>8. Vjedhje e pasurisë</p> <p>9. Vjedhje e pasurisë</p> <p>10. Vjedhje e pasurisë</p>																							
<p><b>3. VEPRAT TËRRELLIM, TËRRELLIM</b></p> <p>1. Tërrellim</p> <p>2. Tërrellim</p> <p>3. Tërrellim</p> <p>4. Tërrellim</p> <p>5. Tërrellim</p> <p>6. Tërrellim</p> <p>7. Tërrellim</p> <p>8. Tërrellim</p> <p>9. Tërrellim</p> <p>10. Tërrellim</p>																							
<p><b>4. VEPRAT TËRRELLIM, TËRRELLIM</b></p> <p>1. Tërrellim</p> <p>2. Tërrellim</p> <p>3. Tërrellim</p> <p>4. Tërrellim</p> <p>5. Tërrellim</p> <p>6. Tërrellim</p> <p>7. Tërrellim</p> <p>8. Tërrellim</p> <p>9. Tërrellim</p> <p>10. Tërrellim</p>																							
<p><b>5. ENKURIMET FINANCIARE</b></p> <p>1. Enkurimet</p> <p>2. Enkurimet</p> <p>3. Enkurimet</p> <p>4. Enkurimet</p> <p>5. Enkurimet</p> <p>6. Enkurimet</p> <p>7. Enkurimet</p> <p>8. Enkurimet</p> <p>9. Enkurimet</p> <p>10. Enkurimet</p>																							

**STATISTIKA MBI PERSONAT NË KËRKIM**

Nr.	Emri / Adresa / Mbanemri	Nr Dokumente	Tipi	Datëlindja	Gjendja	Kategoria
1	DASHAMIR BEQIR ÇALI	0840204	V	01.08.1958	M	ZAKONSHËM
2	DASHAMIR BEQIR ÇALI	0840204	V	01.08.1958	M	ZAKONSHËM
3	DASHAMIR BEQIR ÇALI	20317910	Z	04.04.1977	M	ZAKONSHËM
4	DASHAMIR BEQIR ÇALI	0840204	V	01.08.1958	M	ZAKONSHËM
5	DASHAMIR BEQIR ÇALI	0840204	V	01.08.1958	M	ZAKONSHËM
6	DASHAMIR BEQIR ÇALI	20317910	Z	04.04.1977	M	ZAKONSHËM
7	DASHAMIR BEQIR ÇALI	21749500	Z	01.08.1958	M	ZAKONSHËM
8	DASHAMIR BEQIR ÇALI	20317910	Z	04.04.1977	M	ZAKONSHËM

Çali, D.  
Teknologjia e informacionit dhe Policia e Shtetit

<sup>39</sup> Smart Card - Një kartë smart, kartë chip ose kartë qark të integruar (ICC)  
<sup>40</sup> Biometric- Autentifikimi biometrik është një proces i sigurisë që mbështetet në karakteristikat unike biologjike të një individi për të verifikuar se ai është.  
<sup>41</sup> Firewall - mbron (një rrjet ose sistem) nga aksesit i paautorizuar.

komunikimin me sistemin e-mail të jashtëm të internetit. Ndërfaqimi i postës elektronike me internetin dhe në tërësi ndërfaqimi me “mjediset” e hapura të internetit janë të kontrolluara dhe implementuara jashtë rrjetit të brendshëm të Policisë së Shtetit, si dhe kriteret e përdorimit të tyre të jenë të përcaktuar saktë.

### **5.9 “Word-proccesor”, “speadsheet” dhe aplikimet grafike**

Përdorimi i trajtuesve të tekstit (*word-processor*) u siguron përdoruesve mundësinë e për të aplikuar standarde të njëjta në përpunimin e dokumenteve. *Spreadsheet* i mundëson përdoruesit të analizojnë të dhëna tabelore, të aplikojnë përpunime financiare dhe statistikore. Aplikimet grafike u japin mundësi përdoruesve të krijojnë e paraqitje grafike të rezultateve të ndryshme si për përdorim lokal dhe shpërndarje nëpërmjet internetit.

### **5.10 Ndërfaqja e intranetit<sup>42</sup> me internetin**

Siguron një akses të plotë, të kontrolluar dhe të mbrojtur me Internetin për të gjithë përdoruesit e sistemit.

### **5.11 Kërkesat për softuerin**

E rëndësishme është që sistemi plotëson kërkesat, të cilat përcaktohen në analizën e strukturës së të dhënave që qarkullojnë në TIMS dhe organizmat që lidhen me të. Analiza e strukturave e të dhënave, bëhet nga secila drejtori me vete, duke plotësuar formularët e përgatitur nga DTI. Për një mbarëvajtje të punës, duhet që këto analiza të bëhen duke ju përmbajtur prioriteteve të përcaktuara në bazë të rolit dhe rëndësisë së sektorëve.

### **5.12 Zhvillimet, dhe shfrytëzimi i aplikacioneve dhe i bazave së të dhënave lokale, me interes dhe karakter kombëtar**

1. Sistemi “Papillon”<sup>43</sup>, “Arsenal”<sup>44</sup>, Sistemi i “Witness Protection”<sup>45</sup>, “Case Management Software” (SMD), AND-së<sup>46</sup>, zhvillime të programit “IPA 2012”, bashkëpunimi në drejtësinë penale, “Mbrojtja e dëshmitarëve në luftën kundër krimeve të rënda dhe terrorizmit” (WINPRO II) etj.

E rëndësishme është se, qeveria e SHBA-së, nëpërmjet misionit ICITAP ka mbështetur dhe vazhdon të investojë që në fillimet e para në Policinë e Shtetit, me asistencë të specializuar, aplikacione informatike, pajisje, kompjuterë, serverë etj., sektorë të Policisë së Shtetit, së fundi edhe me realizimin e projektit “Sistemimi dhe menaxhimi i çështjes”, në të gjithë Republikën e Shqipërisë. Në këtë kuadër, në muajin qershor u dhuruan edhe 1 000 kompjuterë të tjerë dhe 55 printerë.

Gjithashtu programi IPA 2015, gjatë vitit 2014 dhe 2015 dhe strukturat e MPB dhe PSH, punuan për identifikimin dhe programimin e projektpropozimeve, të cilat do të financohen nëpërmjet fondeve të programit IPA II 2015, në kuadër të formës së re të menaxhimit të decentralizuar. Për këtë qëllim u hartua dhe u miratua dokumenti i

**Çali, D.**  
« Teknologjia  
e informacionit  
dhe Policia  
e Shtetit »

<sup>42</sup> Intranet - është një rrjet privat që gjendet brenda një ndërmarrjeje.

<sup>43</sup> Papillon - Sistem i Identifikimit automatik të gjurmëve gjshlave.

<sup>44</sup> Arsenal - Sistemi i gjurmëve të armëve me sfond kriminal.

<sup>45</sup> Witness Protection - Sistemi i Menaxhimit të dëshmitarëve të drejtësisë.

<sup>46</sup> AND - Sistemi i menaxhimit të identifikimit nëpërmjet AND-së.

veprimet për IPA 2015, "IPA Action Document"<sup>47</sup>, i miratuar nga strukturat donatore, i cili përmban financimin e projekteve, për asistencë teknike, për rritjen e kapaciteteve profesionale të institucioneve ligjzbatuese sipas praktikave më të mira të BE (PAMECA V)<sup>48</sup> IPA 2015.

Ky projekt, do të mbështetet nga IPA 2015, në vlerën 6 milion Euro, por përzgjedhja, kontraktimi dhe menaxhimi i këtij projekti ishte i centralizuar; por, afati dhe vlera përfundimtare do të saktësohej pas lidhjes së kontratës. Objektivi i këtij projekti ishte këshillimi dhe asistenca teknike për disa drejtime të Policisë së Shtetit dhe MPB. PAMECA-IV vazhdon të mbështesë Policinë e Shtetit dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme. Projekti pritet të ketë kohëzgjatje 2017-2019 me një impakt edhe në rritjen e kapaciteteve në teknologjinë e informacionit.

## 6. Përfundime

Zbatimi me faza i sistemit TIMS dhe përcaktimi i specifkimeve teknike të pajisjeve dhe shërbimeve, implementimi i sistemit të informacionit në përputhje me kërkesat e përdoruesit -në rastin konkret të Policisë së Shtetit, - të përcaktuara në specifikimet teknike, realizimi i sistemit TIMS, duke mundësuar kalimin në fazat e tjera, hap pas hapi, zbatimi i infrastrukturës dhe shërbimeve, duke përfshirë testimin e tyre dhe miratimin e procedurave të punës, përcaktimi i trajnimit për përdoruesit efektivë të sistemit, specialistëve, administratorëve, operatorëve, përcaktimi i kriterëve teknikë për mirëmbajtjen e sistemit, integrimi i programeve ekzistues me programet e reja që do të implementohen etj. : të gjithë këta komponentë teknologjikë, bashkëkohorë, të instaluar, duhet të jenë të ripërdorshëm në fazat pasardhëse të zhvillimit; sistemi operacional duhet të jetë i tillë, që institucionet bashkëkohorë të jenë të afta të operojnë dhe ta përdorin atë.

### 6.1 Sistem qendror i shërbimeve menaxhuese

Sistemi TIMS, menaxhohet nga një qendër e vetme menaxhimi, përfshi këtu edhe instalimin e aplikacioneve dhe njeje të rinj të rrjetit. Instalimet dhe konfigurimi i aplikimeve kryhet DTI, duke pasur nën kontroll serverët dhe postet e punës; siguron një shërbim transparent nga pikëpamja teknologjike, për përdoruesit e fundit (*end user*)<sup>49</sup>.

Qëllimi i këtij shërbimi është ndjekja e proceseve që duhen kryer për optimizimin e funksionalizimit të serverëve; përshpejtimi i proceseve të punës dhe të sigurojë që transaksionet të jenë të përpunuara në mënyrë të përshtatshme dhe me standarde cilësie; realizimi i objektivave pa humbur kohë dhe shmangia e rreziqeve në maksimum. Shërbimi i centralizuar zbaton masat e sigurisë, për parandalimin e aksesit të padëshiruar, që mund të sjellë dëmtime të këtyre të dhënave në server nëpërmjet transmetimeve të virusëve apo ndërhyrjeve që mund të jenë të qëllimshme.

### 6.2 Monitorimi

Monitorimi realizohet dhe me anë të softuerëve të ndryshëm për të siguruar përgjigje

<sup>47</sup> IPA Action document - Instrumenti i Ndhmës së Paraanëtarësimit.

<sup>48</sup> PAMECA V - Mision i Asistencës së Policisë Europiane në Shqipëri.

<sup>49</sup> End user - Përdoruesi.

në kohë të sistemit *System Center Operations Manager 2007 R2 SCOM*, i cili jep aftësi në tre fusha kryesore:

- *End-to-End Datacenter Management*;
- monitorim më të mirë për *Windows*;
- rritje e efikasitetit dhe kontrollit.

Grumbullimi i të dhënave të mësipërme na jep informacionin e nevojshëm për reduktimin e avarive që mund të ndodhin. Sistemi i monitorimit do të raportojë për të gjitha ndryshimet që mund të shkaktohen si dhe arsyet e këtyre ndryshimeve. Kontrollon gjenerimin në mënyrë automatike, të alarmeve për probleme të ndryshme, në bazë të performancës së konfiguruar dhe identifikon situatën e sigurisë, kështu që operatorët mund të fitojnë një pasqyrë të shpejtë të mjedisit të SI/IT dhe shërbimeve të ndryshme të SI/IT, që ekzekutohen përgjatë sistemit dhe për ngarkesën e punës.

### **6.3 Shërbime “e-mail” të brendshëm dhe të jashtëm**

Shërbimi *Mail Server*<sup>50</sup>, për një organizatë të madhe si Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, është mision kritik, është një mjet komunikimi që i lejon punonjësit të prodhojnë rezultate më të mira. Mirëmbajtja e tij, ka një rol të veçantë, nga vetë rëndësia e tij. Me rritjen e punonjësve dhe volumit të punës, në *e-mail* është rritur edhe numri i mesazheve të marra dhe të dërguara, duke ndikuar kështu dhe në shpejtësinë e proceseve të ndryshme të punës. Midis këtij ndryshimi, pritjet e punonjësve kanë evoluar, kështu që ato sot kërkojnë për më shumë efikasitet në *e-mail*, kalendar,<sup>51</sup> *attachment* (bashkëngjitje dokumentesh), kontakte dhe për më shumë pa marrë parasysh se ku janë dhe çfarë pajisjesh janë duke përdorur.

*Exchange 2010* ofron pesë role që mund të kombinohen sipas nevojës së organizatës tonë:

- “edge transport”,
- “hub transport”,
- “client access”,
- “mailbox”,
- “unified messaging”.

### **6.4 Shërbime, “web aplikacion”, “mobile aplikacion”, “server aplikacion” etj.**

Softuerë siç thamë më lart, është në varësi të aplikacionit, funksionit që do ketë aplikacioni. Pasi është verifikuar që serveri ka harduerë të mjaftueshëm bëhet instalimi i softuerit. Shumica e programeve kanë dy grupe kërkesash: ato minimale dhe ato të rekomanduara. Për një instalim sa më efektiv, është mirë që të bazohemi te ato të rekomanduara. Përveç instalimit të sistemit të operimit shpesh herë lind nevoja instalimin e programeve shtesë. Dhe, para se të instalohen këto programe shtesë, duhet verifikuar nëse janë të përputhshëm me sistemin që kemi. Është e nevojshme të realizohet *upgrade*<sup>52</sup> i sistemit, instalimi i “tools”-ve<sup>53</sup> të ndryshëm etj. Çdo program që instalohet

**Çali, D.**  
Teknologjia e informacionit dhe Policia e Shtetit »

<sup>50</sup> Mail Server - Një server mail (ose server email) është një sistem kompjuterik që dërgon dhe pranon email.

<sup>51</sup> Attachment - bashkëngjitje dokumentesh një mundësi për të dërguar dokumente, video, foto etj nëpërmjet email.

<sup>52</sup> Upgrade - Përmirësim të software.

<sup>53</sup> Tool-seve - programeve.

Policiimi dhe Siguria nr.7, 2017

duhet të jetë i licencuar dhe duhet verifikuar që ekzekutohen vetëm shërbimet e duhura, ato të nevojshmet. Prandaj janë disa standarde që duhen zbatuar dhe nuk lejohen instalime të paarsyetuara. Programet që instalohen, do të kenë patjetër një qëllim të caktuar e të aprovuar. Instalimi i një programi (përfshi edhe *driver*, *plugins* etj.) është akti i vendosjes së një programi në një sistem kompjuterik në mënyrë që të ekzekutohet. Por me termin instalim, nënkuptojmë jo vetëm instalime *software* (programesh) por edhe ato *hardware* (komponentë të ndryshëm fizikë të serverit).

*Hardware*<sup>54</sup>. Instalimi i harduerëve dhe ai softuerëve janë gjithnjë në varësi të aplikacionit, funksionit që do ketë serveri. Në momentin që i caktohet aplikacioni që do të ketë serveri, pika e parë me rëndësi është specifikimi i minimumit të harduerit që nevojitet të ketë serveri<sup>55</sup> si procesori<sup>56</sup>, RAM<sup>57</sup>, *hard disk* etj. Shpesh herë mund të jetë nevoja që instalohen disa komponentë shtesë, jo vetëm në rastin e mësipërm, por edhe në rastin kur ka nevojë për një zëvendësim komponenti p.sh. në rast defekti.

### 6.5 Menaxhimi dokumentar i sistemit

Për menaxhimin e sistemit, duhet të përdoret një menaxhim standard i shoqëruar me paraqitje analitike të proceseve dhe objekteve të punës. Për këtë është e nevojshme një punë e detajuar, që të përfshijë rishikimin dhe vlerësimin e dokumentacionit ekzistues, si dhe krijimin dhe miratimin e dokumentacionit për etapat e reja të projektit. Të gjitha dokumentet e zhvillimit të projektit, janë të shpërndara në format elektronik; ashtu si edhe në letër, tekstet e dokumenteve duhet të shpërndahen në një format të lexueshëm nga *Paketa Microsoft Office*.

### 6.6 “Windows Server”<sup>58</sup>

Menaxhimi i *Windows Server* përshin detyra të ndryshme. Ato përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në administrimin dhe monitorimin e serverëve bazuar në rolet funksionale, monitorimin e rrjetit të organizatës, mbajtjen e aktivitetit dhe zbatimin e praktikave të ngurta. Sistemet *Windows Server* marrin pjesë në përgjegjësi të ndryshme në një organizatë. Aspektet e menaxhimit për disa nga rolet që *Windows Server* mund të ndër marrë janë përcaktuar si më poshtë:

- “File Server”, janë kryesisht përgjegjës për mbajtjen e të dhënave. Këto të dhëna duhet të jenë gjithnjë në dispozicion dhe të arrihen shpejt.

- “Print server”. Menaxhimi i *Print Server*: printimi duhet vazhdimisht të auditohet dhe monitorohet.

- “Web server”. *Windows Server Web Server* ofrojnë një shumëllojshmëri të funksioneve të lidhura në internet, të tilla si HTTP, FTP, SMTP, dhe më shumë. Secilin prej shërbimeve të instaluar në server duhet të menaxhohet për të mbajtur të dhënat dhe shërbimet.

- “Domain Controllers”<sup>59</sup>. *Domain Controllers* mban *Active Directory*, e cila

<sup>54</sup> Hardware - pjesë elektronike të prekshme të kompjuterit.

<sup>55</sup> Server- një server është një program kompjuterik ose një pajisje që ofron funksionalitet për programet ose pajisjet e tjera, të quajtura “klientë”.

<sup>56</sup> Procesori - është logjika dhe truri i kompjuterit.

<sup>57</sup> RAM - Kujtesa me akses të rastësishëm është një formë e ruajtjes së të dhënave kompjuterike.

<sup>58</sup> Server - Një kompjuter ose program i cili ofron shërbime për programe të tjera ose përdorues, qoftë në të njëjtin kompjuter ose nëpërmjet një rrjeti kompjuterik.

<sup>59</sup> Domain Controller - shpesh herë referohet si DC, në sistemet Windows Server, është një server që iu përgjigjet kërkesave të sigurisë së autentifikimit (logging, verifikim te drejtash, etj) brenda domainit Windows Server, DOMAIN - Në Active Directory, një grup kompjuterësh, përdoruesish të përcaktuar nga administrator.

përmban shumicën, nëse jo të gjitha, objektet në mjedis *Windows Server. Active Directory* ka role shumë funksional në një mjedis të *Windows Server*, duke përfshirë administrimin e objektit (shtesa, ndryshime, ose fshirje), autentikime, replikime, siguri dhe më shumë se kaq. *Active Directory* ka mjete shumë të dobishme për të ndihmuar në menaxhimin e direktorisë. Ato përfshijnë *Active Directory Domain* dhe *Trusts*, *Active Directory Sites* dhe *Services*, dhe *Active Directory Users* dhe kompjuterin.

- “Application Server”, është një server i cili u ofron aplikacioneve shërbime si: siguria, shërbimi i të dhënave, shërbimi i transaksioneve, “load balancing” dhe menaxhimi i sistemeve me shpërndarje të mëdha. “Application server” nuk është domosdoshmërisht një server makine, megjithatë trajtohet si i tillë pasi është një pjesë e një softueri. Si parim, çdo softuer që përpunon të dhëna në mënyrë të qendërzuar në klientë të shpërndarë quhet një “Application server”.

- “Linux Server”. Sistemi operativ *Linux* është ndryshe nga ai *Windows*, kështu që edhe në procedurat e mirëmbajtjes ata ndryshojnë në disa pika. Është e rëndësishme në për marrjen e informacionit në lidhje me aktivitetet e sistemit, përdorimi i komandave dhe disa *add-on-tools*. Shumica e *Linux distributions* janë të pajisura me monitorime të ndryshme. Komandat e diskutuara më poshtë, janë komandat bazë; kur është fjala për analizën e sistemit dhe çështjet *debugging server*, gjetjen e pengesave, bllokimin e *storage* (disc), pengesat e CPU dhe memories, pengesat e *network*-ut etj.

- “Active Directory”<sup>60</sup>. Struktura e *Active Directory* është një kornizë hierarkike e objekteve, ku çdo objekt përfaqëson një njësi të vetme - qoftë një përdorues, një kompjuter, një printer, ose një grup - dhe atributet e tij. Objektet e caktuara mund të jenë gjithashtu kontenierë të objekteve të tjera. Një objekt identifikohet në mënyrë unike nga emri, dhe ka një sërë atributesh - karakteristika dhe informacion, që mund ta mbajë të përcaktuar nga një skemë, e cila përcakton llojet e objekteve që mund të ruhen në *Active Directory*. Objektet, sipas një fushe të caktuar organizohen në OU (*organization unit*); krijimi i OU mundëson lehtësimin administrimin e *domain*-it dhe jep një ngjashmëri të strukturës së organizatës, të Policisë së Shtetit.

### 6.7 Mirëmbajtja parandaluese

Disa procedura të mirëmbajtjes, kërkojnë më shumë vëmendje se sa disa të tjera. Procedurat që kërkojnë më shumë vëmendje janë të kategorizuar si *procedura të përditshme*. Prandaj, rekomandohet, që administratori të zbatojë këto procedura çdo ditë, për të siguruar besueshmërinë e sistemit, performancën dhe sigurinë.

### 6.8 Planifikimi

Një etapë tjetër e rëndësishme në mbarëvajtjen e punës është edhe parashikimi apo planifikimi i saktë i bazës materiale të nevojshme të SI/TI, duke marrë në konsideratë gjendjen aktuale të materialeve që disponohen dhe organizimin e ri të punës, me qëllim monitorimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e sistemit. Hartojmë një listë me pajisjet e nevojshme - ato *hardware* dhe *software*. Me implementimin e këtyre pajisjeve synojmë të rrisim cilësinë e shërbimeve për përdoruesit e sistemit dhe sigurinë maksimale. Planifikimi synon integrim dhe suport të zgjidhjeve teknike në një mjedis të nivelit të lartë të SI/IT, ku përfshihen projektimi, suportit dhe integrimi i platformave, sistemeve operative, *storage* dhe komponentëve të mundshëm për të zgjidhur nevojat e sistemit. Në momentin që lind nevoja për implementimin e një shërbimi të caktuar, hartohet dokumentacioni dhe sektori i SI/TI bën planifikimin se çfarë serveri më të dhëna fizike duhet dhe, çfarë softueri do të vendoset; pra të gjitha specifikimet. Për realizimin e qëllimit bëhen disa variante brenda sektorit dhe zgjidhet ai më i miri, me efektivitetin më të lartë.

Çali, D.  
Teknologjia  
e informacionit  
dhe Policia  
e Shtetit »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

## 7. Rekomandime

- Ndjekja e një politike efektive për burimet njerëzore bazuar në merita dhe kjo të aplikohet me prurje të reja nga radhët e fakulteteve profesionale të teknologjisë së informacionit si dhe alokimi i mjaftueshëm i këtyre burimeve në Policinë e Shtetit.

- Të intensifikohen aplikimet informatike të drejtuara nga inteligjenca në fushën e rendit dhe sigurisë publike, policimit në komunitet, pastrimit të parave, krimeve kompjuterike, trafikimit të qenieve njerëzore dhe krimeve financiare.

- Sistemi i dërgimit të imeileve që trajton këto nevoja, duhet të balancohet kundrejt kërkesave të tjera si siguria dhe kostoja. Sot, personeli SI/IT duhet të luftojë kundër kërcënimit të imeileve ndaj sigurisë që janë të një spektri të gjerë si: spam dhe viruse. *Microsoft Exchange Server* është projektuar posaçërisht për të përmbushur këto sfida duke ofruar mbrojtje të avancuar .

- Për përmirësimin e punës, realizohet ndarja strukturore, që do të thotë krijimi i site-ve, të cilat janë më shumë fizike se sa logjike, grupime të përcaktuara nga një ose më shumë *subnet*-e IP<sup>61</sup>. Site-t janë të pavarura nga struktura e domain-it dhe OU. Site-t përdoren për kontrollin e trafikut të rrjetit të krijuara nga përsëritjet dhe gjithashtu për t'iu referuar klientëve të kontrolluesit më të afërt domain (DC). Kështu që do krijohen site sipas qyteteve ku ekzistojnë këto DC (Domain Controller)<sup>62</sup>, duke reduktuar kështu trafikun e tepërt dhe një organizim më të saktë.

- Bashkëpunimi mes specialisteve dhe strukturave të specializuara të SI/TI dhe Policisë së Shtetit dhe agjencive të tjera ligj zbatuese, duhet të përmirësohet më tej, duke i paraprirë analizave funksionale sa më të hollësishme, në mënyre që të arrihen kapacitete të mjaftueshme dhe përmirësimi i performancës së gjithë autoriteteve të zbatimit të ligjit, për të luftuar krimin e organizuar dhe terrorizmin.

- Të rritet më tej buxheti i sektorit të SI/TI në Policinë e Shtetit; duhet të plotësohen me burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare, si dhe të marrin trajnimet e nevojshme për të mbuluar koston që nevojitet për mirëmbajtjen, zhvillimin dhe shërbimet që realizon ai, pavarësisht rritjes që ka pasur kohët e fundit.

- Të shfrytëzohen më tepër produktet e inteligjencës strategjike të Policisë së Shtetit, duke u pasur parasysh zbatimin e ligjeve (“Ligji për Policinë e Shtetit”, “Ligji për konfiskimin e asetëve kriminale”, rekomandimet e “Task-forcës kundër krimit financiar”) si dhe mendimet në ligjin Anti-Mafia mbi asetet e sekustruara dhe të konfiskuara.

- Shërbimet e SI/TI, proaktive, të bazuara në analiza të mirëfillta të riskut, duhet të rriten në mënyrë thelbësore për të zhvilluar një rekord solid të hetimeve, ndjekjeve penale si dhe dënimeve finale në rastet e korrupsionit.

- Hapat e ardhshëm duhet të përfshijnë fuqizimin e kapaciteteve investiguese të agjencive ligjzbatuese, si dhe kryerjen e hetimeve proaktive dhe efektive nëpërmjet shfrytëzimit intensiv të bazave së të dhënave, të afuara nga SI/TI.

- Hetimet, ndjekjet penale dhe gjykimet e veprave penale të lidhura me krimet, terrorizmin dhe korrupsionin, duhet të përmirësohen, në mënyrë që hetimet paraprake të bëra nga tre institucionet, të kryhen si rezultat i mbledhjes inteligjente proaktive si dhe aksesit në informacion si nga databazat publike edhe nga ato private. Nëpërmjet dhënies së autonomisë së mjaftueshme dhe garantimit të qëndrueshmërisë për stafin e policisë, me akseset e nevojshme në këto databaza, si dhe nëpërmjet përcaktimit të juridiksionit të qartë në lidhje me krimet, terrorizmin, korrupsionin etj.

- Bashkëpunimi ndërmjet agjencive duhet të zhvillohet më tej. Bashkëpunimi



ndërmjet prokurorisë dhe policisë duhet të përmirësohet, në mënyrë që hetimet paraprake të bëra nga tre institucionet, të kryhen si rezultat i mbledhjes inteligjente proaktive si dhe aksesit në informacion si nga databazat publike edhe nga ato private.

- Kërkohet një bashkëpunim më i ngushtë në shkëmbimin e informacionit dhe veprimeve operacionale me vendet anëtare të BE-së, intensifikimi i hetimeve për personat që nxisin lëvizjen e parregullt, kryerjen e fushatave të rregullta informuese dhe reduktimin e faktorëve shtytës social-ekonomike.

- Duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë eficiencës në kontrollat kufitare, përfshirë parandalimin e kalimit në kufi të fëmijëve të pashoqëruar, nisur nga numri në rritje i tyre, duke nënshkruar më shumë marrëveshje mbi shkëmbimin e informacionit për migracionin me vendet e BE-së, nëpërmjet ngritjes së qendrave të përbashkëta të bashkëpunimit policor, kontrollit në dalje në pikën e kalimit mes Shqipërisë dhe vendeve të BE-së, etj.

- Duhet të rriten ndjeshëm mekanizmat e kontrollit të brendshëm në vendkalimet kufitare, për investigimin inteligjent, për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore, menaxhimin e çështjeve të azilit, hetimet aktive, bazuar në analizat e riskut, për të zhvilluar rezultate bindëse në hetime, ndjekje penale dhe dënime në çështjet e mbrojtjes ndërkombëtare.

- Duhet të zhvillohen programe trajnimi në bazë, për implementimin e sistemit të menaxhimit në strukturat e Policisë së Shtetit. Duhet të përmirësohen kushtet e punës dhe të teknikës për drejtorinë e TI.

- Plotësimi i standardeve të BE-së për informatizimin dhe digjitalizimin në masën 100% të shërbimeve të Policisë së Shtetit, duke siguruar transmetimin e të dhënave dhe komunikimin në çdo kohë dhe në çdo vend ku shtrihet aktiviteti i punës së punonjësve të policisë në komunitet.

## Referenca

1. *Strategjia e Teknologjisë së Informacionit në Shqipëri*, Këshilli i Ministrave, Ministria e Inovacionit dhe Zhvillimit, Akademia e Shkencave, AKSHI, INIMA etj. Dokumenti i parë i strategjisë për SI/TI i miratuar në vitin 2003, objektivat kryesore për SI/TI të përcaktuar në dokumentin e SKZHI-së
2. *Strategjia ndërsëktoriale për Shoqërinë e Informacionit 2008-2013* (SNSHI) e miratuar me VKM nr. 59, dt. 21.1.2009.
3. *Axhendë Dixhitale për Evropën*, COM(2010) 245, miratuar 19.05.2010, EC.
4. SEE-2020 (South East Europe-2020), *Strategjia e Teknologjisë së Informacionit për Vendet e Europës Juglindore*.
5. *Strategjia e Teknologjisë së Informacionit në Shqipëri*, "Shqipëria Dixhitale", Strategjia e SI/TI Kombëtare, 2014-2020.
6. Arkivi qendror i Ministrisë Punëve të Brendshme, Policisë së Shtetit, analiza e analiza pune vjetore, marrëveshje dhe shkëmbime informacioni etj., 1999-2016.
7. Martyn Philips, *Revelation Software & programming basic +*, *OI-Revelation Web application*; London.
8. Francisco José García-Peñalvo, *Journal of Information Technology Research*, (31-48), University of Salamanca.
9. Charles H. Davis dhe Debora Shaw, *Introduction to Information Science and Technology*.
10. Steve Suehring, *Linux Firewalls: Enhancing Security*.
11. Lou Grinzo, *Visual Basics Programing*.
12. Mark Minasi, Christa Anderson, *Mastering Windows Server*, 2003
13. Joan Casteel, *Oracle 12c*.
14. Rand Morimoto, et. al. *XP windows server*.
15. Francesco Balena, *Programming Microsoft Visual Basic .NET*.
16. Ghazi I. Alkhati, *International Journal of Information Technology and Web Engineering*
17. John Wang, *International Journal of Information Technology Project Management* (9-25), Montclair State University.
18. *Modern Information Systems*, leksion. Tirane: UET, 2016.
19. Pranab Kumar Das Gupta, P. Radha Krishna. *Database Management System Oracle Sql And Pl / Sql*.
20. Mitch Tulloch, *Security and Privacy for Microsoft Office 2010 Users*, Microsoft Download Center.
21. Project Management Guide, Programme Management, and Introduction to the Techniques, 2006.
22. Catchpoint Systems, *Web Performance Insights 2011*, posted on Catchpoint blog, from 2011.
23. Microsoft Press, *Performance Testing Guidance for Web Applications*, Microsoft's Guide, recommended approach for implementing performance testing for Web applications.

**Çali, D.**

« Teknologjia e informacionit dhe Policia e Shtetit »

Policimi dhe Siguria nr.7, 2017

# Sër Robert Pil, krijues i policisë moderne



■ **Prof. Asc. Dr. Stavri SINJARI**  
Akademia e Sigurisë

## Abstrakt

*Sir Robert Peel (Sër Robert Pil), njihet si personalitet i madh për krijimin e reformimin e policisë moderne, si reformator, ligjvënës, ideator e krijues ligjesh në formatin e së drejtës anglo-saksone. Atij i përkasin mjaft iniciativa ligjore, që nxitën ndryshime fundamentale të kodit penal anglez, për lehtësimin e dënimeve në shumë dispozita penale, që kodi i vjetër i penalizonte me dënim kapital; për kodifikimin e parimeve e rregullave të reja të sistemit të burgjeve e vuajtjes së dënimit dhe edukimit të së burgosurve, rregullimit të ligjeve të biznesit, të orarit të punës, të së drejtave të grave, të fëmijëve etj. Si një figurë e lartë shtetërore, politike, e periudhës Viktoriane, në Mbretërinë e Bashkuar (MB), kryetar i konservatorëve, ligjvënës i zgjedhur në disa mandate, dy herë kryeministër, inicioi, projektoi e miratoi mjaft reforma, që u finalizuan me ligjin për krijimin e një force të re të policisë në Londër, që shërbeu si fillesë e një policie ndryshe, që me idetë e policimit e parimet dhe organizimit, u bënë embrion i policisë së ardhshme moderne që kemi sot.*

## Fjalëkyçe:

**akt metropolitane, etika e ligjit, figurë krimi, parandalimi i krimit, çrregullim, organizatë shtetërore ligjzbatuese, polici metropolitane.**

Sinjari, S.  
Sër  
Robert Pil,  
krijues i policisë  
moderne

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

## 1. Hyrje

Sir<sup>1</sup> Robert Peel<sup>2</sup> mund të vlerësohet e të quhet ndryshe edhe Hipokrati<sup>3</sup> i policisë moderne. Përveçse një personalitet politik, ligjvënës, udhëheqës partie, kryeministër qeverie i Britanisë së Madhe në periudhën Viktoriane<sup>4</sup>, vlerësohet si mendimtar, ideator e krijues, i policisë moderne angleze, e jo vetëm kaq. Ai ndërmori një numër të konsiderueshëm reformash të rëndësishme ligjore të së drejtës penale anglo-saksone. Ndryshimet për lehtësimet e dispozitave të ndërmarra e drejtuara prej tij, përfshijnë rreth 100 figura krimi, që kodi i vjetër jepte dënim kapital.

Reformat “peeliane” zunë një gamë të gjerë çështjesh, që përmirësuan legjislationin, për parimet e rregullat që rregullojnë funksionimin e organizatës së Policisë, sistemin e burgjeve e vuajtjen e dënimit, metodat për edukimin e të burgosurve, në fushën e rregullimeve ligjore të biznesit, ekonomisë, modernizimit të sistemit bankar, të drejtave të punëtorëve, të orarit të punës e pushimeve, të drejtave të grave e fëmijëve... etj.

Në veçanti, mendimi e kontributi i tij në fushën e policisë i kapërceu kufijtë e kohës kur ai jetoi dhe hapësirës angleze ku ai lindi e punoi. Veprat konkrete që ndërmori e realizoi tashmë i përkasin gjithë policisë, shtrihen përtej hapësirës angleze apo UK<sup>5</sup>. Ndonëse këto ide vinë prej së kaluarës, ato prej dy shekujsh, janë ende të freskëta e aktuale dhe kalojnë përtej kufirit të sotëm, që të drejtojnë në policinë e së ardhmes. Prandaj, historia e vlerëson shumë. Midis më të mëdhenjve mendimtarë të policisë,

**Sinjari, S.**  
« Sër  
Robert Pil,  
krijues i policisë  
moderne »

<sup>1</sup> Sir, angl. titull dallues i një kalorësi ose baroneti.

<sup>2</sup> Enciklopedia Britanica, 5 shkurt 1788, Bury, Lanchashire - 2 qershor 1850, Londër.

<sup>3</sup> Hipokratit, Babai i Mjekësisë, nga ishulli Kos , 460- 375 p.e.s.

<sup>4</sup> Periudha e sundimit nga Mbretëresha e Anglisë, Viktoria, nga 20 qershor 1837 -22 janar 1901.

<sup>5</sup> Mbretëria e Bashkuar, United Kingdom: Anglia, Uells, Skocia, Irlanda e Veriut, pjesë e ish-Perandorisë Britanike.

baroni Sir Robert Peel ka meritat e veta të veçanta për policinë, përtej kufijve të fushës së të drejtës, për krijimin e reformimit të kësaj organizate sipas parimeve të funksionimit të saj në shoqërinë civile dhe midis gjithë të tjerëve, ai mund të renditet në HMP<sup>6</sup> si i pari për idetë e policimit.

Gjithkush, jo vetëm punonjësit e policisë, do donte të dinte më shumë për të dhe për jetën e veprimtarinë e tij, veçanërisht për kontributin e ideimit të parimeve bazë të veprimtarisë së policisë si një organizatë sigurie apo institucion i administratës shtetërore, në mbrojtje të ligjit, për rrugën që ka bërë dhe ku ecën sot, pas 200 vjetësh; rrugë e shtruar nga vizionarë të tjerë të shquar të policisë, të cilët do qëndrojnë gjithmonë në piedestalin e policisë moderne, në atë pedestal ku shkruhen varg emrat e përveçëm, midis të cilëve pa dyshim emri i tij, siç thirret edhe sot në enciklopeditë e mëdha botërore, Sir Robert Peel.

## 2. Edhe pse nuk ishte polic?!

Deri në ditët e sotme policët në Londër e MB, vazhdojnë të thirren me emrin “*bobbies*”, një zhargon, në vendet anglisht folëse, - kryesisht në Britani e SHBA, - i shkurtimit të emrit Robert, shkurt Bobby<sup>7</sup>. Ky emërtim i policëve anglezë, e ka zanafillën prej afër 200 vjetësh, si dublim i emrit të krijuesit të tyre Robert Peel. Interesante është historia e “*bobbs*”-vet, të policëve metropolitan, që morën këtë emër dhe e mbajtën më pas, kur brenda tyre u krijua një forcë e veçantë policore, që fillimisht u thirrën me mbiemrin e tij, me nofkën, “*peels*”-at<sup>8</sup>, si dublim e kuptim i njëjtë me emrin e zakonshëm polic, e më pas ata u quajtën edhe *bobs*-a, sipas Sir Peel-Robert.

Pra, nga *pilsa*, për oficerët e forcës së veçantë brenda policisë metropolitane, në *bobsa*, për gjithë Policinë Metropolitane. Ky nderim i emrit i takoi atij, që jo vetëm e hartoi dhe e mbrojti Aktin Final të krijimit të Policisë Metropolitane, që u miratua në 1829 në Parlament dhe me dekret mbretëror, atëherë kur Sir Robert Peel ishte Sekretar i Kabinetit të Torëve<sup>9</sup>, por sepse edhe u përkujdes gjithë jetën për modelin e policisë që krijoi. Sipas biografëve të tij, kishte edhe një arsye tjetër të vënies së këtyre emrave, si pseudonime të kësaj force policore. Këto emërtime i kishte kërkuar apo pranuar vet Robert Peel. Si një xhentëlmën i vërtetë anglez, duke i pagëzuar ose pranuar me emrin e tij *pilsat* apo *bobsat*, donte të merrte përgjegjësinë mbi veten për forcën e oficerëve të policisë metropolitane që krijoi, për të gjitha detyrat, funksionet, të drejtat si një organizatë ligjzbatuese në Mbretërinë e Bashkuar.

Çudia e parë që të surprizon tek figura e R. Peel është fakti se ai nuk ishte polic, nuk kishte përfunduar ndonjë program edukimi policor, madje as nuk punoi polic, as nuk drejtoi ndonjë departament policie të Skotland Jar<sup>10</sup> në Londër e gjetkë. Madje edhe nëse veshi ndonjëherë uniformë, këtë mund ta ketë bërë për të testuar modelin e veshjes së policëve e oficerëve, të dizajnuar nga vet ai me, dy bashkëpunëtorët e vet të ngushtë të policisë<sup>11</sup>.

<sup>6</sup> HMP-Historia e Mendimit Policor.

<sup>7</sup> Në SHBA, si shembulli i ish-kampionit të botës në shah, Robert (Bobi) Fisher.

<sup>8</sup> “*peels*” thirren oficerë policie në Irlandë, Kanada. “*Cops*” prej “*copper shields*” nga kopsat e uniformës.

<sup>9</sup> Shkurtim i emrit të Partisë Konservatore në Angli.

<sup>10</sup> Kështu quhet policia e Londrës që në atë kohë (shih 12).

<sup>11</sup> Bashkëpunëtorët e ngushtë me Sr. Peel ishin tre oficerë, Koloneli Lejtnant Sr. Charles Rowan dhe Sr. Richard Mayne ish-avokat, komisioneri i parë, kreu i Policisë Metropolitane të Londrës. Këshilltar polici francez, Eugène François Vidocq - ish i dënuar francez dhe kriminalist, u bë themeluesi dhe drejtori i parë i zbulimit si dhe kreu i agjencisë së parë private të zbulimit në Francë.

Ai rridhte nga një shtresë e pasur aristokrate në kastën e hierarkisë mbretërore britanike. Jeta e tij është biografi tipike e një pinjollit<sup>12</sup> aristokrat anglez të kohës, një familjeje të pasur me prona e tituj, të cilat bashkë me privilegjet i trashëgoi e gëzoi Peel-i ri. Në 1788 kur Roberti lindi, i ati ishte një fabrikant i madh tekstilësh, baronet i parë, prej të cilit, Roberti që në fëmijëri, nën kujdesin e tij mori një arsimim të plotë elitar. U shqua për aftësitë e zgjuarsinë e tij, u diplomua në disa fusha të politikës e të së drejtës, ndoqi mjaft kurse, deri matematikë. Ishte studenti i parë në historinë e Universitetit të Oksfordit që u nderua me medalje e çmim, dhe sot emri i tij është simbol honorifik në universitetin e Oksfordit. Mbas diplomimit, shumë shpejtë, në sajë të intuitës politike, zgjuarsisë, meritave personale, filloi të shihej si një yll politik i së ardhmes.

Që kur ishte 21 vjeç, hyri në Dhomën e Komunëve e brenda partisë natyrore të tij, asaj Konservatore, u dallua shpejt, sa për elokuencën e fjalimet e zjarrta aq edhe për shpirtin krijues e reformator, të cilat i dhanë një shtytje të re karrierës së tij, nga sekretar ministror, në sekretar i Përgjithshëm i Kabinetit, e më pas u bë udhëheqës i Torëve<sup>13</sup> dhe, deri dy herë Kryeministër i MB. Në sajë të background-it të shkëlqyer e sidomos guximit e zotësisë të tij, Peel u formua si një burrë i vërtetë shteti britanik, i cili për disa dekada udhëhoqi partinë konservatore dhe shtetin si kryeministër, deputet në disa mandate, e mbeti njëkohësisht edhe krijues, drejtues, e frymëzues i policisë.

Nga tradita e trashëgimia familjare, nuk pati ndonjë lidhje, ndikim a pikë takimi me policinë. Rrjedhimisht, tek ai nuk lindi ndonjë dëshirë e pasion për policinë e rolin e saj, siç ndodh rëndom në shumicën e profesioneve të zgjedhur nga çdo njeri në jetë. Jo! Peel-i nuk kreu ndonjë shkollë apo edukim policor, (ndonëse edhe shkolla të tilla ende nuk kishte); nuk e nisi karrierën e tij si polic dhe as punoi ndonjë ditë si polic. Formimi e arsimimi i tij elitar, strikt, i plotë, i tipit tradicional anglez, u përqendrua kryesisht në fushën e politikës e legjislacionit, gjë që i dha frytet menjëherë në bërjen e një karriere brilante. Profesionit i politikanit dhe udhëheqësit nuk e pengoi, përkundrazi - e ndihmoi të merrej me policinë, porsa të dy këto drejtime u bashkuan në një pikë rastësisht, kur midis detyrave të shumta të zyrës së Kabinetit u ngarkua të merrej posaçërisht me problemin e sigurisë në Londër, për organizimin e një force të re policore, një lloj organizate shtetërore ligjzbatuese, me detyra të përcaktuara saktë me ligj, për mbrojtjen e rendit e sigurisë publike, moment që shënoi krijimin e Policisë Metropolitane në Londër, shkurt MET. Ky rast i paparashikueshëm, u bë baza e lidhjes së tij me policinë dhe pikënisja e një CV-je që do ta bënte Sir Robert Peel-in më të famshëm se qenia kryeministër i një superfuqie, siç ishte në atë kohë Mbretëria e Bashkuar.

Shumë shpejtë, në sajë të tij, MET (Policia Metropolitane) do të njihej e të bëhej aq e suksesshme dhe e famshme, prej pilsave që do të punonin aty, sa do përjetësonte emrin e rrugës ku ishte vendosur ndërtesa e parë, “*Scotland Yard*”, që deri sot e kësaj dite, pothuaj ka zëvendësuar emrin e Shërbimit Policor Britanik<sup>14</sup>.

Standardizimi i profesionalizmit të Policisë Metropolitane, në bazë të legjitimitetit të parimeve e rregullave të reja të përcaktuara nga Peel, do të shërbente për shumë gjatë, si model i së ardhmes. Edhe pa lidhje me policinë, pra pa uniformën e policit të veshur, Sir Peel kishte arsim e kulturë të gjerë, me përvojë në administrim dhe legjislacion, por

<sup>12</sup> Pinjoll-pasardhës i drejtpërdrejtë i një familjeje ose i një fisi.

<sup>13</sup> “Torë” shkurtim i konservatorëve, partisë me këtë emër në Angli.

<sup>14</sup> Megjithëse zyra është zhvendosur dy herë prej andej vazhdon për inerci të njihet në publik me emrin e rrugës, vetëm me ndryshimin se i kanë shtuar para “new”, pra “New Sc. Yard”, që në Londër ka më tepër kuptimin e Selisë qendrore të Policisë Metropolitane.

**Sinjari, S.**  
« Sër  
Robert Pil,  
krijues i policisë  
moderne »

Policimi  
dhe  
Siguria  
**nr.7, 2017**

vërtetoi se ishte superpolic, përdërisa krijoi e projektoi një polici model edhe për të ardhmen e largët.

Ndoshta kjo rastësi, padashur e bëri atë më të famshëm e të njohur. Ndonëse ai kujtohet si burrë shteti i MB, të drejtuar nga “Queen Victoria”, si politikan e ligjvënës dhe krye-ministër<sup>15</sup>, prapëseprapë, kurorën e lavdisë, që do e përjetësonte e do ta bënte të njohur në mbarë botën, ia dha policia, si reformator i madh i organizatës së Policisë Metropolitane.

### 3. Krijues i “Policisë Metropolitane”

Sipas jetëshkruesve,<sup>16</sup> Robert Peel ishte ai që krijoi forcën e parë policore profesionale në Londër dhe më gjerë, në Britani. Ndoshta sot, për lexuesit mund të mos konceptohet kaq lehtë fakti që në Anglinë e fund shek. 18 e fillim të shek. 19, ende nuk ekzistonte një forcë e mirëfilltë policore, qoftë edhe një formë e organizuar mbrojtëse, për parandalimin e luftën kundër krimit. Prej dy dekadash, në Glasgow vepronte një numër “Watchmens”,<sup>17</sup> (roje) dhe në Irlandë një forcë xhandarmërie mbretërore, por asnjë organizatë apo forcë e mirëfilltë sigurie, policore profesionale. Madje, ishte paradoksale që Londra, metropoli i gjithë Mbretërisë së Bashkuar, të mos kishte një forcë të veçantë policore për të mbrojtur qytetarët, që të parandalonte e godiste krimin, i cili në atë kohë, shënonte shifra rritjeje galopante. Kjo ishte penguar më tepër nga politika dhe publiku, sepse dyshonin në përdorimin nga qeveria të kësaj force kundër tyre, për të shtypur protestat, që në atë kohë ishin jo të pakta. Një arsye tjetër, ishte reminishenca që shkaktonte termi “forcë policore” në Londër, njëlloj si në Paris, ku prej kohësh, që nga koha e Napolonit funksiononte një polici sekrete politike, që kishte ndihmuar në luftën me Anglinë, prandaj, s’mund të pranohej nga publiku londinez një model francez, madje edhe vet termi “polic” ishte armiqësor për ta.

Deri në atë kohë, sistemi i ruajtjes dhe sigurisë publike bazohej në disa roja, forca vullnetare e paraushtarake në nivel lokal, të shpërndarë, jo profesioniste, jo si një organizatë e posaçme sigurie, prandaj modeli i xhandarmërisë në Irlandë, shërbente për krijimin e një force të tillë, të ngjashme në Londër. Sidoqoftë, pozita si sekretar i kabinetit i dha Robertit mundësinë për të ideuar e miratuar një forcë të tillë, sigurisht jo si forcë të armatosur ushtarake, as me statusin e xhandarmërisë; jo një kopje franceze, apo irlandeze, por një organizatë e re sigurie për qytetarët, për mbrojtjen e tyre nga krimi e për goditjen e tij. Sigurisht, që hartimi i këtij akti deri miratimi i tij në 1829, ishte përgjegjësi e meritë e R. Peel-it. Por, kjo ishte pikënisja e punës së tij të pandalur, me forcën

<sup>14</sup> Megjithëse zyra është zhvendosur dy herë prej andej vazhdon për inerci të njihet në publik me emrin e rrugës, vetëm me ndryshimin se i kanë shtuar para “new”, pra “New Sc. Yard”, që në Londër ka më tepër kuptimin e Selisë qendrore të Policisë Metropolitane.

<sup>15</sup> Kryeministër i UK (1834-1835 dhe 1841-1846).

<sup>16</sup> Bent Johnson : <http://www.historic-uk.com/HistoryUK/HistoryofEngland/Sir-Robert-Peel/> (maj 2017).

<sup>17</sup> Në Londër, ekzistonin “roja”-të angazhuara për të ruajtur rrugët gjatë natës që nga 1663. “Watchmen” ishin zbatimi i parë i ligjit në vend, duke u shtuar forcën e palëve të papaguara, por nuk ishin të organizuara në mënyrë profesionale. Fjala “policia” ishte huazuar nga frëngjishtja në gjuhën angleze në shekullin e 18-të, por për një kohë të gjatë ajo aplikohet vetëm për forcat policore franceze dhe kontinentale. Fjala dhe koncepti i vetë policisë, ishte “i papëlqyer, si një simbol i shtypjes së huaj” (sipas Britannica 1911). Para shekullit të 19-të, përdorimi i vetëm zyrtar i fjalës “policia” i regjistruar në Mbretërinë e Bashkuar ishte emërimi i Komisionerëve të Policisë për Skoci, në vitin 1714 dhe krijimi i Policisë Detare, në 1798 (e krijuar për të mbrojtur mallin në Portin e Londrës).

Sipas: [https://en.Wikipedia.org/wiki/History\\_of\\_criminal\\_justice#Modern\\_police](https://en.Wikipedia.org/wiki/History_of_criminal_justice#Modern_police) (shtator 2017).

“Bow street runners”- qytetarë privat që kapnin kriminelë kundrejt shpërbërimeve nga “thief-takers” (shih. 19)

Policore Metropolitane që krijoi e që do t'i përjetësonte atij emrin.

Iu desh të zgjidhte një sërë problemesh, deri sa të finalizohej funksionimi e rezultatet e para të forcës policore që ideoi. E veçanta e Sir Robert Peel ishte rruga origjinale që ndoqi për kapërcimin e çdo problemi: zgjidhje origjinale e krijuese, që dalëngadalë, si një ndërtesë e re që lartësohet sipas një projekti - tullë pas tulle, po kështu, problem pas problemi, - filloi të rritej një organizatë e re, në formë edhe në përbajtje, me detyra, të drejta, pajisje e trajtim special e funksional, që ishte organizata Metropolitane e Policisë Londineze, e cila do të bëhej modeli e shtrati i policisë moderne të së ardhmes.

Në radhë të parë, në përbërje të saj duheshin njerëz të zotë, të vendosur e me karakter e fizik të fortë, që të donin e respektonin profesionin, të merrnin parasysh sakrificat, të duronin lodhjen e rrezikun që kanosej në çdo hap në ndeshje me kriminelë të armatosur.

Pra, dilte problemi i rekrutimeve të reja të radhëve të pilsave. Shkollë policie ende nuk kishte por duhej të kishin një nivel arsimor. Nën drejtimin e Çarls Rouan e Richard Mejn, u përcaktuan kriteret e reja të pranimeve të kandidatëve dhe rregulloret përkatëse. Ata duhej të ishin persona të zgjedhur me cilësi, të mos kishin ndonjë rast ndeshje me policinë për shkelje të ligjit; të ishin të shëndetshëm (mos vuanin nga sëmundje), të aftë, të shkathët e të fuqishëm. Kriter gjatësie, u vendos 5.7 feet<sup>18</sup>; mosha minimale e pranimit midis 20-27 vjeç (me raste, jo më tepër se 35). Peel tregoi kujdes të mos fuste në radhët e peels-ave shumë paraushtarakë apo oficerë të ushtrisë, për shkak të reminishencës publike, por futi kryesisht qytetarë nga shtresat e thjeshta të banorëve të Londrës.

Mjaft çështje jo të thjeshta, probleme delikate u ndeshën e u zgjidhën për paraqitjen e tyre në publik, që mos perceptoheshin si një forcë dhune ushtarake, si edhe çështje që lidheshin me detyrat e të drejtat e tyre ligjore, me rolin e vendin e organizatës së policisë në administratën shtetërore si forcë e armatosur, pa dubluar ushtrinë.

Sir R. Peel ishte i palëkundur në idenë e tij, se mposhtja e kimit dhe arritja e sigurisë publike, mund të bëhej vetëm nëpërmjet një force të posaçme, të paguar "full time", profesioniste policore<sup>19</sup>, prandaj iu përvesh me zell e besim konkretizimit të ideve të tij.

Kjo organizatë duhej të bazohej në përdorimin e forcës, por s' mund të ishte nën drejtimin e ushtrisë, sepse detyrat e tyre ishin krejtësisht të ndara. Nga ana tjetër, duhej të kishte një dallim të qartë me forcat e armatosura të ushtrisë mbretërore, që edhe publiku ta pranonte pa shqetësim brenda vetes, si arbitër e mbrojtës për zgjidhjen e çështjeve të veta. Ideja e Peel, për organizimin e një force të tillë, fillimisht u realizua nëpërmjet zgjidhjes së disa gjërave, në dukje të vogla, - si hap të parë, uniformën policore. Ndryshe nga ushtria, me uniformën e kuqe, që e kishin edhe rojet<sup>18</sup> vullnetare, për forcën policore u zgjodh ngjyra blu, sepse i ofrohej më tepër publikut.

Mijëshja e parë e "peels"-ëve, - siç i quajti publiku, - filloi të qarkullojë e patrollojë në rrugët e Londrës, në 29 shtator<sup>20</sup> 1829. Peel-sat e parë ranë në sy, fillimisht me paraqitjen e jashtme, fituan shpejt simpatinë e mbështetjen e banorëve londinezë. Atë ditë, për herë të parë, në rrugët e kryeqytetit u shfaqën disa djem shtatlartë, të fuqishëm, me një pallto treçerekëshe, tip mbretërore, ngjyrë blu e pantallona të bardha; uniformë e paparë ndonjëherë, ku binin në sy kopsat e shndritshme ngjyrë ari; me kapele të lartë

<sup>18</sup> 170.18 cm

(<http://www.history-uk.com/HistoryUK/HistoryofEngland/Sir-Robert-Peel/> (shtator 2017)

<sup>19</sup> Nga shek. 17 në Angli ekzistonte edhe një sistem individual privat policor, "thief-takers" - qytetar pa status, që paguheshin nga Mbreti për çdo arrestim kriminel që arrinin të bënin.

<sup>20</sup> Atë ditë filloi të binte shi dhe rekrutët sipas zakonit në ushtri hapën ombrellat, të tjerët sipas traditës u ulën në pijetore dhe u dehën. Fill pas kësaj u ndalua me rregullore përdorimi i ombrellave dhe shumë pilsa u shkarkuan.

**Sinjari, S.**  
« Sër  
Robert Pil,  
krijues i policisë  
moderne »

Policimi  
dhe  
Siguria  
**nr.7, 2017**

cilindrike (ose helmeta në raste të rralla), mbështjellë nga një mantel, me një xhep të madh ku mbahej një shkop me bisht, i cili do të shndërrohej më pas në “armën” kryesore të policit modern: “shkopi i policit”. Bobbs-at<sup>21</sup> e parë u pajisën edhe me një tjetër “armë”, që quhej “rrapëllimë”, një copë dërrasë që kur tundej bënte një zhurmë çjerrëse, gjë që shërbente për t’i dhënë dikujt një sinjal, për ta ndalur, për të kërkuar ndonjë ndihmë, që dëgjohej nga zhurma rrapëlluese karakteristike. Më pas, kjo u zëvendësua nga një tip lodre e krijuar nga kockat e balenave, me gdhendje, që fishkëllente si bilbil, rreth 20 cm e gjatë, e cila prej vitit 1880 u zëvendësua me “bilbilin e policit”.

Sigurisht, arma vetjake nuk u mungonte “peelsa”-ve: si fillim me një “flintlocks”,<sup>22</sup> që më vonë u zëvendësua me prodhimin vendas, revolverin “Beaumont-Adams” të huazuar nga kontingjenti ushtarak, armë me mjaft avantazh e lehtësi në përdorim, që arrinte të gjuante deri 450 fishekë, të mjaftueshëm për operacione të posaçme policore që rrezikonin jetë. Vonë edhe këto u zëvendësuan me tipin e përparuar “Bulldog”. Rregulli fillestar ishte që armët e zjarrit nuk mbaheshin me vete përditë, por më pas u lanë në armaturat e Departamentit të policisë, por ky rregull ka ndryshuar në periudha të ndryshme, situatë e kohe.

Organizata e re e pilsave ishte e centralizuar, drejtohej nga një qendër dhe shpërndahej në tetë lokacione, të ndara dhe këto në katër njësi të komanduara prej saj, në territorin e Londrës e më pas në qarqe.

Rregullorja ishte mjaft e rreptë, por trajtimi material, sidomos rroga ishte e mirë. Orari i punës zgjaste 12 orë, 6 ditë në javë, me të dielën një ditë pushimi. Pilsat nuk duhet ta hiqnin uniformën edhe pas orarit të punës, duhet të ishin në çdo moment të gatshëm. Një oficeri nuk i lejohej të shoqërohej me civil, por e kishte për detyrë të ndante një vakt me ta. Paga shkonte £.1.05 guine<sup>23</sup>, (rrogë shumë e mirë në atë kohë). Çdo anëtar i pilsave duhej të merrte leje para se të martohej, i ndalohej të merrte pjesë në zgjedhje e nuk i falej asnjë sjellje e parregullt apo shkelje në punë ose në kohën e lirë.

Në fazën e parë, nga rreth një mijë, edhe pse ishin kryesisht nga Torët, u përjashtuan mbi gjysma brenda vitit, për gjëra të natyrës shkelje disipline, dehje, rrahje, dhunë, shkuarje me prostituta, korrupsion, mitmarrje etj.

Në tetë vite u shkarkuan rreth pesë mijë pilsa. Gjashtëmijë dhanë dorëheqjen. Askush nuk i shpëtonte syrit të rreptë të kryekomisionerit të Policisë Metropolitane, kolonellejtënant Sir Çarls Rouan, me një përvojë shumë të gjatë ushtarake dhe, kryepolicit Richard Mejn. Masat e rrepta për zbatimin e rregullores, bënë që të rritej disiplina dhe të ndiheshin frytet e para të punës. Domethënëse ishte edhe mënyra e re në vendosjen e gradave. Tradita ushtarake dhe në përgjithësi përvoja kontinentale, sidomos periudha napoloniane, gradimin e shihte si një shpërblesë që vinte nga lartë, për cilindo, që nga ushtar apo *constable* në polici e deri rangjet e tjera të oficerëve. Kjo vendosej nga eprorët më të lartë, që i jepnin ato me dëshirën e tyre. Për “bobbs”-at filloi për herë të parë një metodë e re. Gradat fitoheshin në bazë të shërbimit e meritave, fillonin nga poshtë lartë, pra secili mund të merrte gradën sipas kriterëve duke filluar nga grada më e ulët, mbi bazën e karrierës e jo sipas dëshirës së ndonjë eprori. Në hierarkinë e gradave vetëm grada e rreshterit mbeti si titull njëlloj si në ushtrinë. Të tjerat u riemëruan ndryshe nga gradat ushtarake.

<sup>21</sup> Pseudonimet “bobbyes” (bobs) dhe “Peels” (Piils) nënkuptojnë oficerët e policisë në atë kohë dhe në këtë shkrim do përdoren analoge, me termin polic. Përdoret edhe “constable” që d.m.th. “polic i thjeshtë”

<sup>22</sup> Tip pistolette e thjeshtë, personale, me çark, nga 6 inches (15 cm) deri 20 inches (51 cm) e gjatë.

<sup>23</sup> Guine ishte një monedhë sa një e katërta e ons ari në Britaninë e Madhe midis 1663 dhe 1814.



Përkushtimi i Sir R. Peelit, ishte aq i madh tek forca policore që krijoi sipas ideve të tij dhe të pandara nga përvoja e dy shokëve të vet, sa që ngjalli tek ai, përveç besimit edhe ndjenjën e përgjegjësisë para kombit anglez, shtetit, e qytetarëve të vet. Prandaj shpjegohet, se “me” apo “pa” kërkesën e tij, forca policore Metropolitane që ideoi e krijoi, mori emrin e mbiemrin tij, Bobby-s dhe Peels, nofkë e mbetur deri në ditët tona.

#### 4. Parimet e policimit “pilian”

Gjithçka që shoqëron aktin e krijimit të forcës Metropolitan nga R. Peel dhe bashkëpunëtorët më të ngushtë të tij, reflekton përkujdes të veçantë në çdo vendim, ndryshim, reformim, shpreh një botëkuptim të ri për forcën policore, ecën sipas një linje, atë që do përvijonte më pas idenë e madhe të policimit, e cila më qartë shprehet në nëntë parimet e policisë “pilianë”. Këto parime, kanë mbetur deri më sot parime bazë të ndërtimit e funksionimit të mbarë policisë profesioniste moderne, e cila është zhvilluar e vazhdon të bëjë reformime progresive në këtë rrugë të ideuar nga Sir R. Peel.

Sigurisht që idetë e policimit të shprehura nga R. Peel në vitet 30-40 të shek. 19-të, janë thëlluar, konkretizuar mbi bazën e kushteve të reja e ndryshimeve sociale. Studimet, botimet, idetë rreth kësaj fushe që hapi Peel, sot janë zhvilluar kaq shumë, sa sot mbulohen me lëndë të veçanta të kolegjeve e akademive policore, në universitetet e shkollat e larta ku përgatiten e edukohen profesionistë policie.

Shpesh herë nëntë parimet e hartuara nga Peel, kodifikohen thjesht si parime etike, pra si disa rregulla të sjelljes së policisë në publik e jo si parime bazike të ndërtimit të një policie profesioniste publike. Ky ambiguitet<sup>24</sup> ka dhe një bazë faktike, që në origjinë, në rregulloret e bobbs-ve, ato emërtohen si të tilla.

Prej këtej zë fill një debat, rreth rolit të R. Peel e autorësisë së hartimit të këtyre parimeve.

Ka disa studiues<sup>25</sup> të veprës së Sir R. Peel, që sjellin idenë, se këto parime janë formuluar nga dy komisionerët, bashkëpunëtorë të Peel-it: nga Ç. Rouan dhe R. Mejn. Ky pohim i mbrojtur nga historiani e aktualisht kryepolic i Departamentit të Los Anxhelosit, W. Bratton, bazohet në mungesën e një dorëshkrimi personal të parimeve nga dora e R. Peel, përpos faktit që ato shkruhen në rregulloret e MET. Prej këtej, ndoshta lind dyshimi se mund të jenë hartuar nga dora e bashkëpunëtorëve të Peel. Prej këtij pohimi të pavërtetuar, parimet mund të konsiderohen më tepër si kode rregulloreje të Policisë Metropolitane, të cilat kanë edhe karakter etik, si çdo rregullore apo ligj. Kjo mbetet hipotezë, por sido që të jetë, e vërtetë ose jo, pohimi i Brattonit nuk mund të anashkalojë rolin kryesor të Robert Peel-it, nisur nga këto argumente (sipas autorit të këtij shkrimi):

*Së pari*, parimet e policisë “pilianë”, nuk përmbajnë në formë e në përmbajtje rregulla detyruese, si nenet e një rregulloreje, në formë urdhëruese, deontike<sup>26</sup> - siç na mëson logjika. Ato më së pari, janë pohime themelore të përgjithshme, për gjithë organizatat e policisë, janë rrugëtim drejt përsosjes, orientim drejt së ardhmes, ato kanë një përmbajtje të thellë analitike, më tepër janë një filozofi e policisë.

<sup>24</sup> Dykuptimësi rreth këtij termi, që është objekt studimi i disa disiplinave shkencore, sociale e policore.

<sup>25</sup> Sipas William Bratton, (deri 2017, komisioner e komisar policie i Boston, Newjork, Los Anxhelos etj. Nën drejtimin e tij u reduktuan krimet e dhunshme. Ndjek parimin e policimit të “dritareve të thyera” në policimin në komunitet, sipas së cilës krimet e mëdha lindin nga devijancat e vogla që s’duhen toleruar, të cilat sinjalizohen nga vet publiku). Në të njëjtën linjë janë historianët: Susan Lentz dhe Robert Chaires.

<sup>26</sup> Sipas Logiikws, gjykimet deontikë janë kategorik, ose urdhërues, përdoren në hartimin e ligjeve, rregulloreve.

**Sinjari, S.**  
« Sër  
Robert Pil,  
krijues i policisë  
moderne »

Policimi  
dhe  
Siguria  
**nr.7, 2017**

Së dyti, a mund të formuloheshin parimet kaq me korrektësi e thellësi, pa venë në to dorë një person me arsimim e përvojë, legjislator e reformator i qindra ligjeve në MB, politikan i spikatur, drejtuesi kryesor i punës për formulimin e Aktit Themelor të MET?!

Së treti, e përforcoj këtë mendim edhe me një arsyetim tjetër rreth Sir Robert Peel-it. Kur lexuesi njihet me kontributin e tij në ndryshimet e kodit të vjetër anglez, civil, penal, të punës, të drejtave të burgosurve etj., kupton ndikimin e ideve të reja mbi të. Idetë e reja liberale, për një shoqëri më të mirë, po rrënjoseshin në elitën intelektuale angleze dhe europiane. Mendimtarët anglez themelues të ideve të reja si, J. S. Mill, J. Bentham<sup>27</sup> në filozofi e jurisprudencë, A. Smith, D. Rikardo, në ekonomi e plot figura të tjera, ndikuan në karakterin e botëkuptimit e tij. Këto ide përshkojnë parimet e policisë, përshkruhen nga e njëjta frymë që po lindte, fryma e re e neoliberalizmit.

Parimet “pilianë” të policimit mund t’i gjejmë pothuaj në të gjitha rregulloret e Policisë së vendeve. Në vetvehte ato shprehin themelet e ndërtimit e funksionimit të organizatës së policisë profesioniste, në shtet e shoqëri.

Të gjitha parimet konvergojnë e kanë një ide të përbashkët, që i shoqëron, nga i pari tek i fundit, pavarësisht nga numri nëntë apo më shumë. Kjo është ideja e policimit. E shprehur më gjerë, policimi është një model ideal i policisë, një synim i përhershëm i saj për t’u afruar pafundësisht me publikun. Policimi synon që punonjësit e policisë të jenë *si qytetarë në uniformë*<sup>28</sup>, të cilët kërkojnë nga bashkëqytetarët pëlqimin e legjitimitetit për ushtrimin e kompetencave të tyre. Policimi në sytë e publikut kërkon një konsensus të përgjithshëm të mbështetjes për integritetin dhe përgjegjësinë e tyre për ta bërë këtë.

Në parimet e policisë “pilianë” vend parësor zë parandalimi i krimit dhe çrregullimeve, që vlerësohet si mision kryesor i organizatës së policisë. Ky parim që në kohën tonë është më i njohuri, duket më i thjeshti midis drejtimeve të policimit si proces. Atëherë kur u shkrua, nuk njihet as si koncept, as si detyrë parësore. Në thelb, ky parim modelon një strategji të re të luftës kundër krimit, që në themel ka bashkëpunimin e komunitetit dhe policisë për arritjen e qëllimit, ndryshe nga vija e ashpër e jurisprudencës klasike, e cila kufizimin e krimit e trajtonte në përpjesëtim të zhdrejtë me shkallën e ashpërsisë së dënimit ndaj subjektit. Dënimi, për cilindo, dikur ishte një “vulë” e pashlyeshme gjithë jetën, një mënjanim i pakthyesëm i individit të dënuar në shoqëri.

Policimi, në idetë e parimet e reja “kiliane”, nuk e sheh të drejtën e shtrëngimit e përdorimit e dhunës nga Policia si mjetin e vetëm e kryesor ndaj kriminelëve, por si mjetin e fundit mbasi janë konsumuar metodat e tjera. Kjo strategji e re, shprehet mjaft në parimin e 6-të, ku thuhet qartë: *“Policia përdor forcën fizike në masën e nevojshme për të siguruar respektimin e ligjit ose për të rivendosur rendin vetëm kur ushtrimi i bindjes, këshillimit dhe paralajmërimit është i pamjaftueshëm”*<sup>29</sup>. Kjo tendencë e zbutjes së përdorimit të forcës është e dukshme në mjaft aspekte e veprime në policinë e sotme, kur policimi gjen më tepër hapësirë publike. Janë disa tregues që i bëjnë të dukshme progresin e policisë sot, heqja e armëve të zjarrit në shërbimin e përditshëm (me përjashtimet e shprehura në rregullore); polici profesionist sot ka orar pune si gjithë

Sinjari, S.

☛ Sër  
Robert Pil,  
krijues i policisë  
moderne

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr. 7, 2017

<sup>27</sup> Jeremy Bentham (1748 - 1832) ishte një filozof reformator politik radikal dhe ligjor dhe social i periudhës së hershme moderne. Ai njihet më së miri si themeluesi i utilitarizmit, të cilin e shihte si parimi bazë moral në të cilin duhet të bazohen reformat e tij ligjore dhe sociale.

J. S. Mill (1806-1873) utilitarist-nxënës e vazhdues i Benthamit, filozof, politikan, ekonomist.

Adam Smith (1723-1790) themelues ekonomisë klasike të tregut. David Rikardo (1772-1823), pasues i tij.

<sup>28</sup> Parimi 3: “Policia duhet të sigurojë bashkëpunimin e gatshëm të publikut në respektimin vullnetar të ligjit për të qenë në gjendje të sigurojë dhe të ruajë respektin e publikut”.

<sup>29</sup> J. S. Dempsey, L. S. Forst, *An Introduction Policing*, Boston 2016, f. 9

punonjësit e administratës publike; veshja e uniformës vetëm brenda orarit të punës; ngjyra e uniformës ka tendencë të jetë sa më e hapët, si civile, deri në këmishë të bardhë krahëshkurtër; shkopi i policit është më simbolik se kurrë dhe mbahet në shërbime caktuara; përdorimi i panevojshëm i dhunës është i dënueshëm; komuniteti dhe policia edukohen që të bashkëveprojnë në arritjen e qëllimit të përbashkët, sipas parimit 7, “publiku është policia dhe policia është publiku...”.

Parimet e Policisë Metropolitane kanë vlerë përtej një organizate policie, si ajo e Londrës, kur u hartuan dhe për më tepër, tejkalojnë një përmbajtje të thjeshtë rregulloreje. Është e nevojshme të shihet pak më gjerë rreth kontributit të Sir Robert Peelit, si reformator, legjislator e politikan, në funksion të arritjes së sigurisë publike dhe detyrat e policisë.

## 5. Sër Pil - përtej Policisë Metropolitane

Tek personaliteti i Robert Peel dukshëm bie në sy karakteri shumëdimensional i formimit dhe veprimtarisë së tij. Si politikan, udhëhoqi e reformoi Partinë Konservatore; si parlamentar hartoi e votoi shumë ligje; si drejtues kabineti qeveritar, ndërmoi shumë nisma e ndryshime ligjore në periudha të vështira, për probleme ekonomike e deri për të drejtat e regjimin e të burgosurve, për përmirësimin e jetës së njerëzve. Tek Sir Roberti gjithmonë spikaste dëshira për të bërë punë të mira në dobi e kombit të vet. Ai, në punën e vet vuri gjithmonë në plan të parë ato interesa, të njerëzve, mbi ato personale si karrierën politike, ngjyrën fetare etj. Megjithatë përshkruhet si njeri i ftohtë, jo shumë i afërt e komunikues, kjo nuk do të thotë se ishte i keq. Kjo duket në qëndrimin këmbëngulës që ai mbajti në periudhën më të vështirë të krizës së urisë, në 1846, që erdhi nga Irlanda - kriza e patateve. Si kryeministër ndërmoi një iniciativë ligjore aq të guximshme, sa edhe përfundimtare të karrierës politike. Me qëllim që të zbutej kriza e urisë, duhej hequr ligji proteksionist<sup>30</sup> i çmimit të misrit. Nga kjo masë prekeshin shumë fermerë e pronarë të mëdhenj vendas, të cilët e mbanin çmimin të lartë për shkak të favorizimit proteksionist të vendosur kohë më parë, që vinte barrierë importit me çmim më të ulët nga jashtë të misrit. Me shumë vështirësi ligji u abrogua nga Parlamenti. Çmimi i misrit shkoi në normale, por kjo sakrificë pati një çmim tepër të lartë për Robertin kryeministër e për jetën e tij politike. Këtë mund ta bënte vetëm një karakter i mirë dhe i fortë. Duke zhvleftësuar ligjin e çmimit të misrit në Parlament, ai u detyrua të jepte dorëheqjen dhe të humbte në zgjedhje. Prandaj, për politikën, me të drejtë shkroi vetëm një fjali: “*Më duket se ka shumë pak fakte, të paktën fakte të vërtetueshme, në politikë*”.

Përkujdesja për policët e rinj të forcës metropolitane, nuk vinte nga ndonjë favorizim që u bëhej policëve të tij. Vlerësimi i njerëzve dhe punës së tyre ishte në botëkuptimin e tij. Një punë e vështirë e me sakrificë, siç është puna e policit që ndeshet çdo ditë me çrregullime e krime, kërkonte edhe një trajtim të mirë, të dallueshëm nga profesionet e tjerë. Prandaj, ai për herë të parë në histori e bëri shërbimin policor të organizuar, të centralizuar dhe një profesion të veçantë publik, të njohur dhe të paguar me rrogë nga shteti.

<sup>30</sup> Proteksionizmi, është një politikë shtetërore e merkantilizmit ekonomik, që vendos çmime e taksë të larta doganore për disa mallrat nga importi, me synimin të mbrojnë prodhimin vendas. Ndiqet rrallë nga disa shtete edhe sot.

Sinjari, S.  
« Sër  
Robert Pil,  
krijues i policisë  
moderne »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

Tradita angleze njihet deri atëherë, disa forma të shpërndara organizimi të ruajtësve të qetësisë, vullnetare ose me pagesë, që angazhoheshin në mbrojtjen e banorëve nga krimi e kriminelët. Prej kohe kishin bërë organizim vetëmbrojtës banorët ose familjet, pra vet komuniteti merrte në dorë mbrojtjen e vet nga krimi. Mund të kishte *constable* të caktuar nga Mbreti; kishte vullnetar që mund të kishin kryer ndonjë krim dhe kërkonin t'u falej kundrejt këtij shërbimi, të kapnin grabitës apo vrasës - disa prej tyre paguheshin si "thief-takers" e "bow street runners". Përveç formave që kemi përmendur më sipër këtij shkrimi, mund të përmendim p.sh., në Angli, disa modele mbrojtëse klasike: "*Mutual Pledge*"<sup>31</sup> - "garanci e dyanshme" që në shek 9; një tjetër model ishte "*yell for help*" - bërtas për ndihmë; "*Shire-reeve*" - mbikëqyrës i kontesë ose *watchmen* etj. Aftësia e Robert Peel konsiston, në atë se nga të gjitha traditat dhe eksperiencat e deriatëhershme, arriti në një model origjinal policimi, që ndërthurte publikun e policinë në një synim të përbashkët, qetësinë e sigurinë publike. Modeli i Peel njihet si "*Beat System*"<sup>32</sup> - sistemi i përzier, i krijuar nga Peel për MET<sup>32</sup>.

Modelet e mësipërme angleze, të policimit të hershëm, janë interesante e me vlera studimi, që të lë të kuptosh se ideja e madhe e një policie ndryshe, ideja moderne e policimit, afrimit e lidhjes së ngushtë të policisë me publikun, kjo ide e madhe që ka pushtuar sot gjithë policitë e botës së qytetëruar, nuk mund të lindte dokudo, por vetëm në një vend si Anglia dhe po ashtu të lë të besosh se një gjë e tillë mund të bëhej realitet, vetëm nga një mendimtar me vullnet të papërkulur siç ishte Sir Robert Peel.

## 6. Përfundime

Përvoja angleze është shumë e gjerë në shumë fusha të zhvillimit, në ekonomi, me ekonominë e tregut, në ndërtimin e funksionimin e shtetit dhe demokracisë, në arritjet e mëdha të shkencës e teknologjisë, etj.

Anglia me kontributin e R. Peel-it në polici dhe mjaft të tjerëve në fushën e së drejtës, ndikoi drejtpërdrejt në kontinentin europian dhe sidomos në atë amerikan<sup>33</sup>.

Për këtë mund të themi se ... "sistemi amerikan i drejtësisë dhe ligjet penale u huazuan nga eksperiencia e policisë angleze, e cila është e pasur dhe e lidhur ngushtë me zhvillimin e kësaj shoqërisë"<sup>34</sup>.

Një organizatë e mirë policie, si shembulli i Policisë Metropolitane nuk u arrit për një kohë të shkurtër. Ajo lindi mbi tabanin e një tradite, kulture dhe disipline, e drejtuar nga njerëz të cilëve përveç dëshirës, nuk iu mungonte as vullneti i mirë. Peel e filloi punën për krijimin e forcës së "peels"-ave me tre profesionistë: njeri që vinte nga radhët e armatave ushtarake dhe dy të tjerë, me përvojë policore. Midis tyre, të tërheq vëmendjen Eugène Francois Vidocq, një ish-ushtar francez, me të shkuar ish i dënuar<sup>35</sup>, i cili themeloi agjencinë e parë private të zbulimit dhe punësonte ish-të dënuar. Vidok është i njohur,

Sinjari, S.

« Sër Robert Pil, krijues i policisë moderne »

Policimi dhe Siguria

nr. 7, 2017

<sup>31</sup> "Mutual pledge", garanci e ndërsjellët; grupe qytetarësh (familjesh) që grupoheshin në mbrojtje të njëra tjetres nga kriminelët. Kur arrinin 100 drejtoreshin nga një polic ose *constable*, i cili paguhej nga Mbreti; "yell for help", thirrje ndihme nga anëtarët e tjerë të komunitetit; "*Shire-reeve*", zyrtari i hershëm anglez i ngarkuar me qarqet që janë pjesë e sistemit të garancisë të ndërsjellët që ka evoluar në konceptin modern të sherifit.

<sup>32</sup> "Beat System", në të cilën zyrtarët e policisë caktoheshin në një post relativisht të ulët dhe të përhershëm dhe pritej të bëheshin familjarë me njerëzit që banonin atje, duke u bërë pjesë të jetës së fqinjësisë; kjo ishte e ndryshme nga patrullimi i policisë së Parisit, që konsiston në mbikëqyrjen e periodike të zonave, gjë që nuk ofron familjaritet midis politikës dhe publikut.

<sup>33</sup> Në SHBA reformat në modernizimin e Policisë amerikane i filloi dhe e drejtoi A. Wollmer (shih: Sinjari, S. dhe Sofokli Duka (post mortem). "August Uollmer - "babai" policisë amerikane", në *Policia dhe Siguria*, nr. 2, 2015 (8-20). Tiranë: Akademia e Sigurisë kryesisht nëpërmjet arsimit policor.

<sup>34</sup> J. S. Dempsey, L. S. Forst, *An Introduction Policing*, Boston 2016, f. 4.

në fushën e teknikave të pyetjeve, të kriminologjisë e balistikës në hetimin penal. Ai bëri i pari kopjen e gjurmëve të këpucëve, krijoi bojë të pashlyeshme, letra të pakopjueshme të bonove. Modeli i tij e antropometrisë është ende pjesërisht e përdorur nga policia franceze.

Peel e përzgjedhi Vidokun si këshilltar duke përfitur nga aftësitë e tij të pazakonshme dhe përvoja policore franceze, që padyshim ishte mjaft e përparuar në atë kohë.

Disiplina, sidomos në ambientin e traditën angleze, ishte ndoshta kriteri kryesor i pranimit në organizatën policore të *pilsave*. Kjo disiplinë nuk mund të vinte menjëherë, sepse edhe përzgjedhjet mijëshe së parë, (për të cilët kryeministri siguroi fondin e pagave menjëherë në buxhet) hasi disa vështirësi. Në të hynë edhe nga ata që ishin aktivizuar si “thief-takers”<sup>19</sup>, por jo të gjithë dolën të besueshëm, duke punuar në dy krahët, ose, duke mos pasur një edukim arsimor, vepronin sipas traditës - që në Angli ishte tipike, si ishte rasti i shiut në daljen e tyre ditën e parë në patrullim<sup>20</sup>. U desh afër një dekadë<sup>36</sup> që *pilsat* ose *bobsat* të shndërroheshin në një organizatë të rregullt, të disiplinuar dhe të simpatizuar nga publiku.

Si përfundim, nga prezantimi i çdo figure të shquar të policisë, del rëndësia e njohjes së kontributit të njerëzve më të shquar të kësaj policie që është arritur deri më sot. Njohja e ideve, veprave, vendimeve, botëkuptimit, formimit të tyre arsimor e kulturor, na ndihmon në thellimin e njohurive tona, të punonjësve të policisë, të studentëve të hetimit të krimit e sigurisë publike, të oficerëve e drejtuesve të policisë në çdo nivel. Personalitetet e mëdhenj të krijimit e modernizimit të policisë ndihmojnë cilindo drejtues, të piketojës rrugëtimin e kësaj organizate drejt së ardhmes, duke qëndruar gjithmonë fort, pa asnjë lëkundje në shinat e policimit, të cilat i vendosi për herë të parë në Londër, Sir Robert Peel.

## Bibliografi

1. Evans, Eric J., *Sir Robert Peel: statesmanship, power, and party*, London, New York: Routledge, 1991.
2. Gash, Norman, *Peel*, London; New York: Longman, 1976.
3. Gash, Norman, *Sir Robert Peel: the life of Sir Robert Peel after 1830*, London; New York: Longman, 1986.
4. Read, Donald, *Peel and the Victorians*, Oxford, UK; New York, NY, USA: B. Blackwell, 1987.
5. Dempsey, J. S., Forst, L. S., *An Introduction Policing*, Boston 2016.
6. *Manual Për Policimin në Komunitet*, SIPU-2015.
7. *Kodi Etik i Policisë së Shtetit*, ICITAP& MPB, 2015.
8. Zanaj, F., *Filozofia e së Drejtës*, Tiranë 2012.
9. Zanaj, F., *Sociologjia e së Drejtës*, Tiranë 2010.
10. Memaj, B., *Lidershipi në Policinë e Shtetit*, Tiranë: Kristalina, 2016.  
*Burime nga interneti:*
11. <https://www.nytimes.com/.../nyregion/sir-robert-peels-nine-principles...>
12. <https://www.gov.uk/government/history/past-prime-ministers/robert-peel-2nd-baronet>
14. John Ivatt Briscoe, *Robert Peel "A letter on the nature... Prison and Punishment" – 1824*, Free Library.
15. <http://content.met.police.uk/Article/The-Metropolitan-Police-how-it-all-began/>.
16. [johnsonfund.org/robert-peel-religions-emerging-role/](http://johnsonfund.org/robert-peel-religions-emerging-role/).
17. <http://www.ucl.ac.uk/scs/degree-programmes/undergraduate?gclid=CMGK09yYswkCFaTnCGodCNëM2Q>
18. <http://biography.yourdictionary.com/sir-robert-peel#j5AFtu3hd7TLWWdU.99>.

<sup>35</sup> Eugène-François Vidocq , (1775 -1857) - ishte një aventurier francez, delikuent, i dënua pastaj polic dhe më në fund detektiv privat. Simpatizohej në publik edhe për filantropi; kurrë nuk informoi për këdo që kishte vjedhur për nevoja reale. Sot rreth tij shkruhet shumë, e vlerësojnë si detektiv i madh, mbret i oficerëve të policisë etj.

<sup>36</sup> Sipas shkrimeve të HMP periudha 1829 deri 1985 njihet si periudha e shkëlqimit të “bobbs”-ave si një simbol i ruajtjes së paqes sociale e sigurisë publike të Londrës. Aq shumë duheshin nga publiku bobsat (=pilsat) sa nga viti 1829 deri 1985 u shënuan vetëm dy raste vrasje policësh në Londër. Ishte e paimagjinueshme të prekje Bobbs-in; konsideroheshin të paprekshëm - mit që u thye në ngjarjet e 1985 në Londër.

**Sinjari, S.**

« Sër Robert Pil, krijues i policisë moderne »

Policimi dhe Siguria  
**nr.7, 2017**

# Krimet virtuale psikologjike: rasti “balena blu”



■ **MSc. Anisa AGASTRA**  
Akademia e Sigurisë

## Abstrakt

*Shoqëritë moderne po preken gjithnjë e më shumë nga problematikat që lidhen me boshllëqet emocionale, shpirtërore e psikologjike që tejçohen me anë të manipulimeve në rrugë virtuale. Këto janë materializuar me anë të formave të ndryshme të krimit në linjë apo krimit kibernetik, siç është rasti i lojës sfiduese vetëvrasëse “balena blu”. Fokusi i këtij punimi është analiza psikologjike e funksionimit të lojës “balena blu”, qëllimit të saj, mënyrën si shënjon viktimat dhe se si u përhap tre-katër vitet e fundit në rang botëror, ashtu sikundër edhe në Shqipëri. Analiza realizohet me anë të paralelizmave e sintezave logjike me përhapjen e krimit kibernetik; fuqizimin e komunikimit në linjë, duke marrë parasysh të mirat e të metat e këtij komunikimi; terrorizmin dhe format e krimeve terroriste me fokus arsyet e shfaqjes së këtyre krimeve, si dhe elementë nga psikologjia e terrorizmit e cila lidhet me rastin e fenomenit shqetësues “balena blu”.*

*Kjo lojë ka për qëllim të shënjojë të rinjtë e t'i çojë ata drejt vetëvrasjes duke ndjekur pesëdhjetë stade, që kulmojnë me këtë akt. Loja ka aftësi manipuluese tek të rinjtë, rëndon gjendjen e tyre psikoemocionale derisa i ndikon ato që të dëmtojnë veten, derisa të vrasin veten. Boshllëqet dhe ngarkesa psikoemocionale e atyre që krijuan lojën, materializohet në lojën e balenës blu, nga futja në shënjestër e deri te vetëvrasja. Kjo përbën shqetësim shoqëror që ka nevojë për vëmendje nga të gjithë institucionet e profesionistët, duke filluar nga familja, e më tutje.*

Agastra, A.  
« Krimet  
virtuale  
psikologjike:  
rasti “balena  
blu” »

## Fjalëkyçe:

**loja psikologjike “balena blu”, shënjestrim, vetëvrasje, të rinj, boshllëk emocional, krime kibernetike.**

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

## 1. Hyrje

Krimet kibernetike kanë pësuar një rritje vitet e fundit, si pasojë e zhvillimit të shpejtë të teknologjisë, internetit dhe komunikimit në linjë. Tendenca e digjitalizimit dhe përsosjes së teknologjisë, po na zhvendos drejt komunikimit gjithnjë e më të madh në rrugë virtuale. Përveç përfitimeve, kjo ekspozon shoqërinë përballë rreziqeve të reja, siç është dhe devijanca dhe kriminaliteti nëpërmjet virtuale. Projekti i shpërthimit të internetit në rang global është rrjedhojë e implementimit të projektit “World Wide Web” në maj 1991, që e shndërroi internetin në një medium lehtësisht të qasshëm për përdoruesin masiv, duke sjellë një popullarizim të shpejtë të tij<sup>1</sup>. Giddens besonte se kemi hyrë në epokën e postmodernitetit kurse Beck theksonte se vazhdojmë të jetojmë në shoqërinë moderne, por në një format të ri. Gjithsesi ata bien dakord në një pikë, se faza e mëparshme klasike e modernitetit u shoqërua me shoqërinë industriale, ndërsa lindja e modernitetit të ri dhe e teknologjisë së tij lidhet me shoqërinë e rrezikut<sup>2</sup>.

## 2. Një mënyrë e re vetëvrasjeje

Nga të dhënat e regjistruara, të qeverisë gjermane dhe shtypit të shkruar, rezultuan 82 649 raste të mashtrimeve kompjuterike, spiunazhit dhe krimeve të tjera kibernetike në 2016-ën, një rritje e frikshme me 80%, krahasuar me 2015-ën.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> Instituti Shqiptar i Medias, *Zhvillimi i internetit dhe i mediave sociale në Shqipëri* (Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias, 2015), 5.

<sup>2</sup> George Ritzer dhe Douglas J. Goodman, *Teoria Sociologjike* (Tiranë: Ufo University Press, 2008), 571.

<sup>3</sup> Marrë nga <http://pcworld.al/krimet-kibernetike-ne-gjermani-u-rriten-80-ne-2016-en>.

Në utopitë e fundit të shekullit të XX-të mbi përmbushjen e demokracisë universale, përfshihen tre ide-koncepte që kanë zanafillë që në vitet 1970: kontradikta ndërmjet mungesës së elasticitetit dhe aftësisë për të nxënë, ndërmjet sekretit të informacionit dhe transparencës dhe ndërmjet njohurive të mbetura stok dhe qarkullimit të informacionit<sup>4</sup>.

“Çmenduria vrasëse në linjë” apo fenomeni “balena blu” kanë tërhequr vëmendjen mediatike e shoqërore për shkak të nivelit të përhapjes dhe mbi të gjitha, viktimave të futura në shënjestër. Loja e rrezikshme, e cila nxit kryesisht fëmijë e adoleshentë që të dëmtojnë e të vrasin veten, preku së fundmi edhe shqiptarët. Kronikat në median në linjë, atë vizuale apo atë të shkruar, tregojnë rastet e vetëvrasjes së rreth 140 të rinjve jashtë Shqipërisë dhe të disa të tjerëve brenda vendit. Lajme të tilla, u bënë të bujshme dhe sa më shumë kronika e raste të shfaqeshin, aq më shumë dilnin në pah raste e shqetësime të reja.

Sipas të dhënave zyrtare në Rusi, viktima e parë nga loja vetëvrasëse u shënuar në vitin 2013 dhe në vitin 2016 ishin regjistruar afro 130 viktima të tjera<sup>5</sup>.

Filozofia e lojës së rrezikshme bazohet në dy elementë kryesorë, që lidhen me futjen në shënjestër e gjetjen e viktimave dhe parapërgatitjen psikologjike të tyre për të hyrë në rrethin vicioz të lojës. Më tej, fazat dhe rregullat e lojës e manipulojnë psikologjikisht, duke e çuar personin drejt vetëfljimit. Fakti që shenjestrat janë fëmijë apo adoleshentë, e bën akoma më të prekshme dhe e vendos në qendër të vëmendjes fenomenin “balena blu”. Kronikat e rasteve tregojnë mënyra se si ‘loja’ bën për vete dhe tërheq vëmendjen e personit. Kjo lojë virtuale shfaqet në formën e aplikacionit që mund të shkarkohet në celular apo administratorët e saj, nën pseudonimin “Balena blu”, shkruajnë në *inbox*-et e adresave personale të personave që fusin në shënjestër. Në disa raste është realizuar përzgjedhje selektive e në raste të tjera, jo.

Kjo lojë ka çuar drejt vetëvrasjes rreth 157 fëmijë në Rusi, në Britani dhe së fundmi në Greqi<sup>6</sup>. Krerë të policisë britanike deklaruan se kushdo që ka krijuar këtë lojë është një “mendje e sëmure”. Fillimisht u dyshua se administrator i lojës ishte 26 vjeçari rus, Ilya Sidorov, i cili kishte udhëzuar një 13-vjeçare të hidhej përpara një treni pasagjerësh<sup>7</sup>. Nga hetimet e mëtejshme, u zbulua se i riu në fjalë administronte një grup të ashtuquajtur “vetëvrasës”, që kishte 32 anëtarë, - të gjithë të mitur, që u caktonte detyra të plagosnin veten e tyre për të nxitur vetëvrasje<sup>8</sup>.

### 3. Krimet kibernetike dhe shenjestrat e tyre

Krimet kibernetike apo krimet nëpërmjet kompjuterit janë aktivitete kriminale që realizohen nëpërmjet kompjuterit dhe rrjeteve në linjë dhe janë të rrezikshme, pasi kanë mundësi të zgjerohen me shpejtësi, si pasojë e intensitetit të lartë dhe shpejtësisë së lëvizjes së internetit e teknologjisë dhe elementit të anonimitetit të dukshëm, që vështirëson zbulimin e veprave të tilla. Nga eksperiencia dhe praktika në këtë fushë, krime të tilla kanë zanafillë të brendshme dhe realizohen nga persona të pakënaqur e të papërmbushur;

Agastra, A.  
« Krimet  
virtuale  
psikologjike:  
rasti “balena  
blu” »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

<sup>4</sup> Instituti Shqiptar i Medias, *Zhvillimi i internetit dhe i mediave sociale në Shqipëri* (Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias, 2015), 318.

<sup>5</sup> Për më tepër shih <http://www.newsweek.com/what-blue-whale-game-russia-suicides-637798>.

<sup>6</sup> Për më tepër, shih: <http://www.dritare.net/2017/05/23/sfida-e-balenes-blu-loja-vetevrasese-mberrin-tek-nje-femije-shqiptar/1>.

<sup>7</sup> Për më tepër, shih: <http://fax.al/read/news/10329857/15085940/balena-blu-mendja-e-semure-ruse-qe-shpiku-lojen>.

<sup>8</sup> Për më tepër, shih: <http://fax.al/read/news/10329857/15086463/arrestohet-nje-administrator-i-lojes-balena-blu>.



nga persona që mund të vuajnë nga çrregullime në sjellje e deri në sëmundje mendore; nga persona që janë të prirë për të përfituruar; nga persona që luftojnë për ideale të veçanta dhe sakrifikojnë gjithçka për të; nga persona që kanë prirje për agresivitet e tendenca armiqësore, e të tjera motivacione<sup>9</sup>. Nga ana tjetër, këto krime, kanë tendencën për të futur në shënjestër apo për të goditur viktimat më të dobëta e më të papërgatitura, që përbëjnë edhe shënjestrat më tërheqëse.

Këto krime zhvillohen nga format e reja të komunikimit në ditët e sotme. Teknologjitë e komunikimit sot, thuhet se i kanë virtualizuar distancat materiale mes njerëzve dhe, i kanë asgjësuar dimensionet materiale bazike, si koha dhe hapësira materiale<sup>10</sup>.

“Balën blu” e krijuan të rinj nga Rusia, ndër të cilët disa janë zbuluar e të tjerë pritet të zbulohen. Balena është kafshë e vetmuar, e padëmshme për të tjerët por e prirë për të qëndruar vetëm dhe që ka nevojë herë pas here, që të qëndrojë në ujë dhe të dalë nga uji pasi e ka të nevojshme frymëmarrjen. Në qoftë se rri në ujë apo në ajër për shumë kohë ajo mund të vdesë. Balena është zgjedhur me qëllim nga ata që kanë ideuar lojë. Kjo formë e krimit në linjë është e pasur me simbolika direkte apo indirekte, deri në mënyrën se si arrihet të përfshihen personat në lëmin e lojës. Ka mundësi që ata që ideuan lojën të kenë pasur probleme me vetminë, me mënyrën si janë rritur, me sjelljen e me personalitetin e tyre dhe këtë e reflektojnë me krijimin e lojës dhe rregullave të saj.

#### 4. Humbja e vetëkontrollit si tregues i problemeve të gjera shoqërore

Loja është e aksesueshme për të gjithë dhe “balena blu” herë përzgjidhte e herë nuk përzgjidhte personat, por ajo që është për t’u theksuar është se “ajo” ngulmon dhe kërcënon duke bërë presion për përfshirje në vorbullën e saj. *Në momentin që përfshihesh në rrethin e balenës, është vështirë të shkëputesh* – kanë thënë në deklaratat e tyre fëmijë e adoleshentë që kanë rënë pre e saj, por ia kanë dalë të shkëputen. Presionet e kërcënimit janë të shpeshta dhe balena virtuale këmbëngul për të futur në rrethin e vet, të gjithë ata me të cilët kontakton<sup>11</sup>. Për këtë janë evidentuar shumë prova faktike të sms-ve e bisedave të rasteve konkrete, që kanë rënë në kontakt me të ashtuquajturën “balena blu”. Ka pasur raste, kur fëmijët apo adoleshentët kanë kundërshtuar, ofenduar apo tallur balenën ndërkohë që kjo e fundit vazhdonte të këmbëngulte.

Kur bëhesh pjesë e një grupi, pavarësisht nga arsyet e motivimet, ka mundësi për deindividualizim. Në këto rrethana individi humb apo zhvendos identitetin personal, humb vetëkontrollin, prirët të jetë më shumë emotiv e agresiv dhe është i gatshëm të shkatërrojë<sup>12</sup>. Duke u identifikuar me grupin, ruan anonimitetin dhe kjo nxit sjelljen kriminale, në trajtën e një rrjeti kriminal në linjë dhe e bën këtë formë të krimit, tendencë, për kohën në të cilën jetojmë.

Një studiuese dhe shkrimtare ruse, Yekaterina Sinelschikova, përgjatë një shkrimi analitik për “balenën blu” thekson se: “Kërcënimi i dukshëm është i vendosur mirë: normat tragjike të vetëvrasjeve në vendet që luftojnë pas rënies së Bashkimit Sovjetik,

<sup>9</sup> Për më tepër, shih: Edmond Dragoti, *Psikologjia Ligjore e Krimit* (Tiranë: Shtypshkronja Dajti, 2000), 220-225.

<sup>10</sup> Artan Fuga, *Komunikimi në shoqërinë masive* (Tiranë: Papyrus, 2014), 22.

<sup>11</sup> Për më tepër, shih: <http://www.gazetatema.net/2017/06/14/si-u-be-gjirokastritja-pre-e-balenes-blu-alarimi-shume-femije-e-luajne-dhe>, <http://www.javanews.al/rrrefimi-trondites-i-vajzes-nga-gjirokastra-qe-ra-viktme-e-balenes-blu>.

<sup>12</sup> Për më tepër, shih: Edmond Dragoti, *Psikologjia Ligjore e Krimit* (Tiranë: Shtypshkronja Dajti, 2000), 220.

**Agastra, A.**

« Krimet virtuale virtuale psikologjike: rasti “balena blu” »

Policimi dhe Siguria  
**nr.7, 2017**

janë rezultat i sëmundjeve shumë më të gjera shoqërore<sup>13</sup>. Shkaku shihet te shpërbërja e moralit të dikurshëm të familjes dhe stresit në të cilin kjo e fundit është e përfshirë. Kur ka përçarje të grupit është shumë e thjeshtë që forcat e jashtme të ndikojnë negativisht në të, në mënyrë të shpejtë e të vrullshme. Mundësia e manipulimit të elementëve të grupit është më e madhe si pasojë e tranzicionit të vlerave apo të asaj që sociologu Durkheim e quan “gëndje anomie”<sup>14</sup>.

## 5. Tiparet dhe arsyet, e atyre që i krijojnë këto lojëra

Përçarja, tranzicioni, kaosi sjellin çrregullime mbi të gjitha morale, psikologjike e shpirtërore. Kjo ndikon në krijimin e qenieve njerëzore me probleme me shëndetin e tyre mendor, si në rastin e krijuesve të lojës dhe krijimin e njerëzve të tjerë, të brishtë emocionalisht e shpirtërisht, si në rastin e viktimave të reja të lojës. Kjo vë alarmin për rrezikshmërinë që i paraqitet shoqërisë së sotme, e cila manifestohet me anë të problemeve të gjithanshme që po përjeton dhe, te rreziku i embrionit të saj, fëmijëve dhe të rriturve. Fenomene si, dhuna, elementët agresivë në televizione, krimet e rrezikshme e seksuale, divorcet, rritja e përdorimit të internetit dhe rrjeteve sociale, sfidat e krimeve kibernetike, problematika e sëmundjeve mendore ndikojnë në shëndetin dhe në jetën e të rinjve të sotëm dhe në sfidat e reja me të cilat ata përballen.

Kjo kërkon nga të gjithë profesionistët vëmendje, mbështetje dhe ndihmë për shoqërinë, kërkon rimodelim dhe rikonceptim të parimeve morale, normave, strukturave, institucioneve, rregullave, ndërgjegjes kolektive në mënyrë që ndërgjegjësimi e parandalimi i më të keqes të jetë sa më efektiv. Arsyet që nxisin ideimin e këtyre lojërave virtuale, mund të jenë të shumta dhe lidhen me trauma të mundshme, boshllëqe apo çrregullime psikoemocionale që lidhen ngushtë me kushtet paraprake ndikuese me natyrë sociale, ekonomike, politike, kulturore, formuese e edukuese.

Për të hyrë në mendësinë e tjetrit, këto i parapërgatitin ata, për të ndryshuar konjencionin, perceptimin, ndjesitë e emocionet me anë të rregullave të lojës që lidhen me dëmtim e prerje të vetes, zgjim në orët e vona të darkës, shikimin e videove dhe sekuencave të frikshme të filmave, qëndrimin sa më shumë vetëm e të parrethuar me njerëz dhe në fund, me vetëvrasje. Mashtrimet intelektuale dhe ato emocionale lëndojnë e nxisin më tepër individin drejt akteve ‘terroriste masive’ sesa padrejtësitë ekonomike apo politike<sup>15</sup>. Boshllëqet shpirtërore, emocionale, psikologjike janë problematika të kohës në të cilën jetojmë rrotull të cilave lëvizin dhe formohen forma të ndryshme të krimeve, ndër të cilat më të përhapura janë ato të cilat kryhen në masë, në mënyrë të dhunshme dhe për një qëllim, e që ndryshe do të quhen “terrorizëm”.

## 6. Tiparet dhe arsyet, e të kërcënuarve nga këto lojëra

### 6.1 Shembull nga psikologjia e terrorizmit<sup>16</sup>

Në këtë pikë, nga psikologjia e terrorizmit citohet një shembull transformimi i

<sup>13</sup> Nandini Rathi, “The truth of “blue while” challenge: A game said to ‘brainwashes’ teens into committing suicide”, 2017. Marrë nga <http://indianexpress.com/article/opinion/web-edits/blue-whale-suicide-challenge-fact-or-fiction-and-a-wake-up-call-4641835>.

<sup>14</sup> Për më tepër, shih: George Ritzer dhe Douglas J. Goodman, *Teoria Sociologjike* (Tiranë: Ufo University Press, 2008), 74-95.

<sup>15</sup> Edmond Dragoti, *Psikologjia Ligjore e Krimin* (Tiranë: Shtypshkronja Dajti, 2000), 230.

<sup>16</sup> Po aty.

individit, si pasojë e mospërmbushjes së brendshme dhe devijimet që akumulohen. Imagjinoni një fëmijë të vogël që rritet në një familje me një baba të ftohtë, të ashpër dhe autokratik. Fëmija është i etur për ngrohtësi. Ai është i etur për një baba që do ta mësojë për botën dhe të pyesë veten për misteret rreth saj. Është i etur për një baba të dhembshur që do t'i mësojë atij për dhimbjet dhe vuajtjet, që do ta mbrojë atë kur të ketë nevojë. Por në realitet, babai i tij e lë pas dore atë. Ai mund të jetë i alkoolizuar apo ai mund të jetë aq shumë i shqetësuar për punën, sa që nuk e vë re familjen e tij. Ai mund të abuzojë emocionalisht, seksualisht apo fizikisht. Në jetën publike ai mund të jetë i madh dhe fisnik, por për fëmijën e tij ai është një mashtrues. Fëmija rritet me boshllëkun nga mungesa emocionale e të atit dhe me idenë e mashtrimit. Kur të rritet ai do jetë i predispozuar që mos besojë në ideale, por t'i pranojë ato si mite. Ai do të qeshë dhe do të tallet me rregullin dhe me disiplinën, me mosbindjen. Ai do të sulmojë të gjithë hipokrizinë në botë me një hakmarrje të drejtuar në mënyrë të pandërgjegjshme kundër babait të tij. Dhe këtë do ta bëjë për të shkatërruar institucionet e shoqërisë, të ulë poshtë statusin publik të së atit.

## **6.2 Shenja dhe tregues të personave të ndjeshëm ndaj këtij kërcënimi**

Zemërimet dhe zhgënjimet nga fëmijëria, në qoftë se nuk thuhet e nuk zbrazen, akumulohen dhe shpërthejnë në forma të rrezikshme e të dhunshme drejtuar shoqërisë, grupeve të futura në shënjestër, individëve të caktuar, etj. Këta persona rriten me mllef, rëndohen psikologjikisht dhe zemërimin e tyre ua delegojnë të tjerëve, në forma të ndryshme, duke e materializuar në dhunë e krime të ndryshme. Në analogji me lojën “balena blu”, njerëz të mbushur me boshllëqe emocionale, psikologjike e shpirtërore, i shprehin këto tek krijimi i këtyre lojërave. Kriteret që ata vendosin, mbartin një më një, dhimbjet që ata mbartin brenda vetes dhe, ua delegojnë ato të tjerëve, duke i manipuluar për t'i përmbushur e ndërë njësoj si ata.

Hap pas hapi këto rregulla ndikojnë drejt një degjenerimi psikologjik, në formën e një manipulimi të rrezikshëm në mënyrë virtuale që u bëhet sidomos fëmijëve e të rinjve për të arritur në pikën e vetëvrasjes. Fëmijët dhe adoleshentët kanë personalitet ende të pazhvilluar e të paformuar, nisur nga mosha e tyre, kështu që kanë më shumë mundësi të tërhiqen dhe të përfshihen nga loja; fillimisht të nxitur nga kurioziteti. Ata që kanë predispozitë më të lartë për të qenë të vetmuar e depresivë, janë më të rrezikuar të bien prë deri në fundin e lojës dhe të realizojnë vetëvrasje. Edhe të rriturit, si rasti i një djali në moshën 28-vjeçare në Shqipëri, mund të bien prë e lojës, në rast se janë natyra introverse, të prirë për të qëndruar vetëm, pa shumë shoqëri dhe me mundësi për depresion<sup>17</sup>.

“Balena blu” e ka më të thjeshtë të depërtojë në këta persona, e në mos këtë, ajo tenton që me anë të bindjes e manipulimit psikologjik virtual, me rregullat kronologjike të lojës, ta çojë individin drejt vetëlëndimit, vetmisë, frikës, mbylljes në vetvete dhe mosshoqërimit me njerëz të tjerë. Të gjitha këto çojnë në izolim nga shoqëria, rëndesë të mendjes, zbrazëti emocionale, bindje të vetvetes në çdo sekondë, minutë, orë të ditës se, të presësh veten, të shikosh video të frikshme, të largohesh nga miqtë e familja, të mbyllesh në dhomë, të rrih pa ngrënë, duhet të realizohen medoemos për të përmbushur qëllimin tënd, perceptimin e qëllimit të lojës tënde, që në fund të fundit nuk është veçse

<sup>17</sup> Marrë nga: <http://telegrafi.com/balena-blu-zbulohet-28-vjecari-nga-durrresi-ne-nivelin-e-40-te-lojes-vdekjepruresse-foto>.

**Agastra, A.**  
« Krimet virtuale psikologjike: rasti “balena blu” »

Pollicimi dhe Siguria  
**nr.7, 2017**

qëllimi i errët për të bërë keq e për të marrë jetën, i dikujt apo i disave, që qëndrojnë gjithnjë “pas kuintave”. Perfeksionimi i këtyre mendimeve i kthen këto bindje e veprime në zakone, e këto zakone kthehen në rutinë dhe rutina nxit vetëvrasjen.

*Balena* zë kohën e individit, e lidh me veten dhe rregullat e saj, plotëson boshllëqet, derisa bëhet qendra e jetës, e mendjes dhe e emocioneve. Si rrjedhojë, ajo gradualisht fiton tagrin të ketë pushtet mbi individin sepse kontrollon mendjen dhe emocionet e tij. Në këtë mënyrë e ka më të thjeshtë ta orientojë drejt aktin të fundit, *vetëfljimit për të arritur nivelin e fundit të lojës*.

Një vajzë 14 vjeç nga Fieri, sipas raportimeve të shoqes së ngushtë, kishte shenja të dukshme shqetësuese të pasojave të lojës si: mbyllje në vetvete, veshje e bluzave të gjata që mos dukeshin shenjat e çarjeve e prerjeve në lëkurë, mosdëshirë për të ngrënë, pagjumësi, mungesë dëshire për të folur e për të ndenjur me shoqet, zgjim në orët e vona të natës, etj<sup>18</sup>. Këto janë simptoma tipike të rënies në depresion dhe rëndesat e vazhdueshme të kësaj gjendjeje mund të çojnë në gjendje psikoze, që nxisin predispozitën për vetëvrasje.

Ashtu si një gjendje e çekuilibruar mendore e nxitur nga faktorë të shumtë sociale, si mungesa e një pune, probleme e grindje në çift, pamundësi ekonomike, pamundësi për të qenë të suksesshëm, varfëria, mentaliteti, etj., nxit sjelljen vetëvrasëse, ashtu edhe “balena blu” është lojë virtuale, e cila me rregullat dhe qëllimet e saj dëmton psikikën e njeriut, e sidomos të fëmijëve e adoleshentëve, duke i çuar drejt vetëvrasjes ose zgjon tek ata dëshirën për vetëvrasje.

Këto rrjete në linjë janë të rrezikshme, tipike dhe fatkeqësisht të pashmangshme për botën në të cilën jetojmë, ku prirja është drejt komunikimit dhe ndërveprimit nëpërmjet valëve të internetit, të cilat sa na afrojnë, aq edhe na largojnë; sa na ofrojnë shpejtësi, aq edhe pasiguri; sa i thyjnë kufijtë e barrierat, aq edhe na largojnë nga realiteti.

## 7. Përfundime

“Mekdonaldizimi” i jetës dhe dhënia prioritet e gjërave që dalin përtej njerëzor dhe konsumit të drejtpërdrejtë, kanë vendosur përballë shoqërisë së rrezikut sot, vështirësi e sfida të reja, të cilat janë sa pozitive aq edhe negative<sup>19</sup>.

Pozitiviteti duhet parë te informacionet e shumta dhe të qasshme për të gjithë dhe te leximi e përdorimi i tyre, për të informuar e ndërgjegjësuar sa më shumë rreth gjithë problematikave në botë, e më së shumti, me ato që vijnë nga bota virtuale. Duhet të ndërgjegjësohemi të gjithë - prindër, fëmijë, të rinj, grupet shoqërore e vetë shoqëria, - për problemet sociale virtuale me të cilat jetojmë çdo ditë, që janë të pashmangshme, por që duhet të gjejmë mënyra për t'i kuptuar, për t'i diferencuar e më tej për t'i parandaluar.

Në lidhje me këtë çështje, stafi i shkollës së Parkros në Oregon, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës shkroi: “Nuk është e qartë nëse është diçka reale apo legjendë urbane. Nuk ka prova të qëndrueshme që përcaktojnë se *balena blu* është një lojë reale. Pavarësisht,

Agasta, A.  
« Krimet  
virtuale  
psikologjike:  
rasti “balena  
blu” »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

<sup>18</sup> Marrë nga: <http://lajmi.net/rrefimi-rreqthes-i-14-vjecares-nga-fieri-balena-blu-po-i-merre-jeten-shoqes-time-foto>

<sup>19</sup> Për më tepër, shih: George Ritzer dhe Douglas J. Goodman, *Teoria Sociologjike* (Tiranë: Ufo University Press, 2008), 573-577.

<sup>20</sup> Max Kutner, “What is the blue whale game, the Russian ‘challenge’ blamed for suicide?”, 2017. Marrë nga: <http://www.newsweek.com/what-blue-whale-game-russia-suicides-637798>

është e rëndësishme që prindërit t'i kushtojnë rëndësi dhe interes, aktivitetëve në rrjetet sociale të fëmijëve të tyre<sup>20</sup>.

“Balena blu” mund të godasë sërish nesër apo në një të ardhme dhe, në vend të saj, mund të vendoset një pseudonim tjetër, por që ndjek logjikën parësore, tendencën për të bërë dëm. Nuk ka receta absolute për zgjidhje, por gjithmonë duhet treguar vëmendje ndaj sjelljeve shqetësuese që mund të shfaqin individët dhe duhet dhënë ndihmë aty ku mendojmë se është e nevojshme. Ndihma ndaj tjetrit, solidariteti dhe bashkëpunimi me profesionistë e specialistë të fushës si, punonjës socialë, psikologë, sociologë, mjekë, terapistë etj., ndikojnë gjithnjë pozitivisht në lehtësimin e rrethanave dhe parandalimin e përkeqësimit të situatave.

## Referenca

1. Dragoti, Edmond. *Psikologjia Ligjore e Krimit*. Tiranë: Shtypshkronja Dajti, 2000.
2. Fuga, Artan. *Komunikimi në shoqërinë masive*. Tiranë: Papyrus, 2014.
3. Instituti Shqiptar i Medias. *Zhvillimi i internetit dhe i mediave sociale në Shqipëri*. Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias, 2015.
4. Ritzer, George dhe Goodman J. Douglas. *Teoria Sociologjike*. Tiranë: Ufo University Press, 2008.
5. Rathi, Nandini. “The truth of “blue while” challenge: A game said to ‘brainwashes’ teens into committing suicide”, 2017. <http://indianexpress.com/article/opinion/web-edits/blue-whale-suicide-challenge-fact-or-fiction-and-a-wake-up-call-4641835>.
6. Kutner, Max. “What is the blue whale game, the Russian ‘challenge’ blamed for suicide?” në Newsweek, 7.8.2017. Marrë nga: <http://www.newsweek.com/what-blue-whale-game-russia-suicides-637798>.
7. PCWorld, “Krimet kibernetike në Gjermani u rritën më 80% në 2016-ën”, 24 prill 2017: <http://pcworld.al/krimet-kibernetike-ne-gjermani-u-rriten-80-ne-2016-en>.
8. Dritare, “Sfida e balenës blu-loja vetëvrasëse mbërrin tek një fëmijë shqiptar”, 23 maj 2017: <http://www.dritare.net/2017/05/23/sfida-e-balenes-blu-loja-vetevrasese-mberrin-tek-nje-femije-shqiptar/1>.
9. Fax.al, “Kapet një administrator i lojës balena blu”, 14 qershor 2017: <http://fax.al/read/news/10329857/15085940/balena-blu-mendja-e-semure-ruse-qe-shpiku-lojen>. <http://fax.al/read/news/10329857/15086463/arrestohet-nje-administrator-i-lojes-balena-blu>.
10. Tema, “Si u bë gjirokastitja pre e balenës blu”, 14 qershor 2017: <http://www.gazetatema.net/2017/06/14/si-u-be-gjirokastitja-pre-e-balenes-blu-almari-shume-femije-luajne>.
11. Javanews, “Rrëfimi tronditës i vajzës nga Gjirokastra, që ra viktimë e ‘Balenës Blu’”, 13 qershor 2017: <http://www.javanews.al/rrfimi-trondites-i-vajzes-nga-gjirokastra-qe-ra-viktme-e-balenes-blu>.
12. Telegrafi, “Balena Blu”, zbulohet 28 vjeçari nga Durrësi në nivelin e 40 të lojës vdekjeprurëse”, 15 qershor 2016: <http://telegrafi.com/balena-blu-zbulohet-28-vjecari-nga-durresi-ne-nivelin-e-40-te-lojes-vdekjeprurese-foto>.
13. Lajmi, “Rrëfimi rrëqethës i 14-vjeçares nga Fieri: “Balena blu” po i merrte jetën shoqes time”, 15 qershor 2017: <http://lajmi.net/rrfimi-rreqethes-i-14-vjecares-nga-fieri-balena-blu-po-i-merrte-jeten-shoqes-time-foto>.

**Agastra, A.**  
« Krimet virtuale psikologjike: rasti “balena blu” »

Polici  
dhe  
Siguria  
**nr.7, 2017**

# Mbrojtja ndërkombëtare e pronësisë intelektuale



■ **MSc. Qetësor GURRA**  
Akademia e Sigurisë

■ **MSc. Jonida GURRA**  
Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë

## Abstrakt

*Historia e njerëzimit është bazuar mbi aplikime të imagjinatës, novacioneve dhe krijimtarisë. Kjo është bërë për të zgjidhur probleme të ndryshme. Progresi shkencor, përdorimi i madh i arritjeve shkencore dhe teknike në prodhim, zgjerimi i lidhjeve jo vetëm tekniko-shkencore dhe intelektuale ndërkombëtare, aktualisht ka çuar në forcimin e problemit të mbrojtjes intelektuale. Ne vijim do të trajtohen pikërisht të tilla problematika por fillimisht do të trajtohen koncepte kryesore të tematikes në fjalë.*

## Fjalëkyçe:

**imagjinatë, krijimtari, mbrojtje intelektuale, novacion.**

## 1. Hyrje

Imagjinata është burim i progresit edhe në art, ku bëjnë pjesë muzika, piktura, skulptura, arkitektura dhe punët e tjera artistike, të cilat janë krijuar nga individë të cilët nuk kënaqen me të vjetrën, por i shohin dhe i shprehin gjërat me mënyra të reja dhe rinovuese. Pasi, është vet në të pavetëdijshmen e qenieve humane, të cilat dëshirojnë gjithmonë të arrijnë më të mirën e mundshme ashtu siç vet filozofi i madh Niçe e përshkruan në librin e tij “Njeriu nicea”.

Le të kujtojmë së bashku ngjarjen historike të shekullit XVIII-të, ku për herë të parë hodhi themelet ajo që ne sot e njohim si *e drejta e autorit*. Mbreti Karli II i Anglisë dekretoi aktin e parlamentit në lidhje me “licencimin e printimit” 1662, që vendosi një regjistër të librave të licencuar dhe kërkonte depozitimin e një kopje tek kompania që e administronte regjistrin. Në 1710 hyri në fuqi “Statuti Anna” i cili njehtë drejtën e autorit për të kontrolluar punimin, të drejtën për t’u njohur si autor i punimit si dhe të drejtën për përfitim financiar. Ai u dha publikuesve të drejta për një periudhë fikse, pas së cilës skadonin të drejtat autoriale. Gjatë mesjetës, në Europë kishte një konceptim të vakët të pronësisë intelektuale, si rrjedhojë e lidhjeve tejet të ngushta me prodhimin dhe gjendjen e organizimit letrar apo ndikimi i kulturës në shoqëri. Kjo situatë vijoi deri me ardhjen e kapitalizmit të famshëm ku me ideologjinë e tij, me bazë individualiste solli një konceptim të ri të pronësisë intelektuale dhe asaj të së drejtës së autorit si pjesë e saj. Produkti intelektual, tashmë nuk shihej më si një produkt kolektiv apo social në pronësi publike, por si një prodhim i një individi, me të drejta individuale. Pika më kryesore sipas mënyrës kapitaliste të prodhimit, patenta dhe të drejtat e autorit, është se mbështesin në mënyrë thelbësore zgjerimin e veprimtarisë krijuese njerëzore që mund

Gurra, Q.  
dhe  
Gurra, J.  
« Mbrojtja  
ndërkombëtare  
e pronësisë  
intelektuale »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

të transformohet. Paralel me këtë, mënyrat se si kapitalizmi çoi në transformimin e shumë aspekteve të jetës shoqërore që deri në këtë kohë nuk kishin vlerë monetare apo ekonomike.

Bashkimi European i filloi përpjekjet e tij për të harmonizuar legjislacionet e shteteve anëtare, me anë të nënshkrimit të “Konventës së Bernës për mbrojtjen e punëve artistike dhe letrare”, të 1886. Të gjithë vendet anëtare të BE-së e kanë nënshkruar këtë konventë dhe ky, përfaqëson edhe një kusht paraprak për vendet candidate për anëtarësim në BE. Hapi i parë madhor i vendeve të Komunitetit European për harmonizimin e legjislacionit mbrojtës të së drejtave të autorit, ishte vendimi për zbatimin e standardeve për mbrojtjen e të drejtave të autorit në programe kompjuterike, që u ligjërua me anë të “Direktivës për programet kompjuterike” (1991). Një kohëzgjatje e përgjithshme e të drejtës së autorit është 70 vjet pas vdekjes së autorit, gjë që u përcaktua në 1993 në direktivën për mbrojtjen e së drejtës së autorit. Implementimi i direktivave të së drejtës së autorit ka hasur vështirësi më tepër se fushat e tjera. Siç shihet edhe nga gjykimet para Gjykatës së Drejtësisë, në lidhje me mungesën e transferimit të “Direktivës për të Drejtat e Autorit”. Tradicionalisht e drejta e autorit varion në bazë të shtetit, sidomos midis shteteve të sistemit *common law* dhe atij *civil law*. Diferencat në të drejtën e autorit janë lidhur edhe me qëndrimet kundër Organizatës Botërore të Tregtisë dhe globalizmit në përgjithësi.

## 2. Koncepti i pronësisë intelektuale

“Pronësia intelektuale” (PI) është termi që përshkruan idetë, shpikjet, teknologjitë, punimet artistike, muzikën dhe letërsinë, të cilat janë fillimisht të pakuptueshme kur krijohen, por që bëhen me vlerë, kur formohen si produkte. Pronësia intelektuale është aplikimi komercial i mendimeve imagjinare, për të zgjidhur një sfidë artistike ose teknike, ajo nuk është produkt në vetvete, por një ide specifike prapa tij, mënyra se si ajo shprehet, emërtohet, përshkruhet. Pronësia intelektuale rrjedh nga bazat e risive në njohuritë ekzistuese. Ajo është rezultat i përmirësimit krijues mbi atë çfarë ka funksionuar mirë në të kaluarën, ose i shprehjeve të reja krijuese të ideve dhe koncepteve të vjetra. Në marrëdhëniet ndërkombëtare, në kohën e tanishme, një vend të rëndësishëm zë bashkëveprimi i shteteve në fushën kulturore. Shtetet lidhin një numër të madh marrëveshjesh për çështjen e mbrojtjes të vlerave kulturore, organizimin e ekspozitave, këmbimin e arritjeve kulturore etj. Ky bashkëpunim drejtohet edhe në të ashtuquajturën fushë të pronës intelektuale, që përfshin objektin e së drejtës së autorit dhe të shpikjes. E drejta e autorit ka veçori specifike, sepse ka karakter veprimi thellësisht territorial. Vepra krijohet dhe botohet në një vend tjetër dhe për këtë autori nuk gëzon mbrojtjen e të drejtës së tij. Gjatë një periudhe të gjatë kohe u ruajt situata që lejonte botues dhe shitës librash të botonin në vende të ndryshme, vepra të autorëve të caktuar dhe këtyre nuk u paguhej honorari përkatës. Për një kohë të gjatë, Belgjika ishte qendra e publikimit joligjor të veprave të autorëve francezë. Gjithashtu, ndodhte që këto vepra dilnin në dritë më parë në Belgjikë se në Francë, siç ndodhi me veprën “Perëndimi” të autorit R. Zoles. Në zhvillimin e botimit dhe të tregtimit të librit, lidhjet kulturore ndërkombëtare u bënë më intensive dhe natyrisht lindi nevoja e mbrojtjes të së drejtave të autorit jashtë shtetit. Në gjysmën e dytë të shekullit të 19-të u lidhën disa marrëveshje dypalëshe për mbrojtjen e së drejtës së autorëve, megjithatë deri në fund të shekullit, problemi nuk u zgjidh në masë të plotë. Në këto kushte lindi nevoja e domosdoshme për një rregullim

Gurra, Q.  
dhe  
Gurra, J.

« Mbrojtja  
ndërkombëtare  
e pronësisë  
intelektuale »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7 2017



shumëpalësh. Konventa e parë e këtij lloji ka përfunduar në vitin 1886, pastaj dolën disa marrëveshje rajonale në Amerikën Latine. Progresi shkencor, përdorimi i madh i arritjeve të reja shkencore dhe teknike në prodhim, zgjerimi i lidhjeve tekniko-shkencore dhe industriale ndërkombëtare, aktualisht kanë forcuar problemin e mbrojtjes së pronës industriale.

### 3. Koncepti i pronësisë industriale

Termi “pronësi intelektuale” i referohet krijimeve të mendjes së njeriut. Pronësia intelektuale mbron të drejtat e shpikësve, krijuesve, tregtarëve, apo artistëve nëpërmjet dhënies të së drejtës ekskluzive të pronësisë mbi shpikjen apo krijimin e tyre. Në këtë mënyrë pronësia intelektuale është një ndër stimuluesit më të fuqishëm të progresit në të gjitha sferat e zhvillimit të shoqërisë – teknike dhe shkencore, ekonomike, kulturore etj.

Njeriu prodhon ide dhe krijime të cilat përbëjnë risi, lind nevoja që këto ide dhe mendime përkufizohen. Është pikërisht pronësia intelektuale, ajo që i përcakton dhe mbron këto krijime dhe risi të mendjes njerëzore. Koncepti pronësi intelektuale na shoqëron gjatë gjithë aktivitetit tonë të përditshëm, ngado që ne shkojmë, p.sh.:

- marka tregtare na orienton në lidhje me origjinën tregtare të produkteve;
- dizajni specifikon se si një produkt duket në pamje të jashtme;
- “copyright” (e drejta e autorit) lidhet me krijimet artistike, si librat, muzika, pikturat skulpturat dhe filmat;
- patentat mbrojnë shpikjet teknike në të gjitha fushat e teknologjisë, apo risitë në prodhimet farmaceutike, bujqësore etj.

Pronësia intelektuale vlerëson krijuesit dhe novatorët dhe bën të mundur, që ata të përfitojnë nga arritjet e tyre. Rëndësia e mbrojtjes së pronësisë intelektuale është njohur fillimisht nga “Konventa e Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale” (1883) dhe “Konventa e Bernës për mbrojtjen e punëve artistike dhe letrare” (1886). Këto marrëveshje administrohen nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (OBPI).

Patentimi i shpikjeve jashtë shtetit bëhet, në bazë të legjislacionit të brendshëm të shtetit, në të cilin kërkohet mbrojtja e dokumentit. Mbrojtja e dokumentit realizohet në përputhje me ligjet nacionale të vendosura, megjithatë merren parasysh dhe kërkesat e marrëveshjeve ndërkombëtare. Në fushën e mbrojtjes të pronës industriale në kohën e sotme veprojnë shumë marrëveshje të përbotshme, rajonale dhe dypalëshe. Në të parat hyn “Konventa e Parisit për mbrojtjen e pronës industriale”, e vitit 1883, pjesëmarrës të së cilës janë rreth 90 shtete. Konventa e dhënë, është rishikuar disa herë (në vitet 1900, 1911, 1925, 1934, 1958, 1967), por problemi i rishikimit të saj qëndron aktual edhe në kohën e sotme.

Në vitin 1970, në Uashington është nënshkruar marrëveshja për kooperimin e patentave, qëllimi i së cilës është thjeshtëzimi i procesit të regjistrimit të patentave jashtë shtetit. Markat e mallrave janë një nga objektet e pronës industriale që gjithashtu u përket mbrojtja ndërkombëtare, në bazë të “Marrëveshjes të Madridit për regjistrimin e markave dhe të mallrave”, të vitit 1891.

Nga marrëveshjet që janë në veprim, duhet të përmendim “Marrëveshjen e Strasburgut për klasifikim ndërkombëtar të patentave”, e vitit 1971. Për sa u përket marrëveshjeve rajonale, duhet të përmendim “Konventën për krijimin e sistemit europian për dhënien e patentave” dhe marrëveshjet që veprojnë në marrëdhëniet

Gurra, Q.  
dhe

Gurra, J.

« Mbrojtja ndërkombëtare e pronësisë intelektuale »

Policimi dhe Siguria nr.7, 2017

midis shteteve afrikane, viti 1973.

Këshilli European dhe Bashkësia Ekonomike Europiane kanë përgatitur disa projekt-marrëveshje për verifikimin e të drejtës së patentave. Në dhjetor të 1975-s, anëtarë të EEC, në Konferencën e Luksemburgut nënshkruan “Konventën për patentën e përbashkët”, sipas të cilës krijohet një e drejtë patente për të gjitha këto shtete. Konventa parashikon mundësinë e dhënies së patentës unike ashtu dhe patentës nacionale.

#### 4. Mbrojtja ndërkombëtare e pronësisë intelektuale

Mbrojtja ndërkombëtare e pronësisë intelektuale bëhet nëpërmjet konventave të ratifikuara nga shtetet. Për mbrojtjen e së drejtës së autorit për vepra letrare, artistike dhe shkencore vepron një dy konventa shumëpalëshe:

1. “Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprimtarisë letrare dhe artistike”, të vitit 1826, e cila është plotësuar me Aktin e Parisit, më 24.07.1971 dhe ndryshuar më 02.10.1979. Kjo konventë deri në kohën e tanishme vepron në redaktime të ndryshme.

2. “Konventa botërore për mbrojtjen e të drejtës së autorit”, e vitit 1952. “Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprimtarisë letrare” përfshin veprat letrare, artistike (në redaktimin e Brukselit të vitit 1948) produktet e kinematografisë, fotografisë, përmbledhjet letrare dhe artistike etj. Afati i mbrojtjes të së drejtave të autorit është baras me afatin e jetës së autorit plus 50 vjet pas vdekjes së tij, (në dokument përmenden dhe përjashtimet e këtij rregulli). Përmbajtja kryesore e konventës së Bernës qëndron në atë se autorët që janë shtetas të shtetit që është pjesëmarrës në konventë, që për herë të parë publikojnë veprën në këto vende, gëzojnë në të gjitha shtetet pjesëmarrëse të gjitha të drejtat, të cilat i gëzojnë shtetasit e këtyre vendeve duke i dhënë një regjim nacional pavarësisht të drejtave të caktuara në konventë<sup>1</sup>.

“Konventa e Gjenevës” e vitit 1952, për të drejtat e autorit është hartuar nën kujdesin e UNESCO s.<sup>2</sup> Iniciator për përpunimin e konventës së re ishin ato vende të cilat mendonin se pjesëmarrja në Konventën e Bernës për to, do ishte e pëlqyeshme. Gjithashtu, pjesëmarrja do ishte e lartë për arsye të nivelit të lartë të mbrojtjes të së drejtës së autorit.

“Konventa botërore për mbrojtjen e të drejtës së autorit” mbron të drejtat e autorit për veprat letrare, artistike, shkencore, si për vepra të shkruara muzikore, dramatike, kinematografike, ashtu dhe për veprat në pikturë, grafik dhe skulpturë.<sup>3</sup>

Dokumenti i dhënë, dallon *veprat e dala në dritë* dhe *të pa dalat në dritë*. Me “vepra të dala në dritë” kuptohet “kopjimi në çfarëdo forme i materialit dhe dhënia një rrethi të përcaktuar personash, të ekzemplarëve të veprës, për lexim ose njohje nëpërmjet perceptimit vizual”. Afati i mbrojtjes së veprës në pajtim me rregullat e kapitullit IV të Konventës së Përbotshme, caktohet në legjislacionin e brendshëm të shtetit, megjithatë mbrojtja e veprës nuk mund të jetë për një periudhë të shkurtër se përfshirja e jetës së autorit deri 25 vite pas vdekjes së tij. Afati i mbrojtjes së veprave fotografike dhe i veprave të artit të aplikuar nuk mund të jetë më i shkurtër se 10 vite sepse ato janë vepra artistike. Afati i mbrojtjes mund të llogaritet nga mbarimi i vazhdimet të jetës së autorit, nga koha e daljes për herë të parë në dritë të veprës ose në rrethana përkatëse,

Gurra, Q.  
dhe  
Gurra, J.  
« Mbrojtja  
ndërkombëtare  
e pronësisë  
intelektuale »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7 2017

<sup>1</sup> Konventa e Bernës, 1826.

<sup>2</sup> Konventa e Gjenevës, 1952.

<sup>3</sup> Konventa Botërore e së Drejtës së Autorit.

nga koha e regjistrimit të kësaj vepre. Në të gjitha rastet, ky afat nuk mund të jetë më i vogël se 25 vite.

Sipas nenit 5 të Konventës së Përbotshme, e drejta e autorit që përfshin të drejtën ekskluzive të autorit për përkthim, nxjerrjen në dritë të përkthimit, lejimin e përkthimit dhe nxjerrjen në dritë të veprës së përkthyer, mbrohen në bazë të konventës.<sup>4</sup> Gjithashtu, çdo shtetas mund të kufizojë të drejtën e përkthimit të veprës së shkruar, nëse gjatë 7 viteve nga koha e daljes në dritë të një vepre të shkruar, mbajtësi i të drejtës së përkthimit nuk ka realizuar përkthimin e veprës në gjuhën tjetër të huaj. Konventa Botërore parashikon se të gjitha veprat që mbrohen nga ky dokument, duhet të përmbajnë shenjë (C) duke treguar emrin e zotëruesit të së drejtës së autorësisë dhe vitin e parë të botimit. Me miratimin e Konventës Botërore, lindi çështja e kufirit të saj me Konventën e Bernës dhe me marrëveshjet dypalëshe të shteteve.

Në paragrafin e parë, të nenit 17, të Konventës Botërore, caktohet se Konventa Botërore nuk prek kërkesat e “Konventës së Bernës për mbrojtjen e veprave letrare, artistike” dhe përkatësinë e bashkimit të krijuar nga kjo konventë.<sup>5</sup> Në vitin 1971 në Paris, tekstet e Konventës Botërore dhe Konventës së Bernës, u rishikuan pjesërisht.

Konventa e Gjenevës, e vitit 1971, flet për të drejtat e organizatave radiotransmetuese me autorizimin e të cilave mund të realizohet ritransmetimi i programit të tyre, paraqitja publike e programeve televizive në vendet ku hyrja është me pagesë. Afati i mbrojtjes që caktohet në të është 20 vjet.<sup>6</sup>

Në vitin 1974, në Bruksel është nënshkruar “Konventa për përhapjen e sinjaleve mbartës të programeve që transmetohen me satelitë”. Zhvillimi i gjerë i bashkëpunimit kulturor ndërkombëtar kërkoi një punë të vazhdueshme bashkërenduese, studimin e problemeve që kishin lindur, si rrjedhim më 14 korrik 1967 në Stokholm është nënshkruar konventa që krijoi një institut të ri të specializuar të OKB-së: Organizatën Botërore të Pronës Intelektuale (VOIS). Siç kemi përmendur dhe më lart, mbrojtja e të drejtave të autorit realizohet edhe në nivel rajonal në Amerikën Latine si dhe nëpërmjet përfundimit të marrëveshjes dypalëshe.

## 5. Pronësia intelektuale në Bashkimin European

Gjatë mesjetës, në Europë kishte një konceptim të vakët të pronësisë intelektuale si rrjedhojë e lidhjeve tejet të ngushta me prodhimin dhe gjendjen e organizimit letrar apo ndikimin e kulturës në shoqëri. Kjo situatë vijoi deri me ardhjen e kapitalizmit, me ideologjinë e tij me bazë individualiste, që solli një konceptim të ri të pronësisë intelektuale dhe asaj të së drejtës së autorit si pjesë e saj. Produkti intelektual tashmë shihej si një prodhim i një individi, me të drejta përkatëse, jo më si një produkt kolektiv apo social në pronësi publike. Çështja më e rëndësishme është se sipas mënyrës kapitaliste të prodhimit, patenta dhe të drejtat e autorit, mbështesin në mënyrë thelbësore zgjerimin e veprimtarisë krijuese njerëzore, që mund të transformohet. Paralel me këtë, edhe mënyrat se si kapitalizmi çoi në transformimin e shumë aspekteve të jetës shoqërore, që deri në këtë kohë nuk kishin vlerë monetare apo ekonomike.

Në vitin 1886, vjen Konventa e Bernës, që për herë të parë njohu të drejtën e autorit

<sup>4</sup> Neni 5, Konventa e Përbotshme.

<sup>5</sup> Paragrafi 1, neni 17 i Konventës Botërore.

<sup>6</sup> Konventa e Gjenevës, 1971.

Gurra, Q.  
dhe

Gurra, J.

« Mbrojtja  
ndërkombëtare  
e pronësisë  
intelektuale »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

ndërmjet shteteve sovrane shkruese, e jo vetëm në konceptin bilateral midis tyre. Të drejtat e autorit të punëve krijuese, nuk kanë nevojë të njihen apo të deklarohen, pasi ato hynë në fuqi automatikisht me krijimin e tyre: një autor nuk ka nevojë t'i regjistrojë apo të aplikojë për të drejtat e autorit në vendet nënshkruese të Konventës së Bernës. Sapo një punë është "fiksuar", që është, shprehja e saj me shkrim ose regjistruar në disa mjete fizike, autori i saj ka të drejtë automatike për të gjitha të drejtat e autorit, si dhe të veprave të prejardhura derisa autori shënohet shprehimisht poshtë tyre, ose deri sa skadon e drejta e autorit. Konventa e Bernës përcakton gjithashtu, se autorët e huaj duhen trajtuar në mënyrë të njëjtë me autorët vendas, në çdo vend që ka nënshkruar konventën. Rregullat e Konventës së Bernës janë inkorporuar në marrëveshjen "TRIPS" të Organizatës Botërore të Tregtisë së (1995), duke i dhënë kështu Konventës së Bernës efekt gati global aplikimi. Viti 2002, Traktati i OBPI, ka miratuar kufizime të mëdha në përdorimin e teknologjisë për të kopjuar punimet në kombet që kanë ratifikuar atë. Bashkimi Europian i filloi përpjekjet e tij për të harmonizuar legjislacionet e shteteve anëtare me anë të nënshkrimit të "Konventës së Bernës për mbrojtjen e punëve artistike dhe letrare", të 1886.

Të gjithë vendet anëtare të BE-së e kanë nënshkruar këtë konventë dhe ky përfaqëson edhe një kusht paraprak për vendet candidate për anëtarësim në BE. Hapi i parë madhor i vendeve të komunitetit evropian, për harmonizimin e legjislacionit mbrojtës të së drejtave të autorit, ishte vendimi për zbatimin e standardeve për mbrojtjen e të drejtave të autorit, në programet kompjuterike, që u ligjërua me anë të *Direktivës për Programet Kompjuterike* 1991. Një kohëzgjatje e përgjithshme e të drejtës së autorit është 70 vjet pas vdekjes së autorit, gjë që u përcaktua në 1993 në direktivën për kohëzgjatjen e të drejtës së autorit. Implementimi i direktivave të së drejtës së autorit, ka hasur vështirësi më tepër se fushat e tjera, siç shihet edhe nga gjykimet para Gjykatës së Drejtësisë në lidhje me mungesën e transferimit të "Direktivës për të drejtat e autorit". Tradicionalisht e drejta e autorit varion në bazë të shtetit, sidomos midis shteteve të sistemit *common law* dhe atij *civil law*. Diferencat në të drejtën e autorit janë lidhur edhe me qëndrimet kundër Organizatës Botërore të Tregtisë dhe globalizmit në përgjithësi.

## 6. Burimet e së drejtës së autorit në Bashkimin Europian

### 6.1 Marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga Bashkimi Europian

#### 6.1.1 Konventa e Bernës

"Konventa e Bernës për mbrojtjen e punëve letrare dhe artistike", e njohur si Konventa e Bernës, është një marrëveshje ndërkombëtare mbi të drejtën e autorit, e cila u nënshkrua në Bernë, Zvicër në 1886. Krijimet e lidhura tradicionalisht me të drejtën e autorit janë objekt i konventës dhe rrjedhimisht ajo mbulon veprat letrare, dramatike, muzikore dhe artistike dhe gjithashtu, filmat kinematografike dhe ato analoge audio-vizuale. Sipas konventës, të drejtat e autorit për veprat krijuese janë automatikisht në fuqi me krijimin e tyre. Autorët e huaj do të trajtohen në mënyrë ekuivalente me autorët vendas, në çdo vend që nënshkruan konventën. Konventa e Bernës kërkon nga nënshkruarit e saj të njohin të drejtën e autorit të veprave, për autorët, shtetas të njërit nga anëtarët e konventës së Bernës në të njëjtën mënyrë si nje autorë shtetasit e vet.

Gurra, Q.  
dhe  
Gurra, J.  
« Mbrojtja  
ndërkombëtare  
e pronësisë  
intelektuale »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7 2017

Përveç kësaj, në këtë marrëveshjeje kërkohet gjithashtu për shtetin anëtar të sigurojë standardet minimale të vendosura në Konventë. Konventa e Bernës thekson se të gjitha të drejtat e autorit për të gjitha veprat, përveç fotografike dhe kinematografike kanë një kohëzgjatje për të paktën 50 vjet pas vdekjes së autorit, por anëtarët janë të lirë për të siguruar një kohëzgjatje më të madhe. Bashkimi Evropian, e bëri me direktivën e viti 1993, mbi harmonizimin e afatit të mbrojtjes së të drejtave të autorit. Për fotografinë, vendos një afat minimal prej 25 vjet që nga viti kur fotografia është krijuar; si dhe, për kinematografinë, një afat minimal 50 vjet pas shfaqjes së parë, ose 50 vjet pas krijimit në qoftë se ajo nuk është shfaqur brenda 50 vitesh që pas krijimit.<sup>7</sup> Vendet mund të zgjedhin për të siguruar kushte më të larta të mbrojtjes, si dhe lloje të tjera të veçanta veprash (të tilla si, *phonorecords* dhe foto-lëvizje) mund të sigurohen kushte më të shkurtër.

#### 6.1.2. “Konventa e Romës për mbrojtjen e interpretuesve, të prodhuesve të fonogrameve dhe organizatave transmetuese”

“Konventa e Romës për mbrojtjen e interpretuesve, të prodhuesve të fonogrameve dhe organizatave transmetuese” u nënshkrua më 26 tetor 1961. Konventa kërkon që çdo shtet anëtar, të aplikojë atë në trajtimin kombëtar të respektimit të së drejtave, të cilat ajo ua akordon interpretuesve, prodhuesve dhe organizatave të transmetimit. Konventa zgjeroi mbrojtjen e të drejtës së autorit nga krijuesit, duke përfshirë edhe pronarët e manifestimeve të veçanta fizike të pronësisë intelektuale, të tilla si kasetat audio ose DVD. Transmetuesve ju garantohen të drejtat ekskluzive mbi riprodhimin, ritransmetimin dhe transmetimin në publik.

Konventën e hartuan 13 shtete, në përgjigje të teknologjive të reja si: regjistrimi në kasetë - që e bëri riprodhimin e tingujve dhe imazheve, më të lehtë dhe më të lirë se kurrë më parë. Ndërsa ligji i mëparshëm për mbrojtjen e të drejtave të autorit, duke përfshirë marrëveshjet ndërkombëtare si Konventa e Bernës 1886, ishte shkruar për të rregulluar qarkullimin e materialeve të shtypura. Konventa e Romës iu përgjigj rrethanave të reja të ideve të përfaqësuara në njësi të ndryshme të riprodhuara me lehtësi, duke i përfshirë interpretuesit dhe prodhuesit e regjistrimeve në të drejtat e autorit. Konventa e garanton një mbrojtje për një afat prej 20 vjetësh, nga kryerja e performancës apo transmetimi në mënyrë të përshtatshme.

#### 6.1.3. *Traktati i Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (OBPI), i vitit 1970*

Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (OBPI) është një organizatë ndërkombëtare e përkushtuar, për të ndihmuar dhe për të siguruar, që të drejtat e krijuesve dhe pronarëve të pronësisë intelektuale në mbarë botën, të jenë të mbrojtura dhe se shpikësit dhe autorët të njihen dhe shpërblehen për zgjuarsinë e tyre. Kjo mbrojtje ndërkombëtare vepron si një nxitje për kreativitetin njerëzor, shtyn përpara kufijtë e shkencës dhe teknologjisë dhe synon pasurimin e botës së letërsisë dhe arteve, duke siguruar një mjedis të qëndrueshëm për marketingun e produkteve të pronës intelektuale, nga i cili varen edhe rrotat e tregtisë ndërkombëtare.

Përmes punës së saj, OBPI luan një rol të rëndësishëm në rritjen e cilësisë dhe gëzimi i jetës, si dhe krijimin e një pasurie të vërtetë për kombet. Me seli në Gjenevë, Zvicër, OBPI është një nga 16 agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara. Ajo i dha

<sup>7</sup> Konventa e Bernës, 1826.

Gurra, Q.  
dhe  
Gurra, J.  
« Mbrojtja  
ndërkombëtare  
e pronësisë  
intelektuale »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

mbrojtje shtesë të drejtës së autorit, për të përmbushur sfidat e paraqitura nga teknologjia. Neni 4 i Traktatit, siguron se programet kompjuterike mbrohen si vepra letrare dhe, neni 5, siguron se marrëveshja dhe përzgjedhja e materialeve në bazat e të dhënave, është e mbrojtur. Artikujt 6-8, u sigurojnë autorëve kontroll mbi qiratë e veprave të tyre dhe shpërndarjen e veprave të tyre, të cilat nuk janë përfshirë në fillim nga Konventa e Bernës. Këshilli i Bashkimit Evropian e miratoi traktatin në emër të Komuniteti European.<sup>8</sup>

#### 6.1.4. Marrëveshja TRIPS

Marrëveshja TRIPS, e cila hyri në fuqi më 1 janar 1995, është deri më sot marrëveshja shumëpalëshe më e plotë në fushën e pronësisë intelektuale. Tre karakteristikat kryesore të marrëveshjes janë:

a) *Standardet*. Në lidhje me secilën nga fushat kryesore të pronësisë intelektuale që mbulohen nga Marrëveshja TRIPS, marrëveshja përcakton minimumin e standardeve të mbrojtjes, që duhet të sigurohen nga çdo anëtar.

Marrëveshja përcakton këto standarde duke kërkuar, së pari, detyrimet substanciale e kryesore nga konventat e OBPI, “Konventa e Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale” (Konventa e Parisit) dhe “Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike” (Konventa Bernës); këto, në versionet e tyre më të fundit, duhet të jenë në përputhje me këto dokumente ndërkombëtare. Me përjashtim të dispozitave të “Konventës së Bernës mbi të drejtat morale”, të gjitha dispozitat kryesore substanciale të këtyre konventave janë të inkorporuar me referenca dhe kështu bëhen detyrime sipas Marrëveshjes TRIPS. Disa dispozita përkatëse gjenden në nenet 2.1 dhe 9.1 të Marrëveshjes TRIPS, të cilët lidhen, përkatësisht, me Konventën e Parisit dhe në Konventën e Bernës.

Së dyti, Marrëveshja TRIPS shton një numër të konsiderueshëm detyrimesh shtesë mbi çështjet ku konventat paraekzistuese kanë heshtur ose shiheshin si të pamjaftueshme. Kështu, ndonjëherë i referohen Marrëveshjes TRIPS si një marrëveshje “Bernë dhe Paris – plus”.

b) *Zbatimi*. Grupi i dytë kryesor i familjes së dispozitave, merret me procedurat dhe mjetet juridike për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Marrëveshja përcakton disa parime të përgjithshme, të zbatueshme për të gjitha procedurat e zbatimit. Përveç kësaj, ai përmban dispozita mbi të drejtat civile dhe procedurat administrative dhe mjetet, masat e përkohshme, të veçanta. Kërkesat lidhur me masat kufitare dhe procedurave penale, të cilat specifikojnë në një sasi të caktuar, të detajuar, procedurat dhe mjetet juridike që duhet të jenë në dispozicion në mënyrë që bartësit e të drejtës në mënyrë efektive mund të zbatojë të drejtat e tyre.

c) *Zgjidhja e mosmarrëveshjeve*. Marrëveshja përcakton procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet anëtarëve të OBT-së në lidhje me respektimin e detyrimeve. Përveç kësaj kjo marrëveshje parashikon disa parime bazë kombëtare dhe trajtim më të favorizuar të kombit, dhe disa rregulla të përgjithshme për të siguruar që procedurat të mos anulojnë përfitimet substanciale që duhet të rrjedhin nga marrëveshja. Detyrimet sipas Marrëveshjes do të zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjitha vendet anëtare, por për vendet në zhvillim do të ketë një periudhë më të gjatë në fazë. Marrëveshja TRIPS është një marrëveshje që përcakton një minimum standardesh, e

<sup>8</sup> Bashkimi European, *Përmbledhje Traktatesh*, Tiranë 2000.

cila lejon për anëtarët të sigurojë mbrojtje më të gjerë të pronësisë intelektuale, në qoftë se ata dëshirojnë. Anëtarët janë lënë të lirë për të përcaktuar metodën e duhur të zbatimit të dispozitave të marrëveshjes në kuadër të sistemit të tyre ligjor dhe praktikës. TRIPS bën edhe përrjashtime, siç është parimi Bernë për kufizimin e përrjashtimeve, që shtrihet në legjislacionet kombëtare në lidhje me të drejtën e riprodhimit.

## 6.2. Të drejtat morale

Vendet anëtare u japin autorëve: 1) Të drejtën e pretendimit në autorësinë e punës, (e quajtur nganjëherë e “drejtë e atësisë”), 2) Të drejtën të kundërshtojë ndonjë shtrembërim ose modifikim të punës, ose çdo veprim përçmues në lidhje me punën, i cili do të jetë i dëmshëm për nderin ose reputacionin e autorit, e quajmë të drejtë integriteti.

Këto të drejta, janë njohur përgjithësisht si të drejtat morale të autorëve.<sup>9</sup> Konventa e Bernës, kërkon që ato të jenë të pavarura nga të drejtat ekonomike të autorit dhe, autori të mos mbetet anonim edhe pasi ai ka transferuar të drejtat e tij ekonomike. Vlen të vihet në dukje se të drejtat morale i janë akorduar vetëm autorëve individualë. Kështu edhe kur, për shembull, një prodhues filmi apo një botues zotëron të drejtat ekonomike të një pune, këtu është vetëm krijuesi individ i cili ka interesa morale në rrezik.

## 6.3 Pronësia, ushtrimi dhe kalimi i të drejtave pasurore të autorit

Pronari në një punë është përgjithësisht autori, të paktën në shkallën e parë. Personi i cili krijoi punën, d.m.th. autori i punës. Por kjo nuk është gjithmonë kështu. Konventa e Bernës (neni 14/2) përmban rregulla për përcaktimin e pronësisë fillestare e të drejta për veprat kinematografike. Disa ligje kombëtare mund të sigurojnë që, kur një punë është krijuar nga një autor i cili është punësuar për qëllimet e krijimit të asaj pune, atëherë nuk është autori, pronar i së drejtë së autorit në punë, por punëdhënësi. Siç përmendet më sipër, megjithatë, të drejtat morale gjithmonë i përkasin autorit individual të punës, kurse pronar i të drejtave ekonomike mund të jetë edhe punëdhënësi. Ligjet e shumë vendeve mund të sigurojnë se të drejtat e pronarit fillestar në një punë, mund t’i transferohen një pale të tretë (të drejtat morale, duke qenë personale, autori nuk mund t’i transferojë).

Autorët mund të shesin të drejtat për veprat e tyre për individët apo kompanitë në gjendje të mira të tregut të punëve, në këmbim të pagesës. Këto pagesa janë bërë shpesh, dhe varen nga përdorimi aktual i punës, si dhe i janë referuar pastaj si honorarë. Transferimet e autorit mund të marrin një nga dy format: detyra dhe licencat. Sipas një detyre, pronari i transferon të drejtën për të autorizuar ose ndaluar veprime të caktuara të mbuluara nga një ose disa ose nga të gjitha të drejtat e autorit.<sup>10</sup>

Një detyrë është një transferim i së drejtës së pronës. Pra, nëse të gjitha të drejtat janë të caktuara, personi të cilit i janë caktuar të drejtat bëhet pronari i ri i punës. Në disa vende, një detyrë e së drejtës së autorit nuk është ligjërisht e mundur, dhe vetëm licencimit është i lejuar. Licencim do të thotë se autori ruan pronësinë, por autorizon një palë të

<sup>9</sup> Direktiva e KE-së 2006/116/EC për harmonizimin kohëzgjatjes së mbrojtjes së të drejtave të autorit.

<sup>10</sup> Po aty.

Gurra, Q.

dhe

Gurra, J.

« Mbrojtja  
ndërkombëtare  
e pronësisë  
intelektuale »

Policimi

dhe

Siguria

nr.7, 2017

tretë për të kryer veprime të caktuara, të mbuluara nga të drejtat ekonomike, në përgjithësi për një periudhë të caktuar kohe dhe për një qëllim specifik.

#### **6.4 E drejta për rishitje**

Direktiva ka krijuar një të drejtë për krijuesit e veprave të artit për të marrë pjesë në fitimet e rishitjes së punës së tyre. Kjo e drejtë, e cila është e njohur është personale, e artistit dhe vetëm mund të transferohet nga trashëgimi. Ai llogaritet si një përqindje e çmimit të rishitjes (neto nga tatimi), e cila varion nga 4 ose 5 për qind për pjesën e çmimit të rishitjes deri në 50 000 euro dhe 0.25% për pjesën e çmimit të rishitjes mbi 500 000 euro.<sup>11</sup> Honorari i përgjithshëm është i kufizuar në 12 500 euro, ekuivalente me një çmim prej 2 000 000 rishitje.

Veprat e artit që janë të mbuluara nga kjo e drejtë rishitje janë veprat e artit grafik ose plastik siç janë fotografitë, mozaikët, piktura, vizatime, printime, gravura, litografi, skulptura, tapiceri, qeramika, qelqe dhe fotografi, me kusht që ato janë bërë nga artisti vetë ose janë kopje të cilat janë bërë në një numër të kufizuar nga artisti ose nën autoritetin e tij.

#### **6. 5 Të drejtat e lidhura**

Qëllimi i të drejtave të lidhura, është për të mbrojtur interesat ligjore të personave të caktuar dhe personat juridikë që kontribuojnë për të vënë punën në dispozicion të publikut, ose që prodhojnë lëndë që, ndonëse nuk kualifikohen si vepra me të drejtën e autorit nga sistemet e të gjitha vendeve, përmbajnë krijimtari të mjaftueshme teknike dhe organizative që i bën të afta për të justifikuar njohjen e të drejtës së autorit.

Ligji për të drejtat e lidhura, gjykon se, prodhimet të cilat rezultojnë nga aktivitetet e këtyre personave dhe subjektet, e meritojnë mbrojtje ligjore, pasi ato janë të lidhura me mbrojtjen e punëve të autorësisë sipas parimit të së drejtës së autorit. Tradicionalisht, të drejtat e lidhura përcaktojnë tre kategori të përfituesve:

- 1) interpretues,
- 2) prodhues të fonogrameve,
- 3) organizata të transmetimit.

Të drejtat e autorëve janë të mbrojtura gjatë jetës dhe për shtatëdhjetë vjet pas vdekjes së tyre.

1) Kjo përfshin të drejta rishitjeje të artistëve.

2) Për filmat dhe veprat e tjera audiovizuale, periudha shtatëdhjetë vjeçare zbatohet nga vdekja e autorit të fundit, mes atyre që konsiderohen të jenë apo jo, autorët e punës, nga ana e ligjit kombëtar të shtetit anëtar: drejtori kryesor (i cili është konsideruar gjithmonë të jetë një autor i veprës audiovizuale), autori i skenarit, autori i dialogut dhe kompozitori i muzikës krijuar posaçërisht për përdorim në punën kinematografike ose audiovizuale.

3) Të drejtat e interpretuesve zgjasin për pesëdhjetë vjet nga shpërndarja ose shfaqja e performancës, ose për pesëdhjetë vjet nga krijimi i vetë performancës, në qoftë se ajo kurrë nuk është shfaqur në publik gjatë kësaj periudhe.

4) Të drejtat e prodhuesve të fonogrameve, zgjasin pesëdhjetë vjet pas publikimit të

**Gurra, Q.  
dhe  
Gurra, J.**  
« Mbrojtja  
ndërkombëtare  
e pronësisë  
intelektuale »

Policimi  
dhe  
Siguria  
**nr.7 2017**

<sup>11</sup> Po aty.



fonogramit, ose për pesëdhjetë vjet pas komunikimit të tij te publiku, në qoftë se kurrë nuk është botuar gjatë kësaj periudhe, ose për pesëdhjetë vjet pas krijimit të tij në qoftë se ai kurrë nuk është shfaqur në publik.

5) Të drejtat e prodhuesit të filmit, zgjasin pesëdhjetë vjet pas shfaqjes së filmit në publik, ose për pesëdhjetë vjet pas krijimit të tij në qoftë se ai kurrë nuk është shfaqur në publik gjatë kësaj periudhe. Të drejtat e organizatave transmetuese, zgjasin pesëdhjetë vjet pas transmetimit parë. Komisioni European propozoi që kjo të shtyhet për 95 vjet dhe pas këtij sugjerimi, Parlamenti Evropian miratoi legjislacionin për rritjen e afatit për 70 vjet. Këto terma të mbrojtjes, zbatohen për të gjitha veprat të cilat janë të mbrojtura, në një shtet anëtar të Zonës Ekonomike Evropiane, që nga 1 korriku 1995. Kjo dispozitë kishte efektin e kthimit, të së drejtave të autorit për vepra të caktuara, të cilat kishin hyrë në domenin publik, në vendet me kohëzgjatje më të shkurtër të autorit.<sup>12</sup>

Është modifikuar afati i mbrojtjes së fonogrameve, duke e llogaritur atë që nga data e publikimit, në vend të një datë më të hershme të komunikimit në publik, por nuk është rivendosur mbrojtja e fonogrameve të cilat kishin hyrë në pronësinë publike sipas rregullave të mëparshme.

## 7. Mbrojtja ndërkombëtare e pronësisë industriale

Në mbrojtjen ndërkombëtare të pronësisë industriale luan një rol mjaft të rëndësishëm Konventa e Parisit. Konventa e Parisit ka si objekt mbrojtje patentat për shpikje, modelet e dobishme, mostrat industrial, markat e prodhimit, shenjat e shërbimeve, emrin e firmave, tregimin e origjinës ose emrin e vendit të origjinës si dhe shmangien e konturimit të pandërgjegjshëm<sup>13</sup>

Në tetor të vitit 1973 në Muni, 14 shtete europiane nënshkruan “Konventën për sistemimin evropian të dhënies së patentave”. Konventa parashikon dhënien e një patente unike europiane në përputhje me kërkesat e paraqitura në Institutit European të Patentave.<sup>14</sup>

Në dhjetor të vitit 1975, 5 anëtare të EEC nënshkruan “Konventën për Patentën e Përbashkët” në Luksemburg, sipas të cilës krijohet një e drejtë patente për të gjithë këto shtete. Konventa parashikon mundësinë e dhënies së patentave unike dhe të patentës nacionale.

Në kontinentin e Afrikës në Libreville në vitin 1962, 12 shtete nënshkruan marrëveshjen afro-malgashe, me të cilën krijuan në Kamerun një institut të patentave për dhënien e patentave që kanë fuqi në vendet e treguara. Në Konventën e Parisit, të vitit 1883 për mbrojtjen e pronës industriale, përcaktohet se shtetasit e shteteve pjesëmarrës të kësaj konvente, gëzojnë në territorin e shtetit tjetër, regjimin nacional në fushën e mbrojtjes juridike të pronës së dhënë.

## 8. Përfundime

Legjislacioni mbi pronësinë intelektuale në Republikën e Shqipërisë synon mbrojtjen e të drejtave të autorit si dhe përfrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* të Bashkimit

<sup>12</sup> Caruso F, Sico L, *Le nuove frontiere della disciplina della concorrenza e del mercato nell'Unione europea*, Giapicheli, Torino 2013.

<sup>13</sup> *Konventa e Parisit*, 1883

<sup>14</sup> *Konventa për Sistemimin European të Dhënies së Patentave*, tetor 1973 në Muni.

Gurra, Q.

dhe

Gurra, J.

« Mbrojtja ndërkombëtare e pronësisë intelektuale »

Policimi

dhe

Siguria

nr.7, 2017

Evropian, ratifikimin e konventave ndërkombëtare në këtë fushë dhe zbatimin konsekuent të tyre, për arritjen e një niveli të ngjashëm mbrojtjeje me atë që ekziston në konventat ndërkombëtare. Detyrimet e Republikës së Shqipërisë përcaktohen nga nenet 70 dhe 73 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe për realizimin e tyre është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 760, datë 1. 9. 2010, “Strategjia kombëtare e zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale”.

Kjo strategjia kombëtare përcakton një sërë masash të rëndësishme:

Sipas të drejtës ndërkombëtare private në Shqipëri, ekziston ligji nr .9947, datë 7.7.2008, për rregullimin e pronësisë industriale.

Jo më shumë se 5 për qind e botimeve, janë libra me teknikë të shkrimit akademik. Përshtatjet, kompilimet deri tek plagjiatura e hapur, sundojnë në fushën e botimeve.

Për Gjykatën Europiane të së Drejtave të Njeriut, e drejta e autorit është një e drejtë themelore.

Sipas nenit 1 të protokollit të parë, çdo person fizik ka të drejtën e respektimit të pronës së tij.

Gjykata duke u bazuar në këtë nen, shprehu se termi “pasuri” përfshin dhe licencat, por gjithashtu dhe markat.

Gjykata konsideron se veprat që mbrohen nga e drejta e autorit janë ato pasuri që njihen nga vetë konventa (vepra letrare dhe artistike, marka, licenca).

Muzika, filmat, librat, arti, shpikjet e ndryshme, si dhe format e tjera të krijimtarisë dhe shprehjes, janë tregues të progresit social dhe cilësisë së jetës.

Si pronësi private të krijuesve të tyre origjinale, ato janë vlerësuar dhe mbrojtur nga shoqëria për rolin e tyre ekonomik, politik dhe kulturor, si shprehje e trashëgimisë dhe e përpjekjeve njerëzore.

Niveli i piratërisë në vendin tonë, është në një shkallë mesatare dhe gjendja e legjislacionit dhe moszbatimi i ligjit (nga ana e individëve të ndryshëm) kanë qenë disa prej shkaqeve për këtë fenomen. Në sistemin tonë të së drejtës, instituti i së drejtës së autorit është i vonë. Kalimi nga lufta e dytë botërore në sistemin monist, padyshim që do ndikonte në rregullimin ligjor të kësaj fushe. Të njëjtën linjë Bashkimi Europian ka ndjekur edhe për fushën e të drejtës së autorit nëpërmjet direktivave. Por ky vendim nuk shtrihet vetëm për shtetet anëtare por edhe për shtetet që synojnë të jenë pjesë e bashkimit. Ndaj këtyre shteteve lind detyrimi i përshtatjes së legjislacionit kombëtar me atë të Bashkimit Europian, me anë të transpozimit të direktivave.

Në punim flitet për synimin e Shqipërisë për të qenë pjesë e BE-së sa më shpejt. Ne kemi nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit dhe kemi marrë përsipër detyrimin për futjen e direktivave në legjislacionin kombëtar të pronësisë intelektuale, të së drejtës së autorit. Nxitja e debatit publik rreth çështjeve aktuale në lidhje me mbrojtjen e pronësisë intelektuale, veçanërisht nga perspektiva e së drejtës ndërkombëtare dhe biznesit ndërkombëtar, përfshirja e sferës së medias dhe masmedias në bashkëpunim në këtë fazë shfaqet si një hap konkret dhe i dobishëm për tu realizuar.

Mbështetja e publikut është një element themelor për suksesin e këtyre iniciativave. Kjo mund të arrihet vetëm nëse publiku do të këtë mundësi të njihet me pasojat e padëshirueshme të shkeljeve të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe gjithashtu të kuptojë ndikimin që ato kanë në jetën e tyre. Në këtë kontekst, është e nevojshme jo vetëm që sektori publik t'i mbrojë si duhet të drejtat e zotëruesve të së drejtave individuale, por edhe që publiku i gjerë të kuptojë se blerja e mallrave të imituara ose të falsifikuara çon në përkeqësim të situatës së punësimit, shpesh duke marrë produkte të

pagarantuar, duke përfshirë edhe ndikimet në fushën e shëndetësisë dhe higjienës dhe nxit përfitimet e strukturave të jashtëligjshme në shoqëri.

Gjithashtu, brenda kuadrit të mundësive ekonomike, publiku prirret të zgjedhë opsionin e marrjes së mallrave me çmimin më të ulët të mundshëm. Ndërkohë, përveç rolit promovues të menjëhershëm që ka media, sensibilizimi i opinionit lidhur me të drejtat e pronësisë intelektuale duhet të trajtohet në mënyrë strategjike nëpërmjet ndryshimeve të nevojshme në sistemin arsimor. Strategjia kombëtare propozon masat që duhet të merren në sistemin arsimor shqiptar, nëpërmjet rivlerësimit të kurrikulave mësimore si dhe përfshirjes në to, të së drejtave të pronësisë intelektuale

## Bibliografi

1. *Konventa e Bernës*, 1826.
2. *Konventa e Brukselit*, 1968.
3. *Konventa e Gjenevës*, 1952.
4. *Konventa Botërore e së Drejtës së Autorit*.
5. *Konventa e Romës*, 1961.
6. *Konventa e Gjenevës*, 1971.
7. *Konventa e Parisit*, 1883.
8. *Konventa për Sistemin Europian të Dhënies së Patentave*, tetor 1973 në Muni.
9. Qoku Maks, *E Drejta Ndërkombëtare Private*, Tiranë, 2015.
10. *Konventa e Parisit*, 1883.
11. Bashkimi Europian, *Përmbledhje Traktatesh*, Tiranë 2000.
12. Direktiva 2006/116/EC, "Mbi kohëzgjatjen e mbrojtjes të së drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të".
13. *Dirito del'Unione Europea- Aspeti Stiuzionali e Politche Del'Unione*, XVI.
14. *Dirito del'Unione Europea*, Edizione aggiornata all'entrata in vigore del trattato di Lisbona, Edizioni Simone, 2010.
15. D'Arcy F, *Politkat e Bashkimit Europian*, Papirus, 2007, Tiranë.
16. *Direktiva e KE-së 2006/116/EC për harmonizimin kohëzgjatjes së mbrojtjes së të drejtave të autorit*.
17. Caruso F, Sico L, *Le nuove frontiere della disciplina della concorrenza e del mercato nell'Unione europea*, Giapicheli, Torino 2013.
18. Johan J. Wild, Kenneth L. Wild, Jerry C.Y.Han, *International Business*, botimi II, USA, 2004.

**Gurra, Q.**

**dhe**

**Gurra, J.**

« Mbrojtja  
ndërkombëtare  
e pronësisë  
intelektuale »

Policimi

dhe

Siguria

**nr.7, 2017**

# Organizatat si sisteme të mësuarit - domosdoshmëri për sukses



■ **Prof. Asc. Dr. Edmond BRANESHI**  
Zëvendësrektor,  
Akademia e Forcave të Armatosura



■ **Prof. Asc. Dr. Qetsor ORHAN**  
Akademia e Sigurisë

## Abstrakt

*Artikulli trajton një sërë metodash që drejtuesit mund të përdorin për t'i bërë organizatat e tyre të suksesshme në mjedise që karakterizohen nga ndryshueshmëria, pasiguria, kompleksiteti dhe paqartësia. Si sisteme të hapura, organizatat janë shumë të angazhuara me mjediset e tyre. Organizatat e suksesshme zhvillojnë tipare dalluese dhe kryejnë procese që i lejojnë ato t'u përshatën situatave jonormale, rreziqeve dhe mundësive. Paradigma e sistemeve është një mjet i fuqishëm, që ofron një qasje për të analizuar aftësitë organizative përmes kuptimit dhe arsyetimit të proceseve që ndodhin në to. Një mjet shumë i vlefshëm në paradigmen e sistemeve është të mësuarit e organizatës, duke u bazuar te përvoja e saj. Kjo tërësi procesesh jep mundësi për të përmirësuar aftësitë e një organizate, duke iu përgjigjur me sukses sfidave të ardhshme të mjedisit.*

## Fjalëkyçe:

**leadership, organizatë, sisteme të hapura, paradigma sistemesh, siguria.**

Braneshi, E.  
dhe

Orhani, Q.

« Organizatat  
si sisteme  
të mësuarit -  
domosdoshmëri  
për sukses »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

130

## 1. Hyrje

Paradigma e sistemeve është një mënyrë të menduari rreth mjedisit strategjik dhe njëkohësisht mënyrë të zhvilluari i procesit në organizata për të arritur objektivat strategjikë. Paradigma e sistemeve duhet të konsiderohet si një mjet që drejtuesit mund ta përdorin për të projektuar aftësitë e organizatës së tyre për të analizuar mjedisin taktik dhe strategjik, për të zhvilluar dhe vënë në veprim strategjitë në përgjigje të kërkesave të mjedisit dhe për të mbajtur një kulturë organizative të përshtatshme dhe të frytshme. Këto tre tipa procesesh organizative janë të rëndësishëm për të përcaktuar nëse një organizatë mund të realizojë objektivat strategjikë në një mjedis konkurrues.

*A Leader's Strategic Analysis of the Environment.*

Në 1997, analizat e Robert Shapiros<sup>1</sup> (zyrtari kryesor ekzekutiv i Monsanto Company<sup>2</sup>) mbi mjedisin strategjik të Monsanto u përballën me nevojën e së ardhmes së kompanisë për të krijuar produkte me kosto të ulët dhe të padëmshëm për mjedisin. Ai bëri të ditur që Monsanto do të fillonte transformimin e saj nga një kompani kimikatesh (renditur e katërta më 1996 në industrinë kimike të brendshme dhe e tetëmbëdhjeta në industrinë kimike globale) në një ndërmarrje me veprimtari shkencore përkushtuar zhvillimit të shëndetit njerëzor, duke kërkuar sinergjitë në teknologjinë biologjike, kërkimeve farmaceutike dhe produkteve ushqimore.

*Developing and Enacting Strategies in Response to Environmental Demands.*

<sup>1</sup> Robert B. Shapiro, lindur në 4 gusht 1938 në qytetin e Nju-Jorkut është një biznesmen dhe përfaqësues ligjor (jurist), që ka punuar në të shumtën e kohës në korporatat kimike G.D. Searle dhe Monsanto Company (shënim i autorit).

<sup>2</sup> Monsanto Company është një korporatë shumëkombëshe bioteknologjike e bujqësore. Ajo është prodhuesi kryesor i herbicideve glyphosate. Monsanto gjithashtu është prodhuesi kryesor i farërave gjenetikiisht të përpunuara. Ajo siguron 90 % të këtyre farërave në tregun amerikan (shënim i autorit).

**Braneshi, E.  
dhe  
Orhani, Q.**  
« Organizatat  
si sisteme  
të mësuari -  
domosdoshmëri  
për sukses »

Policimi  
dhe  
Siguria  
**nr.7, 2017**

Profesorja e Harvardit Rosabeth Moss Kanter, me studimin e saj për korporatat e mëdha amerikane, doli në përfundim që organizatat e suksesshme kanë kultura që inkurajojnë mekanizma të shumtë domethënës dhe mundësojnë reagime të shpejta për të ndryshuar mjedisin, duke nxitur bashkëpunime të frytshme midis njerëzve për punën.

Këta shembuj ilustrojnë një nga parimet kyç në paradigmen e sistemeve: mbijetesa e një organizate është e bazuar në kuptimin, analizat dhe ndërveprimin me mjedisin e saj. Është e rëndësishme të krijosh një tërësi përkufizime termash, që janë të lidhur ngushtësisht me paradigmen e sistemeve në vendimmarrjen strategjike.

## 2. Çfarë është një sistem?

Sistemet përbëhen nga komponentë të ndërlidhur, në mënyrë të tillë që elementet e sistemit dhe të përbërësve të tij të ndryshohen nëse sistemi shpërbëhet në një mënyrë apo në një tjetër<sup>3</sup>. Me fjalë të tjera, sistemet përbëhen nga një platformë elementesh të lidhura së bashku në marrëdhënie ndërvarësie. Nëse marrëdhëniet janë ngushtësisht të ndërvarura, një ndryshim në njërin pjesë të sistemit mund të sjellë ndryshime në të gjithë sistemin. Kjo ndërvarësi ndërmjet pjesëve ose elementeve rezultojnë në një tërësi të integruar.<sup>4</sup> Ekzistojnë nivele të ndryshëm sistemesh, duke filluar nga sistemet mekanike të thjeshta me marioneta apo veprime të paracaktuara levë-manivel (për shembull, në një motor automobili) deri te organizatat shoqërore komplekse që veprojnë për të realizuar objektivat. Paradigma e sistemeve përqendrohet në këto procese që ekzistojnë ndërmjet vetë përbërësve të sistemit, dhe midis këtyre të fundit dhe mjedisit.

## 3. Organizatat janë sisteme të hapura

Sot, organizatat ekzistojnë në mjedise globale konkurruese ku ka një garë të fortë për burime, tregje, punonjës të kualifikuar dhe risi. Në të njëjtën kohë, shumë organizata përballojnë mjedise që janë të paparashikueshëm dhe të ndërlikuar. Mjediset e organizatave janë të shumëllojshme dhe kanë disa tipare:

Së pari, si *sisteme të hapura*, organizatat janë shumë të angazhuara me mjediset e tyre. Organizatat e suksesshme zhvillojnë tipare dalluese dhe kryejnë procese që i lejojnë ato t'u përshatën situatave jonormale, rreziqeve dhe mundësive. Ato nënkuptojnë aftësi nga mjedisi. Kjo aftësi mund të arrihet, duke marrë përvojë nga një organizatë tjetër nëpërmjet një sipërmarrjeje apo projekti të përbashkët; ose duke përmirësuar kapitalin e tyre fizik e njerëzor; ose duke marrë informacionin e nevojshëm me qëllim që ta shndërrojë këtë aftësi në rezultatin e dëshiruar, të tilla si përfitimet fizike, shërbimet apo një strukturë e përqendrimit të parave ose veprime operacionale.

Së dyti, proceset e transformimit të organizatave kanë natyrë ciklike, si të thuash, proceset kanë një strukturë të rregullt dhe parashikuese që mund të përcaktohen prej ciklit buxhetor, ose periudhës kohore më të frytshme. Këto procese të mirëorganizuara krijojnë qëndrueshmëri dhe rezistencë ndaj çrregullimeve, duke ruajtur besueshmërinë e proceseve të transformimit, pavarësisht nga ndryshimi i kushteve të mjedisit. Gjithashtu,

Braneshi, E.  
dhe  
Orhani, Q.

« Organizatat  
si sisteme  
të mësuarit -  
domosdoshmëri  
për sukses »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

132

<sup>3</sup> Ashmos, D. P., and G. P. Huber. 1987. The systems paradigm in organizational theory: Correcting the record and suggesting the future. *Academy of Management Review* 12 (4): 607.

<sup>4</sup> Michael J. Papa, Tom D. Daniels, Barry K. Spiker, *Komunikimi organizativ, qasjet dhe prirjet*, UET Press 2009, f. 88.

sistemet e hapura kanë procese skanimi dhe vëzhgimi të hollësishëm për mjedisin.

Së treti, sistemet e hapura funksionojnë nën kushtet e ekuilibrit dinamik dhe procesit të ruajtjes së natyrës së sistemit përmes rritjes ose zhvillimit të tij. Sistemet e hapura përdorin procese të brendshme rishikimi për të modifikuar proceset e tyre të kontrollit mjedisor, të informacionit që hyn, të transformimit dhe të informacionit që del për t'iu përshtatur faktorëve të ndryshueshëm të mjedisit (*paqëndrueshmëria, pasiguria, kompleksiteti dhe paqartësia*), duke mbetur ndërkohë të fokusuar në kompetencat e tyre thelbësore. Këto modifikime kulmojnë në rritjen sasimore e cilësore të aftësisë së organizatës për t'iu përgjigjur pasigurive të së ardhmes.

Paradigma e sistemeve është një model me vlerë i aftësive të agjencive qeveritare, zyrave, drejtorive apo ministrive, veçanërisht të Ministrisë së Mbrojtjes. Drejtoritë përkatëse të MM dhe Shtabit të Përgjithshëm (sidomos J2) përpunojnë sasi të mëdha informacioni rreth mjedisit të jashtëm. Kjo i shërben drejtpërsëdrejti analizës së kërcënimeve dhe rreziqeve, zbatimit të proceseve që përpunojnë informacionin rreth fuqisë njerëzore e rezervave të kapaciteteve luftarake dhe rregullojnë proceset e jashtme për informacionin e sintetizuar për të mbështetur të gjitha nivelet e vendimmarrjes.

Në të vërtetë, ne karakterizohemi më shumë nga ndryshimi se sa nga qëndrueshmëria. Ka kërkesa pafund për reforma në çështjet e ristrukturimit të mbrojtjes, të kujdesit ndaj ndryshimeve rrënjësore në çështjet globale ushtarake dhe kërcënimit në rritje të terrorizmit. Këta ndryshime në mjedis kanë ndikime në nivel strategjik përtej fushës së një vendimmarrësi të vetëm apo madje, të një ekipi të lartë menaxhues që ka lidhje me vendimmarrjen. Por, paradigma e sistemeve nxit dhe kërkon që drejtuesit e së ardhmes të analizojnë aftësitë e organizatës së tyre për t'iu përgjigjur çështjeve të paqëndrueshmërisë, pasigurisë, kompleksitetit dhe paqartësisë. Ja disa pika që duhen të merren në konsideratë:

- Çdo çështje do të ketë një sërë faktorësh unik të mjedisit që kanë ndikim në sistemin e funksionimit të organizatës. Cila pjesë e organizatës është përcaktuar të nxjerrë në pah dhe të analizojë këta faktorë?

- Në dritën e këtyre çështjeve, a mundet të përftohet sigurimi i kontributeve të tilla, si buxheti, lënda e parë dhe kapitali njerëzor, duke rritur efektshmërinë e organizatës?

- A do të përballeshit me sfidat kur mjedisi ndryshon sipas kërkesave radikale të një procesi transformues, duke nisur dhe mbështetur nivelin e dëshiruar të aftësive për të vepruar?

Aftësia për t'iu përgjigjur këtyre çështjeve varet se si ju formatoni aftësitë organizative. Në qoftë se ju e shihni organizatën si një *projekt strukturor* (për shembull, një batalion), si një skemë organizative (për shembull, një drejtori në Shtabin e Përgjithshëm), si një listë ose organikë personeli (për shembull, zyrë auditimi)... për më tepër, ju nuk do të arrini të kuptoni se si proceset janë të përkthyer në aftësi. Ju keni nevojë për të përshtatur mendimin tuaj ndaj një *kuptimi sistemesh* për të sjellë apo mundësuar këto dinamika.

*Parë nga perspektiva e sistemeve, organizatat janë grumbullime të kapitalit njerëzor dhe fizik që shkëmbejnë dhe përpunojnë informacionin, transformojnë objektivat fizikë dhe marrin vendime me qëllim që të arrijnë objektivat përkatës që kanë lidhje me mjedisin e tyre të jashtëm. Me fjalë të tjera, organizatat përfaqësojnë një përzierje komplekse të elementeve të mëposhtëm: vizionit, qëllimeve, objektiveve, rregullave*

**Braneshi, E.  
dhe  
Orhani, Q.**  
« Organizatat  
si sisteme  
të mësuarit -  
domosdoshmëri  
për sukses »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

të zakonshëm dhe praktikave, njerëzve; mekanizmeve, marrëdhëniet e brendshme (kultura, vlerat, etika) dhe marrëdhëniet e jashtme (organizatat e tjera, grupet e interesit, dhe mjedisi.<sup>5</sup> Nga ky kuadër reference, drejtuesit mund të gjejnë mënyra për të zhvilluar proceset ekzistuese në organizatë, mund të identifikojnë nevojën për procese shtesë të analizave të mjedisit për të ruajtur mbijetesën e organizatës.

## 4. Paradigma e sistemeve dhe vendimmarrja strategjike

Sot, drejtuesit strategjikë të organizatave konkurruese përballen me sfidat përkatëse të sistemeve të hapura të organizatave të tyre për t'u përgjigjur sfidave të mjedisit aktual dhe të së ardhmes. Kjo është një detyrë e vështirë për çdo ekip të drejtuesve strategjikë, pavarësisht zgjuarsisë dhe përvojës së tyre. Shpesh, drejtuesit e këtij niveli përballen si me sasinë, ashtu edhe me dukuritë e paqëndrueshmërisë, pasigurisë, kompleksitetit dhe paqartësisë të ndryshimit të mjedisit. Nuk janë të pakta rastet, kur këto kushte i venë vendimmarrësit në situata që janë përtej ekspertizës apo njohurive të tyre. Në këto situata, në qoftë se një vendim duhet të merret, drejtuesit duhet të mbështeten vetë në këqyrjen, analizat dhe interpretimin e të dhënave të tyre, pavarësisht paragjykimëve të tyre vetjake. Disa drejtues janë efektivë në përdorimin e kësaj teknike, por për çështje më strategjike kërkohen metoda tepër rigorozë për zgjidhjen e tyre.

Për qëllimet e vendimmarrjes strategjike, organizatat mund të quhen *sisteme interpretimi*.<sup>6</sup> Interpretimi organizativ përkufizohet si “procesi i përshtatjes apo i shpjegimit të ngjarjeve dhe zhvillimit të kuptimit të ndërsjellë dhe skemave ose projekteve konceptuale ndërmjet anëtarëve të nivelit më të lartë të menaxhimit”.

Në përgjithësi, anëtarët e organizatave mbështesin interpretimet e drejtuesve strategjikë me anë të krijimtarisë dhe zhvillimit të aftësisë së organizatës për të grumbulluar informacionin rreth rreziqeve dhe mundësive të mjedisit; analizës me efektivitet, vlerësimit dhe sintetizimit deri në detaje të këtij informacioni për të mbështetur procesin e vendimmarrjes strategjike. Proceset e interpretimit organizativ janë të vlefshme për vendimmarrësit strategjikë në dy pika. Së pari, ato ulin “dozën” e paqartësive të çështjeve strategjike, duke analizuar të dhënat e marra drejtpërdrejt nga mjedisi. Së dyti, këto procese, ulin gjithashtu edhe “dozën” e pasigurisë (për shembull, vëzhgimi i shqendërzuar i kryer përgjatë “zonës” së organizatave, të sektorëve të niveleve më të ultë dhe individëve specialist, japin një pamje më të gjerë dhe më të saktë për çështjet strategjike në një kohë më të shkurtër). Përfitimi themelor për vendimmarrësit strategjikë është që ata mund t'u përgjigjen çështjeve strategjike më shpejt, me vendime të një cilësie më të lartë.

Në qoftë se drejtuesit i lejojnë organizatat e tyre të diskutojnë çdo përballje me ndryshimin e mjedisit si një përvojë unike, atëherë, pavarësisht përmbushjes së rezultateve, këto drejtues nuk janë duke përfituar aftësinë e plotë të interpretimit organizativ. Kur organizatat zhvillojnë aftësitë për të mësuarit sistematik atëherë përvojat e suksesshme dhe jo të suksesshme do të ndikojnë favorshëm në proceset e ardhshëm të këqyrjes, shoshitjes dhe interpretimit. Mareshalli Foch, te “Parimet e Luftës” shkruan:

Braneshi, E.  
dhe  
Orhani, Q.

“Organizatat  
si sisteme  
të mësuarit -  
domosdoshmëri  
për sukses”

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

<sup>5</sup> Prof. Dr. Ruzhdi Ramadani, Dr. Agim Lala, Prof. As. Kristaq Xharo, Dr. Edmond Braneshi, *Udhëheqja Strategjike*, Shtëpia Botuese “GEER”, Tiranë 2010, f. 273.

<sup>6</sup> Daft R. L., and K. E. Weick. 1984. Toward a model of organizations as interpretation systems. *Academy of Management Review* 9: 284.



“E vërteta është se gjatë betejës nuk mund të studiosh: atje e shumta, bën atë çka mund, me qëllim që të zbatosh atë çka di. Prandaj për të bërë qoftë edhe pak, duhet të kesh mësuar shumë, madje shumë mirë”<sup>7</sup>.

## 5. Organizatat si sisteme të mësuarit

Të mësuarit, qoftë ai i lidhur me njerëzit apo me organizatat, është një tërësi procesesh që prodhon ndryshime. Edwin Nevis, Anthony DiBella dhe Janet Gould nga MIT<sup>8</sup>, Qendra e të Mësuarit Organizativ përkufizojnë të mësuarin organizativ si “*kapacitet (mundësi) ose procese brenda organizatës për të ruajtur ose përmirësuar performancën bazuar në përvojë*”. Qëllimi i kësaj çështjeje është identifikimi i rrugëve të drejtuesve që mund të ndikojnë mbi këto procese për t’i dhënë shtysë të mësuarit dhe për të përmirësuar udhëheqjen dhe vendimmarrjen strategjike.

Në fillim të këtij shkrimi, ne përshkruam tiparet e organizatave si sisteme të hapura. Dy nga këto tipare i përkisnin sistemit të së mësuarit organizativ<sup>9</sup>:

- Aftësia e organizatës për të rishikuar brenda për brenda vetes efektshmërinë e proceseve të sistemeve krahasuar me dinamikën e mjedisit dhe brenda parametrave të kompetencave të saj thelbësore.

- Modifikimi i procesit grumbullues që rezulton në një rritje sasiore dhe cilësore të aftësisë së organizatës për t’iu përgjigjur pasigurive të ardhshme të mjedisit.

Tipari i parë nxjerr në pah rëndësinë e anëtarëve të organizatës kushtuar *përmirësimit të procesit të vazhdueshëm*. Shprehja “përmirësimi i procesit” është shumë e përdorshme, por ajo do të thotë që njerëzit duhet të jenë duke analizuar vazhdimisht se si ato mendojnë, komunikojnë, përmbushin detyrimet dhe shtojnë vlera për organizatën e tyre. Gjithashtu, tipari i parë nënkupton atë, që anëtarët kanë nevojë të zotërojnë njohuri të plota dhe të hollësishme mbi kompetencat thelbësore të organizatës, se si puna e tyre kontribuon tek këto kompetenca dhe tek faktorët e mjedisit që kanë lidhje po me këto kompetenca thelbësore.

*Niveli i të kuptuarit të punonjësve rreth kompetencave thelbësore të organizatës është e inicuar dhe fuqizuar prej mesazheve të udhëheqjes*. Kur drejtuesit komunikojnë se si kompetencat thelbësore të organizatës janë të lidhura me veprimtaritë e njëjse të ndryshme vartëse, atëherë punonjësit do të kuptojnë se si përpjekjet e tyre ditore konvertohen në aftësi në të mirë të organizatës. Për më tepër, kur drejtuesit komunikojnë vizionin e organizatës, vlerat dhe ideologjinë që mbështet kulturën e saj, ata rrisin te punonjësit e tyre dukurinë e të kuptuarit rreth objektivave strategjike të organizatës. Si shembull tipik mund të përmendim Gjeneral Colin Powell, i cili ishte një profesionist shumë i mirë, kishte përvojë, kishte integritet, kuptonte objektivat politike<sup>10</sup> që mund të arriheshin me forcë, kishte mendje të kthjellët, intelektualisht ishte sundues dhe kishte aftësi për t’u komunikuar civilëve botën ushtarake dhe procedurat e komandimit e të

<sup>7</sup> L.A. Pennington, Romeyn, B. Hought, H.W. Case, “Psikologjia e drejtimit në ushtri”, SHBU, Tiranë 1993, fq. 87.

<sup>8</sup> Massachusetts Institute of Technology (MIT), Instituti i Teknologjisë në Masaçuset është një universitet privat kërkimesh dhe hulumtimesh i vendosur në Kembrixh, Masaçuset. Ai ka pesë shkolla dhe një kolegji, duke patur në total 32 departamente akademike, me prije veçanërisht në kërkime shkencore dhe teknologjike. I themeluar në vitin 1861, në përgjigje të rritjes së industrializimit në SHBA, Instituti adoptoi modelin e universitetit politeknik evropian, duke vënë theksin që në fillimet e saj në mësimet laboratorike (Shënim i autorit).

<sup>9</sup> Termi “Të mësuarit organizativ” (Organizational learning) është një fushë e dijes brenda teorisë mbi organizatën që studion modelet dhe teoritë rreth mënyrës se si një organizatë mëson dhe përshtatet (Shënim i autorit).

<sup>10</sup> Kolin Pauell, *Udhëtimi im amerikan*, SHBU, Tiranë 1999, f. 13.

**Braneshi, E.  
dhe  
Orhani, Q.**  
« Organizatat  
si sisteme  
të mësuarit -  
domosdoshmëri  
për sukses »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

drejtimit në ushtri.

*Drejtuesit organizativ duhet të institucionalizojnë proceset e përvetësimit të njohurive. Përvetësimi i njohurive përfshin veprimet e mendimet e stafit përkatës, programet e kërkim zhvillimit, projektet treguese, rishikimet e performancës dhe analizat e fryteve konkurruese të punës. Objektivi për përvetësimin e njohurive është përmbushja në vazhdimësi në dallim nga një reagim i vetëm ndaj një kërkese të menaxhimit. Në një sistem të mësuarit organizativ, përvetësimi i njohurive ndiqet nga shpërndarja e informacionit. Studiuesi për çështjet e organizatës, George Huber nga Universiteti Teksasit në Austin përshkruan shpërndarjen e informacionit si më poshtë: “Shpërndarja e informacionit është përcaktuese e zhvillimit dhe e gjerësisë së të mësuarit organizativ... zakonisht, përbërësit e organizatës përpunojnë informacionin e “ri”, duke bashkuar në një të vetme pjesët e informacionit, të marra nga njësitë vartëse të organizatës... Kur informacioni, në një organizatë shpërndahet gjerësisht, në mënyrë të tillë që të ekzistojnë gjithnjë e më shumë burime të ndryshme, përpjekjet korrigjuese janë më të mundshme për të arritur suksesin dhe për rrjedhojë, individët dhe njësitë janë më të prirë të mësojnë”<sup>11</sup>.*

Madje, veprimtaria e shpërndarjes së informacionit merr një rëndësi më të madhe, kur në të angazhohen punonjësit të cilët janë të informuar mirë rreth kompetecave thelbësore të organizatës. Në më të mirën e mundshme, shpërndarja e informacionit në organizmat e të mësuarit<sup>12</sup> përfshin shkëmbimin e qëllimshëm të informacionit midis strukturave vartëse në organizata, me qëllim që të ulë përpjekjet e çdo nënstruktura më vete që të këqyrë me hollësi mjedisin. *Drejtuesit organizativ mund t’i lehtësojnë këto procese të komunikimit.* Në fund të fundit, ata mund të bëjnë investime në kapitalin njerëzor nëpërmjet programeve të trajnimit dhe zhvillimit për të standardizuar dhe përmirësuar aftësitë e “shpërndarjes së informacionit”. Rëndësia e kësaj dukurie është trajtuar edhe te “Udhëheqja Ushtarake” ku thuhet se *vartësit, duke pasur informacion për probleme të caktuara, ndihmojnë në marrjen dhe zbatimin e vendimit brenda qëllimit që ka udhëheqësi, rrisin iniciativën e tyre, përmirësojnë punën dhe bashkëveprimin dhe e ngrenë në një shkallë më të lartë moralin e tyre.*<sup>13</sup> Gjithashtu, drejtuesit mund të investojnë në kapitalin fizik. Ata mund të krijojnë sisteme të gjera informacioni, të cilat lehtësojnë dhe rrisin shkallën e shkëmbimit të informacionit nëpër njësitë vartëse (apo seksione, degë, departamente).

## 6. Kujtesa e organizatës

Tipari i dytë i sistemeve të hapura, që zbatohet në organizmat e të mësuarit është *proces i modifikimit*. Ky tipar varet nga proceset e kujtesës së organizatës. Aftësia e organizatës për të mësuar, dhe tek e fundit, përmirësimi i përgjigjeve të ardhshme të saj për mjedisin mbështetet në proceset që:

- regjistrojnë përvojat e organizatës, të cilat kanë lidhje me objektivat strategjike;

<sup>11</sup> Huber G. P. 1991. Organizational learning: The contributing processes and the literatures. *Organization Science* 2 (1): 88.

<sup>12</sup> Organizmat e të mësuarit (learning organization) është term që i jepet organizatës, e cila lehtëson të mësuarit e anëtarëve të saj, duke transformuar veten vazhdimisht. Ato zhvillohen si rezultat i presioneve me të cilat përballen organizatat moderne dhe u mundëson atyre që të mbeten konkurruese në mjedisin ku veprojnë. Një “learning organization” ka pesë karakteristika kryesore: sistemet e të menduarit, zotërim personal, modelet mendore, vizion të përbashkët dhe të mësuarit ekipit (Shënim i autorit).

<sup>13</sup> “Udhëheqja ushtarake”, SHBU, Tiranë 1995, faqe 38.

- korrigjojnë përvojën e organizatës;
- zbatojnë këto përvoja në veprimtaritë e vendimmarrjes strategjike.

Megjithatë, proceset që krijojnë kujtesën e organizatës, shpesh bëhen problematike. Shumë organizata kanë kujtesë të varfër për shkak të një besimi vetëm në kujtesën e punonjësve për të ruajtur, korrigjuar dhe zbatuar përvojat e organizatës. Kjo formë e kujtesës së organizatës është e prekshme ndaj ndryshimeve dhe shkurtimeve (strukture). Për më tepër, organizatat mund të kenë kujtesa të pamjaftueshme të sukseseve ose dështimeve sepse drejtuesit zhvillojnë procese për adresim të çështjeve të menjëhershme, por dështojnë për vlerësim në qoftë se proceset kanë vlera për të ardhmen. Së fundi, kujtesa e varfër e organizatës, mund të burojë nga mungesa e proceseve të vetë organizatës për të dokumentuar dhe regjistruar (kataloguar) veprimet dhe përfundimet e organizatës, ose për të vlerësuar se si strategjitë e shkuara mund të zbatohen për të realizuar objektivat e reja strategjike.

Drejtuesit mund të ndërhyjnë për të përmirësuar proceset e kujtesës së organizatës. Për shembull, ata duhet të përcaktojnë se si përvojat aktuale të organizatës janë të lidhura me vizionin që ata kanë për të, me kompetencat thelbësore të saj dhe me objektivat strategjike. Këto veprime ndihmojnë në vendosjen e kriterëve për identifikimin që përvojat duhet të jenë pjesë e kujtesës së organizatës.

Më tej, drejtuesve u nevojitet të forcojnë rolin e tyre si modelues të kulturës së organizatës për të ngulitur bindjen te punonjësit, që kujtesa e organizatës është një mjet i vlefshëm, instrument për arritjen e objektivit. Kur proceset e krijimit të kujtesës bëhen pjesë e kulturës së organizatës, ato kanë një shans më të mirë për jetëgjatësi, pavarësisht nga ndryshimet që ndodhin te punonjësit. Jo më kot kultura e organizatës, lehtësisht përkufizohet “mënyra se si ne i bëjmë gjërat këtu”<sup>14</sup>. Kultura nuk ndryshon shpejt por ata mund ta zhvillojnë.

Gjithashtu, erozioni i kujtesës së organizatës mund të zvogëlohet kur drejtuesit i japin formë proceseve për krijimin dhe përdorimin e saj. Kujtesa, bazuar te kompjuteri mund të variojë nga sistemet ngushtësisht arkivore deri te “banka e kujtesës” (database), që vazhdimisht përpunojnë informacionin dhe krijojnë rrjete nga përvojat e organizatave, duke siguruar akses të shpejtë nëpërmjet motorëve të kërkimit.

Si për ta mbyllur, kujtesa e organizatës, ashtu si kujtesa njerëzore, përmirësohet kur vihet në përdorim. Drejtuesit strategjike duhet të krijojnë kushte të përshtatshme dhe të gjejnë rrugë apo mënyra për të rritur lidhjet dhe kapacitetin e kujtesës së organizatës. Ata duhet të rrisin mundësitë për anëtarët e organizatës për ta përdorur këtë kujtesë në mbështetje të vendimmarrjes strategjike, ose në proceset e tyre të vendimmarrjes strategjike.

## 7. Përfundime

Ky artikull trajton një sërë metodash e mjetesh që drejtuesit mund të përdorin për t'i bërë organizatat e tyre të suksesshme në mjedise që karakterizohen nga ndryshueshmëria, pasiguria, kompleksiteti dhe paqartësia. Paradigma e sistemeve është një “mjet madhor”, që ofron një qasje për të analizuar aftësitë organizative përmes kuptimit dhe arsytimit të proceseve që ndodhin në to. Ky mjet mund të jetë i vështirë për disa, që ta zotërojnë

<sup>14</sup> Mike Mears, Leadership Elements, A Guide to Building Trust, iUniverse, Inc New York Bloomington 2009, faqe 243.

**Braneshi, E.**  
**dhe**  
**Orhani, Q.**  
« Organizatat  
si sisteme  
të mësuarit -  
domosdoshmëri  
për sukses »

Policimi  
dhe  
Siguria  
**nr.7, 2017**

apo kontrollojnë, por ai ka vlerë për shumë çështje të organizatave që kanë të bëjnë me mjedisin strategjik. Një mjet shumë i vlefshëm në paradigmen e sistemeve është të mësuarit e organizatës. Kjo tërësi procesesh jep mundësi për të përmirësuar aftësitë e një organizate, duke iu përgjigjur me sukses sfidave të ardhshme të mjedisit.

Duke nxjerrë në pah këto koncepte si mjete që ndihmojnë në arritjen e suksesit, përgjegjësia më e madhe qëndron tek udhëheqja (leadershipi), mënyra se si përdor këto mjete për të arritur rezultate me efektshmëri strategjike dhe njëkohësisht favorizuese për organizatën.

## Referenca

1. Ashmos, D. P., and G. P. Huber. 1987. The systems paradigm in organizational theory: Correcting the record and suggesting the future. *Academy of Management Review* 12 (4).
2. Daft, R. L., Sormunen, J. and D. Parks. 1988. Chief executive scanning, environmental characteristics, and company performance. An empirical study. *Strategic Management Journal* 9.
3. Daft R. L., and K. E. Weick. 1984. Toward a model of organizations as interpretation systems. *Academy of Management Review* 9.
4. Huber G. P. 1991. Organizational learning: The contributing processes and the literatures. *Organization Science* 2 (1).
5. Mike Mears, Leadership Elements, *A Guide to Building Trust*, iUniverse, Inc New York Bloomington 2009.
6. Michael J. Papa, Tom D. Daniels, Barry K. Spiker, *Komunikimi organizativ, qasjet dhe prirjet*, UET Press 2009, ISBN: 978-99956-39-12-9.
7. Kolin Pauell, *Udhëtimi im amerikan*, SHBU, Tiranë 1999.
8. L. A. Pennington, Romeyn, B. Hought, H. W. Case, *Psikologjia e drejtimit në ushtri*, SHBU, Tiranë 1993.
9. Prof. Dr. Ruzhdi Ramadani, Dr. Agim Lala, Prof. As. Kristaq Xharo, Dr. Edmond Braneshi, *Udhëheqja Strategjike*, SHB "GEER", Tiranë 2010, ISBN: 978-9928-105-15-8.
10. *Udhëheqja ushtarake*, SHBU, Tiranë 1995.

Braneshi, E.  
dhe

Orhani, Q.

« Organizatat  
si sisteme  
të mësuarit -  
domosdoshmëri  
për sukses »

Policimi  
dhe  
Siguria  
nr.7, 2017

138

ENGLISH

---

# ABSTRACTS

---

"POLICIMI DHE SIGURIA", NR. 7, SPETEMBER, 2017

**Preventing cultivation, the key to anti-cannabis success**  
**- PhD Sandër Lleshi, PhD Xhavit Shala**

**Abstract**

In this paper the object of study and research is the treatment of the phenomenon of cannabis cultivation as a criminal activity penalized by national and international legislation, for the period 1992-2016, with the potential to return to a threat to national security, dynamics and the trend of spreading this phenomenon in our country, factors that have influenced its birth and spread, the characteristics of the war so far against this phenomenon, with the aim of identifying better methodology and giving recommendations for policy making that guarantee the success of the war on cannabis cultivation. The cultivation of cannabis has been and still remains a serious challenge for the structures of the Albanian state. The cultivation of this plant as a phenomenon, became officially known in Albania in 1993. After that, it spread rapidly almost all over the country, as a dangerous epidemic. Withdrawing - over the years - from preventative work on cannabis cultivation, lack of inter-institutional cooperation, leaving the responsibility of this war only to the State Police and the lack of co-operation with the community in cultivation areas has limited success over the years of law enforcement agencies in the fight against this phenomenon. The police operation for taking control of the Lazarat area in June 2014 has positively affected the restoration of state authority in that part of the territory that was under the control of the criminal networks of cannabis cultivation and trafficking. In this paper we will mainly focus on the phenomenon of cannabis cultivation, as it was successful at this stage and it determines the dynamics of the fight against its trafficking. During this paper, there are applied the basic quantitative and qualitative research methods and instruments, such as method of analysis and synthesis, comparative analysis, historical, juridical, comparison and confrontation as well as case studies. At the end of the paper, following the application of basic scientific research methods and instruments, it is concluded, among other things, that the key to anti-cannabis success it's the only strategy that considers successful prevention of cannabis planting, as an optimal criterion or destruction, when they are still seedlings as acceptable. The paper concludes with the conclusions, the prognosis for the future of this phenomenon, as well as recommendations for policy-making that guarantee the success of the fight against cannabis cultivation.

**Prevention of environmental crime as the responsibility judicial police**  
**- MSc Nikoll Rica, MSc Erand Rica**

**Abstract**

The aim of this theme is to give information to the reader for the criminal offences which can be committed against environment, features of the prosecution, detection, prevention and the punishment of the perpetrators, as well as the strengthening of the regional cooperation for the prevention of this activity. Our country has been faring these types of crimes times ago, they have international character and have serious consequences to life and health of every one. Air quality, water quality, the level of cleanliness from the rests, noise levels and protection of bio-diversity are the most essential elements for a healthy life. Unfortunately, in the past two decades, in the Balkan Region and particularly in Albania, has increased the number of criminal activities against the environment. During the drafting of this theme are treated

preventive or protective features and mechanisms, foreseen in international treaties and national legislation for the environment. The aspect of the legal analysis of these offenses dealt closely with the criminal procedural activities and tasks to be carried by the investigate law enforcement structures. This analysis is done from the perspective of the judicial investigative practice, based on statistical data of prosecutors and courts in Albania. It is also handled the cooperation of the State Police with Forest Inspectorate at the bilateral and regional plan for criminal information exchange and implementation of joint operations in order to protect the environment. Interesting for the reader will be the treatment of the levels of risk against environments, identified as: "environmental degradation and natural disasters; environmental destruction; as well as deforestation, pollution of rivers and natural or industrial disasters caused by human influence." These factors are considered first-level risk to the environment, both considered as high priority in the work of the bodies responsible for preventing them. At the same group of risks involved, corruption and organized crime, as high the risk factors to environmental degradation. Meanwhile, climate change, although are considered as third-level risk, should be considered serious in countries' policies to avoid bearing the consequences of not natural climate changes. In this paper, environmental protection is treated as a major task of the whole society, every citizen and no doubt governments and institutions in particular. As always, the priority from the governments is given to economy in relation with the environment. Therefore it is recommended that natural resources must be used prudently, stopping the environmental degradation and evaluate the environment as a necessity for life and health of every person.

## **Motorcycle Service at the Police**

### **MSc. Besnik Shehaj**

#### **Abstract**

Motorcycle Service at the Police (MSP) is not a novelty in itself, but in the present conditions of the policing, the role of this service takes dimensions and special attention that is dictated by a number of factors, of which the most important can mention: environment; technological developments; new issues in the field of public order or crime prevention; the growing demands of the community for public security. In this context, this article aims to analyze and argue the need for reorganization, equipment, professional training and the efficient and effective use of MSP.

The urban environment where it operates the largest part of the State Police has undergone a radical transformation from the past. Urban and interurban road infrastructure has improved considerably, creating facilities for the free movement of vehicles and citizens, while this development factor has increased the premise for exploitation by individuals with criminal inclination or violators of the law. Technological developments have improved the quality of life for citizens, enabling them to operate freely in space and time for the purposes of economic activities, social and cultural rights. On the other hand, these technological developments are largely exploited by criminal groups or unconscious individuals to realize their anti-legal intentions. New issues in the field of public order, as well as conflicts over property, domestic violence, illegal constructions, environmental protection, etc., require adequate police response strategies and tactics. Prevention and detection of crimes, due to the sophisticated forms and methods used by elements of criminal groups nowadays, require a proactive reaction of the Police to gather information and find legal evidences, as the latter

change rapidly the quality and validity to be used in the investigation process or prosecution. It is well known that delay in finding a violation or investigating a criminal event aggravates the chances of punishing or detecting them. Guaranteeing rights and freedoms in a democratic state, the awareness of citizens to exercise these rights and increasing welfare have also grown the public demands for life safety, property, dignity and integrity. So social peace becomes more and more an obligation of the state, where the main burden for its preservation is the Police.

After this "philosophical" approach, everyone can ask the question of what are the above mentioned factors with the MSP?! It is this combination that we will try to address in this paper with some theoretical and practical arguments that emerge from the current experience of State Police services in the field.

### **Violent Extremism and ISIS, threat to Security** **- PhD Xhavit Shala, MSc. Gledis Nano**

#### **Abstract**

The object of the study and research of this paper is to observe radicalism, violent extremism, and ISIS activity in terms of security threats. Radicalization, which leads toward terrorism, is a dynamic process through which an individual starts to accept terror as a possible or even legitimate way of action. Often times this might incite one to speak in favor, to act in support of, or even get involved in terrorist acts. Violent extremism is noticed when violence is exercised in such an order as to achieve political goals. This is the broader meaning of terrorism. In other words, terrorism can be described as the use of violence, mainly against non- military objects, in order to achieve political goals. In a way, violent radicalism is the process and violent extremism is the result. The escalation from "violent radicalization" into "violent extremism" heightens our threat level from danger to threat of national security. Radicalism, violent extremism, and terrorism may have ethnic, nationalistic, and religious background. ISIS is a serious threat to international, regional, and national security. Compared to other terrorist groups, ISIS has greater potential and capabilities in the areas of state organization, economic support and its own properties, its armaments in use, and the trained human resources at its disposal. The participation of Albanian nationals, whether citizens of Albania or Kosovo, as ISIS volunteer fighters in foreign conflict areas, especially in Syria and Iraq and their possible return and re-engagement in their countries of origin, constitutes a permanent threat to the national security of Albania and Kosovo. Quantitative and qualitative research methods and instruments, such as the method of analysis and synthesis, comparative analysis, legal, historical, and case studies were all applied throughout this research paper. This paper finds among other things, that radicalization, violent extremism, ISIS activities, and fighters returning from Syria, because of their indoctrination and the premises for their involvement in destabilization or terrorist activities, pose a grave risk to our national security if it is not managed properly. Nevertheless, today Albania possesses the capacities and has taken the necessary measures to cope with such terrorist threat.

### **Information Technology and State Police** **- MSc. Dashamir Çali**

#### **Abstract**

In recent years, information technology (SI / IT) has played a special role in realizing



the mission of the State Police and in accomplishing the projection's objectives of the Ministry of Internal Affairs. The article deals with the development and growth of SI / IT in the police as an approach based on ongoing knowledge and development efforts to respond to the challenges of the time, public and security order. This information technology - where later, with the growth of data communication capacities, took the meaning "Information, Information Technology and Communication Technology Systems" (SI / TIK), with the development of the "Information Network" (LAN / WAN 2, further with the development of the intranet and the internet, - has enabled the provision of a higher quality of service for the structures of the Ministry of Internal Affairs and the State Police in particular. Dynamic developments of markets and technologies, as a series of IT Information Technology) 3 technologies, for collecting, storing, locating, processing, analyzing and transmitting information have led to convergence of boundaries for specific needs and services the volume of information, to increase the effectiveness of the work of the State Police structures. It has been a long way full of challenges to reach the present levels of technology implementation within, offices, sectors, directories and specialists, not only of information technology, which may have been profiled or not. During this article, we will see this progress step by step.

**Sir Robert Peel, the creator of the modern police**  
**- Assoc. Prof. Stavri Sinjari**

Abstract

Sir Robert Peel is known as a great personality for the creation and reform of modern police, as a reformer, lawmaker, the creator of laws in the Anglo-Saxon right format. It involves many legal initiatives that sparked fundamental changes to the English Criminal Code to alleviate penalties in many penal provisions that the old code penalized with a capital punishment and to codify the new rules of the prison system, the punishment and the education of prisoners, the regulation of business laws, hours of work, the rights of women, children, ect,. As a senior state-political figure of the Victorian period in the United Kingdom, the mayor of conservatives, legislators elected in several mandates, twice prime minister, he initiated, drafted and adopted many reforms that were finalized by the law on the creation of a new police force in London. This force has been served as a lineup of a different police, where were based the embryo of the upcoming modern police rules that we have today.

**Virtual psychological criteria: the case of 'Blue Whale'**  
**- MSc. Anisa Agastra**

Abstract

Modern societies are still facing many of the problems associated with emotional, spiritual and psychological gaps that are transmitted through manipulations in virtual paths. Those have been materialized through various forms of cybercrime, as is the case of a challenging game of 'blue whales'. The focus of this paper is the psychological analysis of the functioning of 'the blue whale' balloon, its aim as targeting the victims and the widespread and the last three years in the world, as well as in Albania. The analysis is carried out by realizing parallelism and logical synthesis with the spread of cybercrime; strengthening online communication, taking into account the pros and cons of this communication; terrorism and forms of terrorist crimes focusing on the

causes of the emergence of these crimes as well as an element of the terrorist psychology, which is related to the case of 'the blue whale turtle phenomenon'. This game is aimed at targeting young people and bringing them to the suicide by following the fifteen stages that culminate with this act. The game has manipulative skills in young people, improves their psycho-emotional state until it affects them to defame themselves until they kill themselves. The defects and psycho-emotional burdens of those who created the game materialize in blue gaming, from targeting to twisting. This has given rise to social concerns that need attention from all the professional institutions, starting from the family and beyond.

**International protection of Intellectual Property**  
**- MSc. Qetësor Gurra, MSc. Jonida Gurra**

Abstract

The history of mankind is based on applications of imagination, innovations and creativity. This is done to solve various problems. Scientific progress, the great use of scientific and technical achievements in production, the expansion of not only international technical-scientific and intellectual ties, has now led to the strengthening of the problem of intellectual protection. The following will deal with such issues, but will first address key concepts in the subject.

**Organizations as learning systems, a necessity for success**  
**- Assoc. Prof. Edmond Braneshi, Assoc. Prof. Qetsor Orhan**

Abstract

The article addresses a number of methods that managers could use to make their organizations successful in environments, characterized by variability, insecurity, complexity, and ambiguity. As open systems, organizations are very committed to their environments. Successful organizations develop distinctive features and perform processes that allow them to adapt to abnormal situations, dangers and opportunities. The system paradigm is a powerful tool that provides an approach to analyzing organizational skills through the understanding and reasoning of processes occurring in them. A very valuable tool in the paradigm of systems is learning the organization, based on its experience. This whole process provides opportunities to improve an organization's capabilities, responding successfully to future environmental challenges.



*"Policimi dhe siguria",*  
rev. shkenc.  
nr. 7, shtator 2017,  
ISSN 2413-1334.  
Botues: Akademia e Sigurisë,  
Policia e Shtetit, RSH  
Përmasa: 160X240 mm

ISSN 2413-1334

AKADEMIA E SIGURISË



2 413 1 334000 3



**POLICIMI DHE SIGURIA**

**SHTATOR 2017**



**AKADEMIA E SIGURISË**

Qendra Kërkimore Shkencore  
Rruga e Elbasanit, Sauk, Tiranë



**NR**

**7**